

Doktoratë

Përgatitur nga: M.A. Ornela Çoku

Për marrjen e gradës shkencore “DOKTOR”

Fusha : Gjuhësi

Specialiteti: Stilistikë

**TIPARET DALLUESE TË LEKSIKUT DHE STILIT SHPREHËS NË
TRAGJEDINË “MAKBETH”. NJË VËSHTRIM KRAHASUES MIDIS
TEKSTIT ORIGJINAL TË SHEKSPIRIT DHE TEKSTIT TË
PËRKTHYER NGA NOLI.**

Udhëheqës Shkencor :Prof.Dr. Emine Sadiku

Mbrohet më,dt. _____.____2021

KOMISIONI

1.....Kryetar

2 (Anëtar)

3 (Anëtar)

4 (Anëtar)

5 (Anëtar)

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Fakulteti i Shkencave Humane,

Departamenti i Gjuhës Shqipe.

18.03.2021

Drejtuar : Këshillit të Profesorëve, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës Shqipe.

DEKLARATË

Për mbrojtjen e doktoraturës me temë:

Tiparet dalluese të leksikut dhe stilit shprehës në tragjedinë “Makbeth”. Një vështrim krahasues midis tekstit origjinal të Shekspirit dhe tekstit të përkthyer nga Noli.

përgatitur nga doktorantia Ornela Çoku, i programit të ciklit të tretë “Doktoratë në Gjuhësi”, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Fakultetit të Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhës shqipe.

Me cilësinë e doktorantes të temës së sipërcituar, deklaroj që punimi në fjalë është origjinal.

Doktorantia

Ornela Çoku (Muça)

ABSTRACT

This dissertation will treat the role of Noli as a translator in general and the translator of the tragedy of “Macbeth” in particular. In this work, lexical-semantic procreations, (procedes) will be another interest of study, as Noli has a perpetual propensity towards expressive lexicon. Expressive sources are closely related to their functions, in terms of stylistic value, stylistic coloration, expressive coloration of the affective and semantic order. Then it is treated the phenomenon of semantic consumption, which avoids possible usage of words that are semantically consumed.

Semantic expansion with its variations is an important issue treated in this work.

The dissertation will also treat the old-fashioned lexical elements which are systematically used by the translator. The use of the old lexical layer makes Fan Noli's discourse more lively, more convincing and real.

Noli is the master in creating new words, as new lexical units, or existing units that carry new meaning/s. As neologisms are treated those language units that have recently entered the language to mark an item or a new phenomenon that still feels like it. The new words created by Noli are built with the subject of the native language. Noli's loan-words are also treated in the dissertation.

Figures of speech used in Noli's translation are very expressive and magnificent. They attract the readers. Among the most useful tropes in translating the tragedy of "Macbeth" by Noli are: Metaphors and Metonymies. These figures are special, original and quite expressive. They are artistic-literary figures which are frequently used by Noli as part of text structures. They play a special role in grasping the meaning of texts.

The paper concludes with the findings of stylistic differences and similarities between Shakespeare's lexicon written in the original tragedy of “Macbeth” and Noli's lexicon in its translation. Thanks to the in-depth study of the issues discussed, we believe that this paper has successfully treated the above-mentioned problems by providing the common sides of the two languages for organizing the expressive lexicon.

Key words: Translator, lexical-semantic procreations (procedes), stylistic value, stylistic and expressive connotation, semantic consumption, lexical variation, lexical equalisation, lexical and stylistic dubbing, semantic irradiation, semantic and stylistic expansion, lexical units, old-words, neologisms, archaism, metaphor and metonymy.

ABSTRAKT

Në këtë disertacion do të trajtohet roli i Nolit si përkthyes, duke u ndalur veçanërisht në përkthimin e tragjedisë së “*Makbethit*”. Përftesat stilistikore do të përbëjnë një tjetër interes studimi në këtë punim, pasi Fan Noli ka një prirje të përhershme kah leksikut ekspresiv. Burimet e shprehësisë shihen të lidhura ngushtë me funksionin e tyre në pikëpamje të vlerës stilistike, ngjyrimit stilistik, ngjyrimit shprehës të rendit afektiv dhe semantik. Me pas analizohet dukuria e konsumimit semantik i cili shmang nga përdorimi i mundshëm fjalë që janë harxhuar kuptimisht.

Zgjerimi semantik me variacionet e tij është një çështje e rëndësishme që trajtohet në këtë punim.

Disertacioni trajton elementet e shtresave leksikore të përdorura sistematikisht nga përkthyesi. Përdorimi i shtresës së vjetër leksikore e bën ligjërimin e tij më të gjallë, më të vërtetë e më bindës. Noli mbetet mjeshtër në krijimin e fjalëve të reja, si njësi krejt të reja leksikore ose njësi ekzistuese që mbartin kuptim të ri. Si neologjizma janë trajtuar ato njësi gjuhësore që kanë hyrë rishtazi në gjuhë për të shenjuar një send a një dukuri të re dhe që ende ndihet e tillë. Fjalët e reja të krijuara nga Noli ndërtohen në lëmin e gjuhës amtare. Një syth tjetër në këtë disertacion janë edhe huazimet e përdorura prej tij në përkthimin e kësaj vepre.

Figuracioni i përdorur në vepër është mjaft ekspresiv dhe i goditur, gjë që tërheq dhe vëmendjen e lexuesit. Figurat letrare më të përdorshme në përkthimin e veprës së “*Makbethit*” janë metafora dhe metonimia. Këto figura janë të veçanta, origjinale dhe mjaft shprehëse. Ato janë figura artistiko-letrare që përdoren dendur në përkthimin e “*Makbethit*” si pjesë e strukturave tekstore, që luajnë një rol të veçantë në rrokjen e kuptimit të teksteve.

Punimi mbyllet me dallimet dhe ngjashmëritë stilistike midis leksikut në tekstin origjinal të Shekspirit dhe tekstit të përkthyer nga Noli. Falë studimeve të thelluara të çështjeve të trajtuara, ky punim mendojmë se ka trajtuar problemet e lart përmendura, duke dhënë anët e përbashkëta të të dy gjuhëve për organizimin e leksikut shprehës.

Fjalët kyç: Përkthyes, procede leksikore-semantike, vlerë stilistike, ngjyrim stilistik dhe ekspresiv, konsumim semantik, variacion leksikor, barazimi semantik, dublimi leksikor stilistik, rrezatimi semantik, zgjerimi leksikor semantik, shtresa leksikore, neologjizmat, huazimet, arkaizmat, metafora dhe metonimia.

FALENDERIME

Do të doja të falenderoja dhe të shprehja mirënjohjen time ndaj atyre që më ndihmuan dhe inkurajuan në realizimin e këtij punimi. Së pari, një mirënjohje e thellë dhe falënderim i veçantë shkon për prof.dr. Emine Sadikun, për përkushtimin serioz, inkurajimin dhe udhëzimet e vlefshme që më ka dhënë gjatë punës dhe realizimit të këtij punimi.

Do të falenderoja me shumë mirënjohje Departamentin e Gjuhësisë të Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, që me udhëzimet dhe ndihmesën e tyre të pakursyer inkurajuan kualifikimin tim të mëtijshëm profesional dhe shkencor, duke më dhënë mundësinë të realizoj këtë punim.

Një falënderim është për kolegët e mi të Departamentit të Gjuhës Shqipe si dhe të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Angleze dhe Gjermane të Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Do të falënderoja familjen, prindërit dhe vëllanë tim, Erjoni, të cilët më ndihmuan duke më ofruar mbështetje morale, konkrete dhe materiale në realizimin me sukses të disertacionit.

Së fundi nuk do të ndjehesha e përkushtuar në punën time pa të qeshurat e të qarat që më kanë dhuruar dy vajzat e mia të shtrenjta, Orinda dhe Ajdi, së bashku me nipin tim të dashur, Hergis.

Tabela e përmbajtjes

KOMISIONI.....	1
DEKLARATË	2
ABSTRACT.....	3
FALENDERIME	5
HYRJE	9
QËLLIMI, KORPUSI DHE METODOLOGJIA	20
KAPITULLI I.....	25
VEÇORITË PËRKTHIMORE NË VEPRËN “MAKBETHI”	25
1.1 Përkthimi dhe përkthyesi.....	25
1.2 Noli dhe “Makbethi”	30
1.3 Procedetë leksiko-semantike. Mbi konceptin vlerë stilistike, ngjyrim stilistik, ngjyrim shprehës i rendit afektiv dhe semantik.	39
1.4 Ngjyrimi stilistik.....	44
KAPITULLI II	52
MBI KONSUMIMIN SEMANTIK DHE VARIACIONET E TIJ.....	52
2.1 Konsumimi semantik.....	52
2.1.1 Konsumimi semantik për shkak se fjalët e shkurtra kanë volum të vogël fonetik ...	54
2.1.2 Konsumimi semantik për shkak të ndryshimeve fonetike	55
2.1.3 Konsumimi semantik për shkak të sinonimisë kontekstuale.....	57
2.1.4 Një lloj i veçantë i konsumimit semantik.....	59
2.1.5 Konsumimi semantik për arsye etike	60
2.2 Konsumimi stilistik i disa pjesëzave.....	61
2.3 Përdorim fjalësh me mbingarkesë emocionale	62
2.4 Variacioni sinonimik.....	62
2.4.1 Variacione sinonimike të shprehura me emra dhe mbiemra	65
2.5 Barazimi Semantik (ekuacioni semantik)	69
2.6 Rrezatimi semantik	72
2.6.1 Disa prapashtesa të tjera si mjete ngjyruese	75
2.6.2 Përftesa të reja stilistikore me anë të prapashtesave të tjera prodhuese në gjuhën shqipe.....	77

2.6.3 Parashtesimi si përftesë stilistikore	79
KAPITULLI III.....	82
MBI ZGJERIMIN SEMANTIK DHE VARIACIONET E TIJ	82
3.1 Zgjerimi semantik	82
3.2 Dublimi.....	83
3.3 Zgjerimi i kuptimit.....	88
3.4 Zgjerimi stilistik	89
3.5 Zgjerimi me marrëdhënie sinonimike.....	89
3.6 Zgjerimi me gjymtyrë emër + emër	92
3.7 Zgjerimi me gjymtyrë <i>folje + folje</i>	93
3.8 Enumeracioni/vargëzimi.....	94
3.9 Fusha tematike kontekstuale	96
3.10 Lidhja e fjalëve me kuptim konkret në vargje të ndryshme	97
3.11 Lidhja e fjalëve me kuptim abstrakt dhe konkret në vargje të ndryshme	98
KAPITULLI IV	100
SHTRESAT LEKSIKORE NË VEPRËN E SHQIPËRUAR TË “MAKBETHIT”	100
4.1 Fjalë të vjetëruara të leksikut	100
4.1.1 Historizmat.....	101
4.1.2 Fjalë të vjetëruara, të cilat shenjojnë emërtime veshjesh, objektsh të vjetëruara, nocione që sot kanë tjetër kuptim.....	103
4.1.3 Forma shkrimore të vjetëruara, fjalë të shkruara me apostrof në fund	104
4.2 Fjalë të vjetëruara foljore	105
4.3 Neologjizmat.....	106
4.3.1 Neologjizma të përbëra	110
4.3.2 Neologjizma me mbiemra ose mbiemra të substantivuar	112
4.3.3 Neologjizma ndajfoljore.....	113
4.3.4 Neologjizma të krijuara nga togfjalësha apo shprehje frazale.....	114
4.3.5 Formimi i neologjizmave me parashtesat për- dhe para-.....	116
4.3.6 Formimi i neologjizmave me prapashtesa të tjera	117
4.4 Përdorimi i neologjizmave	118
4.5 Fjalorth neologjizmesh nga Noli te përkthimi i tragjedisë së “Makbethit”	121
4.6 Huazimet në tragjedinë e “Makbethit”	122

4.7. Shtresa e huazuar e leksikut	123
4.7.1 Fjalë të huazuara emërore	125
4.7.2 Fjalë të huazuara mbiemërore	130
4.7.3 Fjalë të huazuara foljore.....	132
4.7.4 Fjalë të huazuara ndajfoljore.....	134
4.8 Huazim-shkurtime	135
4.9 Arkaizmat, si shtresë e vjetër e leksikut të përdorur në përkthimin e “Makbethit” ..	137
4.9.1 Arkaizma që tregojnë tituj.....	139
4.9.2 Arkaizma emërore që shenjojnë individë ose profesione të tyre.....	140
4.9.3 Arkaizma që paraqesin nocione të ndryshme.....	142
4.9.4 Arkaizma mbiemërore	144
KAPITULLI V.....	146
FIGURACIONI	146
5.1 Termi figurë	146
5.2 Disa tipare të shprehjeve metaforike në tragjedinë “Makbethi” të përkthyer nga Noli	149
5.3 Metafora të shprehura me emër	153
5.4 Metafora të shprehura me mbiemër	154
5.5 Metafora të shprehura me folje	157
5.6 Metafora të shprehura me ndajfolje	158
5.7 Metafora të shprehura me pjesë të ndryshme të ligjëratës.....	159
5.8 Disa karakteristika të metonimisë në tragjedinë “Makbethi” të përkthyer nga Noli.....	167
PËRFUNDIME.....	172
BIBLIOGRAFIA.....	194
SUMMARY OF THE SCIENTIFIC RESEARCH.....	197

HYRJE

Punimi ka si objekt synues shprehësinë e leksikut në përgjithësi dhe posaçërisht vetë leksikun shprehës të studiuar në tragjedinë e famshme “Makbethi” të Shekspirit të përkthyer nga F. Noli. Lëvrimi dhe pasurimi i shqipes së sotme letrare nuk mund të parafytyrohet pa ndihmesën e shquar të letërsisë artistike, asaj origjinale dhe asaj të përkthyer. Vlerat e veprave letrare nuk mund të kapen të plota pa e studiuar edhe punën mjeshtërore të shkrimtarëve e përkthyesve me mjetet e gjuhës si pjesë e pandarë e krijimtarisë.

Nxjerrja në pah e mjeteve dhe e mënyrave shprehëse gjuhësore ndihmon për të rrokur stilin e secilit autor që bën pjesë në tablonë e larmisë stilistike të letërsisë artistike. Ky punim ka qëllim të paraqesë e të analizojë pikërisht ato veçori ligjërimore të rrafshit semantiko-leksikor, që bëhen më së mirë përçues të artit e të stilit. Pra, qëllimi i veçantë i punimit janë fjalët që kanë ose fitojnë vlera stilistike në ligjërim.

Trajtimi i krahasuar i objektit ka sjellë informacion të bollshëm mbi burimet e shprehësisë të Shekspirit dhe të shqipëruarit të tij, Nolit. Realizimi i këtij punimi është bazuar në burime të pasura teorike. Punimi përmban dhe informacion të zgjedhur mbi Fan Nolin, si përkthyes dhe shkrimtar. Ky studim është mbështetur mbi metoda përqasëse - krahasuese.

Kapitulli i parë trajton përkthimin dhe përkthyesin. Noli në përkthimet poetike bëri punën e një rikrijuesi, saqë mjaft nga ato mund të mbahen si krijime të tij.

Kështu, me fjalë dhe sinonime të ndryshme të krijuara prej tij, Noli përktheu tragjedinë e “Makbethit”, e cila është cilësuar si tragjedia më “e tmerruar” që ka dalë nga pena e Shekspirit, është pasqyra e historisë së Skocisë, tragjedia e ambicies kriminale, mëkati dhe punitja jo në ferrin e jetës tjetër, por në ferrin e kësaj jetë. Ambicia egoiste pa skrupull, pa mëshirë dhe pa ndërgjegje është një kuçedër që ha vetveten dhe krijon për të zotin një ferr mbi dhë të llahtaritur.

Noli është mjeshtër në gjetjen e fjalës për të krijuar lidhjen ndërmjet veprës origjinale dhe shqipërimit të “Makbethit”. Noli bën që në ligjërimin e tij fjala të jetë e saktë, ashtu siç e përjeton vetë, sepse për atë fjala është forcë.

Noli strukturon në gjuhën e përkthimit një tekst, i cili ndërthur saktësinë semantike me funksionalitetin pragmatik në një kontekst të ri gjuhësor dhe kulturor në përshtatje me kushtet e komunikimit dhe situatës ligjërimore.

Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se stili i Nolit duhet të mos konsiderohet thjesht si zbukurim dhe stisje gjuhësore, por, përkundrazi, si mënyrë e përshtatshme e përdorimit të mundësive shprehëse të gjuhës në një situatë të caktuar, duke respektuar strukturën e përgjithshme gjuhësore të gjuhës së përkthimit.

Për të dhënë një ide sa më konkrete të llojit të veprimtarisë përkthyesë të Nolit kemi ngritur disa pyetje, të cilat dolën gjatë realizimit të studimit: Sa vargje ka përkthyer Noli nga tragjedia e “Makbethit”? Sa vargje janë përkthim fjalë për fjalë? Sa vargje janë përkthim kontekstual? Sa vargje janë përkthim me fjalë të shtuara? Sa vargje janë përkthim me fjalë të hequra? Sa vargje janë përkthim me përshtatje? Sa vargje janë përkthim me shtim idesh dhe opinione?

Kapitulli i parë vazhdon me procedetë leksikore-semantike, mbi konceptin vlerë stilistike, ngjyrim stilistik, ngjyrim shprehës i rendit afektiv dhe semantik.

Termi procede leksikore-semantike është një qasje individuale në krijimin artistik, si dhe transformimi i gjuhës së përditshme në atë poetike. Përftesat ose procedet janë përpunime plotësuese që u bëhen mjeteve e lidhjeve gjuhësore parësore, janë alternativa kundrejt lidhjeve të zakonshme ose edhe lidhjeve të panjohura më parë. Noli është frymëzuar nga shumë aspekte për të paraqitur veçori ligjërimore të rrafshit leksikor, duke përdorur shumë burime shprehësie.

Një nga treguesit më të qartë të tonit të një tregimi është stili në të cilin është shkruar. Në përgjithësi stili i referohet trajtimeve ose karakteristikave individuale të një pjese të shkruar, nga mënyrat e veçanta të shkrimtarit për të organizuar fjalët, të cilat ne i njohim si të zakonata. Stili dallues e paraqet veprën e Nolit të mrekullueshme; ne mund të dallojmë punën e tij apo përkthimin e tij nga punimet e shkrimtarëve të tjerë pikërisht me anë të stilit.

Punimi vazhdon me vlerat stilistike të fjalëve apo togfjalëve të paraqitura nga Noli të cilat përmbajnë ngjyime stilistike, të tilla janë gjurmët që lënë në fjalë rrethi i përdorimit të saj të zakonshëm, ngjyime ekspresive të rendit semantik dhe afektiv që mund t'i shtohen përdorimit të saj të zakonshëm. Të tilla vlera stilistikore janë shprehur mjaft mirë nga Noli.

Punimi vazhdon me vlerat stilistike të fjalëve apo togfjalëve të paraqitura nga Noli të cilat përmbajnë ngjyime stilistike, të tilla janë gjurmët që lënë në fjalë rrethi i përdorimit të saj të zakonshëm, ngjyime ekspresive të rendit semantik dhe afektiv që mund t'i shtohen përdorimit të saj të zakonshëm. Të tilla vlera stilistikore janë shprehur mjaft mirë nga Noli.

Ngjyrimi emocionues është tregues i qëndrimit të folësit ndaj asaj çka përmend. Fjala, veç kuptimit leksikor, ka edhe atë që quhet konotacion. Ngjyrimi emocionues mbishtresohet te fjalët, sepse folësi synon që bashkë me informacionin të shprehë edhe qëndrimin e tij për atë që thotë, me qëllim që të arrijë synimet e tij. Këtë ngjyrim Noli e bën kryesisht përmes fjalëve me ngjyrim emocionues.

Ne mund të depërtojmë në kuptimin e teksit nëpërmjet analizës denotative dhe tematike, por ky kuptim është ende i paplotë. Në të vërtetë duhet të kuptojmë gjuhën poetike të Nolit, pra të vlerësojmë se si është përcjellë mesazhi, në ç'mënyrë ka mbërritur përmbajtja te lexuesi, çfarë elementesh gjuhësore ka përdorur përkthyesi dhe si i ka harmonizuar ato. Këto elemente gjuhësore janë forma metrike dhe ritmi, figurat retorike të kuptimit, strukturat sintaksore, leksiku dhe lidhjet morfo-sintaksore, etj, te përdorura në perkthimin e Makbethit.

Ngjyrimet stilistikore të përkthimit të Nolit përfshihen nga fjalë të thjeshta ose me kompozicion, të fjalat **zemërgur** kemi kompozicion emër+emër, ku përbërësi i dytë **-gur** përcakton të parin dhe stilema e krijuar merr ngjyrim poetiko-libror.

Do të analizohet se ngjyrimet subjektive të përdorura nga Noli, që lidhen me marrëdhëniet vetiake të ligjëruesit me bashkëbiseduesin dhe me objektin, janë plot emocion. Marrëdhëniet mund të jenë negative ose pozitive, keqësuese ose miratuese.

Po ashtu do të trajtohen se ngjyrimet funksionale të shprehura nga Noli krijohen nga marrëdhëniet e ligjëruesit me objektin, ose e bashkëbiseduesit me shoqërinë. Ato, gjithashtu, lidhen edhe me mjedisin, me situatën, ose me një veprimtari shoqërore. Së

bashku me ato do të analizohen ngjyrimet shprehëse të Nolit të cilat krijohen si marrëdhënie ndaj gjuhës, e cila ka të bëjë me fushën artistike që zgjedh ligjëruesi, duke shfrytëzuar formën gjuhësore për të tërhequr vëmendjen në letërsinë artistike.

Kapitulli i dytë është rreth konsumimit semantik, objekti i të cilit është leksiku shprehës. Konsumimi semantik mund të ndodhë për shkak të volumit semantik dhe fonetik, sinonimisë kontekstuale, sinonimisë së pjesshme kontekstuale, si dhe për shkaqe etike. Këto veçori të shprehjeve semantike të konsumuara janë përdorur nga Noli për një funksion më të mirë paraqitjeje.

Leksiku i Nolit është shumë ekspresiv. Në të vihet re dukuria e konsumimit stilistik, semantik, ku fjala e konsumuar është zëvendësuar ose ka ndryshuar kontekstin e saj. Ky ndryshim varet nga koncepti artistik i shkrimtarit. Noli është jashtëzakonisht origjinal dhe i veçantë. Ai krijon atmosferë shumë afektive dhe emocionale.

Konsumim semantik pësojnë fjalët të cilave u mungon shprehësia, ekspresiviteti, ngjyrimi emocional, kuptimet e figurshme të ligjërimit afektiv etj., d.m.th. janë fjalë pa ndonjë ekspresivitet të dukshëm e që sjellin monotoni në ligjërim.

Kështu, fjala e konsumuar mund të jetë ose jo në tekst, ose Noli mund të sjellë një fjalë tjetër në vend të fjalës së konsumuar. Kështu, fjalët, të cilat shfaqin ekspresivitet, janë të ekspozuara ndaj konsumimit. Të tilla mund të jenë fjalët që shenjojnë cilësi, veprime ose fjalë që shenjojnë fenomene dhe mjete të ndryshme. Është kjo arsyeja që shpeshherë fjalët, të cilat përmbajnë ngarkesë emocionale, si: emrat, foljet, dhe mbiemrat në ligjërimin artistik konsumohen me shpejtësi.

Konsumimi semantik në letërsinë artistike fiton një rëndësi të veçantë e ka një përhapje të madhe që bie në sy. Procedeja e konsumimit semantik në letërsinë artistike kushtëzohet nga mënyra e paraqitjes së materialit, si dhe nga forma e komunikimit me lexuesin.

Konsumimi semantik realizon përftesa ose procede të tjera. Leksiku i përdorur nga Noli dallohet nga ekspresiviteti, d.m.th nga ngjyrimet emocionale, figuracioni etj. Fjalët e harxhuara mund të jenë shumë shprehëse, ose për shkak të etikës përdoret fjala për të cilin shkrimtari mendon se ka përdorim me përmbajtje më të mirë.

Një çështje tjetër e trajtuar në këtë kapitull është variacioni sinonimik i përdorur nga Noli. Gjuha shqipe ka një bërthamë të qëndrueshme, e cila shfaqet në volum. Bërthama përbën strukturën, ndërsa realizimet quhen variante. Çdo variant ka ndarjet e veta, rolin

dhe kushtet e përdorimit. Variacioni është i nevojshëm për ekzistencën e gjuhës në jetën e gjatë e të pasur të popullit.

Punimi do të trajtojë se përhapja gjeografike bën variantet krahinore, si arbërishtja e shqiptarëve të Italisë, e cila është një variant gjeografik-historik. Gjuha lind dhe jeton si gjuhë e folur, por edhe njësia e gjuhës është e domosdoshme. Njësimi është çështje e përsosjes dhe pasurimit të sistemit të gjuhës letrare, e ngulitjes së normës standarde. Për këtë arsye bëhet më e gjallë nevoja për variacion.

Kapitulli i dytë vazhdon me barazimin semantik (ekuacionin semantik). Në ekuacionin semantik fjalët hyjnë në gjykim me kuptimin e tyre të mirëfilltë dhe gjykimi pohon barazinë e tyre kuptimore. Subjekti dhe predikati përfytyrohen nga Noli si barazvlera kuptimore, po kështu vështrohen edhe nga lexuesi. Përkthyesi ka synuar që përmbajtjen e predikatit ta barazojë me atë të subjektit. Ajo që thuhet për subjektin nuk krahasohet me atë që thuhet në predikat, por barazohet me atë. Kështu, prej leksikut të Nolit përftohen stilema interesante e ndikuese, meqë synohet barazim atje ku nuk ka barazi.

Ç'janë këto *të fishkura* dhe *rrobëçjerra* që nuk duken *ndenjëse* të dheut. [N:20]

Në këtë shembull kemi barazvlerën e *të fishkura* dhe *rrobëçjerra* me *ndenjëse* të dheut.

Jeni vallë pamje *fantazije* apo me trup siç dukeni, *të gjallë*? [N:21]

Koncepti *pamje fantazije* njejtësohet me konceptin *të gjalla*. Ky barazim bën që koncepti i parë të rrethohet me një atmosferë emocionale negative, pesimiste.

Më pas analizohet rrezatimi semantik i përdorur nga Noli i cili ka të bëjë me përqëndrimin e një ngjyrimi kuptimor a emocional në një mbaresë e prapashtesë, e cila arrin të ngjyrosë krejt fjalën. Ngjyrimi kuptimor, emocional-shprehës, që fiton një fjalë i detyrohet vetëm një elementi të fjalës, një elementi pa kuptim leksikor të pavarur, siç është p.sh. një prapashtesë. Punimi do të trajtojë mjetet ngjyruese të cilat përdoren në rrezatimin semantik.

Këtu përfshihen një numër jo i vogël prapashtesash të përdorura nga Noli: **-z(ë), -osh, -ça, -or(e), -em, -inë, -aq, -an, -ra, -or, -ak, -ik(e), -kë, -ok(e), -llëk, -osh(e), -çkë, -th, -yer**. Ato luajnë rol të rëndësishëm në ngjyrim.

Fjalët e fitojnë ngjyrimin emocional përmes prapashtesash me nuanca përkëdhelie ose keqësuese, si: mëmë**zë**, birth**th**, huta**q**, frikaca**k**, përtac**sh**, gjumash**sh**, burrac**sh** etj. Me

përdorimin e këtyre prapashtesave, përgjithësisht, nuk kalohet në njësi të reja leksikore, por në kuptimin leksikor të njësisë së dhënë shtresohen ngjyime të ndryshme kuptimore, emocionale ose stilistike.

Një çështje e trajtuar në kapitullin e tretë është zgjerimi semantik dhe variacionet e tij të cilët janë një tjetër dukuri që përdoren dendur në përkthimin e Nolit. Në krijimet dhe në përkthimet e tij shpesh gjenden pranë e pranë dy a më shumë fjalë që shenjonë cilësi, veprime, objekte, rrethana etj. Lidhja është me bashkërenditje, **edhe, dhe e** për të përforcuar më shumë mendimin që shpreh fjalja. Gjatë studimit të përkthimit të Nolit dallojmë lidhje me bashkërenditje me anë të lidhëzës **e**.

T'i thonë me levdat **e** brohori. [N:24]

Ditë që zbardh **e** nxin si kjo nuk kam parë. [N:19]

Dukuria e zgjerimit kuptimor të njërive të formuara me prapashtesim, të cilat fitojnë ngjyime kuptimore ose emocionale, vihet re në mbarë gjuhën e shprehur nga Noli. Kështu formohen emra me kuptim zvogëlimi me prapashtesat: **-th, -z(ë)** (zog**th**, birth, shtëpiz**ë**, streh**ëz**).

Do të analizohet gjithashtu se gjatë procesit të ngjyimit me anë të prapashtesave njëria e formuar fiton nuancë kuptimore. Fjalët me prapashtesën **-ra** janë në numrin shumës. Ky afiks shërben për të formuar shumësin e emrave të ndryshëm konkretë e abstraktë: **idera, shtëpira** etj. Përdorimi i prapashtesave zë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë përkthyesë të Nolit, sepse me prapashtesa të ndryshme ai formon neologjizma ndajfoljore.

Do ta bëj të njohur **botërisht**. [N:29]

Fati i buzëqeshi **kurvërisht**. [N:14]

Dua të theksoj se në përkthimin e Nolit ne vëmë re leksikun e formuar me prapashtesën **pa-**për të shprehur një kuptim negativ.

Ambicj' **e pakursyer** që përpin. [N:66]

Më vunë në kokë një kurorë të **papemët**. [N:71]

Dua të theksoj gjithashtu se në shembujt e lartpërmendur prefiksi **pa-** është shoqëruar nga ngjyrimi afektiv-subjektiv, po ashtu dhe mohimi. Në gjuhën angleze ky prefiks zëvendësohet me prefiskin **un-**. Ndërsa në shembujt e Shekspirit ne shpesh ndeshemi me sufiksin **-less** për të formuar mohimin.

Kur përdoren dy emërtime për të njëjtin nocion kemi të bëjmë me dublim. Emërtimet mund të bëhen njëri me mjete asnjëse, tjetri me mjete shprehëse. Të dy emërtimet gjenden në të njëjtin vend të thënies dhe përbëjnë një të tërë, një emërtim të dyfishtë.

Dukuria e dublimit krijon barasvlera kuptimore, duke na dhënë sinonimi kuptimore. Por, në dublim sinonimia midis elementeve përbërëse nuk është e plotë. Këto nuk thonë e nuk shprehin krejt të njëjtin nocion. Midis tyre ka dallime të ndryshme kuptimore, si edhe shprehëse.

Njëra gjymtyrë ka kuptim të drejtpërdrejtë, ndërsa tjetra ka kuptim të figurshëm. Gjymtyra me kuptim të figurshëm funksionon si barasvlerë shprehëse për gjymtyrën tjetër. Prandaj, themi se sinonimia kuptimore midis elementeve të dublimit është kontekstuale. Nga ana stilistikore njëra prej gjymtyrëve është asnjëse. Kështu dublimi i shprehur nga Noli është tepër i arrirë.

Dhe dallëndyshja, **mysafirja e pranverës**. [N:36]

Gjymtyra e dytë plotëson kuptimin e së parës, duke na dhënë një atmosferë të këndshme pranverore, optimiste dhe plot shpresë.

Kapitulli i tretë mbyllet me enumeracionin/vargëzimin.

Noli është mjeshtër në përdorimin e fjalëve. Në manovrimet e tij me leksikun ndodh t'i vendosë fjalët në varg njëra pas tjetrës, në mënyrë të bashkërenditur. Në raste të tilla përftohen vargje që përmbajnë dy a më shumë fjalë. Ky fenomen përbën një veçori të ligjërit të këtij shkrimtari dhe mjeshtri-përkthyes. Këto vargje fjalësh kanë si karakteristike të përbashkët mënyrën se si ato janë lidhur midis tyre. Ato lidhen me njëra-tjetrën me lidhëza bashkërenditëse ose në mënyrë asindetike.

Sa më i gjatë të jetë vargu aq më i madh bëhet informacioni dhe së bashku me informacionin rritet efekti i shprehësisë. Pikërisht, krijimi i këtyre vargjeve tërheqin larminë e elementeve me të cilët lidhen.

Kapitulli i katërt trajton shtresën leksikore të përdorur nga Noli në përkthimin e Makbethit. Një nga çështjet e trajtuara në kapitullin e katërt është leksiku i vjetruar, i cili në përgjithësi karakterizohet nga dy lloje fjalësh: historizmat dhe arkaizmat. **Historizmat** janë fjalë të vjetruara, që paraqesin një objekt, një send apo një koncept. Ato lidhen me periudha të ndryshme historike. Të tilla janë fjalët: **than, rreshtar, komandar,**

kamë etj. Konceptet dhe objektet që paraqesin historizmat nuk janë më sot. Ato lidhen me një periudhë të kaluar historike dhe kanë dalë nga përdorimi.

Më pas në këtë kapitull analizohen neologjizmat, të cilat mund të përkufizohen si njësi leksikore ose njësi ekzistuese, që mbartin kuptim të ri. Neologjizmat janë fjalë ose shprehje që kanë hyrë rishtazi në gjuhë për të shenjuar një send a një dukuri të re, që ende ndihet e tillë. Neologjizëm quhet një fjalë, një term i ri i krijuar, që mund të jetë në procesin e përdorimit të zakonit, por që ende nuk është pranuar në gjuhë.

Fjalët e reja ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare. Fjalë të krijuara kot nuk ka. Na duket ndonjëherë se fjala e re ka dalë rastësisht, ndërsa në të vërtetë në formimin e saj kanë vepruar ligjet e brendshme të gjuhës. Vetë kërkesat e jetës e të shoqërisë janë shkaku që lindin fjalët e reja dhe ato formohen duke u mbështetur në pasurinë e gjuhës e sipas ligjeve të saj.

Neologjizmat stilistike ndërtohen sipas modeleve prodhuese në gjuhë, ose duke u shmangur prej tyre. Shmangia shfaqet edhe në semantikë, dhe atëhere kemi një stilemë. Përgjithësisht kur shprehësia mbështetet te shmangiet kërkon kujdes të veçantë, sepse mund të arrihet efekti i kundërt ose teksti del me ton të fryrë, të papranueshëm.

Sipas Peter Newmark është thënë se çdo gjuhë fiton 3000 fjalë çdo vit. Në të vërtetë neologizmat nuk mund të përcaktohen me saktësi, sepse ato rrinë pezull midis pranimit dhe harresës dhe shumë prej tyre janë krijime individuale me jetë të shkurtër. Ajo që është e dukshme është se numri i tyre po rritet ndjeshëm dhe kur përdoren më shumë bëhen më të kuptimta, me anë të artikujve, librave dhe specialistët e përkushtuar ndaj tyre i fusin në fjalorët e përgjithshëm. Meqë ato krijohen së pari si një përgjigje ndaj një nevojë të veçantë, shumica e tyre kanë një kuptim të vetëm dhe prandaj mund të përkthehen nga konteksti, por shumë prej tyre fitojnë shpejt kuptime të reja dhe nganjëherë humbasin kuptimin e vjetër. Noli është mjeshtër në krijimin e neologjizmave.

Një tjetër çështje e trajtuar në këtë kapitull ka të bëjë me **huazimin**. Huazimi është një proces që haset në të gjitha gjuhët e botës. Huazimi si proces tregon se popujt kanë pasur apo kanë marrëdhënie historike, ekonomike dhe kulturore ndërmjet tyre. Huazimi leksikor ndodh në rrethana historike e gjuhësore të caktuara, gjithashtu ndodh edhe kur në një gjuhë ka emërtim për të njëjtën realie a për të njëjtin koncept. Sipas R. Memushajt huazimet përbëjnë një dukuri të zakonshme për të gjitha gjuhët. Ato prekin të gjitha

rrafshet gjuhësore: fonetikën, morfologjinë, leksikun dhe sintaksën. Por, rrafshi që preket drejtpërdrejt dhe më shumë nga huazimet është leksiku. Meqënëse janë një dukuri shumë e përhapur në të gjitha gjuhët, huazimet leksikore paraqesin një interes të veçantë. Ato janë objekt jo vetëm i leksikologjisë, por edhe i gjuhësisë historike.

Huazimet leksikore të Nolit janë: a) **të drejtpërdrejta**, d.m.th. të marra drejtpërdrejt nga gjuha e huaj. Kështu, fjalët **invasion**, **salute**, etj. janë marrë drejtpërdrejt nga latinishtja, **haber** nga turqishtja; b) **huazime strukturore**, kur fjala në të vërtetë është shqip, por është ndërtuar sipas modelit të një fjale të huaj, që shpreh cilësi, sasi etj. Fjalët e huazuara të përdorura nga Noli janë kryesisht me prejardhje nga greqishtja, latinishtja, anglishtja, frëngjishtja apo turqishtja.

Kur vjetrohen vetëm fjalët e jo nocionet e kur këto fjalë zëvendësohen me njësi të tjera leksikore kemi të bëjmë me **arkaizma**. Fjala *arkaizëm* është përdorur për herë të parë në mesin e shekullit XVII nga latinishtja moderne “*archaismus*”, që rridhte nga greqishtja “*arkhaismos*” (*arkhaizein*), që do të thotë i vjetër, i lashtë.

Sasitë e arkaizmave të përdorura nga Noli në krijimet dhe në përkthimet e tij janë të ndryshme në vepra të ndryshme, p.sh. te “Makbethi” ka shumë arkaizma. Siç e kemi thënë dhe më lart arkaizmat janë fjalë që janë vjetëruar a po vjetërohen dhe për këtë arsye kanë dalë nga përdorimi, kalojnë nga shtresa aktive në shtresën pasive të leksikut.

Arkaizmat kanë dalë nga përdorimi për shkak se kanë dalë fjalë të tjera për të emërtuar po ato objekte, nocione a dukuri. Fjalët që vjetërohen për shkaqe të tilla gjuhësore janë arkaizma të mirëfillta. Të tilla janë te përkthimi në fjalë i Nolit, **than**, që do të thotë një titull.

Arkaizma të tjera janë fjalë si: **lartësi**, **lartmadhëri**, ku arsyeja kryesore e mospërdorimit të këtyre fjalëve mendojmë se ka të bëjë me faktin se këto fjalë kanë lidhje me ekzistencën e familjes mbretërore, gjë që sot është një dukuri e rrallë.

Janë arkaizma edhe disa fjalë të fushës ushtarake që janë zëvendësuar më pas me fjalë e trajta të tjera, si p.sh: **rreshtari**, **kumandari** etj. Arkaizmat paraqesin një larmi ndërtimore. Ato mund të jenë fjalë të parme, të prejardhura, të përbëra.

Për **arkaizmat** kanë shkruar gjuhëtarë të huaj dhe vendas, Peter Newmark, Rami Memushaj, Xhevat Lloshi, Jani Thomai, Emine Sadiku etj., të cilët midis të tjerave shprehen se ato futen në fjalorin pasiv, sepse janë fjalë të vjetra që kanë dalë nga

përdorimi,: *shëndre* me fjalën gjegjëse sot “*dhjetor*”, “*shinik*” me fjalën gjegjëse sot *çetur*, “*ushtë*” me fjalën gjegjëse sot *shqytë* etj. Nëse do t’i referohemi autorëve të vjetër apo rilindasve kemi një listë të gjatë të arkaizmave:

Të Bogdanit: *mësonjëto* (shkollë), *dheshkronjë* (gjeografi), *bujtinë* (hotel), *jetëshkronjë* (histori).

Të Naimit: *shkronjëto* (gramatikë), *letrëri* (letërsi).

Të Asdrenit: *vdekësi* (vdekshmëri), *rëndokësi* (mediokritet), *kundresht* (kundërshti).

Kapitulli i pestë trajton figuracionin. Në këtë kapitull do të trajtohen kryesisht tropet, **metafora** dhe **metonimia**. Tropet si mjete të shprehësisë së autorit janë gjithashtu shmangie nga emërtimi i drejtpërdrejtë, si p.sh. **qielli ishte pus, e la shakull të shtrirë përdhe**, në rastin e dytë shkalla e shprehësisë rritet.

Fjala metaforë vjen nga greqishtja **meta-**, anglisht **change**, në shqip **ndryshim**, greqisht **-phero**, anglisht **-carry**, që në shqip do të thotë **mbart**. Metafora është figurë zëvendësimi, një gjë për tjetrën ose një thënie për një tjetër.

Metafora është përcaktuar nga stilistë të shumtë gjuhësorë si një proces paraqitjeje të dy fushave të ndryshme konceptuale. Ato njihen si fusha e burimit dhe fusha e qëllimit. Metafora është thjesht një pjesë e natyrshme e mendimit konceptual dhe padyshim një tipar i rëndësishëm i krijimtarisë dhe nuk duhet të konsiderohet si tipar i veçantë i ligjëritimit letrar.

Metafora është një krahasim pa lidhëzat *si, ashtu si*. Në përgjithësi krahasimi i referohet vetëm një karakteristike që dy gjëra mund të kenë të përbashkët, ndërsa metafora nuk është e kufizuar nga numri i ngjashmërive që mund të paraqiten. Leksiku i Nolit është shumë i pasur me figura letrare.

Se përmbi buzët **zhubra** tuajat, [N:20]

atje me **shoshe lundrëzoj** [N:18]

jetën ia **nxij** e ia **mallkoj**. [N:18]

Një figurë tjetër e afërt me metaforën është metonimia (greq. vj. “metonymia” ndërrim i emrit), që shenjon mbartjen e emërimit të mbështetur në fqinjësinë e sendeve, në takimin e tyre në hapësirë, në kohë, në lëndë etj. Metonimia vështirëson, komplikon, zhvillon, përpunon zhvendosjen midis koncepteve të shoqëruara, e cila shpesh rezulton në zhvendosjen midis pjesës dhe të tërës; ose të tërën për pjesën, njëjtesin për shumësin etj.,

p.sh. **shqiptari** në vend të **shqiptarët**, **fshati** në vend të **fshatarit**. Po kështu kur shprehemi: le të takohemi përballë **parlamentit**, këtu nënkuptojmë **ndërtesën**. Në shprehje të tilla “**parlamenti** diskutoi..., **parlamenti** refuzoi..., **ministra** miratoi..., **qeveria** vendosi etj. nënkuptojmë parlamentarët, deputetët, ose anëtarët e qeverisë, ministrat etj.

*Eni ju xhindër, **bëmëni burrë** dhe mbushmëni. [N:33]*

*Nga **koka e gjer në thonj e në buz**’. [N:33]*

Me fjalët **koka e gjer në thonj e në buz**’ nënkuptohet e gjithë qenia.

***Po Bota** a do të besojnë vallë, që e kanë vrarë ato që e ruajnë? [N:33]*

Pra, **bota** nënkupton njerëzit.

Ndërsa X. J. Kennedy thotë se në metonimi emri i një gjëje është zëvendësuar me atë me të cilin është lidhur mjaft ngushtë.

Shtëpia e Bardhë vendosi.

Ky shembull do të thotë se: *presidenti* vendosi.

Robert Dale Parker në librin “*How to interpret literature*” shkruan thënje të Roman Jakobson: se metafora dhe metonimia janë figura retorike. Roman Jakobson pretendon se metafora dominon vizatimet surrealiste në romanticizëm, simbolizëm dhe poezi, ndërsa metonimia dominon në vizatimet kubiste në veprat realiste dhe në prozë.

QËLLIMI, KORPUSI DHE METODOLOGJIA

Mbështetur në përvojën e autorëve të huaj dhe shqiptarë mbi shtjellimin e shumë çështjeve që ngërthen stilistika dhe leksikologjia në punimin tonë do të japim një zbërthim më të detajuar të procedeve leksikore dhe veçorive të tyre leksiko-semantike në shqipërimin e “Makbethit”.

Përmes kësaj analize do të përpiqemi të shqyrtojmë llojet e informacionit më të imët të leksikut shprehës të Nolit nga një këndvështrim krahasues. Qëllimi ynë është të zbulojmë nëse leksiku shprehës në anglisht dhe shqip shpreh hollësi të krahasueshme. Gjithashtu synojmë të zbulojmë llojet e përbashkëta të leksikut shprehës dhe të mësojmë nëse leksiku shprehës i shqipëruar nga Noli është po aq i pasur dhe i larmishëm siç është në anglisht, si edhe të zbulojmë nëse ka të veçanta në përkthimin e tragjedisë së “Makbethit”.

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë një vështrim të hollësishëm krahasues të një pjesë të konsiderueshme të leksikut shprehës në tragjedinë “Makbethi” të shqipëruar nga Noli, duke e krahasuar me origjinalin e Shekspirit. Ky studim synon që brenda caqeve të lejueshme të shpalosë dhe të kategorizojë leksikun shprehës të Nolit, duke i pranvënë dhe duke e krahasuar me përgjegjëset gjuhësore të origjinalit anglisht.

Duke qenë një nga përpjekjet e pakta deri më tani në këtë fushë rreth leksikut shprehës të Nolit të “Makbethi”, disertacioni eksploron veçoritë e jashtëzakonshme të leksikut shprehës të tij. Puna e Nolit me leksikun për të arritur shprehësinë dhe ndikimin e pamungueshëm është shumë e gjerë, jo vetëm të “Makbethi”, por dhe në vepra të tjera të përkthyer, si dhe krijime të tij. Analiza e mëtejshme, më e detajuar e stilit të tij, mbetet objekti i punimeve të tjera në të ardhmen.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është krahasimi i leksikut në të dy gjuhët, por duke u përqëndruar më shumë te leksiku i gjuhës shqipe, sepse ka raste kur veçoritë e përkthimit në gjuhën shqipe nuk përkojnë plotësisht me ato të gjuhës angleze. Gjithashtu do të përpiqemi të zbulojmë ngjashmëritë dhe dallimet e leksikut shprehës midis këtyre dy gjuhëve.

Për hartimin e këtij korpusi kemi shfrytëzuar vargje nga krijimtaria dhe përkthimet e Nolit, si dhe vargje nga “Makbethi” në anglisht dhe shqip. Në rastin e gjuhës angleze janë vjelur materiale nga burimet, si: Shakespeare, Great books of the Western World, Volume 2, “Macbeth”, 1952 by Encyclopedia, Britannica, Inc. Në gjuhën shqipe janë shfrytëzuar një grup veprash dhe literaturash, ndërto përmendim: Fan Noli “*Makbethi*” Tiranë 1943, Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*, vëllimi i parë dhe i dytë, botim i parë; Xhevat Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika etj.* Në këtë punim është zbatuar metoda përqasëse-krahasuese, kurse analiza është bërë në këndvështrimin e gjuhësisë bashkëkohore.

Studime për leksikun kanë bërë gjuhëtarë të ndryshëm, vendas dhe të huaj. Janë studiuar vepra të gjuhëtareve të huaj, si: Peter New Mark, X. J. Kennedy, Halliday, Umberto Eco, Clifford E. Landers, Robert Dale Parker, Katie Walles etj.

Nga veprat e autorëve shqiptarë janë studiuar aspekte përkthimore apo studime përkthimore të Viktor Ristanit, Edmond Tupes, Shpëtim Çuçkës etj.

Ky punim është ndarë në pesë kapituj, të cilët së bashku mundësojnë disertacionin tonë. Në kapitullin e parë do të trajtohet figura e Fan Noli si shkrimtar dhe përkthyes, gjithashtu do të bëhet dhe analiza e përkthimit të vargjeve të “Makbethit”.

Në këtë kapitull do të analizohen çështje mbi procedetë leksikore-semantike dhe konkretisht duke analizuar dhe iu përgjigjur pyetjeve, si: Çfarë kuptojmë me konceptin vlerë stilistike, ngjyrim stilistik, ngjyrim shprehës i rendit afektiv dhe semantik?

Në kapitullin e dytë do të analizojmë çështje, si: Çfarë është konsumimi semantik, variacioni sinonimik, ekuacioni/barazimi semantik, rrezatimi semantik.

Më pas do të vijojmë me kapitullin e tretë, në të cilin do të trajtojmë zgjerimin semantik dhe variacionet e tij, dublimi, zgjerimi stilistik, enumeracioni apo vargje fjalësh.

Kapitulli i katërt do të analizojë shtresat leksikore, si: fjalët e vjetruara, neologjizmat, huazimet dhe arkaizmat.

Punimi vazhdon me kapitullin e pestë, figuracioni, ku do të trajtohen kryesisht figurat letraro-artistike, si: metafora dhe metonimia, të përdorura nga Noli në përkthimin e tij të tragjedisë së “Makbethit” dhe mbyllet me përfundimet.

Në punën tonë kanë ndihmuar së tepërmi edhe punimet e studiuesve dhe autorëve shqiptarë, si: Xhevat Lloshi, Fatmir Agalliu, Viktor Ristani, Jani Thomai, Nasho Jorgaqi, Abdulla Ballhysa, Emine Sadiku etj.

Mbështetur te pranvënia dhe krahasimi i strukturave stilistikore të përdorura nga Noli në krijimtarinë poetike, politike, muzikore, gjuhësore, si dhe përkthimore, do të hidhet dritë mbi parimet bazë të përbashkëta dhe të veçanta për të dyja gjuhët. Në fund do të japim edhe disa përfundime të vlefshme mbi leksikun shprehës që ka përdorur Noli në këtë përkthim.

Realizimi i synimit të këtij punimi, pasqyrimi i saktë e i qartë i klasifikimit, analizës dhe dendurisë së përdorimit të leksikut shprehës bazohen në një literaturë të pasur bashkëkohore shkencore, si dhe në një material të pasur faktik të gjurmuar në të dyja gjuhët.

Tekstet për analizë nga gjuha angleze janë shfrytëzuar tragjedia “Makbethi”, marrë nga vepra e Shakespeare-it; Great books of the Western World, volume 2, ndërsa në gjuhën shqipe “Makbethi”, shqipëruar nga Fan Noli (Tiranë, 1943).

Janë marrë gjithashtu citime nga përkthime të ndryshme, si dhe krijime origjinale të Nolit. Në këtë punim vargjet janë analizuar nga pikëpamja shkencore, çka na bën të shpresojmë se kjo analizë do të jetë një hap i mirë drejt analizash të tjera më të thelluara në të ardhmen, jo vetëm rreth tragjedisë “Makbethi”, por edhe më gjerë.

Analiza e leksikut shprehës të Nolit ka arritjet e veta. Kjo analizë e korpusit tonë nxori në pah se të dy gjuhët shprehin lloje të ngjashme të leksikut shprehës, si leksiku i Nolit në gjuhën shqipe, ashtu dhe i Shekspirit në anglisht. Ne nuk pretendojmë se analiza e leksikut shprehës të Nolit në përkthimin e “Makbethit” është fjalë për fjalë me atë çfarë ka dashur të shprehë Shekspiri. Megjithatë, analiza semantike na ka lejuar të formulojmë hipoteza në lidhje me natyrën e përkthimit të leksikut shprehës të Nolit në shqip krahasuar me origjinalin e Shekspirit në anglisht, duke ofruar një bazë të shëndoshë tipologjike gjuhësore për të vazhduar hulumtimin në baza shkencore.

Për të dhënë një ide sa më konkrete të llojit të veprimtarisë përkthyesë të Nolit kemi dhënë një tabelë me të dhëna statistikore mbi tipat apo mënyrat e përkthimit të realizuara nga vetë ai. Në përkthimin e “Makbeth-it” nga Noli janë hedhur në letër **2452** vargje, të cilat i kemi analizuar nga lloji i përkthimit: në vargje të përkthyer fjalë për fjalë, në

vargje të përkthyer nga kuptimi kontekstual, në vargje të përkthyer me fjalë të shtuara, në vargje të përkthyer me përshtatje, në vargje të përkthyer me fjalë të hequra, dhe në vargje të përkthyer me shtim idesh + opinione etj. (Por ne nuk i kemi paraqitur në punim të gjitha vargjet, sepse është detyrë për të ardhmen).

Edhe pse një disertacion doktorature nuk mjafton për të trajtuar dhe për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve kërkimore që rrjedhin nga analiza, ky punim besojmë se ka trajtuar me sukses leksikun shprehës të Nolit, falë studimeve të thelluara të çështjeve të trajtuara.

Për herë të parë mendojmë se analiza e leksikut shprehës dhe e figuracionit të Nolit në mënyrë të detajuar në veprën e “Makbethit” japin anët e përbashkëta se të dy gjuhët ndjekin të njëjtin organizim të leksikut shprehës.

Analiza e bërë në këtë disertacion ka ngritur çështjen nëse përkthimi i Nolit është fjalë për fjalë apo me përshtatje kontekstuale etj., dhe nëse leksiku shprehës i tij përkon në të dyja gjuhët. Gjatë analizës sonë kemi hasur probleme rreth leksikut shprehës të variacioneve sinonimike, të dublimit, zgjerimit, enumeracionit etj. Pyetja lind a do të ishte e mundur që të gjitha parashtesat dhe prapashtesat të krijojnë ngjyrim stilistik? A do të ishte e mundur që të gjithë sinonimet të krijojnë variacione? Kur do të kishim dublime?

Nevojiten kërkime të mëtejshme për të testuar hipotezën se grupet sinonimike mund të krijojnë variacione, po ashtu kur japim dy emërtime për të njëjtin nocion kemi të bëjmë me dublim. Për të hedhur dritë mbi leksikun shprehës të Nolit, konkretisht mbi figuracionin, që është përdorur gjatë përkthimit të veprës, nevojitet një punim më vete.

Për studimin ndërgjuhësor do të ishte me vlerë të motivohej nëse prirjet e përkthyer më lart për leksikun shprehës të Nolit në gjuhën shqipe, të përqasura në gjuhën angleze, të vlejné edhe për studentët e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera të huaja.

Kjo punë kërkimore shkencore do të vazhdojë më tej në mënyrë të pandërprerë për të gjetur të tjera vlera letrare e gjuhësore të Nolit, jo vetëm të “Makbethit”, por dhe në përkthime apo krijime të tjera të tij.

Ky punim konsiston të kontribuojë në tri drejtime kryesore: për kërkime të mëtejshme në fushën e leksikut shprehës, për përkthimin, për fushën e figuracionit. Për më tepër kjo fushë kërkimore do të përfitonte nga kuptimi më i mirë i leksikut shprehës dhe prirjet e përgjithshme të vërejtura në dy gjuhët e trajtuara. Shumë studime në fushën e stilistikës,

të leksikut shprehës zënë fill nga të dhëna gjuhësore, të cilat janë konfirmuar si të vlefshme.

Ky punim mund t'i shërbejë fushës së letërsisë, pasi aty zbulohet dhe krahasohet natyra komplekse e figuracionit të një numri të madh vargjesh në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Nëse tropet u paraqiten studentëve dhe më pas hulumtohen sipas informacionit që mbartin, studentët do ta kenë të lehtë të kuptojnë fushën e përdorimit të tyre.

Së fundi, përfaqësimet semantike të leksikut shprehës të përkthyer nga Noli mund të gjejnë zbatime në mësimdhënien e gjuhës angleze si gjuhë e dytë, si edhe të gjuhës shqipe. Studentët e gjuhës angleze do të gjejnë material të bollshëm për të përvetësuar mënyrat e përkthimit, pasi aty zbulohet dhe krahasohet natyra komplekse semantike e leksikut të përkthyer. Bazuar në këtë krahasim studentët mund të zgjedhin mënyrën e përkthimit: fjalë për fjalë, kontekstual, me përshtatje etj. Në secilën nga çështjet e trajtuara kemi dalë me konkluzione e përfundime të studiuara dhe të analizuara mirë.

Në këtë punim janë përdorur disa shkurtime dhe simbole.

Shkurtime:

[N:15] = Fan Noli Makbethi Shqip.Tiranë 1943, f.15

[Sh: 288] =Shakespeare, Great books of the Western World, Volume 2. 1952
Encyclopedia Britanica, Inc.p.288.

Numri i faqeve ndryshon.

Simbole:

= i/e barabartë

“ ” thonjëza

() për të përkufizuar ose për të dhënë përjasjen ekuivalente në anglisht, apo shqip.

Shënim: Punimi mund të ketë përsëritje vargjesh por të analizuara në aspekte gjuhësore të ndryshme.

KAPITULLI I

VEÇORITË PËRKTHIMORE NË VEPRËN “MAKBETHI”

1.1 Përkthimi dhe përkthyesi

Përkthimi, tashmë, ky është një parim më se i qartë i traduktologjisë, nuk ndodh mes sistemesh, por mes tekstesh. Nëse përkthimi do kishte të bënte vetëm me marrëdhëniet mes dy sistemeve gjuhësore, atëherë sipas atyre që kanë mbështetur idenë se një gjuhë natyrore e detyron folësin të ketë një këndvështrim të vetin për botën do të thoshim se këto këndvështrime për botën janë ndërsjellshmërisht të pamatshme.¹

Një nga konceptet që mbart përkthimi letrar ndaj atyre që kurrë nuk janë përpjekur seriozisht, duke përfshirë këtu praktikantët në fushat e përkthimit teknik dhe komercial, është se si një njeri thotë diçka e cila mund të jetë e rëndësishme, ndonjëherë më e rëndësishme se sa çfarë ai mund të thotë.²

Për Hjelmslevin një gjuhë ka një rrafsh të shprehjes dhe një rrafsh të përmbajtjes, që përfaqëson universin e koncepteve që mund të shprehen nga ajo gjuhë. Secili prej dy rrafsheve përbëhet nga forma e përmbajtja dhe të dy janë rezultat i copëzimit të një komunikimi apo lënde paragjuhësore.³

¹U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 40.

²C. E. Landers, *Literary Translation, A Practical Guide*, British Library, Cataloguing in Publication Data, 2001, p. 7.

³U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria 2006, f. 41.

Sipas Edmond Tupes përkthimi është një veprimtari psiko-gjuhësore, ushtruar nga dikush me gojë a me shkrim me qëllim komunikimi midis bashkësish a individësh që nuk flasin të njëjtën gjuhë. Në rastin e përkthimit letrar, kjo veprimtari ka një rezonancë estetike, që do të thotë se sot në botën e qytetëruar ekziston një shkencë e përkthimit që quhet *traduktologji*, themeluar nga Danica Seleskovitch dhe Marian Lederer, të cilat kanë qenë profesoresha në Shkollën e Lartë të Përkthyesve e të Interpretëve (ESIT) në Paris.⁴

Sipas Tupes sot përkthimi është shkencë dhe si i tillë ai mban lidhje të ngushta me gjuhësinë, psikologjinë, leksikologjinë e leksikografinë. Përkthimi është edhe art. Është i tillë, sepse përkthyesi letrar gjatë procesit përkthimor kryen ndër të tjera një përvetësim estetik të një realiteti gjuhësor, që vetë rrjedh nga një përvetësim, tashmë estetik, i një realitetit jashtëgjuhësor. Sipas tij ka dy lloje përkthimesh, ai i shkrimeve të shenjta, pra i teksteve fetare, dhe ai i teksteve letrare. I pari është thuajse fjalë për fjalë. Ka dhe raste të “përkthyeshmërisë”, si rasti i Kuranit, meqë Zoti është i papërkthyeshem, hoxhallarët e gjithë vendeve të botës lutjet dhe leximin e Kuranit i bëjnë në gjuhën arabe. Në këtë rast bëjnë përjashtim budistët, që mund t’i mësojnë këshillat e Budës secili në gjuhën e vetë amtare.⁵

Përsëri sipas Tupes, përse i përket llojeve të përkthimeve, ekziston përkthimi me gojë dhe përkthimi me shkrim. Në të folmen e përkthyesve interpretë (përkthimi me gojë) përdoret termi *përkthim konsektiv*. Krahas kësaj përdoret dhe termi *përkthim simulant*, ose i njëkohshëm, prej kabinës së vet, me kufje në vesh për ta dëgjuar oratorin e huaj, që ndodhet në sallë para publikut të pranishëm, përkthyesi flet njëkohësisht me këtë orator, në gjuhën e publikut, i cili ndjek me kufje përkthimin e tij.⁶

Rreth përkthimit me shkrim, në ndryshim nga ai me gojë, Tupja thekson se gjatë përkthimit një ligjëratë kthehet nga njëra gjuhë në tjetrën, këtu bëhet fjalë për tekste, kuptimi i të cilëve rishprehet në një gjuhë tjetër. Këto tekste mund të jenë të natyrave të ndryshme: letrare, pragmatike, shkencore apo teknike. Edhe këtu, për të qenë një përkthyes i denjë për këtë emër, nevojiten disa aftësi a dhunti të veçanta.

⁴ E. Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2000, f.11-13.

⁵ E. Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2000, f.113-15.

⁶ E. Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2000, f.12-14.

Sipas Ristanit përkthyesi hyn së pari në kontakt me një tekst a ligjeratë të formuluar në një gjuhë të huaj. Para se ta përkthejë, pra, para se ta formulojë në gjuhën amtare, atij i duhet doemos ta kuptojë atë. Ristani gjithashtu thekson se në përkthim, në mungesë të formave të përkthyer të ligjërit nënstandard, në mënyrë që të shmanget njëtrajtshmëria e përkthimit dhe të përcillen vlerat shprehëse të tekstit, përkthyesi shfrytëzon mënyrën habitore.⁷ Te “Makbethi” Noli shprehet:

What? Can the devil speak true? [Sh:286]

A e thënka të vërtetën djalli? [N:24]

Sipas mendimit tonë, duke u bazuar në shkrimet e autorëve të lartpërmendur, problemi kryesor në përkthim është se duhen kuptuar përbërësit gjuhësorë, domethënë çfarë paraqet *teksti* nga pikëpamja gjuhësore, më pas duhen kuptuar përbërësit e pathënë, *nënteksti*, dhe së fundi paraqitet materiali me të dhëna nga kultura e përgjithshme, pra me një *kontekst* që lidhet me temën për të cilën bëhet fjalë në tekstin apo ligjëratën për t’u përkthyer.

Duke iu referuar sërish Tupes, përkthyesi, ashtu si skulptori, punon me model e për model këtij i shërben fjala e origjinalit. Përsa i përket ndryshimit midis fjalës *përkthej* dhe *shqipëroj* Tupja shkruan se: *përkthej*- kthej me shkrim a me gojë diçka nga një gjuhë në një gjuhë tjetër, duke e ruajtur tërësisht kuptimin e fjalëve e të frazave; *shqipëroj*- përkthej në gjuhën shqipe një vepër letrare të huaj, duke e bërë të tingëllojë sa më shqip. Mund të përkthesh libra të çdo natyre (tekste letrare, politike, teknike etj.), por mund të shqipërosh vetëm libra letrarë.⁸

Sipas tij përkthyesi mund të krahasohet me piktorin apo muzikantin, në këtë mënyrë përkthyesi mund të krahasohet shumë më tepër me piktorin sesa me fotografën, shumë më tepër me muzikantin sesa me magnetofonin, sepse piktori-pikturon, ka krijim në të, ndërsa fotografi merr diçka të gatshme. Po ashtu, muzikanti-komponon, krijon, ndërsa magnetofoni jep diçka të gatshme. Ndaj themi me këmbëngulje se përkthimi është art.⁹

⁷ V. Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f. 168.

⁸ E. Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2000, f.11-17.

⁹ E. Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2000, f.11-13.

Përkthimi për Nolin, sipas Çuçkës, ishte një mision shoqëror dhe jo vetiak, ishte për më tepër një mision shoqëror përparimtar, sepse ishte në shërbim të së vërtetës dhe jo reaksionit. Noli ishte njeri me kulturë të mirëfilltë, jo thjesht me kulturë informacionesh, por edhe me kulturën e të menduarit, të arsyetuarit, të logjikuarit. Ai mbetet i patundshëm edhe sot, qoftë si parim pune, qoftë edhe si kriter vlerësimi për përkthimet.¹⁰

Përkthimet e Nolit janë tepër të arrira. Ai e filloi veprimtarinë e tij si përkthyes në një moshë tepër të re. Në shtator 1905 ai përktheu në greqisht veprën programatike të Rilindjes Shqiptare “*Shqipëria Ç’ka qenë, Ç’është dhe Ç’do të bëhetë*” të S. Frashërit.

Mendojmë se çdo përkthyes ka mënyrën e vetë të përkthimit, qofshin këta vendas a të huaj, dhe sipas Tupes del se dy janë mënyrat kryesore: e para, të kërkosh përsosmërinë e përkthimit në përmbajtje, formë e stil që në fillim, pastaj t’i rikthehesh përkthimit për t’i bërë kontrollat, plotësimet a saktësimet e nevojshme; dhe e dyta, të bësh fillimisht një përkthim të shpejtë, ashtu siç të vjen natyrshëm, pa humbur shumë kohë me nuancat kuptimore, formale e stilistike, pastaj t’i kthehesh e rikthehesh disa herë tekstit të përkthyer, ta krehësh e përsosësh atë pareshtur.¹¹

Roli i dijeve stilistike është i pazëvendësueshëm gjatë përkthimit. Përkthimi nuk është thjeshtë kalimi nga një strukturë gjuhësore në një tjetër, por ridhënia në një gjuhë tjetër e veçorive kulturore-historike të mishëruara në lëndën gjuhësore, duke kaluar nga një traditë në një tjetër formë të komunikimit, të rrëfimit, të përshkrimit, të dialogut, të përçimit të ngarkesës emocionale, të tonalitetit, të përfimit, të shprehësisë.¹²

Viktor Ristani në lidhje me përkthimin thekson se përkthyesi në lidhje me elementet e tjerë të tekstit, duke lënë mënjatë fshehtësinë gjuhësore, përkujdeset që në gjuhën shqipe të ndjehet aroma e veçantë e ligjëritimit. Këto elemente përkthyesi i realizon nëpërmjet ndërthurjes së elementeve bisedore.¹³ Më tej ai shkruan se më komplekse dhe të ndërlikuara janë marrëdhëniet ndërmjet skemës së gjuhës, përkatësisht normës gjuhësore dhe gjuhës së letërsisë, përkatësisht stilit të veprimtarisë letraro-artistike, gjuhës së veprave letraro-artistike, e cila vendos një marrëdhënie të veçantë me skemën e gjuhës,

¹⁰ Sh. Çuçka, *Noli simbol i përkthimit shqiptar*, m.k.balkanweb, 26 dhjetor, 2015.

¹¹ E. Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2000, f.11-13.

¹² Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 16.

¹³ V. Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f. 199.

duke përdorur elemente gjuhësore me qëllim që të krijojë skema të reja të tyre.¹⁴ Duke iu referuar asaj çka u tha më sipër Noli ia ka arritur shumë mirë këtij synimi stilistik.

Sipas Nasho Jorgaqit Noli zotëronte mbi dhjetë gjuhë, dhe unë mendoj se kjo ishte dhe arsyeja që ai kishte përkthyer disa vepra letrare e fetare në fillim të karrierës së tij si përkthyes, duke na dhënë dhe *ngjyrim stilistik*. Në mënyrë që të ishte sa më i aftë dhe zotërues i gjuhës, Noli ndoqi studimet në Universitetin e Havardit, si universiteti më i vjetër në SHBA. Këto përpjekje dhe studime ndihmuan në cilësinë e përkthimeve të tij të mëvonshme. Ai studionte dhe vazhdonte të përkthente në të njëjtën kohë. Të gjitha shqipërimet e tij janë bërë nga tekstet origjinale nga anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, po dhe nga jahudishtja, duke i shoqëruar me shënime ose komente, që flasin për njohuritë e gjëra dhe aftësitë e shijen e tij të hollë në këto gjuhë.¹⁵

Përkthimet e Nolit e kanë nismën që kur ishte në Greqi. Ai përktheu 11 libra liturgjikë dhe 3 vepra nga letërsia biblike, duke ia kaluar për nga numri dhe përkthimeve kishtarë që kish kryer në gjuhën shqipe. Asnjë klerik i lartë i ortodoksisë amerikane nuk kishte arritur të bënte një punë siç e realizoi prelati shqiptar.¹⁶

Për Nolin sipas Jorgaqit letërsitë më të mëdha ishin shkrimet e shenjta. Bibla ishte libri i parë në gjuhën shqipe që Noli kishte lexuar, ndaj përkthimi i *Dhjatës së Re* ishte i një rëndësie të madhe. Ai vendosi ta përkthejë anglisht dhe jo shqip, sepse në gjuhën shqipe ajo ishte përkthyer nga Kristoforidhi, dhe përkthimi i saj në anglisht ishte dëshira e Nolit.¹⁷

Noli, sipas tij, punoi për afro njëzet vjet për kishën ortodokse panamerikane, duke përkthyer mijëra faqe nga letërsia liturgjike dhe biblike. Ai i ripunoi përkthimet e para, duke i ripërkthyer edhe njëherë me një gjuhë bashkëkohore me nivele të larta cilësore. Ai unifikoi gjuhën e predikimit mbi të cilën u ngrit bashkimi i gjithë Kishave Ortodokse Lindore në SHBA. Ai pati sukses në përkthimet, sepse tekstet duke qenë në pjesën më të madhe të natyrës poetike i përkthente lirisht, sepse ishte vetë poet¹⁸.

¹⁴V. Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f. 19.

¹⁵ Nasho, Jorgaqi, *Jeta e F. S. Nolit*, Ombra GVG, vëll. I, 2005, f. 308-3012.

¹⁶ N. Jorgaqi, *Jeta e F. S. Nolit*, Ombra GVG, vëll. I, 2005, f. 308-3012.

¹⁷N . Jorgaqi, *Jeta e F. S. Nolit*, Ombra GVG, vëll. I, 2005, f. 300-3015.

¹⁸N . Jorgaqi, *Jeta e F. S. Nolit*, Ombra GVG, vëll. I, 2005, f. 308-3020.

Punimet e Nolit para së gjithash shquhen për qartësinë e tyre kuptimore për faktin se edhe sot shqipja e shkruar, shqipja letrare, ka kryer përparime të jashtëzakonshme, që përbëjnë krenari për shkencën tonë gjuhësore. Shqipja letrare e tij mbetet për lexuesin thellbësisht e kuptueshme, e qartë estetikisht dhe e këndshme. Fan Noli mbetet simbol i përkthimit shqiptar me përvojë të madhe. Ai është ndër ato figura jo të shumta të historisë sonë, të cilat kanë spikatur me vlerat e veprimtarisë së tyre në të gjitha fushat ku janë përfshirë. Ai ka qenë publicist, politikan, burrë shteti, poet, klerik, kritik i letërsisë, historian, muzikant dhe përkthyes.¹⁹

1.2 Noli dhe “Makbethi”

Fjalori i zgjedhur në veprat e përkthyer nga Noli ka stil dhe ngjyrim. Me përftesa apo procedë të ndryshme ai krijon fjalë, të cilat përdoren në situata të ndryshme, të këndshme dhe jo të këndshme.

Sipas Umberto Ecos të përkthesh nga një gjuhë në një tjetër do të thotë të kesh pengesa e vështirësi të pashmangshme. Kjo do të konfirmonte idenë e Humboldt-it se çdo gjuhë ka gjenialitetin e vetë, se çdo gjuhë shpreh një variant të ndryshëm të botës.²⁰

Në një tekst verbal është themelore substanca thjesht gjuhësore, por jo gjithmonë është më e rëndësishmja. Kur kemi fjalinë *passami il sale* (kalomë kripën) dimë që mund të shprehë zemërim, mirësjellje, sadizëm, druajtje, në varësi të mënyrës si shqiptohet, dhe mund të dallojmë kumtuesin si njeri të kulturuar, të pagdhendur apo komik, nëse theksi i tij është dialektor. Këto vlera do të na komunikojnë edhe nëse fjalia do ishte *passami l'olio*-kalomë vajin. Këto janë të gjitha dukuri që gjuhësia i konsideron si mbisegmentore dhe që nuk kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me sistemin e gjuhës.²¹

Umberto Eco, përsa i përket përkthimit të poezisë, mbështet bindjen e përbotshme se në poezi është shprehja ajo që kryeson mbi përmbajtjen. Pra, përmbajtja, si të thuash, duhet të përshtatet me këtë pengesë të shprehjes. Parimi i prozës është *rem tense, verba sequuntur*, ndërsa parimi i poezisë është *verba tene, res sequuntur*.²² Ndërkohë Noli i ka kaluar këto vështirësi.

¹⁹ Sh. Çuçka, *Noli simbol i përkthimit shqiptar*, m.k.balkanweb, 26 dhjetor, 2015.

²⁰ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 39.

²¹ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 58.

²² U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 60.

Fan Noli nuk ka hedhur në letër një ngjarje që e ka jetuar vetë drejtpërsëdrejti, por çfarë ka lexuar të shkruar tashmë nga Shakespeare-i. Përdërisa kemi përvetësim estetik, qoftë të një realiteti tashmë estetik, kemi art, sepse kemi krijim të mirëfilltë, ndonëse kemi njëkohësisht edhe rikrijim. Kemi krijim në rrafshin gjuhësor, meqenëse Shakespeare-i nuk e ka shkruar “Hamletin” në gjuhën shqipe, por në gjuhën angleze, në gjuhën shqipe atë e “ka shkruar” Fan Noli, domethënë se në shqip atë e ka krijuar ky i fundit.²³

²³ E. Tupja, *Këshilla një përkthyesi të ri*, Onufri, Tiranë, 2000, f. 12.

Në rrafshin leksikor interpretuesi mund të jetë madje një sinonim, ndërsa për Piercein interpretuesi mund të jetë një ligjëratë komplekse që jo vetëm përkthen, por rrjedhimisht shtjellon të gjitha mundësitë logjike të përfshira nga shenja, një silogjizëm i deduktuar nga një hyrje e rregullt, që në dritën e një teorie të interpretuesve të Pierce-it mund të shihet si pragmatika më e madhe.²⁴

Noli në përkthimet poetike bëri punën e një rikrijuesi saqë mjaft nga ato mund të mbahen si krijime të tij. Prandaj lexuesi nuk habitet kur sheh që Kadareja vargun “dasmë që shkrepëtinte nga zia”, përkthyer nga Noli prej një poezie të poetit rus Fjodor Tjutçev, e sjell për ilustrim si varg të vetë Nolit.²⁵

Kështu, me fjalë dhe sinonime të ndryshme të krijuara prej tij, Noli përktheu tragjedinë e “Makbethit”, e cila është cilësuar si tragjedia më “e tmerruar” që ka dalë nga pena e Shekspirit, është pasqyra e historisë së Skocisë, tragjedia e ambicjes kriminale, mëkatit dhe punitja jo në ferrin e jetës tjetër, po në ferrin e kësaj jetë.²⁶ Ai është mjeshtër në gjetjen e fjalës për të krijuar lidhjen e fjalës me shqipërimin e “Makbethit”. Noli bën që në ligjërimin e tij fjala të jetë e saktë, ashtu siç e përjeton vetë ai, sepse për atë fjala është forcë.

Till he unseam'd him from the nave to the chaps[Sh:284]

Gjersa ia shthuri nofullat. [N:14]

I have begun to plant thee [Sh:285]

Të kam mbjellur mu në zemër. [N:29]

Emocioni që buron në këtë fjali është shumë i fortë: *të kam mbjellur mu në zemër*, të kam shumë për zemër. Kështu, përkthimi, përveç të tjerash, është edhe stil.

Përkthyesi duhet të strukturojë në gjuhën e përkthimit një tekst, i cili të ndërthurë saktësinë semantike me funksionalitetin pragmatik në një kontekst të ri gjuhësor dhe kulturor në përshtatje me kushtet e komunikimit dhe situatën ligjërimore. Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se stili duhet të mos konsiderohet thjesht si zbukurim dhe stisje gjuhësore, por, përkundrazi, si mënyrë e përshtatshme e përdorimit të mundësive shprehëse të gjuhës në një situatë të caktuar, duke respektuar strukturën e përgjithshme gjuhësore të gjuhës së përkthimit.²⁷

²⁴ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 91.

²⁵ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi*, Toena, Tiranë, 1999, f. 149.

²⁶ F. S. Noli, *Poezi të zgjedhura*, Përkthime, Introdakta, Dituria, 1998, f. 119.

²⁷ V. Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f. 208.

Shprehësia e leksikut të Nolit ka burime të ndryshme. Në studim janë analizuar disa nga burimet kryesore të shprehësisë në përkthimin e tragjedisë së “Makbethit”.

Në përkthimin e “Makbethit” Noli hodhi në letër gjithsej 2452. Për të dhënë një ide sa më konkrete të llojit të veprimtarisë përkthyesë të Nolit po japim një tabelë me të dhëna statistikore mbi tipat e mënyrat e përkthimit të realizuara nga Noli, duke iu përgjigjur disa pyetjeve, të cilat dolën gjatë realizimit të studimit.

Nr.	Lloji i përkthimit	Nr. i vargjeve	%
1	Përkthim fjalë për fjalë	2142 vargje	87%
2	Përkthim kontekstual	156 vargje	6.3%
3	Përkthim me fjalë të shtuara	64 vargje	2.6%
4	Përkthim me përshtatje	40 vargje	1.6%
5	Përkthim me fjalë të hequra	35 vargje	1.5%
6	Përkthim me shtim idesh + opinione	15 vargje	0.6%

Tab. 1

Siç shihet dhe nga tabela përkthimi *fjalë për fjalë* zë vendin e parë me 87% të vargjeve. Me këtë nuk duhet të kuptojmë se renditja e fjalëve në përkthim është si në gjuhën angleze, por duke iu përshtatur rregullave të strukturës së gjuhës shqipe. Clifford E. Landers shprehet se: “Faktikisht, përkthimi fjalë për fjalë krijon më shumë rrjedhshmëri dhe transparencë”.²⁸

Sit, worthy friends. My lord is often thus. And hath been from his youth. Pray you, keep seat. The fit is momentary: upon a thought. He will again be well. If much you note him. You shall offend him and extend his passion. Feed and regard him not (outside to Macbeth). Are you a man? [Sh:298]

Rrini. Mbreti është shpesh kështu, se e ka pasur prej djalërie. Ju lutem rrini. Kjo tronditje mban një çast dhe bëhet menjëherë mirë. Po mos e vini re se zemërohet, dhe ca më keq sëmundja na i ndizet. Mos vini re, po hani! -A je burrë? [N:87]

²⁸ C. E. Landers, *Literary Translation, A Practical Guide*, Great Britain, Cromwell Press, LTD, 2001, f. 55.

Prithee, see there! Look! Lo! How say you? Why, what care I ? If thou canst nod, speak too. If charnel houses and our graves must send those that we bury back, our monuments, shall be the maws of kites. (Exit Ghost) [Sh:298]

Të lutem shih atje! Shiko!- Si the? Si? Ç'kam? Posa tund kokën, folmë! Kur varret nxjerrkan jashtë të varrosurit, kufomat mos na i mbuloni fare, po hidhuani korbave ta hanë (fantazma zhduket). [N:88]

Be innocent of the knowledge, dearest chuck, till though apploud the deed. Come, seeling night, scarf up the tender eye of pitiful day, and with thy bloody and invisible hand, cancel and tear to pieces that great bond. [Sh:297]

E dashur, mos e dij, po prit, të bëhet dhe të ma dorëtrokaç. Eja, o natë syverbonjëse, mbuloja ditës dritën dhembjeplotë. E bëj batall e çirre copra-copra, me dorën e përgjakur të padukur. [N:79]

Kur na duhet të krahasojmë përkthimet e quajtura *fjalëpërfjalshme* me shumë përkthime të quajtura ndërsemiotike duhet të pranojmë se të shumte janë ato që e konsiderojnë një interpretim të tillë, sepse ky lloj përkthimi risjell gjendjen shpirtërore që kërkonte të sillte teksti poetik.²⁹

Nga analiza e përkthimeve të vargjeve në vend të dytë janë përkthimet kontekstuale. Ky lloj përkthimi zë 6.3% të vargjeve të përkthyer. Përkthyesi duhet të njohë jo vetëm gjuhën, por edhe kulturën e vendit për të cilën është shkruar teksti që po përkthen, për këtë arsye, siç thotë dhe Umberto Eco, sistemet gjuhësore janë të krahasueshme dhe keqkuptimet e rastit mund të zgjidhen kur përkthehen tekste në dritën e konteksteve dhe duke iu referuar botës për të cilën ky tekst i caktuar flet. Noli ka shumë njohuri, jo vetëm gjuhësore por edhe kulturore, prandaj në përkthimet e tij ai shpesh përdor kontekstet dhe nënkontekstet.

*Nought's had, all's spent. Where our desire is got without content. 'Tis safer to be that which we destroy, than by **destruction dwell** in doubtful joy. (enter Macbeth), How now, my Lord! Why do you keep alone of sorriest fancies your companions making. Using those thoughts which should indeed have died, with them they think on? Things without all remedy, should be without regard. What's done is done. [Sh:296]*

Të gjitha i humbasim, gjë s'fitojmë, kur mbushim një dëshirë e s'e gëzojmë. Pa lavd në krye jemi ca më mirë, se sa pastaj me lavd e gaz të nxirë. (hyn Makbethi) - Imzot i dashur,

²⁹ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 63.

ç'rrri i vetëm i mejtuar, dhe humbet mendjen me ata që vdiqnë? Një gjë që s'ka shërim duhet harruar: Ç'u bë u bë. [N:77]

Një përkthim nuk varet vetëm nga konteksti gjuhësor, por edhe nga diçka që qëndron përtej tekstit, që do ta quajmë informacion mbi botën ose informacion enciklopedik.³⁰ Te vargjet e sipërpërmendura Noli arrin që me anë të përkthimit kontekstual të na pajisë me informacionin rreth trashëgimisë së fronit mbretëror.

Ne mendojmë se për t'i dhënë përkthimit një kuptueshmëri sa më reale dhe ta bëjë atë sa më të besueshëm Noli në disa vargje ka kompensuar mendimin, duke shtuar ndonjë fjalë a shprehje, të cilat nuk janë në origjinal. Për këtë Umberto Eco thotë se: “Sieburth-i, njësoj si unë, shton një varg për të rifituar ndonjë humbje të mëparshme apo të mëvonshme”.³¹ Ky fenomen vërehet dhe te Noli.

My dearest love, Duncan comes here tonight. [Sh:288]

E dashur, drit' e syrit tim, vjen sonte Dunkani këtu. [N:34]

Në këtë shembull unë mendoj se Noli ka përforcuar fjalën e dashur me *drit' e syrit tim*, por ai e ka parapëlqyer dublimin, ku gjymtyra e dytë, e shtuar prej tij, *drit' e syrit tim*, funksionon si barazvlerë shprehëse për gjymtyrën e parë, duke krijuar sinonimi kuptimore.

We are men, my liege. [Sh:295]

Jo, jemi burra që të dy, imzot. [N:73]

Mendojmë se Noli, duke e krahasuar me origjinalin, ka shtuar duke e kompensuar me pjesëzën *jo* dhe *që të dy* për të përforcuar mendimin. Edhe në këtë rast ai ka parapëlqyer dublimin *që të dy*.

It will be rain tonight. [Sh:297]

Si duket sonte do të kemi shi. [N:82]

Fjalinë Noli e ka zgjeruar duke shtuar elementin *si duket*.

Third murderer 'Tis he. First murderer: Stand to 't. [Sh:297]

I treti vrasës: Ësht' ai. I pari vrasës. I bini pra, o burrani! [N:81]

Shprehjen në origjinal të Shekspirin *-stand to 't* -Noli e ka zgjeruar duke shtuar elementë për ta bërë shqipërimin sa më të besueshëm, sepse veprimet që do të kryejë më vonë Makbethi janë goditjet për të vrarë Bankon.

³⁰ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 34.

³¹ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 80.

Here my good lord. What is 't that moves your Highness? [Sh:298]

Këtu imzot. Ç'ju tremb e ç'ju tmerron? [N:87]

Noli ka përforcuar mendimin duke shtuar një element sinonimik për ta bërë sa më të besueshme dhe reale ngjarjen në mënyrë që të tingëllojë sa më shqip. Noli përdor dublimin *tremb* e *tmerron*. Nga shembujt e sipërpërmendur, sipas nesh, ashtu siç thotë dhe Eco, të përkthesh nuk mjafton të krijosh një interpretues të termit, të fjalisë apo të tekstit original. Pierce thotë se interpretuesi është ai që më bën të di diçka më shumë. Ndonjëherë përkthyesi mund të më thotë edhe diçka më shumë, që në krahasim me një tekst që duhet përkthyer është diçka më pak.³²

Nga studimi nxorrëm një tjetër veçori në stilin e përkthimit të Nolit, është përkthimi me përshtatje. Kjo mënyrë përkthimi zë 1.6% të vargjeve të përkthyer. Për këtë Umberto Eco shkruan se: “Një parim i arsyeshëm i kthyeshmërisë do kërkonte që thëniet dhe shprehjet idiomatike të përktheheshin jo fjalë për fjalë, por duke zgjedhur shprehjen e thënien që përkon me ato në gjuhën ku do të përkthehet”.³³

What are these, so withered and so wild in their attire? [Sh:285]

Ç'janë këto të fishkura dhe rrobëçjerra? [N:20]

Fjalën *attire* që ka kuptimin *veshje* Noli e ka përshtatur *rrobëçjerra*. Ndoshta, sipas mendimit tonë, Noli na paralajmëron se ka të bëjë me magjistricat. Ai ka bërë një përshtatje të mrekullueshme përkthimi, gjë që e bën lexuesin të presë me ankth për të mësuar se cilat janë këto rrobëçjerra.

*Those of his chamber, as it seem'd, had done 't. Their hands
and faces were all badged with blood. [Sh:293]*

Si duket do ta kenë bërë Shambellanët. Me gjak i kishin duart edhe faqet. [N:60]

Në këto vargje Noli ka përshtatur fjalën e origjinalit faces (fytyra) me faqet.

*I wish your horses swift and sure of foot. And so I do commend
you to their backs . Farewell. [Sh:295]*

Uroj të t'ecë mirë kali. Udhën e mbarë dhe u kthefsh shëndoshë! [N:70]

Një tjetër karakteristikë në përkthimin e Nolit është heqja e disa fjalëve. Umberto Eco thotë se të përkthesh do të thotë gjithnjë “të lëmosh e hedhësh tutje” disa prej rrjedhojave që fjala në

³² U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 92-93.

³³ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 72.

original i përmbante. Në këtë kuptim, duke përkthyer *nuk thuhet kurrë e njëjta gjë*. Interpretimi që paraprind çdo përkthim duhet të përcaktojë sa dhe cila nga rrjedhojat e mundshme deduktuese që sygjeron fjala mund të hidhen tutje, pa qenë kurrë krejt të sigurt se nuk kemi humbur një reflektim ngjyrë ultraviolett, një aluzion infrakuq.³⁴ Noli ka vepruar në këtë mënyrë që vargjet të tingëllojnë sa më shqip, pa i prishur kuptimin fjalisë.

Thou'rt mad to say it. Is not thy master with him, who, were't so.

Would have informed for preparation? [Sh:288]

Mos je i marrë që më thua gjë t'atillë? [N:33]

Vargun e dytë dhe të tretë Noli nuk i ka përkthyer. Siç vihet re, ai ka përkthyer vetëm vargun e parë, dy të tjerët i ka hequr. Unë mendoj se përkthyesi e ka parë të tepërt të shkruajë sqarimet e zonjës Makbeth sepse kur nocioni i përmbajtjes thelbësore na lejon të përdorim një ide ekuivalente kuptimi më të qartë, ai përfaqëson një kufizim si të thuash më të vogël, një kriter minimal të proceseve të përkthimit, por jo një parametër absolut.

Some say, the earth was feverous and did shake. [Sh:292]

Dhe u trondit, u drodh i tërë dheu. [N:57]

Në vargun e sipërpërmendur Noli ka eliminuar thënien *some say - disa thonë*. Nisur nga kjo mund të themi se kalimi i menjëhershëm i jep bukuri vargut në gjuhën shqipe.

Ay, Madam, but returns again tonight. [Sh:296]

Po kthehet sonte përsëri. [N:76]

Siç vihet re, nëse do të krahasojmë vargjet e Shekspirin në anglisht dhe përkthimin e tyre në shqip mund të themi se Noli ka eliminuar, *Ay, Madam - he zonjë*. Edhe pse janë hequr fjalët kuptimi i vargut nuk prishet, sepse Noli është përqëndruar te veprimi i Bankos.

Së fundi nga studimi i përkthimit të “Makbethit” rezulton se vetëm 15 vargje ose 0.6% janë përkthime të cilat Noli ka pasuruar vargun, duke shprehur idetë apo opinionin e tij. Sipas Ecos: “Gjuhëtari duhet të nisë kështu, të përpunojë një sërë hamendjesh analitike që e bëjnë të krijojë një manual përkthimi, që duhet të përkojë me një manual të tërë, jo vetëm të gjuhësisë, por edhe të antropologjisë kulturore”.³⁵

Një përkthyesi, të cilit i duhet të kthejë një tekst nga anglishtja në një gjuhë tjetër, i duhet të bëjë një sërë hamendësimesh mbi kuptimin në të cilin përdoret në një kontekst të caktuar, p.sh.

³⁴U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 99.

³⁵ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 40.

fjala *grandchild*. Përkthyesi përkthen gjithnjë tekste, pra, do të thotë kumtime që shfaqen në një kontekst gjuhësor apo shqiptohen në ndonjë situatë specifike.³⁶ Duke u bazuar tek Umberto Eco gjatë këtij lloji përkthimi mund të ketë humbje (të hiqen fjalë a shprehje), të cilat mund të kompensohen me rrëfime që mund të hamendësohen nga rrëfimtari, i cili është shijehollë, p.sh:

Good things of the day begin to *droop* and drowse. Whiles
nights black agents to their preys do rouse. [Sh:297]

Pëllumb' i ditës nisi dhe dremit. *Kuçedr'e natës* dhëmbët pregatit. [N:79]

Noli ka dhënë mendimin e tij duke shqipëruar *good things* of the day me *pëllumbat*, të cilët mund të simbolizojnë *njerëzit e mirë* etj. Mendojmë se Noli ka përdorur *pëllumbat* për vetë faktin se kjo krijesë personifikon paqën, njerëzit e mirë. Ai ka hequr fjalën *droop*, që nënkupton lodhjen e venitjen. Është Noli-poet që ka ditur mjaft mirë të bëjë lidhjen, duke dhënë kontrastin *Pëllumb' i ditës* me *Kuçedr'e natës*.

*If the assassination, could trammel up the consequence, and catch with
his surcease success; that but this blow, might be the be-all and
the end-all here, but here, upon this bank and shoal of time. [Sh:289]
Sikur kjo vrasje, të përjashtonte çdo pasojë dhe të kapte suksesin me
mbarimn' e saj, sikur kjo vepër një her' e mir' hesapn e saj ta mbyllte,
pa lënë bisht e gjurm' e hije pas. [N:38].*

Noli ka bërë jo thjesht një zgjerim, por ai ka dhënë një ide të tij të shprehur me anë të një vargu të tërë, i cili nuk është në origjinal (*pa lënë bisht e gjurm' e hije pas*).

Gjatë analizës së përkthimit rezultoi një tjetër veçori në përkthimin e Nolit. Në shqipërim Noli nuk i mbetet strikt faktit që pjesët e ligjëratës të mbeten të pandryshueshme. Ka raste kur foljen nuk e shqipëron folje, por bën përshtatje kontekstuale.

*I know this is a joyful trouble to you, But yet 'tis one. [Sh:292]
E di që të gëzon ky shqetësim, po është një mërzitje prapë. [N:56]*

Nëse do të ishte përkthim strikt, ku të mos ndryshonin pjesët e ligjëratës, do të ishte shqetësim *i gëzueshëm* (mbiemër), por Noli ka preferuar ta përkthejë *të gëzon* (folje) ky shqetësim, për ta bërë kundrinorin (ty) të përjetojë një akt, i cili është *të gëzon*. Stilema e përfutur është me ngjyrim poetik.

³⁶ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 46-47.

Mendoj se Noli ishte mjeshtër në përkthimet e veprave letrare artistike, duke përdorur një ligjërim të pasur. Në sajë të informacionit të tij enciklopedik, ligjërimi i tij është tej mase i përkryer. Askush tjetër deri më sot nuk ka arritur t'i përkthejë aq bukur me një leksik të përbërë nga krijime ku spikasin thellësia e mendimit, imponimi i ndjenjës për vrasje, për pushtet, mundësisë së plotësimit asociativ nga ana e lexuesit. Përkthimet dhe krijimet e tij karakterizohen nga frymëzimi dhe përjetimi i vërtetë shpirtëror. Te Makbethi del në pah reagimi i fortë emocional ndaj problematikës që magjistricat e kanë frymëzuar.³⁷

1.3 Procedetë leksiko-semantike. Mbi konceptin vlerë stilistike, ngjyrim stilistik, ngjyrim shprehës i rendit afektiv dhe semantik.

Termi *procede* sipas fjalorit është çdo qasje individuale e krijimit artistik, si dhe transformimi i gjuhës së përditshme në atë poetike. Po këtë qasje formalistët rusë të shekullit XX e quanin procedurë për të përshkruar transformimin e gjuhës së përditshme në atë poetike. Sipas gjuhëtarit frëng Charl Bali, që mbahet si themeluesi i stilistikës gjuhësore, i kësaj disipline të re të shkencës mbi gjuhën, e cila ende nuk është ngjizur sa dhe si duhet, stilistika merret me studimin e mjeteve të shprehjes në të folurit e një bashkësie gjuhësore nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre ndjenjësore (afektive), d.m.th shprehja e fakteve të ndjenjësorisë nëpërmjet ligjëritimit dhe veprimi i fakteve të gjuhës mbi ndjenjësitë. Stilistika është një majë, *sui generis*, e studimit të gjuhës, një bazë teorike e zhvillimit të kulturës gjuhësore kombëtare.³⁸

Ndërsa sipas Xhevat Lloshit, themi se mënyra me të cilën ndërtohet dhe përftohet stilema quhet përftesë. Përftesa (në vend të huazimit *procede*) është mekanizmi i brendshëm gjuhësor i stilemave ose i tufës stilemore. Stilema është një produkt i gatshëm i ligjëritimit, të cilat kanë marrë trajtë, ku proceset e saj të brendshme janë kristalizuar.³⁹

Përftesat ose procedet janë përpunime plotësuese që u bëhen mjeteve e lidhjeve gjuhësore parësore, janë alternativë kundrejt lidhjeve të zakonshme, ose dhe lidhjeve të panjohura më parë.

³⁷ F. S. Noli, *Poezi të zgjedhura*, Përkthime, Introdakta, Dituria, 1998, f. 119.

³⁸ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi*, Toena, Tiranë, 1999, f.147- 148.

³⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 25.

Sipas Xhevat Lloshit në rastin, *përkthen anglisht-përkthen në gjuhën angleze*, po të zëvendësojmë një ndajfolje me një tog të zbërthyer do të kemi një togfjalësh me ngjyrim libror. Mekanizmi i këtij togfjalëshi është pikërisht ky zbërthim, kjo është *përftesa* ose *procedaja* e tij e brendshme:

ndajfolje = parafjalë + emër + mbiemër (nga e njëjta temë fjalëformuese me ndajfoljen).

drejt, bukur = në mënyrë të drejtë, në mënyrë të bukur.

Përftesat ose procedetë krijojnë një strukturë karakteristike, stilema kthehet në tog të gjymtyrëve përbërëse, përftohet një vlerë e re. Madje, kur ndryshon gjymtyrë atëherë del në pah se e ka struktura këtë vlerë të re, ruhet vetia stilistike e përftuar edhe me zëvendësime, p.sh. poezia “*Kënga e ushtarëve të vdekur*” e Ismail Kadaresë nis me vargun “*Nga lufta vijmë, në luftëra shkojmë*”. Janë dy fjali me rend paralel, i cili vë në pah kontrastin semantik, dy parafjalë antonime dhe dy folje antonime, madje edhe emri me dy trajta në opozicion. Këtë strukturë të brendshme e kanë shfrytëzuar publicistët për të ndërtuar stilema të tjera. Stilema është një produkt i gatshëm i ligjëritimit, ku kanë marrë trajtë, janë kristalizuar proceset e saj të brendshme, procedetë. Me pjesëmarrjen e disa procedeve (përftesave) dhe të një ose disa niveleve të gjuhës për ndërtimin e një stileme, tabloja reale në tekste bëhet mjaft e ndërlikuar.⁴⁰

Shkrimtarët i shfrytëzojnë në mënyra të ndryshme mjetet e mundësitë e gjuhës sipas gjinive dhe temave të parapëlqyera dhe prirjeve të tyre. Kështu, puna mjeshtërore e shkrimtarëve me mënyrat shprehëse gjuhësore të përdorura në krijimtarinë e tyre përbëjnë stilin e secilit autor, duke dhënë larminë stilistike të letërsisë shqiptare.

Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se, stili duhet të mos konsiderohet thjesht si zbukurim dhe stisje gjuhësore, por, përkundrazi si mënyrë e përshtashme e përdorimit të mundësive shprehëse të gjuhës në një situatë të caktuar duke respektuar strukturën e përgjithshme gjuhësore të gjuhës së përkthimit.⁴¹

Rexhep Qosja për stilin e Nolit mendon se bukuria e tij mbështetet kryesisht në ndërtimin sintaksor të fjalive dhe në renditjen e tyre sipas një ritmi gati poetik në prozë. Noli është frymëzuar nga shumë aspekte për të paraqitur veçori ligjërimore të rrafshit leksikor, duke përdorur shumë burime shprehësie. Burimet e shprehësisë janë vështruar si në aspektin teorik të

⁴⁰Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 26.

⁴¹V. Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f.208

përgjithshëm, ashtu edhe në aspektin konkret të veçantë, d.m.th dukuria në ligjërim, është e lidhur me aspektin funksional dhe me vlerën e përdorimit shprehës në situata të ndryshme.⁴²

Trajtimi i konceptit *vlerë stilistike* përmban *ngjyrimë stilistike*, të tilla janë gjurmët që lënë në fjalë rrethi i përdorimit të saj të zakonshëm; *ngjyrimë ekspresive*, të rendit semantik dhe afektiv, që mund t'i shtohen përdorimit të saj të zakonshëm. Një gjuhë u asocion formave të ndryshme të shprehjes, formave të ndryshme të përmbajtjes.⁴³

Kontinuumi i ngjyrave apo lënda e përmbajtjes do ishte gjithë sa mund të mendohet e mund të klasifikohet, por gjuhët e ndryshme dhe kulturat e ndajnë këtë kontinuum në mënyra kaq të ndryshme, për këtë qytetërimë të ndryshme e copëzojnë kontinuumin e ngjyrave në mënyra të ndryshme aq sa duket e pamundur të përkthesh një fjalë që tregon ngjyrë e që ka kuptim në gjuhën **Alfa** në një fjalë që tregon ngjyrë tipike të gjuhës **Beta**.⁴⁴

Në teori ky do ishte një rast në të cilin ekuivalenca referenciale (sigurisht John's daddy është saktësisht i njëjti person me *John's father*, *le pere de John*, ose *il papa di John*) nuk përkon me ekuivalencën ngjyruese, që ka të bëjë me mënyrën se si fjalët apo shprehjet e përbëra mund të nxisin në mendjen e dëgjuesve apo të lexuesve të njëjtat asocime dhe reagime emotive.⁴⁵

Në stilin e Nolit kanë ndikuar shkrimet biblike e veçanërisht mitologjike. Janë fjalët ato të cilat kanë ose fitojnë në ligjërim vlera stilistike, të cilat veç kuptimit stilistikor përmbajnë dhe ngjyrimë rendesh të ndryshme. Fjalë të tilla përbëjnë fondin specifik të ligjërimit artistik. Këto fjalë shenjojnë me gjallëri emocionale, mendore dhe bëjnë ngjyrosje ideostilistike të përmbajtjes. Ato luajnë rol mbizotërues kuptimor dhe estetik. Në këtë mënyrë fjalët bëhen përçuese të artit e të stilit të shkrimtarit. Përdorimi i tyre si dhe elementët e tjerë të formës kushtëzohen nga përmbajtja dhe talenti i shkrimtarit.

Në të gjithë koleksionin e shkrimeve "In Memoria", për Fan Nolin, eseja e Eqrem Çabejt është më e sakta, me një stil të fuqishëm. Eqrem Çabej portretizon profilin madhështor dhe shumëdimensional të Fan Nolit. Kjo ese mbetet si një model mendor, një *modus vivendi*, si mund të shkruhet mbi një figurë që vjen shumë rrallë në histori, që buron nga thelbi i shekujve. Eqrem

⁴² F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi*, Toena, Tiranë, 1999, f. 31.

⁴³ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi*, Toena, Tiranë, 1999, f. 31.

⁴⁴ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 42.

⁴⁵ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 29.

Çabej nuk mëton të tregojë se Fan Noli si shkrimtar, përkthyes, poet dhe dijetar është njeriu pa ekselencë, pikërisht prototipi i krijuesit, sepse Fan Noli ka diçka demoniake, e cila mbase është vetia e parë e njëriut krijues, qetësia e mirëfilltë e *furor poeticus*, e marrëzisë së poetit të vërtetë. Tekstet e Fan Nolit për gjuhësinë dhe sidomos për vëllimin e studimeve etimologjike janë të një niveli shkencor. Ai operon me nocione të përpikta për nivelin bashkëkohor të gjuhësisë botërore.⁴⁶

Sipas Rami Memushaj fjala është jo vetëm njësia bazë e leksikut, por edhe një nga njësitë themelore të gjuhës. Të gjitha njësitë e tjera mund të kuptohen dhe të përcaktohen vetëm në lidhje me të, qofshin këto njësi me kuptim apo njësi pa kuptim. Njësitë, si fonemat, rrokjet dhe morfemat nuk gjëlljnë dot në të folur jashtë fjalëve, po ashtu edhe sintagmat dhe fjalitë nuk formohen dot pa fjalë.⁴⁷ Kështu, fjalët luajnë rol mbizotërues kuptimor dhe estetik te Noli. Në këtë mënyrë fjalët bëhen përçuese të artit e të stilit të shkrimtarit. Përdorimi i tyre si dhe elementet e tjerë të formës kushtëzohen nga përmbajtja dhe talenti i shkrimtarit. Në pjesën e poshtëshënuar Noli shprehet:

Are ye fantastical, or that indeed. [Sh:286]

Për Zotin, jini vallë pamje fantazie. [N:21]

Në të folurën e përditshme do të ishte **po fantazon pamje**, produkt i fantazisë, duke e përdorur emrin fantazi në rasën rrjedhore me funksion atributi, fantazie. Togu **pamje fantazie** është më pak i përdorur në të folur dhe është karakteristikë për gjuhën e shkruar, sidomos atë artistike. Në shembullin e dhënë më poshtë krijohen rende paralele:

And say which grain will grow and which will not. [Sh:286]

E të më tregoni ç'mbin e ç'nukë mbin. [N:21]

Fraza **ç'mbin**, supozon tekstin informues, dhe **ç'nukë mbin**, supozon tekstin përforcues. Të dyja këto, **ç'mbin dhe ç'nukë mbin**, paraqesin ide me raporte përforcuese. Kallëzimi paralel flet për pritjen e gjatë të Bankos, duke iu drejtuar fantazmave që të shprehin haptazi farën e së pritmes, d.m.th çfarë mund të arrihet, të realizohet dhe çfarë nuk mund të realizohet. Pas fitores gjithëkush kërkon një ngritje në detyrë. Në fjalinë primare nënkuptohet një realizim pas lufte, pra të arrijë diçka, ndërsa teksti i pjesës së dytë mosrealizimi. Të dy pjesët mund të këmbëhen.

⁴⁶ M. Zeqo, *Nje esse e pazakontë për Nolin*, Dita, 3 mars, 2018.

⁴⁷ R. Memushaj, *Hyrje në Gjuhësi*, Toena, 2006, f. 129-132.

Teksti dytësor ka një fund më të shpejtë e të qartë, që është një lloj profetësie për fundin e pritur, për farën e mbjellë, e cila pas lufte pritej të mbinte, të jepte frytet e saj, por që mund të mos mbijë, të mos realizohet ëndrra.

Përdorimi i termave në tekstet paralele e bën më të vërtetë informacionin, po ashtu edhe burimin e tyre. Terminologjia e përdorur nga Noli, krahas kuptimit të drejtpërdrejtë, shpreh dhe kuptim të figurshëm, e cila jep vlera të veçanta stilistike.

What he hath lost noble Macbeth hath won. [Sh:285]

*Ai e **humb**, Makbethi **e fiton**. [N:17]*

Edhe kontrasti **humb dhe fiton** ka forcë të veçantë shprehëse.

A limbeck only. When in swinish sleep. Their drenched natures lie as in a death. [Sh:290]

*Në **pellg të gjumit si në varr** të vdekjes. [N:41]*

Look like the innocent flower, but be the serpent under't. [Sh:288]

*Duku **si lulja e pafajshme po jij si gjarpër i fshehur nënë të**. [N:35]*

Në këto shqipërime të Nolit emocioni i krahasimit është rrënoqethës, drithërues, sepse të jep imazhin e një **gjumi të rëndë**, ashtu si një i vdekur në varr. Vdekja ka një forcë të rrallë shkatërruese. I njëjti emocion përcillet dhe te krahasimi **jij si gjarpër**. Krahasimi te sintagma **jij si gjarpër** ka shprehësi të veçantë. Kjo gjë vjen ngaqë figura të tilla përdoren rrallë. Ndodh të përdoren terma për ndërtimin e figurave. Me këto terma përftohen figura të gjalla, ku duket qartë figura midis kuptimit të bartur dhe kuptimit të mirëfilltë terminologjik, pra midis kuptimit të fjalës dhe atij që mund të arrihet. Duke e emërtuar një nocion tjetër, termi e shfaq kuptimin e tij parësor. Nocioni i emërtuar rishtazi me një term fiton diçka nga përcaktueshmëria dhe saktësia kuptimore e termit. Ajo që thuhet në mënyrë figurative me një term është e kapshme dhe e fiksueshme.

Gjuha është një dukuri e ndërlikuar dhe shumëplanëshe ndaj e studiojnë një varg disiplinash. Gjuha ka dhe nivel stilistik, që përbën objektin e stilistikës. Gjuha shërben për të shprehur mendimet dhe për të komunikuar, kjo gjë arrihet me ndërthurjen e disa mjeteve dhe me vargëzimin e tyre. Sipas Xh. Lloshit kur ngrihemi nuk themi natën e mirë, nuk të lejon koha reale.⁴⁸

⁴⁸ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 25.

Komunikimi kërkon organizim tërësor të lëndës gjuhësore. Ky është organizimi parësor gjuhësor, i cili është i domosdoshëm për të arritur komunikimin. Organizimi dytësor nuk është i shkëputur nga organizimi parësor, por i ndërthurur organikisht, veçantia që përftohet i përket tërësisë gjuhësore. Organizimi sjell pasurimin e komunikimit dhe sjell modele sipas një tradite, por është i hapur me modele vetjake, pra lejon të shprehet individualiteti i ligjëruesit dhe origjinaliteti i tij. Organizimi ka dhe funksion stilistik të gjuhës. Stilistika e sheh gjuhën të lidhur me komunikimin, me nevojat shoqërore individuale, si dhe variacionin gjuhësor të shprehur në tekstet ligjërimore.⁴⁹

1.4 Ngjyrimi stilistik

Në librin “English Literature” X. J. Kennedy, shkruan se: “*Një nga treguesit më të qartë të tonit të një tregimi është stili në të cilin është shkruar*”.⁵⁰ Në përgjithësi stili i referohet trajtimeve ose karakteristikave individuale të një pjese të shkruar nga mënyrat e veçanta të shkrimtarit për të organizuar fjalët, të cilat ne i njohim si të zakonata.

Stili dallues e paraqet veprën e një shkrimtari të mrekullueshme dhe ne mund të dallojmë punën e tij apo të saj nga të tjerët pikërisht prej stilit. Gjithsesi shkrimtari mund ta ndryshojë stilin nga vepra në vepër dhe në disa raste stili mund të ndryshojë kuptueshëm midis kapitujve, ndërsa tregimi vazhdon.⁵¹

Shumë shkrimtarë të mëdhenj dhe filozofë të shekullit XVIII, si Buffon, D’Alembert, Helvece, Condillac etj., kanë shprehur pikëpamjet e tyre edhe për problemet e stilit. Në mënyrë të veçantë në shekullin XVIII përpunohen pikëpamjet mbi klasifikimin e stileve. Volteri dallon në “Fjalorin Filozofik” të tij me stilin e thjeshtë dhe të ngritur. Marmonteli dallon stilin e thjeshtë, të mesëm, të lartë. Ferraud në parathënien e “Fjalorit Kritik” dallon stilin polemik, kritik, satirik, gazmor, të këndshëm, komik, grotesk. Po ky autor flet nga ana tjetër për stil të

⁴⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 25.

⁵⁰ X. J. Kennedy, *Literature, an introduction to fiction, poetry and drama*, Fourth Edition, Boston, Toronto, 1987, p. 120.

⁵¹ X. J. Kennedy, *Literature, an introduction to fiction, poetry and drama*, Fourth Edition, Boston, Toronto, 1987, p. 120.

thjeshtë ose të bashkëbisedimit, duke mos e njësuar atë me familjarin, që sipas tij ka një lehtësi dhe liri më të madhe.⁵²

Sipas Plangaricës stili përcaktohet jo vetëm si tërësi e mjeteve të shprehjeve në përputhje me një gjini të caktuar letrare, por gjithashtu në raport me rrethanat e shprehjes, të vendit, kushteve të funksionimit të tij. Ndërsa A. Ballhysa shpjegon se fjala *stil*, si term i gjuhësisë, shenjon një varietet a variant të gjuhës të lidhur me një sferë të caktuar përdorimi dhe që ka veçori kryesisht të leksikut dhe të sintaksës. Më tej Ballhysa shprehet se *stili* është vetëm një aspekt i gjuhës, i cili si i tillë rrjedh nga zgjedhja që bëhet midis këtyre mjeteve dhe mënyrave të shprehjes në përputhje me një fushë të caktuar të veprimtarisë, si dhe me kushtet në të cilat realizohet komunikimi. Fusha më e rëndësishme ku dallohen stilet është leksiku.⁵³

Gjuha është e larmishme dhe si e tillë ka vlera potenciale, të cilat i shërbejnë organizimit dytësor dhe kthehen në vlera stilistike, p.sh. variantet bashkekzistuese janë me vlerë potenciale. Shtresat e ndryshme të fjalëve, si arkaizmat, neologjizmat, krahinorizmat kanë aftësi evokuese, dhe mund të shfrytëzohen si vlera stilistike, i japin ngjyrim stilemës ose tekstit, që, sipas Xh. Lloshit ky është objekti i stilistikës.⁵⁴

Gjuha shërben për të formësuar dhe komunikuar mendimet që arrihet nga një sistem mjetesht (tinguj, morfema, fjalë etj.) dhe rregullash e vargëzimesh. Megjithatë komunikimi nuk arrihet thjeshtë nga vargëzimi i mjeteve sipas disa rregullave, por me ndërthurjen e tyre në përputhje me pasqyrimin e realitetit, të vijueshmërisë logjike, me synimet e folësit në rrethanat e komunikimit dhe me veprimin e përbashkët të të gjitha anëve sipas mënyrave të përvijuara historikisht në përvojën e kulturës gjuhësore të popullit shqiptar.⁵⁵

Në këtë drejtim rol përcaktues luan aspekti stilistik, njohja dhe identifikimi i elementëve stilformues, identifikimi i përftesave që ndihmojnë në mbujtjen e vlerave stilistike të tekstit, identifikimi i tipareve idiosinkretike të ligjërit të personazheve, ndërgjegjësimi në lidhje me format e larmishme të adresimit.⁵⁶

⁵² T. Plangarica, *Universi i vlerave të munguara*, Sejko, 2002, f. 183-184.

⁵³ A. Ballhysa, A. Jashari, *Formimi shprehjeve komunikative*, Formim gjuhësor, Flesh, 2011, f. 128-129.

⁵⁴ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 22.

⁵⁵ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 25.

⁵⁶ Viktor Ristani, Kontribut ne studimet perkthimore gjate viteve '90, Geer, 2010, f.10

Sipas gramatikës gjenerative të R. Memushajt, stili i tekstit formohet në nivelin e strukturës sipërfaqësore të tekstit. Stili është një veçanti e autorit ose shmangie nga gjuha e zakonshme. Xh. Lloshi në veprën e tij “Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika” thekson se përcaktimi mbizotërues sot e sheh stilin si zgjedhje nga visari i gjuhës në përshtatje me qëllimet dhe natyrën e ligjëruesit. Stili është zgjedhja ndërmjet mënyrave sinonimike për të shprehur po atë mendim, përmbajtje apo kuptim. Stili gjithashtu është veçanti e një tërësie gjuhësore, i cili përftohet duke krijuar një strukturim gjuhësor të njëkohësishëm me strukturimin e përmbajtjes.⁵⁷

Më tej ky autor thekson se stili shfaqet si një tip lidhjesh tërësore ku merr përparësi ana funksionale semantike sipas kërkesave të veçanta gjuhësore e jashtëgjuhësore. Stili sipas tij është veçantia e një tërësie gjuhësore të organizuar në një mënyrë që i jep ligjëritimit veçanti në realizimin e përmbajtjes, duke synuar përshtatjen me qëllimet e komunikimit, me kushtet dhe me synimet vetjake. Stili është një përdorim i shenjave gjuhësore që sjell edhe një kuptim të ri, më të pasur se shprehja e zakonshme. Stili është vetë njeriu, individualiteti, ekzistenca e tij, mënyra e tij origjinale e të vështuarit të botës, pra mënyra se si gërshetohen mendimet, emocionet, etj.⁵⁸

Duhet të pranojmë se ngjyrimet stilistike veprojnë në trajtë dhe në kuptim. Pjesa parësore semantike e stilemës rrethohet me shoqërime e vlera evokuese, të cilat të përfutuara përmes organizimit dytësor japin efektin. Me ngjyrim stilistik kuptojmë mjetet e përfshira në organizimin dytësor, që të tërheqin vëmendjen, të ngjallin emocion. Kështu, po të themi *kaltërsia qiellore* shprehja ka ngjyrim poetik. Një lidhje tjetër e mundshme është duke dhënë sendin me tiparin d.m.th. emër me mbiemër *qielli i kaltër*. Pra, kjo është lidhja e rregullt, asnjëse, e vetvetishme. Por, ka mundësi që ta kalojmë si gjymtyrë kryesore fjalën që shenjojmë. Pra, me fjalë të tjera përftesa është kalimi i mbiemrit në emër, nga mbiemër *i kaltër* përftuam përftesën *kaltërsi*. Stilema e përftuar është me ngjyrim poetik. Por, duhet të pranojmë se nga vështrimi i sendit *qielli i kaltërt* kemi kaluar te perceptimi i tiparit *kaltërsia*.⁵⁹

Ngjyrimi emocionues është tregues i qëndrimit të folësit ndaj asaj çka përmend. Pra, fjala veç kuptimit leksikor ka edhe atë që quhet konotacion.

But signs of nobleness, like stars, shall shine. [Sh:287]

⁵⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 25-30.

⁵⁸ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 122-127.

⁵⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 22-27.

Si yj të bukur, me shenja të mëdha fisnikërie. [N:30]

Noli, nga **fisnik** i madh në fjalorin bisedor, ka përdorur ngjyrimin poetik *shenja të mëdha fisnikërie*. Ngjyrimet përftohen në fjalë të thjeshta ose të përbëra.

Of direst cruelty. [Sh:288]

Zemërgurësinë më të egër. [N:33]

Te fjala **zemërgur** kemi kompozicion emër+emër, ku përbërësi i dytë, **gurësinë**, përcakton të parin, sepse ka raste kur përbërësi i parë përcakton të dytin, si fjala *mëmëdhe*. Fjala **zemërgur** ka një kuptim negativ, duke i shtuar mbiemrin në shkallë krahasore, stilema e krijuar merr ngjyrim poetiko-libror.

Nor heaven peep through the blanket of the dark, to cry. [Sh:288]

Kurtinën ngjyrëpus e të bërtasë. [N:34]

Në ligjërimin e lirë bisedor do të ishte **nata pus e errët**, por Noli i ka dhënë ngjyrim poetiko-libror, duke u shprehur **kurtinën ngjyrëpus**.

Shall blow the horrid deed in every eye, that tears shall drown the wind.

I have no spur. [Sh:289]

Tmerrin e veprës sime të pabesë dhe do ta mbytë erën me shi lotësh. [N:39]

Sintagma **shi lotësh** është një paraqitje librore, në të folurën e përditshme thuhet *i rrodhën lotët si shi*. Pra, atributi në këtë rast është i shprehur nga emri në rasën rrjedhore. Në këtë rast personazhi i Makbethit e imagjiron se çfarë do të ndodhë pas vrasjes makabre që do të kryejë. Ai imagjiron se gjithë njerëzia do të vajtojë, do të derdhin lotë, të cilët do të mbulojnë çdo gjë, madje dhe erën.

By each at once her choppy finger laying. [Sh:285]

Po veni duart e krasitura. [N:20]

Sërish përkthimi përmban ngjyrim poetik-libror, sepse në fjalorin bisedimor nuk përdoret **duar të krasitura**, por fjala **të krasitura** më vete ekziston. Sipas Xhevat Lloshit, kriteri bazë për klasifikimin e ngjyimeve stilistike merret marrëdhënia midis ligjëruesit me objektin, të cilat ai i ndan në tri grupe:

Në ngjyrimet *subjektive*, që lidhen me marrëdhëniet vetiake të ligjëruesit me bashkëbiseduesin dhe me objektin, dhe si të tilla janë plot emocion. Marrëdhëniet mund të jenë negative ose pozitive, keqësuese ose miratuese.

Sleep no more! [Sh:291]

Një zë më thirri: Mos fli më, Makbethi vrau gjumin! [N:50]

Në fjalinë e sipërpërmendur dëshira, emocioni lënë gjurmë në stilemat që përdoren nga Noli. Pikëvështrimi në thelb është psikologjik, subjektiv. Emocioni lë gjurmë në mënyrën e të folurit, *ka vrarë gjumin*. Gjumi nuk vritet, por kjo vepër makabër e bëri Makbethin të mos flejë. Një zë i thirri, *mos fli më*. Mendojmë se **zëri** është ndërgjegja e tij e vrarë. Ai arriti të eliminojë njeriun që e vlerësoi, i dha një titull dhe e nderoi në shtëpinë e tij.

Ngjyrimet subjektive na tregojnë për gjëndjen dhe qëndrimet e folësit, për marrëdhëniet e tij me dëgjuesin, për individualitetin e tij.⁶⁰

Ngjyrimet funksionale krijohen nga marrëdhënia e ligjëruesit, ose nga marrëdhënia e përgjithshme me objektin, ose me bashkëbiseduesin, me situatën, ose me një veprimtari shoqërore. Në të folurën e përditshme themi *rrezet e diellit*, por kur themi *rrezet diellore* e ndjejmë se kemi të bëjmë me gjuhën shkencore, pra kalohet nga togu emër + emër në emër + mbiemër.⁶¹

That the proportion both of thanks and payment. [Sh:287]

Masën e falënderjes dhe pagesës. [N:29]

Të falënderoj pa masë, do të ishte në të folurën e përditshme ose në fjalorin bisedor. Por, Noli i ka dhënë një ngjyrim poetiko-libror. Mjetet e përfshira në organizimin dytësor të tërheqin vëmendjen, të ngjallin emocion. Pra, vargu, masën e *falënderjes dhe pagesës*, ka ngjyrim poetik. Në këtë lidhje folja **të falënderoj** kalon në atribut, duke dhënë stilemën *masën e falënderjes*. Pra, në këtë rast, përftesa është kalimi i foljes në emër, nga folja *falënderoj* krijohet përftesa e *falënderjes* (shprehur me emër në rasë gjinore), stilema e përftuar është me ngjyrim poetik. Disa shembuj të tjerë ilustrues.

That tend on mortal thoughts. [Sh:288]

Na ndërseni sulmat vrasëse. [N:33]

Na ndërseni në **sulm për të vrarë** do të ishte sintagma e fjalorit bisedimor, ndonëse në situatë lufte apo marrje pushteti **sulmi** vetë nënkupton vrasje. Por, kur themi **sulmat vrasëse** shprehja merr ngjyrim poetik dhe kalon në fjalorin libror.

That hast no less deserved, nor must be known. [Sh: 287]

⁶⁰Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 27

⁶¹Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 28.

Dhe që ta bëj të njohur botërisht. [N:29]

Fjala **botërisht** merr ngjyrim poetik në të folurën formale, ndërsa në të folurën joformale do të ishte **do ta njohë e gjithë bota**. Çdo tip veprimtarie është dhe një mënyrë vështrimi, të menduari e gjykimi mbi objektin, e cila kristalizohet në ngjyrimin e stilemeve përkatëse. Sintagma **do ta bëj të njohur botërisht** krijon marrëdhënie të ngulitur shoqërisht.

Ngjyrimet funksionale na përçojnë të dhëna për fushën e veprimtarisë, mjedisin shoqëror etj.⁶²

Përsa i përket *ngjyimeve shprehëse*, siç shkruan Lloshi, ato krijohen si marrëdhënie ndaj gjuhës, të cilat kanë të bëjnë me fushën artistike që zgjedh ligjëruesi, i cili shfrytëzon formën gjuhësore që të tërheqë vëmendjen, sidomos në letërsinë artistike.

Sipas T. Plangaricës, duke u prirur gjithnjë e më shumë të përvijojmë qasje të reja ndaj tekstit letrar, si një produkt i formësuar qartë, koheziv dhe koherent, kemi krijuar një status të ri, jo vetëm të raporteve autor-tekst- lexues, por gjithnjë e më shumë po nxjerrim në pah edhe vlera të lidhjeve dhe bashkëmarrëdhënieve të ndërsjella mes autorit dhe tekstit apo tekstit dhe lexuesit, veçanërisht të lexuesit të sotëm. Në një qerthull të gjerë pikëpamjesh, vlerësimesh dhe interpretimesh nga më interesantet që teoritë bashkëkohore ofrojnë në hapësirën shkencore të letërsisë, edhe Noli, vepra e tij dhe lexuesit e tij, kanë ç'të përvijojnë si një qasje të re.⁶³

Klodeta Dibra në lidhje mbi konceptin e tekstit thekson se teksti është njësi gjuhësore funksionale që realizon ligjërimin, ashtu si fjalia që është një njësi sintaksore dhe funksioni tekstual nuk kufizohet vetëm me vendosjen e marrëdhënieve midis fjalive, por merret edhe me organizimin e brendshëm dhe kuptimin e fjalive.⁶⁴

Ndërsa Halliday, siç shkruan Dibra, e sheh tekstin si njësi gjuhësore, duke vënë në pah njëkohësisht edhe funksionin e tij si realizues i ligjëritimit, d.m.th. ligjërimi ynë realizohet me anë të teksteve. Gjithashtu në përkufizimin e tij, Halliday, prek edhe problemin e organizimit të brendshëm të tekstit, por pa nxjerrë në dukje elementet që e realizojnë këtë organizim. Ajo që e

⁶²Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 28-29.

⁶³ Tomorr Plangarica, *Hyrje në studimin e kuptimit semantike dhe pragmatike ,analize pragmatike e teksteve*, Elbasan, 2013, f.48

⁶⁴ K. Dibra, N.Varfi, *Gjuhësi teksti*, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 25.

bën të rëndësishëm përkufizimin e Halliday-t është fakti se studiuesi e shtrin tekstin në kuadrin gjuhësor dhe nuk vë shenjën e barazimit me ligjërimin.⁶⁵

Lesser than Macbeth, and greater. [Sh:286]

M'i vogël se Makbethi dhe *m'i madh*. [N:21]

Në shembujt e lartpërmendur kemi antitezë midis *m'i vogël* dhe *m'i madh*.

But in a sieve I'll thither sail, And, like a rat without a tail,

I'll do, I'll do, and I'll do. [Sh:285]

*Atje me shoshë lundrëzoh, dhe si një mi pa bisht kaloj dhe i
a punoj dhe ia punoj. [N:18]*

Në vargjet e sipërpërmendura kemi izotonizëm. Pra, në nivelin fonetik krijohet rimë fundore, *lundrëzoh, kaloj, ia punoj*, të cilat janë edhe sinonime kontekstuale. Vargu i dytë dhe i tretë fillon me të njëjtin tingull me lidhëzën bashkërenditëse *dhe*, e cila krijon paranomazi.

Pjesa më e madhe e leksikut ekspresiv të Nolit ka ngjyime letrare-librore. Shkrimtari e përdor mjaft mirë këtë ton dhe krijon brenda tij larmi, shprehësi, natyrshmëri, duke na dhënë mjaft emocion. Vlerat artistike të këtyre varianteve janë vështruar në kuadrin e konteksteve ku ato gjenden. Noli, gjatë përdorimit të këtyre varianteve nuk e respekton gjithmonë ngjyrimin e veçantë të tij, sepse një variant me ngjyrim libror mund të dalë në ligjërimin e një personazhi të thjeshtë nga jeta e përditshme, ndërsa një variant me ngjyime të stilit bisedor ndodh që të shfaqet në situatë formale etj.

Përsa i përket gjymtyrëve të modeleve të përdorura nga Noli ato nuk janë njëlloj të përdorshme në sferat e komunikimit. Ato dallohen nga ngjyrimi stilistik. Disa prej tyre mund të përdoren në stilin bisedor të përditshëm.

Ngjyrimet që ndërthuren nuk janë të shkëputura. Kështu emocionalia bëhet edhe shprehëse. Xh. Lloshi thekson se ngjyrimet mund të jenë të përherëshme ose kontekstuale, mund të jenë lëvizëse, sepse ndryshojnë gjatë historisë së gjuhës. Jo çdo fakt me ngjyrim stilistik ka vlerë për stilin e një teksti, pasi ndeshen edhe dukuri të rastit ose madje të gabuara.⁶⁶

Me këto ngjyime arrihet një efekt i caktuar, i cili është veprimi plotësues mbi arsyen, ose ndjenjat e marra si reale, që i shtohen funksionit themelor të komunikimit.

⁶⁵ K. Dibra, N.Varfi, *Gjuhësi teksti*, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 25.

⁶⁶ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 29.

Është shumë e qartë, siç shprehet dhe Umberto Eco, se ndjesia dhe efekti që kërkon të sjellë teksti (intentio-operis) është që lexuesi të ketë një ndjesi ngjyrash ngahera të larmishme. Tipari stilistikor i përdorur për të dhënë këtë përshtypje kromatike bazohet në shmangien e çdo përsëritjeje të të njëjtës fjalë për ngjyrën; prandaj dhe qëllimi i përkthimit është të arrijë të njëjtën marrëdhënie mes sasisë së fjalëve dhe sasive së ngjyrave.⁶⁷

⁶⁷ U. Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë, përvoja përkthimi*, Dituria, 2006, f. 158.

KAPITULLI II

MBI KONSUMIMIN SEMANTIK DHE VARIACIONET E TIJ

2.1 Konsumimi semantik

Objekti i konsumimit semantik është leksiku shprehës, fjalët që shprehin emocione, reagime shpirtërore, vlerësime subjektive, ku edhe ato më të fortat e më ekspresivet e humbasin forcën kur përsëriten shpesh.⁶⁸

Për të shmangur këto fenomene konsumuese Noli përdor shumë burime emocionuese shprehëse.

Gjuha e sotme letrare pasurohet vazhdimisht. Gjallërimi dhe pasurimi i shqipes është lidhur ngushtë me ndihmesën që jep letërsia artistike me të gjitha zhanret e saj. Vlerat stilistike të veprave letrare nuk mund të jenë të plota pa patur parasysh punën mjeshtërore të shkrimtarëve me mjetet e gjuhës, të cilat përdoren në krijimtarinë e tyre.⁶⁹

Fjalët me kalimin e kohës pësojnë konsumim semantik. Konsumimi semantik shpesh vepron në letërsinë artistike, ku shprehësia është një dallim konstant i leksikut. Vetë konsumimi është një mënyrë për të arritur një shprehësi sa më të lartë. Konsumimi semantik në letërsinë artistike varet nga mënyra e paraqitjes së materialit, si dhe nga mënyra e komunikimit me lexuesin.

Leksiku i Nolit është shumë ekspresiv. Në të vihet re dukuria e konsumimit stilistik semantik, ku fjala e konsumuar është zëvendësuar ose ka ndryshuar kontekstin e saj. Ky ndryshim varet nga koncepti artistik i shkrimtarit. Noli është jashtëzakonisht origjinal dhe i veçantë. Ai krijon atmosferë shumë afektive dhe emocionale. Në këtë mënyrë Noli krijon lidhje të forta lexues-shkrimtar-përkthyes. Sipas E. Sadikut konsumimi semantik mund të shprehet me:

- a. fjalë ekspresive (me ngjyime emocionale, me kuptim të figurshëm të ligjërimit afektiv etj.).
- b. fjalë të tjera, pa ndonjë ekspresivitet të dukshëm, por që përdoren shpesh e që sjellin monotoni në ligjërime.

⁶⁸E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 10.

⁶⁹E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 1.

- c. harxhimi kuptimor, i cili në disa raste ndodh për arsye shoqërore. Në emër të një etikete, të një shijeje, parapëlqimi zgjidhen disa fjalë në vend të disa të tjerave që kanë përmbajtje të rëndë.⁷⁰

Kështu, fjala e konsumuar mund të jetë ose jo në tekst, ose shkrimtari mund të sjellë një fjalë tjetër në vend të fjalës së konsumuar. Fjalët që shfaqin ekspresivitet janë të ekspozuara ndaj konsumimit. Të tilla mund të jenë fjalë që shenjojnë cilësi, veprime ose fjalë që shenjojnë fenomene dhe mjete të ndryshme. Kjo është arsyeja që fjalët, të cilat përmbajnë ngarkesë emocionale, si emrat, foljet dhe mbiemrat në ligjërimin artistik konsumohen me shpejtësi.⁷¹

Konsumimi semantik si dukuri është trajtuar edhe në letërsinë e huaj. Mendoj se me konsumim semantik nënkuptohet harxhimi i kuptimit të fjalës së dhënë, mospërdorimi i saj me kuptimin e parë, daljen e fjalës nga përdorimi ose përdorimi i saj me tjetër kuptim.

Konsumimi semantik vepron dëndur në letërsinë artistike, ku shprehësia është një dukuri e përhershme e leksikut. Ashtu si Sadiku edhe unë mendoj se vetë konsumimi është një mënyrë për të arritur një shprehësi sa më të lartë.⁷²

Konsumimi semantik në letërsinë artistike fiton një rëndësi të veçantë, i cili ka një përhapje të madhe që bie në sy. Procedeja e konsumimit semantik në letërsinë artistike kushtëzohet nga mënyra e paraqitjes së materialit, si dhe nga forma e komunikimit me lexuesin.

Konsumimi semantik realizon përftesa ose procede të tjera. Kështu, fjala e konsumuar apo e harxhuar mund të jetë në tekst ose jo, ose shkrimtari mund të sjellë një tjetër në vend të saj.

Leksiku i përdorur nga Noli dallohet nga ekspresiviteti, d.m.th. nga ngjyrimet emocionale, figuracioni etj. Fjalët e harxhuara mund të jenë shumë shprehëse, ose për shkak të etikës përdoret fjala për të cilin shkrimtari mendon se ka përdorim me përmbajtje më të mirë.

Në ligjërimin afektiv ndodh që nuk përdoren fjalët e konsumuara, të cilat ndodhin për shkaqe fonetike ose semantike. Kur fjala është shumë e shkurtër mund t'i mungojë shprehësia, sepse siç shkruan Çeliku fjala është njësi leksikore që kuptimin e saj leksikor e gramatikor e ka të mbyllur

⁷⁰ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 10-12.

⁷¹ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 10-12.

⁷² E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 11.

në vetvete.⁷³ Si e tillë ajo ose zhduket nga përdorimi ose i shtohet ndonjë prapashtesë për të mbijetuar. Ky fenomen shfaqet shpesh në gjuhën shqipe. Konsumimi semantik shfaqet në forma të ndryshme.

2.1.1 Konsumimi semantik për shkak se fjalët e shkurtra kanë volum të vogël fonetik

Fjalët me volum të vogël fonetik kanë veti të kalojnë nga kuptimi i tyre primar në kuptime të tjera. Ky fenomen shfaqet dendur në gjuhën shqipe. Në këtë kuadër mund të vendosim dhe fenomenin e ruajtjes së fjalëve duke u shtuar parashtesa ose prapashtesa, p.sh. fjala **humb-**antonimi i saj është **gjej**. Duke i shtuar parashtesa dhe prapashtesa kemi krijime fjalësh me kuptim të spikatur: përhumbem, përhumba, e përhumbur; humbas, humboj, i humbur.

*A desert **place**. [Sh:284]*

*Një **yrt**, i shkretë. [N:11]*

Fjala **yrt** është njërrrokëshe, d.m.th me volum të vogël fonetik dhe në këtë rast ka kuptimin *vend*. Fjala është konsumuar, ajo është harxhuar kuptimisht dhe si e tillë nuk përdoret më. Dalim në këtë përfundim, sepse fjala **yrt** e shqipëruar nga Noli nuk ndodhet në Fjalorin e Shqipes së Sotme, 2002.

Be this the whetstone of your sword: let grief. [Sh:306]

*Kjo le të bëhet **Grih' e shpatës sate**. [N:130]*

Fjala **grih** nuk përdoret më, kuptimi i saj është **mprehësja** e shpatës sate. Mendoj se fjala ekzistuese ishte njërrrokëshe, prandaj, për shkak të volumit të saj nuk përdoret më, sepse është harxhuar, është konsumuar.

Më e prekshme nga harxhimi kuptimor është ajo pjesë e përmbajtjes së fjalës që përbën atmosferën afektive, si ngjyrimet emocionale, vlerësuese-subjektive etj. Vlera ekspresive e fjalëve dobësohet nga përdorimi. Fjalët që shprehin emocione, reagime shpirtërore, vlerësime subjektive edhe ato më të fortat e më ekspresivet e humbasin forcën kur përsëriten shpesh.⁷⁴

Në konsumimin stilistik fjala harxhohet e zbehet aty për aty e nuk del më në kontekstin ligjërimor, ia lë vendin një përgjegjëse tjetër, më shprehëse (kur rasti e kërkon që ajo të

⁷³ M. Çeliku, *Sintaksë e Gjuhës Shqipe (Përbërësit Sintaksore)*, Tiranë 2012, f. 19.

⁷⁴ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikon shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 10.

rishfaqet). Në fakt, konsumimi stilistik kushtëzohet në një shkallë të madhe nga interesat e prirjet stilistike të shkrimtarit, nga ndjeshmëria e tij ndaj forcës emocionale-vepruese të fjalës. Është vetë shkrimtari që e ndjen të harxhuar një fjalë, pa efekt, dhe ndërmerr zëvendësimin dhe plotësimin e saj.⁷⁵

Ndërsa në gjuhën angleze kemi fenomenin e disa formave të vjetra të shumësit, p.sh. sot përdoret **brother-s**, ndërsa më parë **brothren**, e cila sipas mendimit tonë ka ndodhur për arsye të konsumimit fonetik. Kjo formë e vjetruar ruhet sot te shumësi i parregullt i **child**, që në numrin shumëbëhet **children**.

Sipas Xhevat Lloshit kur dy fjalë janë homonime apo homofone atëherë njëra prej tyre konsumohet.⁷⁶

2.1.2 Konsumimi semantik për shkak të ndryshimeve fonetike

Kur dy fjalë bëhen homonime, d.m.th. përputhen fonetikisht për shkak të pësimeve fonetike që ndodhin tek ato, gjuha synon ta zhdukë homoniminë duke e zëvendësuar njërin fjalë me një tjetër. Fjala që zëvendësohet ndihet e konsumuar. Studiuesi Xhevat Lloshi, lidhur me zhdukjen dhe zëvendësimin e fjalëve për shkak të homonimisë me fjalë të tjera, shprehet se zhdukja e fjalëve është ndikimi më i fuqishëm e më karakteristik që mund të ushtrojë homonimia në gjuhë dhe që shpie në ndryshime rrënjësore. Emri **gjedhi** për bagëtinë e trashë mendohet se duhet të jetë zhdukur në toskërisht, sepse atje shqiptojë **gjedh** dhe dilte homonim për **gjeth-i** dhe **gjethe**.⁷⁷

Një mendim të tillë shpreh dhe Jani Thomai kur trajton kundërveprimin e gjuhës ndaj homonimisë së padëshirueshme. Ai shprehet se një nga kundërveprimet e gjuhës për të shmangur homoniminë, që mund të sjellë keqkuptime e të errësojë ligjërimin, është rënia nga përdorimi i njërit homonim dhe zëvendësimi i tij me një fjalë sinonime.⁷⁸

⁷⁵ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 12.

⁷⁶ Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë, 1972, f. 228.

⁷⁷ Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë, 1972, f. 228.

⁷⁸ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, f. 72.

Në shembujt e mëposhtëm janë dhënë disa raste të konsumimit fonetik të fjalëve, si dhe të përputhjes fonetike të tyre.

Whose horrid image doth unfix my hair. [Sh:287]

Pse kor' e saj e tmerrtë m'i ngre qimet? [N:26]

As two spent swimmers, that do cling together. [Sh:284]

Si dy notës që pran' e pran' ngjitur çaj në ujën. [N:13]

Imazhin e origjinalit *ngjitur notojnë* Noli na e ka dhënë me *çaj në ujën*. Fjala e konsumuar është *notojnë* që jepet me *çaj në ujën*. Shprehja e përdorur është shumë ekspresive. Mund të themi se kuptimi i fjalës *çaj në ujën* është përdorur për *hapin ujin* apo *largojnë dallgët*. Shprehja *çaj në ujën* krijon sinonimi të pjesshme me fjalën *notoj*, që është konsumuar stilistikisht.

*A limbeck only. When in swinish sleep. Their drenched
natures lie as in a death. [Sh:290]*

*Kur të shtrihen e të flenë derrërisht në pellg të gjumit, si
në varr të vdekjes. [N:41]*

Shenjimi në *pellg të gjumit* është përdorur për të dhënë *gjumin*. Në situatën e përshkruar me vargun e përmendur, varg që përmban dhe stilemen *derrërisht*, element me ngjyrim të spikatur emocional, përdorimi i njësisë neutrale *gjumë* do ta zbehte emocionalitetin. Prandaj, Noli e ka përforcuar shprehjen, për atë fjala *gjumë* nuk e ka forcën që i duhet vargut. Vetë Shekspiri ka përdorur fjalën *gjumë*. *Pellg i gjumit* është barasvlera emocionale e fjalës *gjumë*, që përpunohet në mekanizmin e konsumimit semantiko-afektiv.

Është për t'u theksuar se fjala e përdorur nga Noli paraqet veprimin apo gjendjen me një intensitet të veçantë si në shembujt e sipërpërmendur, *çaj në ujën*, *pran' e pran'*, *pellg të gjumit* etj. Midis fjalëve të nënvizuara në thëniet e cituara ka sinonimi të pjesshme-kontekstuale. Zbehja kuptimore, rifitimi i shprehësisë me një mjet tjetër sinonim nuk janë thjeshtë veprime formale me gjuhën, veprime në plan gjuhësor me efekte të momentit e që lenë pas boshllëk.

Gjuha gjithmonë ndjek relievën e mendimit. Është konceptimi artistik i shkrimtarit që e vë në punë mekanizmin e harxhimit semantik.⁷⁹

⁷⁹E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikon shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 12.

Unë mendoj se Noli ka një këndvështrim të objektit të tij tepër original, interesant dhe tërheqës. Në veprën e tij është konsoliduar një lloj komunikimi me lexuesin, pra është mënyra mendimtare e komunikimit

2.1.3 Konsumimi semantik për shkak të sinonimisë kontekstuale

Konsumimi semantik krahas përfatesave të tjera ka ndihmuar që të arrihet shprehësia e kërkuar. Konsumimi semantik ndodh brenda një konteksti a brenda një thënieje. Fjala e konsumuar mund të jetë e pranishme në tekst ose jo. Ajo mund të ndjehet e konsumuar që në ndërgjegjen e shkrimtarit dhe shkrimtari nuk e sjell këtë fjalë në ligjërim, por sjell një tjetër, më domethënëse.⁸⁰

Mendoj se më e prekshme nga harxhimi kuptimor është ajo pjesë e përmbajtjes së fjalës që përbën atmosferën afektive, si ngjyrimet emocionale, vlerësuese-subjektive etj. Vlera ekspresive e fjalëve dobësohet nga përdorimi. Fjalët që shprehin emocione, reagime shpirtërore, vlerësime subjektive, edhe ato më të fortat e më ekspresivet e humbasin forcën kur përsëriten shpesh.

You secret, black and midnight hags! [Sh:300]

*Lubira **faqemvrojtur** të natës. [N:101]*

's fall'n into the sear the yellow leaf. [Sh:307]

*Ra në një mal të thatë **fletëfishkur**. [N:141]*

Në origjinalin e Shekspirit fjalët e nënvizuara dalin me kuptime më të zbeta, pothuajse asnjënjëse: **plakë e keqe, gjethe e zverdhur**. Në gjuhën e përdorur nga Noli në përkthim veprohet me intensifikimin e kuptimit dhe të shprehësisë. Për këtë ai hedh në ligjërim njësi të vëllimshme, si në formë ashtu dhe në kuptim e ngjyrim afektiv, **faqemvrojtur, fletëfishkur**. Njësitë përgjegjëse të origjinalit ndjehen të konsumuara. Më tej Noli përdor mbiemrin **rrobëcjerra**.

So wither'd and so wild in their attire. [Sh:285]

*Ç'janë këto **të fishkura** dhe **rrobëcjerra**. [N:20]*

⁸⁰E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 13.

Në mekanizmin e konsumimit stilistik të Nolit ndodh shpesh zëvendësimi i elementeve neutrale të dobësuar semantikisht me fjalëformime shprehëse.⁸¹

Sipas mendimit tonë është veçoria e leksikut shprehës të Nolit që gjeneron fjalëformime të tilla.

Një grup fjalësh që në kuptimin e tyre të mirëfilltë shenjojnë sende me një veçori të spikatur japin tiparin në nivele maksimale e në mënyrë mbresëlënëse. Në këtë grup përfshihen fjalët e sipërpërmendura: *të fishkura* dhe *rrobëçjerra*.

Upon her skinny lips. [Sh:285]

Se përmbi buzët zhubra. [N:20]

Në një thënie paralele do të kishim *buzët e rrudhosura*. Elementi nominal *zhubra* e jep më të spikatur veçorinë. Fjala sinonime *e rrudhosura* ndjehet e zbehtë në disa drejtime krahasuar me *zhubra*, që krahas cilësisë së theksuar jep dhe negativitetin, përbuzjen për një veçori qeniesh të neveritshme. Vetë Shekspiri bën fjalë për *buzë të holla*.

You murdering ministers. [Sh:288]

Vrasës, gjakës të padukur. [N:33]

Fjala *gjakës* emërton njerëzit që merren me vrasje, gjakderdhje. Sinonimi i konsumuar do të ishte *vrasës*.

With Tarquin's ravishing strides. [Sh:291]

Si Tarkimi i hazdisur. [N:47]

Commends the ingredients of our poison'd chalice. [Sh:289]

Na zgjat në buzë vrerin që gatitëm vetë. [N:38]

Fjalët e përdorura nga shkrimtari-përkthyes, krahasuar me origjinalin, shprehin veçori më të theksuara e më të evidentuara. Ato e japin tiparin në përmasa jo të zakonshme. Në semantikën e këtyre fjalëve spikat ideja e kapërcimit të një kufiri.

⁸¹ Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, Tiranë, 1972, f. 228.

2.1.4 Një lloj i veçantë i konsumimit semantik

Në rastin e këtij konsumimi bëhet fjalë për disa forma të vjetruara (në rastin tonë ndajfolje) që konkurrojnë me trajtat e sotme. Duke qenë të markuara, si forma arkaike, këto ndajfolje paraqesin përgjegjësen shprehëse të tyre psh: (*plotërisht*=*plotësisht*). Prandaj mund të themi që forma arkaike ka bërë që fjala sot të ndihet e zbehur në kuptimin e shprehësisë, dhe si rezultat i saj të konsumohet duke i lënë vendin fjalës së sotme:

I'll be myself the harbinger and make joyful. [Sh:287]

Këtë gëzim ma falni ***plotërisht***. [N:30]

Fjala *plotërisht* qëndron për plotësisht.

So humbly take my leave. [Sh:287]

Lyp lejen pra ***përunjësisht***. [N:30]

Shprehësia e manifestuar nga elementet ndajfoljore të nënvizuara ka të bëjë me formën e tyre të vjetëruar. Nëse do ta inkuadronim këtë dukuri në procedenë e konsumimit do të duhej ta ballafaqonim me gjendjen e sotme të këtij grupi, *plotësisht*, *përunjësisht*. Ashtu si shprehet dhe Agalliu, për lexuesin e sotëm diferenca hermeneutike midis këtyre varianteve përbën ngjyrimin stilistik.⁸²

Krahasuar me fjalët e përdorura nga Noli do të ndjeheshin më të zbehta fjalëformat e sotme.

I have a strange infirmity. [Sh:298]

Kam sëmundje ***të çudiçime***. [N:89]

Kjo formë nuk para përdoret në shqipen e sotme, prandaj rrezaton shprehësi për lexuesin e sotëm. Ndërsa në gjuhën angleze ajo mbart kuptimin e çudisë. Mjete të tilla, si ato të sipërpërmendura, i përçojnë shumë informacion dhe ndjenjë lexuesit: idetë, emocionet, vlerësime etj. Fjalët që shenjojnë tipare cilësore e kanë në natyrën e tyre shprehësinë. Në këtë mënyrë ligjëruesi shpreh vlerësime e qëndrime për atë që cilësohet. Gjatë përdorimit ndodh që këto fjalë e harxhojnë shprehësinë, prandaj ato zëvendësohen me fjalë të tjera më shprehëse.

By each at once her choppy finger laying. [Sh:285]

*Po veni duart e **krasitura**. [N:20]*

⁸²F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, Toena, Tiranë, 1999, f.110

Në tekst *duart e krasitura* ka kuptimin të rraskapitura, të lodhura. Mbiemrat e mundshëm të *rraskapitura*, *të lodhura*, që hyjnë në marrëdhënie sinonimie kontekstuale me *të krasitura*, ndjehen të çngjyrosur, dhe Noli nuk i sjell në ligjërim, por tenton drejt elementeve më shprehëse, siç është fjala *të krasitura*, që del në kuptim të figurshëm për të dhënë nocionin *të lodhura*. Fjalët që shprehin veprim a gjendje kanë aftësi të veçantë transmetuese në ligjërimin afektiv. Ato mënjahohen e zëvendësohen shpesh me sinonime shprehëse a përshtypjelënëse.

2.1.5 Konsumimi semantik për arsye etike

Konsumimi semantik, që ndodh sidomos në fjalët me vlera shprehëse, është shumë veprues në letërsinë artistike, ku shprehësia është një atribut i përhershëm i leksikut. Vetë konsumimi është një mënyrë për të arritur një shprehësi sa më të lartë. Procedeja e konsumimit semantik në letërsinë artistike kushtëzohet nga mënyra e paraqitjes së materialit letrar dhe nga mënyra e komunikimit me lexuesin.⁸³ Këto të fundit, paraqitja e materialit letrar dhe forma e komunikimit me lexuesin, kanë sjellë një përdorim të dukshëm të këtij mekanizimi edhe në tragjedinë e “Makbethit”, të shqipëruar nga Noli.

Leksiku i Nolit përmban një rreth të gjerë njësisish shprehëse që e kanë arritur nivelin e lartë shprehës, duke u përfshirë në procedenë e konsumimit. Ky është një konsumim i llojit stilistik, që ndryshon nga konsumimi i përhershëm linguistic, nga shpejtësia e veprimit dhe nga përhapja.

Konsumimi semantik, siç e kemi përmendur më lart, në disa raste ndodh për arsye shoqërore. Konsumimi, sipas Emine Sadikut, mund të përdoret në emër të një etike, të një shijeje të ngritur, të një parapëlqimi të përparuar a të përgjithshëm, për këtë zgjidhen disa fjalë në vend të disa të tjerave, që kanë përmbajtje të rëndë.⁸⁴ Ky fenomen vihet re në leksikun e përdorur nga Noli.

⁸³ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 11.

⁸⁴ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 14.

2.2 Konsumimi stilistik i disa pjesëzave

Veç fjalëve shprehëse një lloj harxhimi kuptimor pësojnë dhe një grup fjalësh që përdoren shumë dendur në ligjërim, të tilla janë pjesëzat mohuese: *mos*, *nuk*. Këto fjalë, nga përdorimi shumë i madh, kanë humbur diçka nga pesha kuptimore. Agalliu shprehet se në fazën e parë të krijimtarisë Noli përdor pjesëzën *mos* dhe jo *nuk*, ndërsa në fazën e dytë të krijimtarisë, Noli si në publicistikë ashtu edhe në prozën historike mbisundojnë ndërtimet e plota dhe format mohore me *nuk*, megjithatë nuk mungojnë edhe mohimet me *mos*. Mohimi i bërë me pjesëzën *mos* lë vend për t'u plotësuar me ndonjë fjalë tjetër që të marrë pamjen e prerë të një mohimi të mirëfilltë e të padyshimtë. Pjesëza *mos* mund të përsëritet, mund të përforcohet nga fjalë të tjera me kuptim mohues, si: *jo*, *kurrë*, *asnjëherë* etj. Noli, shpeshherë, në vend të *jo-së* dhe *nuk* përdor pjesëzën *mos* (në ndërtime të caktuara) ose ndonjë mjet tjetër.⁸⁵

Mohimi i formuluar me këto pjesëza është i prerë. Një fenomen i tillë në gjuhën angleze shprehet me fjalët mohuese *no*, *not*, *don't*, *never* etj.

Sleep no more! [Sh:291]

Mos fli më! [N:51]

Glamis hath murder'd sleep. Shall sleep no more,

Makbeth shall sleep no more. [Sh:291]

Mos fli më! Makbethi vrau gjumin! S'fle më,

Makbethi nukë fle dot më!" [N:50]

Përsa i përket pohimit ai bëhet me pjesëzën *po*, por shpesh i vërejmë se kjo pjesëz lihet mënjanë dhe për të pohuar përdoren fjalë e shprehje të tjera, si: *Amen* etj. Kjo dukuri vihet re edhe në origjinalin e Shekspirit.

One cried 'God bless you!' and 'Amen' the other. [Sh:291]

Një tha "Na ruajt Zoti"; tjetri tha "Amen". [N:50]

Amen është lutje që do të thotë "*po*", na ruajt Zoti. Noli e përdor dendur fjalën *Amen*. Shprehësia e fjalës pohuese, *Amen*, qëndron në vëllimin kuptimor-emocional, që është më i madh nga ai i fjalës *po*.

⁸⁵ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, Toena, Tiranë, 1999, f.111

2.3 Përdorim fjalësh me mbingarkesë emocionale

Fjalët e Shekspirit vijnë shumë të gjalla dhe kuptimplote nëpërmjet Nolit, duke lënë shumë mbresa dhe emocione.

I am too savage. [Sh:303]

Do të kisha qenë m' i *pashpirtmë*. [N:114]

Veçoria e leksikut të Nolit është se fjala e zgjedhur prej tij në shembullin e lartpërmendur është më e zbutur, nuk e ka atë forcë emocionuese që të jep fjala në origjinalin e Shakespirit, i cili do të ishte *barbar, i egër*.

The merciless Macdonwald-Worthy to be a rebel, for to that. [Sh:284]

Mizor i *pamëshirti* Makdonald-rebel, (N.14)

Till he unseame'd him from the nave to the chaps. [Sh:284]

Ai ia *shthuri* nofullat e gjoksin. [N:14]

Folja *shthuri* nuk shenjon një krim të poshtër, por një vepër barbare, kafshërore. I tillë është Mekdonaldi, katil dhe i pamëshirë. Këto veçori të leksikut shprehës janë në funksion të paraqitjes sa më të bukur, jo vetëm të materialit letrar, por edhe të komunikimit sa më të mirë, të ndjeshëm e prekës me lexuesin.

Si përfundim konsumimi semantik mund të ndodhë për shkak të volumit semantik dhe fonetik, sinonimisë kontekstuale, sinonimisë së pjesshme kontekstuale, si dhe për shkaqe etike shoqërore. Këto veçori të shprehjeve semantike të konsumuara janë përdorur nga Noli për një funksion më të mirë paraqitjeje. Ne do ta vazhdojmë studimin në këtë fushë për të gjetur forma të tjera të konsumimit semantik në përkthimet dhe krijimet e Fan Nolit.

2.4 Variacioni sinonimik

Xhevat Lloshi për variacionin gjuhësor shprehet se gjuha shqipe ka një bërthamë të qëndrueshme, e cila shfaqet në volum. Bërthama përbën strukturën, ndërsa realizimet quhen variante. Çdo variant ka ndarjet e veta, rolin dhe kushtet e përdorimit. Variacioni është i nevojshëm për ekzistencën e gjuhës në jetën e gjatë e të pasur të popullit. Kur variantet largohen

shumë përfundojnë në gjuhë të ndryshme, siç janë gjuhët neolatine kundrejt latinishtes. Edhe në rrafshin sinkronik shoqëria e zhvilluar ka një shumësi mënyrash të përdorimit të gjuhës.⁸⁶

Asnjë bashkësi folësish dhe asnjë njeri i zakonshëm nuk e kufizon repertorin e vet me një mënyrë të vetme gjuhësore, që nuk do t'i lejonte të shprehte gjendjen e qëndrimin e tij, dëshirat e parapëlqimet, veçantitë e grupit shoqëror ose dhe prirjet e tij krijuese. Shqipja e sotme, si një dukuri e gjerë, është një tërësi variantesh.⁸⁷

Tipat e varianteve dallohen nga ndryshimi gjatë historisë. Shqipja e vjetër vjen deri në shek. VIII-IX, kur ishin përvijuar dy dialektet e saj kryesore, ndërsa shqipja e mesme vjen deri në shek. XVII dhe quhet arbërishte. Në kohën e arbërit lindi kërkesa historike për ta shkruar shqipen. Me librin e Gjon Buzukut, më 1555, na shfaqet varianti kryesor, gjuha e autorëve të vjetër; shqipja e re e shek. XVIII e deri në ditët e sotme. Edhe këtu dallohen tri faza, ndër të cilat e dyta është Rilindja (afërsisht 1820-1920), dhe faza e tretë, ose ndryshe quhet gjuha e sotme, e cila është pas viteve 1920.⁸⁸

Përhapja gjeografike bën variantet krahinore, si arbërishtja e shqiptarëve të Italisë, e cila është një variant gjeografik-historik. Gjuha lind dhe jeton si gjuhë e folur, por edhe njësimi i gjuhës është i domosdoshëm. Njësimi është çështje e përsosjes dhe pasurimit të sistemit të gjuhës letrare, e ngulitjes së normës standarde. Kështu, nevoja për variacion bëhet më e gjallë.⁸⁹

Gjuha shqipe merr përsipër rolin historik për t'iu përgjigjur kërkesave të unitetit e të variacionit, ndaj, kjo është problematika themelore e shqipes si gjuhë e kulturës së një kombi dhe të një shteti. Nga njëra anë ajo synon drejt një norme më të ngulitur e të përgjithshme, nga ana tjetër ajo shfaqet me një sistem tërësor variantesh ligjërimore e funksionale.

Vendosja e normës standarde sipas Lloshit sjell ngadalësimin e ndryshimeve strukturore, sidomos në fonetikë dhe morfologji. Ndryshimi dhe pasurimi bëhen sidomos në leksik, fjalëformim, semantikë e sintaksë, të cilat përcaktohen nga kërkesat e stileve, ku vihen re

⁸⁶ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 147

⁸⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 147.

⁸⁸ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f.148.

⁸⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f.148.

variacione me vlera stilistike. Në etapën e sotme merr më tepër rëndësi shtresimi social e stilistik i gjuhës.

Sistemi stilistik është shfaqja themelore e variacionit të gjuhës dhe atij i përket e ardhmja, si zgjidhja më e përshtatshme për variacionin. Ristani thekson se thelbin e sistemit gjuhësor e përbën një bërthamë e përbashkët gramatikore, leksikore dhe sintaksore, e cila i shërben strukturimit të metejshëm gjuhësor si bosht mbështetës për përdorimet e ndryshme diakronike dhe sinkronike të emërtuara *variante*.⁹⁰

Sipas Emine Sadikut variacioni sinonimik është një procedë, e cila ka të bëjë me përdorimin e shprehjeve paralele që nga ana kuptimore kanë të njëjtin kuptim. Këto shprehje të tilla paralele krijojnë njësi sinonimike ose variante semantike, p.sh.

Nisi të qante, këtë herë më *ngashërueshëm*. Zëri i doli prapë gjithë *ngashërim*.

Për të përcaktuar kuptimin e foljes në rastin e parë përdoret ndajfolja *ngashërueshëm*, në rastin e dytë sintagma *gjithë ngashërim*. Midis këtyre gjymtyrëve ka sinonimi.

Gjuha, sistemi i saj, ofron shpesh disa mundësi për të shprehur të njëjtin kuptim. Kjo gjë duket dhe në shembujt e sipërpërmendur. Si përcaktor i një emri mund të përdoret një emër a një mbiemër (që janë barazvlera kuptimore). Kjo gjë përshkruhet dhe në gramatikat tona: “Fjalët që përcaktojnë kuptimin e foljeve, që tregojnë cilësinë e veprimit, bëjnë punë të ngjashme me përcaktorin; janë si të thuash përcaktor i foljes dhe shprehen me ndajfolje dhe lokucione ndajfoljore, ose me emra të prirë nga parafjalë *me, pa, në* etj., me togfjalësh të zakonshëm e frazeologjik”.⁹¹

Citimet e sipërpërmendura tregojnë se gjuha ofron një larmi mjetesh për të dhënë një ide. Por, secili mjet paralel e plotëson idenë bazë me ngjyime llojesh të ndryshme, p.sh. ndërtimet parafjalë + emër kanë ngjyime të ligjërit bisedor krahasuar me disa ndajfolje që evokojnë sferën librore të komunikimit etj.

Thelbi i variacionit, rrjedhimisht edhe i stilit, duke përbërë lidhjen ndërmjet gjuhës, kontekstit dhe sjelljes gjuhësore në një situatë të caktuar ligjërimi është dallimi, i cili mund të analizohet duke u bazuar në krahasimet që janë të domosdoshëm për të vënë në dukje shkallën e variacionit stilistik në situata specifike ligjërimi. Efektet e spikatura stilistike krijohen si rezultat i shmangieve nga përdorimi që është më se normal për situatën e dhënë. Në çdo rast në

⁹⁰ V. Ristani, *Kontribut në studimet përkrthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f. 13.

⁹¹ *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, III, 2*, Tiranë, 1983, f. 6.

marrëdhëniet folës/dëgjues, shkruar/lexues vendoset një masë e caktuar pritshmërie në varësi të lidhjes mesazh-situatë ligjërimore, rrjedhimisht mesazhi i pritshëm përmbush kërkesat ose e zhgënjën dëgjuesin/lexuesin. Në rast se mesazhi i përmbush kërkesat atëherë ai përputhet me stilin.⁹²

Noli i shfrytëzon në mënyrë artistike këto shprehje. Ai krijon shpesh variacione sinonimike. Sinonimet janë një dukuri objektive në gjuhë, meqenëse ekzistojnë fjalë, forma morfologjike, kategori dhe ndërtime gramatikore që kanë kuptime të afërta, por jo krejtësisht të njëjta. Megjithatë, shkrimtarët nuk kufizohen vetëm me mundësitë që u vë përpara sinonimia e gjuhës së përgjithshme, ata përpriqen të futin në marrëdhënie sinonimie edhe mjete gjuhësore të reja. Varfëria e sinonimeve, sipas M.Gorkit, tregon jo vetëm pakujdesi, por edhe padije.⁹³

Noli është shumë i aftë në përdorimin e mjeteve sinonimike me anën e të cilave synohet që mendimi e ndjenjat të jepen me ngjyra të bukura stilistike. Kështu, ai krijon nga rrënja e një emri, si p.sh. *kurorë*, mbiemrin *i kurorëzuar*. Në këtë mënyrë ai shmang dhe monotoninë që shkaktohet nga përdorimi herë pas here i të njëjtit mjet. Këto mjete, të cilat përdoren gjërësisht nga Noli, janë sinonime kuptimore jo të plota. Midis tyre ka dallime. Si të tilla këto mjete ndihmojnë për të dhënë një informacion të pasur e të detajuar. Mendojmë se për këtë arsye përdorimi i tyre, i këmbyer, e bën ligjërimin më të gjallë. Këto shprehje paralele kuptimore që vihen re në ligjërimin e Nolit, në përkthimin e “Makbethit”, mund të ndahen në disa lloje variacionesh kryesore.

2.4.1 Variacione sinonimike të shprehura me emra dhe mbiemra

Në këtë grup bëjnë pjesë variacione të shprehura me emra dhe mbiemra, të cilat cilësojnë emra dhe shprehin tipare të sendeve e të dukurive të shenjuara me emra. Për të shprehur tipare të tilla përdoren mbiemra dhe emra.

Ristani thekson se për dukurinë e variacionit në raport me ligjërimin autorë të ndryshëm, duke trajtuar pamjen e dimensioneve stilpërshkruese dhe stilformuese, e cila është më e gjërë, komplekse dhe nuk përputhet me idenë thjeshtëzuese të variacionit stilistik të gjuhës, pohon se

⁹² V. Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f. 42.

⁹³ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 169.

do të ishte e çuditshme në rast se kompleksiteti i variacionit gjuhësor të mund të shpjegohet duke iu referuar vetëm fushës së veprimtarisë, statusit, modalitetit dhe njëjtësisë. Por duhet skema e organizimit të tipareve stilistike në mënyrë që të krijohet në kuadrin e strukturës së tekstit një ndërthurje e dimensioneve të përshkrimit, kategorive të përshkrimit dhe tipareve stilistike nën veprimin e kufizuesve situative, të cilët nuk i shqyrtojnë të veçuar, por në ndërveprim.⁹⁴

Mbiemrat në përgjithësi kanë ngjyrim vlerësuese. Mbiemri lejon të kuptohet qëndrimi i folësit ndaj sendit a qenies apo personit të përcaktuar. Përcaktorët mbiemërorë lidhen drejtpërsëdrejti me fjalën e përcaktuar, ndërsa emrat lidhen me fjalën e përcaktuar indirekt ose me ndërmjetësinë e një mjeti tjetër.

Përcaktorët mbiemra dhe emra, zakonisht, përdoren në të gjitha sferat e komunikimit, prandaj, në përgjithësi ata nuk marrin ngjyrim stilistike të veçanta.⁹⁵

A Child crowned, with a tree in his hand. [Sh:301]

Del nga kazani një foshnjë e kurorëzuar me një degë në dorë. [N:104]

*What is this that rises like the issue of a king, and wears upon his baby-brow the round,
and top of sovereignty [Sh:301]*

Kush është ky që ngrihet si bir mbreti, kjo foshnjë me kurorën përmbi kokë? [N:104]

Në shembullin e parë është përdorur përcaktori e kurorëzuar, në shembullin e dytë është përdorur emri me kurorën. Këto dy gjymtyrë janë sinonime kuptimore, të cilat mund të zëvendësohen me njëra-tjetrën.

Një emër abstrakt mund të shenjojë cilësinë që është i së njëjtës familje me mbiemrin që shenjon. Në pikëpamje sintaksore emri abstrakt i cilësisë është më i pavarur se fjala që shenjon bartësin e cilësisë. Kjo bën që cilësia të jetë tepër e spikatur.⁹⁶

Spiteful and wrathful, who, as others do. [Sh:299]

Smirtar e zemërndezur që lakmon. [N:94]

You murdering ministers, wherever in your sightless substances. [Sh:288]

O xhinder vrasës, gjakës të padukur. [N:33]

⁹⁴ V. Ristani, *Kontribut në studimet për kthimore gjatë viteve '90*, Geer, 2010, f. 28.

⁹⁵ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 18.

⁹⁶ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 18.

It is the bloody business which informs, thus to mine eyes. [Sh:290]

Kjo s'është veç se vepra e gjakëshme që po m'i shfaqet syrit. [N:46]

Dallimi midis këtyre mjeteve cilësuese paralele ka të bëjë me semantikën e shprehësinë e tyre. Përcaktorët emërorë të përdorur nga Noli, *vrasës, gjakës*, luajnë një rol sintaksor më të pavarur, pavarësisht se janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Kjo pavarësi, që ka të bëjë me veçoritë morfologjike të fjalës, vepron në vlerën e saj përcaktuese. Pikërisht cilësia e shprehur me emër e bën paraqitjen më konkrete, më të dukshme dhe më të spikatur. Përcaktori emër e jep cilësinë konkretisht dhe e detajon me anë të përdorimit të ndonjë mbiemri apo emri që plotëson më tej kuptimin e emrit.

Këto njësi paralele dallojnë njëra nga tjetra. Ato shprehin ngjyime emocionale. Elementi që ka ngjyrim emocional plotëson elementin tjetër. Ato kanë dhe dallime që lidhen me semantikën dhe shprehësinë e tyre. Edhe pse që të dyja variantet sinonimike janë gjymtyrë të dyta të fjalisë, përcaktori emër apo vetë emri luan një rol sintaksor më të pavarur. Kjo ka të bëjë me veçoritë morfologjike të fjalës. Emri në funksionin e përcaktorit e jep cilësinë më të detajuar

*And thy hair, thou other gold-bound brow, is like the first. What, will
the line stretch out to the crack of doom? [Sh:301]*

*Si mbret i par' i paske dhe ti flokët. Çudi! Mos po vazhdon
kjo vijë mbretërisht [N:106]*

Në këtë shembull ndodh përsëritja e së njëjtës fjalë me forma të ndryshme. Në fjalinë e dytë njësia '*mbretërisht*' shërben si përcaktor i fjalës *vijë* me kuptimin varg mbretërisht. Në fjalinë e parë kemi variantin *mbret* po me funksion përcaktuesi, emër në emërore.

I am bent to know, by the worst means, the worst. [Sh:299]

Se jam gati të di më të ligën, me mjetet më të liga. [N:93]

Njëherë përdoret emri *të ligën*, pastaj mbiemri në shkallën krahasore të sipërisë *më të liga*. Fjalët kanë lidhje prejardhje. Zakonisht përcaktorët mbiemra dhe emra përdoren në të gjitha sferat e komunikimit. Disa mbiemra të tjerë kanë ngjyime poetike, ngjasojnë me mjetet tingëlluese poetike.

Of direst cruelty! [Sh:288]

Me zemërgurësinë më të egër! [N:33]

Tipari i paraqitur, ligësi ekstreme, jepet me emrin *zemërgurësi*, që përcaktohet më tej me mbiemrin *më të egër*.

My lord, his throat is cut; that I did for him.

Thou art the best o' the cut-throats. [Sh:297].

*Imzot ia preva **kokën**: e mbarova. Je më i miri i **kokëprerësve**. [N:84]*

Shprehjet me të pjerrta kanë të bëjnë me personin që pret koka; njëherë kuptimi jepet me një grup folje+emër, njëherë me kompozitën *kokëprerës*. Njësitë dallojnë në semantikë dhe në shprehësi. Njësia *preva kokën* e ka ngjyrimin emocional brenda kuptimit të saj, sepse prerja e kokës ngjall gjithnjë emocione e ndjenja negative. Ndërsa *kokëprerës* shenjon personin sipas këtij veprimi makaber. Mund të përdorej ndërtimi sinonimik *ai që pret koka*, por fjala e përbërë *kokëprerës* del më sinjifikative dhe shprehëse. Edhe këtu lidhja e prejardhjes është e evidente.

For thy undaunted mettle should compose, nothing but males. [Sh:290]

*Bëj vetëm djem, moj grua. Se **trimëria** jote **e patrembur**. [N:41]*

Të dyja njësitë e nënvizuara kuptimisht paraqesin një lloj sinonimie. Semantema e përbashkët “*që nuk ka frikë*” jepet me dy emërtime *trimëri* - *e patrembur*. Të vendosura në një grup “*trimëri e patrembur*” synojnë intensifikimin kuptimor dhe shprehësor.

Në shembullin ilustrues të mëposhtëm kemi përdorimin e dy attributeve *e pabesë-tradhëtore*. Kuptimisht elementet vendosin marrëdhënie sinonimie. Për nga shprehja dallojnë midis tyre, prandaj i kemi trajtuar si raste të shprehjes së variacionit sinonimik.

Assisted by that most disloyal traitor. [Sh:285]

*Me ndihmën e pabesë **tradhëtore**. [N:16]*

Duhet të theksojmë se zgjedhja e një varianti lidhet ngushtë me rrethanat ligjërimore e me gjendjen e ligjëruesit. Ai mund të përdorë shprehësinë e fjalës tjetër sinonime për të dhënë një situatë të tensionuar e nervoze.⁹⁷

Noli i shfrytëzon artistikisht të gjitha mundësitë që ofron gjuha për një shprehje sa më të detajuar në mënyrë të hollësishme të ideve dhe të emocioneve. Duke patur parasysh shembujt e lartpërmendur, Noli krijon larmi shprehëse me variante sinonimike, të cilat shprehen në forma të ndryshme, si: emër me mbiemër, emër me folje, emër me emër, mbiemër me folje, mbiemër me mbiemër, folje me folje, ndajfolje me mbiemër.

⁹⁷F. Agalliu, Gjuha e Nolit, Toena, Tiranë, 1999, f.33

Variacionet sinonimike paraqesin tipare me shumë saktësi, me ngjyrimë e me forcë ndikuese. Nga analiza konstatuam se i njëjti fenomen ndodh edhe në gjuhën angleze, si p.sh. *mystery* (mister-emër), *mysterious* (misterioze-mbiemër) etj.

I lindur dhe i rritur në një mjedis gjuhësor që trashëgonte dhe zhvillonte veçoritë e të folmeve toske, Noli në shkrimet e veta u bë një ndër përpunuesit më në zë të variantit jugor të gjuhës letrare shqipe duke vazduar dhe çuar më tutje punën e nisur nga pararendësit e vet si Naimi, Samiu, Konica etj. Ai që në hapat e parë të veprimtarisë atdhetare u bë i vetëdijshëm për nevojat e njësimi gjuhësor, duke filluar me alfabetin e duke mbaruar me gjuhën letrare, sepse një kombi të formuar, që ka njësinë e vet shpirtërore, i duhet patjetër edhe njësia gjuhësore.⁹⁸

2.5 Barazimi Semantik (ekuacioni semantik)

Noli ndërton shumë ekuacione semantike. Ai vë shenjën e barazimit midis dy fjalëve, që nëse i shohim të veçura kanë kuptime krejt të ndryshme. Po t'i shohim nga ana sintaksore subjekti dhe predikati janë nocione me përmbajtje të ndryshme, është dhe konteksti ai që bën dallimin e tyre. Fjalët nuk kanë përdorim të figurshëm.

Në ekuacionin semantik, sipas Emine Sadikut, fjalët hyjnë në gjykim me kuptimin e tyre të mirëfilltë dhe gjykimi pohon e shpall barazinë e tyre kuptimore. Subjekti dhe predikati përfytyrohen nga shkrimtari si barazvlera kuptimore, po kështu vështrohen ato edhe nga lexuesi.⁹⁹

What are these, so wither'd and so wild in their attire. [Sh:285]

Ç'janë këto të fishkura dhe rrobëçjerra që nuk duken ndenjëse të dheut. [N:20]

Këtu kemi barazvlerën e të fishkura dhe rrobëçjerra me ndenjëse të dheut.

Are ye fantastical, or that indeed, Which outwardly ye show? [Sh:286]

Jeni vallë pamje fantazije apo me trup siç dukeni, të gjallë? [N:21]

⁹⁸ F. Agalliu, Gjuha e Nolit, Toena, Tiranë, 1999, f.33

⁹⁹ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadasës*, Tiranë, 1998, f. 51-52.

Koncepti *pamje fantazije* njëjtësohet me konceptin *të gjalla*. Ky barazim bën që koncepti i parë të rrethohet me një atmosferë emocionale negative, pesimiste. Fjala e parë e afron atë kuptimisht me fjalën e dytë, që e përmban ngjyrimin emocional negativ në strukturën e saj kuptimore, duke përfutur ngjyrimet të zbehta.

The earth hath bubbles, as the water has. [Sh:286]

*Ka **fluska dheu** pikërisht si **uja**. T'atilla janë. [N:22]*

Në këtë rast kuptimi leksikor i *fluska dheu* ka të njëjtën vlerë me *fluska uji*.

The service and the loyalty I owe, in doing it, pays itself. [Sh:287]

***Shërbimi e besa** që ju detyron më janë një pagesë prej vetiu. [N:29]*

Në këtë shembull kemi barazimin e njësive leksikore *shërbimi e besa* me *pagesë*.

And our duties are to your throne and state children and servants. [Sh:287]

*Detyrat janë **bij e shërbëtorë**. [N:29]*

Barazime të tilla kanë bukuri dhe forcë tërheqëse. Ato ndikojnë ndaj njëra - tjetrës dhe afrohen kuptimisht, duke fituar ngjyrimet të njëra-tjetrës. I tillë është barazimi i kuptimit semantik i njësive leksikore *detyrat* me *bij e shërbëtorë*.

Our will became the servant to defect. [Sh:287]

***Rob' i mungesës** ish **vullneti** ynë. [N:44]*

Kemi barazvlerën e dy njësive leksikore *rob i mungesës* dhe *vullnet*.

Art thou not, fatal vision, sensible, to feeling as to sight?

Or but the dagger of the mind? [Sh:290]

***Pamje fatale**, apo s'je veç **kam' e mendjes**, një **krijes' e rreme**? [N:46]*

Në fjalinë e sipërpërmendur kemi ekuivalentim të njësive leksikore të *pamje fatale* me *kam e mendjes* dhe *krijes' e rreme*.

*There's no such thing: It is the bloody business which informs,
thus to mine eyes. [Sh:290]*

Kjo s'është veçse vepra e gjakëshme që m'i shfaqet syrit. [N:46]

And drink, sir, is a great provoker of three things. [Sh:292]

*Dhe e **pira**, or zot, është **një provokator** i madh prej tri gjërash. [N:54]*

Njësia leksikore e *pira* ekuivalentohet semantikisht me *provokator*.

Therefore, much drink, may be said to be an equivocator with lechery. [Sh:292]

*Prandaj pra, e **pira** e shumë, mund të thuhet që është **një sofist**
kundrejt harvalerisë. [N:55]*

Në fjalinë e sipërpërmendur kemi barazvlerën e njërive leksikore e *pira* me *një sofist*.

Anon, anon! I pray you, remember the porter. [Sh:292]

*Mos harroni që edhe **portieri** është **njeri me kusure**. [N:54]*

Në këtë shembull kemi ekuivalentimin e njërive leksikore *portieri* dhe *njeri me kusure*. Mendoj se Noli e ka shqipëruar *njeri me kusure*, duke patur parasysh se çfarë nënkuptohet midis rreshtave.

It's night's predominance, or the day's shame. [Sh:294]

***Fitorj' e natës është turp' i ditës.** [N:64]*

Fitorja e natës' dhe turp' i ditës barazohen. Nëse fjalët do të ishin marrë të shkëputura nuk kanë asnjë gjë të përafërt midis tyre.

'T is unnatural. [Sh:294]

***Kjo është gjë e panatyrshme.** [N:64]*

Barazimi shprehet me anë të fjalëve *kjo* dhe *gjë e panatyrshme*.

Art thou afeard to be the same in thine own act and valour

As thou art in desire? [Sh:289]

*Vall' a ke frikë të jesh aq burrë **në vepr' e në kurajë** gjithashtu. [N:40]*

Me anë të këtyre fjalëve nënkuptohet që zonja Makbeth i drejtohet Makbethit duke vënë shenjën e barazimit midis *burrë në vepër* e *në kurajë*.

Your spirit shine through you. [Sh:296]

Nga syri juaj shoh që (ju) jini burra. [N:75]

Në shembullin e lartpërmendur Noli origjinalin e Shekspirit *spirit shine* e ka përkthyer jo fjalë për fjalë shpirt që shkëlqen, por *burra*, d.m.th trima, pra, shoh *burra*, trima përpara. Pra, Noli jep një përkthim kontekstual. *Ju* barazohet me *burra*. Shprehjet e cituara *fitorj' e natës është turp' i ditës*, *kjo është gjë, vepr' e në kuraje*, *(ju) jini burra* japin një gjykim kategorik pohues, duke i barazuar *fitorja me turp*, *në vepr' e në kurajë* etj. Kjo bën që fjalët të shprehin emocion dhe ngjyrim.

Angels are bright still, though the brightest fell. [Sh:304]

*Se **ëngjëj** drite ishin dhe **djajtë**. [N:116]*

Në këto shembuj kemi ekuivalentimin e njërive leksikore *ëngjëj e djajtë*. Një ekuivalentim i tillë shpreh besimin ndaj fesë, rrëfim biblik.

Mjetet e ligjërimit fetar kërkojnë të përçojnë diçka të shenjtë, të mistershme, të përjetshme, të mbinatyrshme, duke e kthyer në burim shprehësie.¹⁰⁰

*Not in the legions of horrid hell can come a devil more damn'd
in evils to top Macbeth. [Sh:304]*

*As në taboret e skëterrës s'ka një djall më të paudh' e të mallkuar,
që mund të barabitet me Makbethin. [N:118]*

*I grant him bloody, Luxurious, avaricious, false, deceitful Sudden,
malicious, smacking of every sin That has a name. [Sh:304]*

*Vërtetë e di që është gjakatar, kurvar, avar, dinak e i pabesë,
në çdo mëkat që ka një emër. [N:119]*

Ekuivalenca e njërive leksikore paraqitet me fjalët *djall* me *gjakatar*, si dhe *kurvar*, *avar*, *dinak* me *i pabesë*. Këto ekuivalentime shfrytëzohen nga Noli për të përftuar efekte të forta.

Boundless; intemperance in nature is tyranny. [Sh:304]

Mosmbajtja e natyrës është tirani. [N:119]

Në të gjithë shembujt e sipërpërmendur barazimi semantik ndodh kur njësitë leksikore me kuptime semantike të ndryshme marrin shenjë e barazisë dhe barazohen nga ana kuptimore. Të njëjtën gjë themi edhe për gjuhën angleze, sepse në të shumtën e rasteve vihet re i njëjti fenomen, d.m.th., barazimi shprehet në të njëjtën formë si në gjuhën shqipe. Barazimi semantik krijon bukuri dhe forcë tërheqëse. Ekuacioni përdoret për të nënvizuar nocione dhe për t'i bërë ato sa më të spikatura. Ato gjithashtu kanë tendencë të afrohen kuptimisht, duke fituar ngjyrim të njëri-tjetrit.

2.6 Rrezatimi semantik

Rrezatimi semantik ka të bëjë me përqëndrimin e një ngjyrimi kuptimor a emocional në një mbaresë a prapashtesë, e cila arrin të ngjyrosë krejt fjalën. Ngjyrimi kuptimor, emocional-

¹⁰⁰ E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000. f. 25.

shprehës që fiton një fjalë i detyrohet vetëm një elementi të fjalës, një elementi pa kuptim leksikor të pavarur, siç është p.sh. një prapashtesë.¹⁰¹

Për të paraqitur dukurinë e rrezatimit semantik fjalët do të grupohen sipas njësive të përfuara me anë të procedeve apo përfitesave, duke patur në konsideratë mjetet e përdorura sipas ngjyrymeve që arrihen në sajë të këtyre procedeve. Si mjete ngjyryese përdoren prapashtesat. Këtu përfshihen një numër i konsiderueshëm prapashtesash, të cilat krijojnë fjalëformime, duke i dhënë fjalës ngjyryme emocionale-stilistike. Kështu, ato krijojnë një mori ndajfoljesh, të cilat zunë vend në gjuhën letrare.¹⁰²

- a. Mjete ngjyryese rrezatuese me prapashtesat **-risht** ose **-isht**, **-(rë)shme**:

Make joyful. [Sh:287]

*Këtë gëzim ma falni **plotërisht**. [N:30]*

Who have died holily in their beds. [Sh:306]

*Kanë vdekur **shenjtërisht** në shtrat [N:135]*

Thus with his stealthy pace. [Sh:291]

*Ngadalë dhe me çap **hajdutërisht**. [N:47]*

That very frankly he confess'd his treasons. [Sh:287]

*Të gjitha tradhësitë **frankërisht**. [N:28]*

Art thou not, fatal vision, sensible to feeling as to sight. [Sh:290]

*Pamje fatale s'je e **ndjerëshme** për dorën si për syrin? [N:46]*

Fjalëformimet e sipërpërmendura marrin ngjyryme emocionale-stilistike në sajë të prapashtesave. Është fjala për një shtresë ngjyrymore arkaike-dialektore. Ky tipar është veçori e stilit të Nolit.¹⁰³

- b. Mjete ngjyryese rrezatuese me prapashtesat **-(ë)ri**, **-ar**:

Macbeth doth come. [Sh:285]

*Na vjen Makbethi, **kumandari**. [N:19]*

¹⁰¹ E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000. f. 26.

¹⁰² F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 97-98.

¹⁰³ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 98.

Me këtë prapashtesë në shembullin e mësipërm formohen emra personash sipas punës që bëjnë. Kjo prapashtesë është e specifikuar për formime të tilla. Ndërsa në rastin e mëposhtëm prapashtesa përdoret për formimin e emrave abstraktë nga mbiemrat përgjegjës. Ngjyrimi abstrakt që fitojnë fjalët me bazë mbiemërore është i pranishëm në të gjitha formimet e këtij lloji.

My bosom franchised and allegiance clear. [Sh:290]

*Po me ndërgjegje dhe **besnikëri**. [N:45]*

- c. Mjete ngjyruese rrezatuese me prapashtesat **-ur, -tur, -rak, -ak**:

The flighty purpose never is o'ertook. [Sh:302]

*Qëllimi **fluturak**. [N:108]*

Nga emri *flutur* përftohet mbiemri *fluturak*, që përdoret rëndom në poezi, dhe sjell ngjyime poetike në ligjërim.

- d. Mjetet ngjyruese rrezatuese me prapashtesat e dëshirores **-(f)sha** janë karakteristike për ngjyrimet emocionale-subjektive. Këto janë fjalë me ngjyime të theksuara subjektive që shprehin dëshirën e folësit krahas përmbajtjes objektive të foljes.

If trembling I inhabit then, protest me the baby of a girl. [Sh:298]

*N'u **drithtërofsha** quamë doç kurve! [N:90]*

*Hough you untie the winds and let them fight the yesty
waves confound and swallow navigation up. [Sh:300]*

*Dhe në **përpifshi** anijet nën valat. [N:101]*

Though bladed corn be lodged and trees blown down. [Sh:300]

*Dhe të **shkretofshi** pyj e çafshi dushqe. [N:101]*

Though palaces and pyramids do slope. [Sh:300]

*Dhe në **rrëzofshi** që nga themeltë, kështjella e piramida. [N:101]*

Do slope their heads to their foundations. [Sh:301]

*Dhe në **shkallmofshi** mushkërit' e dheut. [N:101]*

Format e sipërpërmendura të shprehura me dëshirore, **përpifshi, shkretofshi, rrëzofshi, shkallmofshi** etj. janë fjalë me ngjyime të theksuara subjektive meqë shprehin dëshira të folësit krahas përmbajtjes objektive të foljes. Ato janë shprehur me mënyrën dëshirore, e cila është ndër

mënyrat karakteristike të shqipes. Ato japin modalitet të shoqëruar me ndjenjë dhe prandaj në thelb janë forma shprehëse, prania e të cilave sjell vetvetiu ngjyrim në fjalitë e tekstit.¹⁰⁴

Të njëjtën ndjesi japin shembujt e sipërpërmendur edhe në origjinalin e Shekspirit.

2.6.1 Disa prapashtesa të tjera si mjete ngjyruese

Prapashtesat **-aq**, **-or**, **-ac-aç** **-ore** i japin ngjyrim stilistik dialektor fjalës së përdorur. Ato shërbejnë si mjete ngjyruese rrezatuese. Në përdorimin e prapashtesave të lartpërmendura përgjithësisht nuk kalohet në njësi të reja leksikore, por shtresohen ngjyime të ndryshme kuptimore ose stilistike, të cilat rrezatojnë emocion.¹⁰⁵

*Makes him stand to, and not stand to. And live a coward
in thine own esteem. [Sh:289/292]*

*E bën' të qëndrojë si burrë dhe t'i hedhë armët si **frikaç**. [N:40]*

Till thou applaud the deed. [Sh:297]

*Të bëhet dhe të ma **dorëtrokaç**. [N:79]*

*What is a traitor? Was my father a traitor, mother? And be
all traitors that do so? [Sh:302]*

*Të gjithë **tradhëtorët** kështu janë? Çfarë është **Tradhëtor**?*

*Ishte babai im **tradhëtor**? [N:112]*

Assisted by that most disloyal traitor. [Sh:285]

*Me ndihmën e pabesë **tradhëtore**. [N:16]*

Our fears do make us traitors. [Sh:302]

*Bëhemi **tradhëtorë** shpesh nga frika. [N:109]*

Fjalët **frikaç**, **dorëtrokaç**, **tradhëtor** janë fjalë me ngjyime dialektore dhe emocionale, të cilat përftohen nga rrezatimi semantik i prapashtesave të vendosura te fjala e dhënë. Ndërsa forma me prapashtesën **-or(e)** është e vjetruar, prandaj përmban dhe rrezaton ngjyrimin stilistiko-arkaik.

¹⁰⁴ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 98-100.

¹⁰⁵ E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f.27.

Mjete ngjyruese rrezatuese me prapashtesa **-aq** dhe **-ak** janë prapashtesa fjalëformuese, të cilat shpeshherë modifikojnë kuptimin e njësisë së formuar me shtim të ngjyimeve keqësuese. Këto formime bien më shumë në sy për ngjyime dialektore.¹⁰⁶

Mjete ngjyruese rrezatuese me prapashtesat **-(ë)si**, **-ës**, **es**, **-ri** janë veçori e përdorimit të këtyre prapashtesave në leksikun e Nolit, ku fjalët e formuara me ato marrin ngjyrim stilistik. Në gjuhën e sotme këto prapashtesa nuk sjellin ndonjë ngjyrim të veçantë emocional-stilistik, ato janë prapashtesa fjalëformuese.¹⁰⁷

Te Noli ato paraqesin bashkime fjalëformuese të ndryshme krahasuar me ato të sotmet. Le të krahasojmë **tradhësi** - **tradhëti**; **vogëli** - **vogëlsi** etj.,

But treasons capital. [Sh:286]

*Po e përmbysi **tradhësi**’ e lartë. [N:25]*

Fjala **tradhësi** me formën e saj të vjetruar rrezaton ngjyrim stilistiko-dialektor.

My young remembrance cannot parallel. A fellow to it. [Sh:292]

*Si kjo s’mbaj mend të kem parë, askurrë që prej **vogëlisë sime**. [N:57]*

Këto prapashtesa, shpeshherë, u japin fjalëformimeve ngjyime dialektore.

Murder and treason. [Sh:293]

*Vrasje, **tradhësi**. [N:58]*

O, treachery! Fly, good Fleance, fly, fly, fly. [Sh:297]

*Oh, **tradhësi**. Bir, ik, ik. [N:82]*

Mjete ngjyruese rrezatuese me prapashtesën - **si** (sot përdoret **-(t)i**) ngjyros me natyrën e saj arkaike-dialektore.

Treason has done his worst. [Sh:296]

*E vrau **tradhësia**. [N:78]*

Prapashtesat që përdorshin për të formuar dimunitivin në greqishten e vjetër e në latinisht nuk e kishin këtë kuptim në origjinë, por e fituan me kohë duke u përdorur në fjalë që shprehin ngjyime dimunitive, duke e shfaqur këtë fenomen pambarimisht. E njëjta gjë ndodh dhe me prapashtesat, që sipas Sadikut, i sjellin fjalës jo ngjyime emocionale-shprehëse, por ngjyime

¹⁰⁶ J. Thomai, *Leksikologjia e Gjuhes Shqipe*, Tiranë, 1984, f. 116.

¹⁰⁷ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 98.

kuptimore.¹⁰⁸ P.sh. foljet latine me **-sco** tregojnë fillimin e veprimit ose një veprim që kryhet pak nga pak. Një kuptim të tillë prapashtesa e ka marrë duke u përdorur në fjalë, si: *adolesco* (*rritem*), *flosco* (*lulëzoj*), *senesce* (*plakem*). Një tjetër prapashtesë ngjyruese rrezatuese të Noli është **-onjës**:

In the division of each several crime. [Sh:304]

*Me vese e krime **lulëzonjëse**. [N:120]*

Fjala **lulëzonjëse** është një fjalë e bukur me tingëllim poetik. Prapashtesa luan rolin e saj të veçantë në ngjyrimin e kuptimit të fjalës.

In the affliction of these terrible dreams. [Sh:296]

*Dhe ëndrra **drithtëronjëse** për natë. [N:77]*

Mjete ngjyruese rrezatuese me prapashtesën **-os**:

And does blaspheme his breed. [Sh:304]

*Dhe **munxuros** e nxin shtëpin' e tij. [N:121]*

Në këtë shembull nuk është vetëm prapashtesa përgjegjëse për ngjyrimin emocional të fjalës, por është edhe tema e vetë fjalës **munxur** (sot forma standarde është *mynxyrë*). Pra të gjitha prapashtesat e lartpërmendura i japin fjalëve ngjyime kuptimore ose stilistike me anë të të cilave rrezatojnë emocione të ndryshme.

2.6.2 Përftesa të reja stilistike me anë të prapashtesave të tjera prodhuese në gjuhën shqipe

Në kapitullin e fjalëformimit në tekstin “*Leksikologjia e Gjuhës Shqipe*” shtjellohet mundësia e formimit me prapashtesim të njërive leksikore që fitojnë ngjyime emocionale krahasuar me njësinë primitive. Kështu formohen emra me kuptim zvogëlimi me prapashtesat **-th**, **-z(ë)**: *zogth*, *shtëpizë*, *birth*, *strehëz*.

Fenomene të tilla në gjuhën angleze shprehen me prapashtesa zvogëlimi **mini-**, siç është fjala **minibus**, **miniskirt** etj; me prapashtesën **-en**, p.sh: *kitten*, *maiden*; me prapashtesën **-let**, p.sh: *booklet*, *droplet*; prapashtesa **-ish**, p.sh: *childish*; prapashtesa **-y**: *bluey*, *kitty*. Prapashtesa **-za**

¹⁰⁸ E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f.26.

është ndër ato prapashtesa në gjuhën shqipe e cila i jep fjalës ngjyrim dialektor dhe është përdorur dendur nga Noli në shqipërimin e tij.

Wreck'd as homeward he did come. [Sh:285]

*Q'umbyt **njëditëzaj** qyqari. [N:19]*

That way are they coming. [Sh:307]

***Andejza** po na vijnë. [N:137]*

Hence horrible shadow. [Sh:298]

*Shporru **këtejza** hije e tmerruar. [N:90]*

Hence! Why, so, being gone. [Sh:298]

***Këtejza** shporru. [N:90]*

Si sjellëse të ngjyimeve kuptimore në rrezatimin semantik është edhe prapashtesa **-ra**. Kjo prapashtesë mbart ngjyrimin e të folmeve të jugut dhe sjell në ligjërim një timbër popullor. Ajo përdoret për të formuar shumësin e tipit “*teorira*”. Kjo prapashtesë shpjegon krijimin e një sasive nuancash kuptimore në fjalët e formuara prej saj. Fjalët me prapashtesën **-ra** janë në numrin shumës, si pusira. Ky afiks shërben për të formuar shumësin e emrave të ndryshëm, konkretë e abstraktë: *idera, shtëpira* etj. Në gjuhën shqipe prapashtesa **-ra** përdoret për të formuar shumësin e disa emrave të gjinisë mashkullore e femërore. Gjatë formimit të shumësit me **-ra** emrat e gjinisë mashkullore zakonisht e ndërrojnë gjininë. Kjo gjë ndodh me emrat që shënojnë lëndë: *barë-ra, bulmet-ra, gjak-ra*. Ndërsa emrat, *fshat, mall, shi*, e kanë shumsin me **-ra** si formë normale, p.sh: *fshat-ra*. Tek fjala *shi-ra*, shumësi me **-ra** tregon përsëritjen a vazhdimin e fenomenit.¹⁰⁹

Shumësi i formuar me prapashtesën **-ra** vihet re dhe tek emrat e gjinisë femërore. Zakonisht trajta e shumësit me prapashtesën **-ra** del si formë dytësore dhe nuk përbën normë në gjuhën letrare: *kohë-kohëra, gjuhë-gjuhëra*, etj. Këto trajta zakonisht përdoren me një ngarkesë stilistike, sepse trajtat e rregullta janë: *kohë-t, gjuhë-t*, etj.¹¹⁰

Në formimin e temës së shumësit të emrave femërorë, në gjithë shkrimet e Nolit, sidomos në publicistikë, bie në sy një përdorim fort i dendur i prapashtesës **-ra**. Tek autori ka ndikuar jo vetëm e folmja e vendlindjes, por edhe gjuha e autorëve pararendës ose bashkëkohës.¹¹¹

¹⁰⁹ *Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës së Sotme Letrare Shqipe II*, Tiranë, 1976, f. 73.

¹¹⁰ *Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës së Sotme Letrare Shqipe II*, Tiranë, 1976, f. 76.

¹¹¹ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 98.

Who committed treason enough for God's sake. [Sh:292]

*I cili ka bërë një gjëmë **tradhëtirash** për hesap të perëndisë. [N:53]*

Trajtat e shumësit me ngarkesë stilistike i shohim në përkthimin e “Makbethit”. Në këtë varg prapashtesa **-ra** i zgjeron kufijtë kuptimorë të fjalës, duke shtuar nuancë kuptimore që ka të bëjë me masën e asaj që shënohet në fjalën e dhënë.

2.6.3 Parashtesimi si përftesë stilistikore

Si mjete ngjyruese rrezatuese janë edhe një grup parashtesash, një ndër të cilat është edhe prapashtesa **pa-**. Kjo parashtesë shpreh mohim, i cili shoqërohet gjithnjë me ngjyrim subjektive-afektive si çdo mohim tjetër.¹¹²

Look like the innocent flower. [Sh:288]

*Duku si lulja e **pafajshime**. [N:35]*

You murdering ministers in your sightless substances. [Sh:288]

*O xhindër, vrasës, gjakës **të padukur**. [N:33]*

The unguarded Duncan. [Sh:290]

*Mbi mbretin Dunkan **të paruahtur**. [N:41]*

For thy undaunted mettle. [Sh:290]

*Se trimëria jote e **patrembur**. [N:41]*

And that their fitness now does unmake you. [Sh:289]

***Pazotësia** jote i largon. [N:40]*

And shut up in measureless content. [Sh:290]

*Dhe shkoi në shtrat **pamasë** i kënaqur. [N:44]*

And let us not be dainty of leave-taking, but shift away. [Sh:294]

*Le t'ikim fshehtazi **palamtumirë**. [N:63]*

Gainst nature still! Thriftless ambition, that wilt ravin up. [Sh:294]

*Dhe kjo një punë krejt e **panatyrte**! Ambicij'e **pakursyer**, që përpin. [N:66]*

Upon my head they placed a fruitless crown. [Sh:295]

¹¹² F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 47.

*Më vunë kokës kurorë të **papemët**. [N:71]*

Unsafe the while, that we must have our honours [Sh:296]

*Të **pasigurtë** jemi në fuqi, [N:78]*

That I am reckless what I do to spite the world. [Sh:296]

*Me dackat e **pashpirtme**. [N:74]*

Në të gjithë shembujt e sipërpërmendur parashtesa **pa-** shoqërohet gjithnjë me ngjyime subjektive-afektive, si çdo mohim tjetër. Sipas Agalliut shumicën dërrmuese të formimeve e përbëjnë ato mjete që vijnë prej temash emërore, ndajfoljore përemërore. Në mes tyre njeriu mund të dallojë mjaft neologjizma vetjake, që s'munden të hyjnë në përdorim, ka ndër këto fjalë të atilla që përmbajnë parashtesën antonime **pa-**, pa të cilën fjala e krijuar s'mund të qëndrojë, si: i pashpirtmë e pafajshime.¹¹³

Në gjuhën angleze më të përdorshmet me kuptim përgjegjës janë parashtesa **un-** dhe prapashtesa **-less**. Ndërsa në tekstin e Shekspirit për të mohuar është përdorur prapashtesa **-less** dhe parashtesa **un-**, si dhe fjalë me kuptim sinonimik.

I am too savage to do worse to you were fell cruelty,

which is to nigh your person. [Sh:303]

*Po do të kisha qenë m'i **pashpirtmë** sikur të heshtja. [N:114]*

Thou liest, thou shag-hair'd villain. [Sh:303]

*Gënjen zuzar, e laro i **pakrehur**. [N:115]*

*Foul whisperings are abroad. **Unnatural** deeds do breed*

unnatural troubles: infected minds. [Sh:307]

*Po pëshpëriten punë të **paudha**, dhe vepr' e **panatyrtë** lind lëngatë. [N:136]*

Then fly, false thanes. [Sh:307]

*Ikni pra të gjithë, ju thanër të **pabesë**. [N:139]*

This even-handed justice. [Sh:289]

Kjo drejtësi me dorë të paanëshme. [N:38]

Me përdorimin e këtyre parashtesave dhe mjeteve të tjera të sipërpërmendura nuk kalohet në njësi të reja leksikore, por përftohen ngjyime kuptimore. Rrezatimi semantik është dukuri objektive dhe një lloj mundësie gjuhësore për pasurimin kuptimor të fjalës, duke i dhënë asaj

¹¹³ F. Agalli, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 47.

ngjyrimet të ndryshme emocionale, semantike apo artistike. Pikërisht ky rrezatim semantik i llojit stilistik të Noli vë në punë më shumë mjete ngjyruese.

Duke përforcuar mendimin e autorëve të lartpërmendur mendojmë se rrezatimi stilistik është tepër veprues dhe një mundësi e hapur për t'u shprehur sa më bukur. Këto përftesa i sjellin njësisë leksikore me të cilën lidhen ngjyrimet të reja stilistikore, emocionale a kuptimore. Kjo veçori është një veprim mbi fjalën për të rritur domethënien, bukurinë e tërheqjen e saj. Sipas modeleve kuptimore e ndërtimore të gjuhës së gjallë dhe sipas modeleve vetiake, Noli arrin të ndërtojë një sasi të madhe e të larmishme rrezatimesh semantike, të cilat i bëjnë thëniet më të plota, më ndikuese dhe të ekuilibruara.¹¹⁴

¹¹⁴ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, 1999, f. 98.

KAPITULLI III

MBI ZGJERIMIN SEMANTIK DHE VARIACIONET E TIJ

3.1 Zgjerimi semantik

Zgjerimi semantik është një dukuri që përdoret dendur në letërsi. Në krijimet dhe në përkthimet e Nolit shpesh gjenden pranë e pranë dy a më shumë fjalë që shenjojnë ose cilësi ose veprime, objekte, rrethana etj. Umberto Eco shprehet se çdo fjali apo varg fjalish që del në shfaqjen lineare mund të përmblihet (apo të interpretohet nga një mikrofjali). Këto mikrofjali futen gjatë leximit në makrofjali më të gjëra.¹¹⁵

Sleep shall neither night nor day. [Sh:285]

S'e lë të flier' as dit' as natë. [N:18]

Lidhja është me bashkërenditje me anë të lidhëzës **as**, e cila përdoret dhe si pjesëz, zakonisht me folje për të grishur dikë që të flasë e të veprojë. Përdoret e ndjekur shpesh nga lidhëzat shtuese **e, dhe, edhe** për të përforcuar më shumë mendimin që shpreh fjalja, e cila përdoret me kuptimin **bile, madje, qoftë edhe** në vend të pjesëzës **nuk**, e ndjekur zakonisht me **nga që** për të përforcuar mohimin ose kur flitet për një madhësi që nuk është arritur plotësisht.¹¹⁶

Te Noli e gjejmë dhe si lidhëz dyfishe (**as...as**) dhe si pjesëz me funksionin e sipërpërmendur.

Gjymtyrët e procedesë së zgjerimit semantik lidhen në mënyra të ndryshme, mjeti kryesor lidhës janë konektorët. Konektorët, sipas raportit që shenjojnë në tekst, i ndajmë në tri kategori:

- a. *konektorë logjikë*- shprehin marrëdhënien logjike që lidh përmbajtjet e ndryshme të tekstit. Këto raporte mund të jenë të kohës, hapësirës, kundërvënies, zgjerimit të informacionit, shpjegimit, shtjellimit, përfundimit.
- b. *konektorë që saktësojnë organizimin kontekstual*- shërbejnë për të udhëhequr lexuesin dhe për ta orientuar në strukturën e tekstit.
- c. *konektorë që shprehin qëndrimin e folësit apo të shkruesit*.¹¹⁷

¹¹⁵ U. Eco, "Të thuash gati të njëjtën gjë", Dituria, 2006. f.164- 165.

¹¹⁶ Fjalor i Shqipes së Sotme, Tiranë, 2002, f. 59.

¹¹⁷ K. Dibra, N. Varfi, *Gjuhësi teksti*, Ribotim, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 92.

3.2 Dublimi

Çfarë është dublimi? Kur përdoren dy emërtime për të njëjtin nocion kemi të bëjmë me dublim. Emërtimet mund të bëhen njëri me mjete asnjane, tjetri me mjete shprehëse. Të dy emërtimet ndodhen në të njëjtën thënie dhe përbëjnë një të tërë, një emërtim të dyfishtë.¹¹⁸

Dukuria e dublimit krijon barazvlera kuptimore duke na dhënë sinonimi kuptimore. Në dublim sinonimia midis elementeve përbërëse nuk është e plotë. Po të shohim këto elemente do të vëmë re se elementet përbërëse nuk shprehin krejt të njëjtin nocion. Duhet të themi se midis tyre ka dallime të ndryshme kuptimore, si dhe shprehëse. Disa nga dallimet mund të jenë se njëra gjymtyrë ka kuptim të drejtpërdrejtë, ndërsa tjetra ka kuptim të figurshëm. Gjymtyra me kuptim të figurshëm funksionon si barazvlerë shprehëse për gjymtyrën tjetër. Prandaj, themi se sinonimia kuptimore midis elementeve të dublimit mund të jetë kontekstuale. Njëra prej gjymtyrëve nga ana stilistikore është asnjane.¹¹⁹

Earl of Northumberland, general of the English forces. [Sh:284]

*Kont i Northumberlandës, **gjeneral** i ushtrisë Angleze. [N:9]*

For brave Macbeth-well he deserves that name. [Sh:284]

*Makbethi **trim**-ky titull i ka hije. [N:14]*

The merciless Macdowald-Worthy to be a rebel. [Sh:284]

*I **pamëshirti** Makdonald-**rebel**. [N:14]*

Këto fjalë *trim*, *i pamëshirti*, *rebel* kanë kuptim të figurshëm. Noli e ka emërtuar dy herë Makdonaldin. Në të dyja rastet të dy gjymtyrët e dublimit kanë ngjyrim shprehëse. Ndonëse gjymtyrët janë të dallueshme njëra nga tjetra vlen të theksojmë se ato mbartin të njëjtin kuptim. Kuptimi i tyre lesikor është pothuaj i njëjtë.

Come, thick night, And pall thee in the dunnest smoke of hell. [Sh:288]

***O nat' e errët**, eja dhe u vish me **tym**in e dendur të skëterrës. [N:34]*

Të dy gjymtyrët mbartin kuptim të fortë negativ. Ekuivalenti i dytë është figurativ dhe më shprehës se i pari dhe ngjall emocione të frikës. Kjo gjymtyrë është shprehur me togfjalësh.

This guest of summer, the temple-haunting martlet. [Sh:288]

¹¹⁸ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikon shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 53.

¹¹⁹ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikon shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 52-54.

Dhe dallëndyshja, mysafirja e pranverës. [N:36]

No jutty, frieze, Buttress, nor coign of vantage, but this bird. [Sh:288]

*Një çip ku të mos këtë **va, fole e djep** për zogjt' e saj kjo shpesë. [N:36]*

Këto gjymtyrë (*va, fole e djep*) japin imazhin e ngrohtësisë, ashtu si familja për njerëzit, ashtu dhe foleja për shpendët. Gjymtyrët e plotësojnë mjaft mirë njëra-tjetrën. Gjymtyra e dytë plotëson kuptimin e së parës, duke na dhuruar një atmosferë të këndshme pranverore, optimiste dhe plot shpresë.

All our service in every point twice done and then done double. [Sh:289]

Shërbimet tona, të dyfishta në çdo pikë. [N:36]

Në këtë shembull vihet re se elementet sinonimike të dublimit i përkasin shtresave të ndryshme leksikore. Gjymtyra e parë është shprehur me togfjalësh, ndërsa e dyta me një fjalë të vetme. Gjymtyra e dytë dyfishon shprehësinë, rrit forcën shprehëse. Gjymtyra e dytë mund të jetë me kuptim të figurshëm. Ajo bëhet barazvlera shprehëse e gjymtyrës tjetër (që mund të jetë asnjansë stilistikisht). Barazvlerë shprehëse shërben një fjalë me kuptim të figurshëm.

First, as I am his kinsman and his subject. [Sh:289]

*E para e kam **prind** dhe e kam **mbret**. [N:38]*

Në fjalinë e sipërpërmendur kemi dublim të shprehur me **emër+emër**. Mendojmë që elementi i dytë është më shprehës, më domethënës. Por, gjithsesi, të dyja gjymtyrët kanë forcë tërheqëse ndikuese. Funkcioni që kryen dublimi është për të theksuar, për të nënvizuar nocione, për të tërhequr vëmendjen mbi elementet, për t'i vënë më në dukje. Një funksion të tillë kryen dublimi kur gjymtyrët ekuivalente kanë pak a shumë shprehësi të njëjtë, janë zgjedhur si njësi shenjuese, pa ndonjë shprehësi të veçante.¹²⁰

Këtu bëhet fjalë për ngjyrimet pozitive që fiton fjala e parë, që e afrojnë atë kuptimisht me fjalën e dytë, që përmban ngjyrim emocional në strukturën kuptimore.

When Duncan is asleep-Whereto the rather. [Sh:290]

*Posa ta zërë **gjumi** dhe **gjum'** i rëndë. [N:41]*

Në këtë fjali kemi përdorimin e dublimit në një përshkrim psikologjik.

For thy undaunted mettle should compose nothing but males. [Sh:290]

***Trimëria** jote **e patrembur** s' duhet të lindë tjetër veçse djem. [N:41]*

¹²⁰ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikon shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 57.

A dagger of the mind, a false creation, proceeding from the
heat-oppressed brain. [Sh:290]

Veç kam' e mendjes, një krijes' e rreme. [N:46]

And wither'd murder, Alarum'd by his sentinel, the wolf. [Sh:290]

Dhe vrasja fishkëse, -e alarmuar. [N:47]

Thou sure and firm-set earth, Hear not my steps, which way they walk. [Sh:291]

O Dhë i ngjeshur hekur, themelfortë, mos i dëgjo ku më baresin këmbët [N:47]

Macbeth does murder sleep', the innocent sleep, Sleep that knits up the ravell'd sleeve of care,

The death of each day's life, sore labour's bath,

Balm of hurt minds, great nature's second course. [Sh:291]

Makbethi vrau gjumin!-gjumin e pafajshëm, Gjumin që shqit përleshjen e kujdesit, vdekjen e jetës së përditshme, Banjën e punës trupkapitëse, Ballsamn' e shpirtit vrar' e të plagosur,

Gjellën e dytë të natyrës së madhe. [N:50-51]

Në këto vargje dublimi bëhet për sqarim, për saktësim. Njëra gjymtyrë saktëson dhe sqaron kuptimin e tjetrës. Shpesh nocioni që shenjon përfshihet në nocionin që shprehet me gjymtyrën e dytë. Ky nocion ka përmbajtje më të përcaktuar për gjymtyrën e parë dhe e sqaron atë. Pothuaj në të njëjtën mënyrë ndodh dublimi edhe në gjuhën angleze.

Dublimi sqaron, përforcon nocionin e pjesës së parë (të stilemës) siç ndodh në vargjet: *murder sleep', the innocent sleep*, vrau gjumin apo në fjalinë *The death of each day's life, sore labour's bath*. Makbethi vrau *gjumin!-gjumin* e pafajshëm, *Gjumin* që shqit përleshjen e kujdesit, vdekjen e jetës së përditshme, *Banjën* e punës trupkapitëse, *Ballsamn'* e shpirtit vrar' e të plagosur, *Gjellën* e dytë të natyrës së madhe

Gjymtyra e dytë është më e gjërë. Ngjyrimet e zymta që fiton fjala e parë e afrojnë atë kuptimisht me fjalën e dytë, që e përmban ngjyrimin emocional negativ në strukturën e saj kuptimore.

Strange scream of death, and prophesying with accents terrible. [Sh:292]

Furtun' e rreptë çirrej dhe vajtonte me klithma dhe rënkime vdekjeje,

me profetira dhe me gjëma tmerr. [N:57]

O horror, horror, horror! [S:293]

O tmerr, tmerr, tmerr! [N:57]

Malkolm! Awake! Shake off this downy sleep, death's counterfeit,
and look on death itself! [Sh:293]

U zgjoni, **Taklitn' e vdekjes, gjumin pupël** shkundeni dhe shihni **vdekjen** vetë. [N:58]
And Duncan's horses- a thing most strange and certain Beauteous and swift, the minions of their
race turn'd wild in nature. [Sh:294]

Kuajt e Dunkanit, **të bukur e të shpejtmë, stoli e racës tyre**, u egërsuan. [N:65]
Dublimi është trigjymtyrësh dhe realizohet me fjalë klasash të ndryshme, emra, mbiemra.

According to the gift which bounteous nature Hath in him closed. [Sh:295]

Q'i dha **natyra, nëna dorëhapur**. [N:74]

And with him. To leave no rubs nor botches in the work, Fleance his son,
that keeps him company. [Sh:296]

Pastaj, që të mos mbetet **bishti prapa- i bir' i tij** Fleanc q'e shoqëron. [N:75-76]

Hence. Horrible shadow! Unreal mockery, hence! [Sh:298]

Shporru këtejza, **hije e tmerruar, Kukudh imagjinar**. [N: 90]

And I, the mistress of your charms, the close contriver of all harms. [Sh:299]

Kur **mua-perëndeshën e magjive**, dhe **zonjën yshtëse të llahtarive**. [N:94]

What is this? The rises like the issue of a king, and wears upon his baby-brow
the round and top of sovereignty? [Sh:301]

Kush është **ky** që ngrihet si **bir mbreti**, kjo **foshnjë** me kurorën përmbi kokë? [N:104]

Of horrid hell can come a devil more damn'd in evils to top Macbeth. [Sh:304]

Një djall **më të paudhë e të mallkuar**. [N:118]

'Tis call'd the evil: A most miraculous work in this good king. [Sh:305]

Skrofulla, tani e quajnë **sëmundj' e mbretit**. [N:123]

Give sorrow words: the grief that does not speak. [Sh:305]

Po zbraze **vrerin, helmin** që s'po flet. [N:128]

You have displaced the mirth, broke the good meeting, with most admired disorder. [Sh:298]

E prishe muhabetin e gostisë, me ca përçatj' e llo moti pa vend. (N 91)

Not so happy, yet much happier. [Sh:386]

Jo aq **i lumtur**, ca **m' i lumtur**. [N:21]

Duke përsëritur fjalët *i lumtur, ca m' i lumtur* Noli ka dhënë dublimin. Ja disa dublime të tjera të Nolit tek Makbethi.

As cannons overcharged with double cracks, doubly redoubled strokes upon the foe. [Sh:285]

*Armikut me **rrebesh të përsëritur e të dyfishuar**. [N:15]*

Tiparet që shprehen me fjalët e lartpërmendura janë të zmadhuara, të dyfishuara.

Only look up clear; to alter favour ever is to fear. [Sh:288]

*Po vetëm **jij i kthjellët dhe i kjartë**. [N:35]*

You murdering ministers, wherever in your sightless substances.

You wait on nature's mischief! [Sh:288]

*O xhindër vrasës, **gjakës të padukur**. [N:33]*

My plenteous joys, wanton in fulness. [Sh:287]

*Gëzimi **i madh, i plot, i kolmë**. [N:30]*

Fjalët *i madh, i plot, i kolmë* plotësojnë kuptimin e gëzimit, duke e përforcuar njëra-tjetrën.

Në këtë mënyrë Noli ka përshtatur mjaft mirë përdorimin e dublimit të Shekspirin në origjinal.

I drink to the general joy o'f the whole table. [Sh:298]

***Ngre kupën për të gjithë, Gëzuashi!** [N:89-90]*

Here, my good lord. What is 't that moves your Highness? [Sh:298]

*Këtu imzot. **Ç'ju tremb e ç'ju tmerron?** [N:87]*

Fan Noli me raportet midis gjymtyrëve të dublimit, të cilat i analizuam më lart, jep disa modele ndërtimore.

Dublimi ka vlerë jo vetëm për bukurinë e fuqinë e tij shprehëse, jo vetëm se e bën ligjërimin tërheqës, por dhe për shërbimet e shumëfishta që kryen në ligjërim. Dublimi, krahas përfatesave apo procedeve të tjera, është një mënyrë frytdhënëse për ndërtimin e njësive stilistike që paraqesin një informacion më të gjerë dhe një shprehje më të lartë e të spikatur. Gjymtyrët që marrin pjesë në dublim japin secila ndihmesën e vet në përmbajtjen e në shprehësinë e grupit të ri të formuar.¹²¹

¹²¹ . Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 53.

Në gjuhën angleze, sipas studimeve të bëra, vihet re përdorimi i sinonimeve. Gjuha angleze është shumë e pasur me sinonime. Noli ka ditur të na i shqipërojë ato me anë të dublimit, duke e pasuruar në këtë mënyrë gjuhën shqipe, duke e bërë atë më të gjallë dhe më shprehëse.

3.3 Zgjerimi i kuptimit

Sipas Rami Memushaj *zgjerimi i kuptimit*, dmth. kalimi nga një emërim më i veçantë në një më të përgjithshëm, është një dukuri edhe më e përhapur. Kështu janë krijuar emrat abstraktë prej emrash konkretë, si *brengë*, kuptimi i mirëfilltë i së cilës ka qenë *bullungë*, *gungë e ënjtur* e dalë në trupin e njerëzve dhe të kafshëve. Me zgjerim kuptimi është kaluar nga bark "pjesë e trupit "në bark "gjiri, brez, (tri barqe).

Sipas tij një zgjerim tipik kuptimi kemi edhe në rastin e fjalës greke *trapezë* (tra = tri, peza = këmbë), e cila në fillim kishte kuptimin e një tryeze të vogël me tri këmbë, kurse më vonë shërbeu për të shenjuar tryezën në përgjithësi.¹²²

Në anglisht fjala *bird* fillimisht ka pasur kuptimin “*zog i vogël*”, kurse sot emërton çdo shpend. Një zgjerim të kuptimit kemi edhe në rastet e *antonomazisë*, p.sh. në gjermanisht **Kaiser** “*perandor*” dhe në rusisht **Car** “*mbret*”, të dyja nga emri i Jul Çezarit, perandorit të Romës; edhe fjalët *cicerone* (Ciceroni, orator i shkëlqyer romak), *mecen* (nga emri i senatorit të shquar romak Maecena, mbrojtës i artit dhe letërsisë), *mentor* (Mentor, këshilltari i Telemakut në “Odisenë” e Homerit) etj.¹²³

Ndryshimet e kuptimit që realizohen nëpërmjet bartjes së emërtimit, janë mënyra më prodhimtare e prejardhjes semantike. Po përveç këtyre, një rrugë tjetër është dhe konversioni, kalimi i një fjale në një pjesë tjetër të ligjëratës. Gjatë këtij kalimi fjala ndryshon jo vetëm përkatësinë morfologjike por dhe funksionet gramatikore, por edhe kuptimin leksikor. Mund të ndodhim kalime jo vetëm nga emra në folje, e anasjelltas si dhe nga emra në mbiemra dhe e kundërta, nga emra në ndajfolje e parafjalë etj.¹²⁴

¹²² R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006, f. 176.

¹²³ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006, f. 176.

¹²⁴ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006, f. 176.

3.4 Zgjerimi stilistik

Në rastin tonë do të bëjmë fjalë për një zgjerim të llojit stilistik, ku duke rritur vëllimin e një njësie leksikore rrisim dhe informacionin e emërtuar, por sidomos shprehësinë e segmentit në fjalë. Lidhja bëhet me elemente të ndryshme.

He shall live a man forbid. [Sh:285]

Jetën ia nxij e ia **mallkoj**. [N:18]

Lidhja është me bashkërenditje, me anë të lidhëzës **e**. Në këtë shembull elementi leksikor, i dhënë ose i pranishëm, ka kuptim më të pavarur. Ai mund të ketë kuptim leksikor, ngjyrim emocional si dhe ngjyrim të tjera. Elementi i shtuar në shembullin e sipërpërmendur është **mallkoj**. Në këtë rast elementi i shtuar, i cili krijon zgjerimin semantik, mund të përdoret dhe më vete.

Nëse do të përdoreshin vetëm këto njësi nuk do ta kishin vlerën që fitojnë duke u bashkuar me një ose disa njësi të tjera leksikore, me të cilat formojnë një stilemë. Stilema e përfutur u kundërvihet njësive të marra veç e veç për nga përmbajtja. Ajo është më e gjërë. Ngjyrimet kuptimore dhe emocionale janë më të shumta, dhe shprehësia është më e lartë. Gjymtyrët e zgjerimit mund të formojnë marrëdhënie të ndryshme.¹²⁵

3.5 Zgjerimi me marrëdhënie sinonimike

Një mënyrë e veçantë për pasurimin e fjalorit është edhe e ashtuquajtura prejardhje kuptimore, d.m.th. zgjerimi i fushës së emërtimit të disa fjalëve nga nevoja për të shenjuar procese, dukuri dhe veti të reja që lindin në procesin e njohjes dhe të zhvillimit të kulturës. Edhe Nolit, duke shkruar në një gjuhë të lëvruar relativisht pak, iu desh që të bëjë një punë të veçantë me kuptimet e fjalëve. Ai shpeshherë ua zgjeroi ose ua ngushtoi kuptimin fjalëve ekzistuese, u dha kuptime të tjera që s'i kishin më parë, pa u stepur edhe përpara kalkimit, kur ia lypte nevoja.¹²⁶

¹²⁵ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006, f. 174-176.

¹²⁶ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, Tiranë, 1999, f. 63.

Kur pranë një njësie leksikore shtohet një tjetër njësi kemi të bëjmë me zgjerim të thënies. Duhet të theksojmë se në rastin e zgjerimit, njësitë që vendosen pranë njëra-tjetrës mund të përmbajnë secila informacionin e saj leksikor apo kuptimor. Kështu shtimi i njësisë së dhënë me njësi të tjera leksikore, nga ana kuptimore, është shtim i ri kuptimor, duke i shtuar një nocion të ri thënies.¹²⁷

Në shembujt e mëposhtëm të tilla janë fjalët: *admiroi dhe lavdëroi; me lëvdat e brohori* etj.

And when he reads thy personal venture in the rebel's fight,

his wonders and his praises do contend. [Sh:286]

*Dhe kur mësoi me ç'trimëri i theve, **admiroi e lavdëroi**. [N:23]*

Lidhja bëhet me bashkërenditje me anë të lidhëzës bashkërenditëse **e**. Këto dy fjalë nuk janë sinonime, por në kontekstin e dhënë krijojnë sinonimi kontekstuale.

Marrëdhënjet e foljes me emrin prejfoljor janë gjithashtu një nga nyjat semantike dhe stilistike për shqipen e sotme. Gjuha e sotme e shkruar e ka shtuar shumë numrin e emrave prejfoljorë me prapashtesë. Pikërisht këta emra, duke zënë vendin e foljes së drejtpërdrejtë, e ndryshojnë natyrën e thënjeve. Folja shenjon veprimin në mënyrë më konkrete, më drejtpërdrejtë dhe duke e lidhur atë me një kohë, me një vetë, me një modalitet.¹²⁸

And everyone did bear thy praises in his kingdom's great defence. [Sh:286]

*T'i thonë me **lëvdat dhe brohori**. [N:24]*

Lidhja është me bashkërenditje, e cila realizohet me anë të lidhëzës bashkërenditëse **dhe**. Në rastin tonë përftesa leksiko-stilistikore arrihet gjatë zgjerimit me fjalën **brohori**.

The earth was feverous and did shake. [Sh:292]

*Dhe **u trondit, u drodh** i tërë dheu. [N:57]*

Zgjerimi **u trondit, u drodh** shenjon tronditjen dhe shpreh vuajtjen shpirtërore që shkakton ngjarja e vrasjes së mbretit, kohëra të turbullta ku njerëzit jetojnë mes frikës dhe mosbesimit për të ardhmen.

Murder and treason. [Sh:293]

*Vrasje, **tradhësi**. [N:58]*

¹²⁷ Agalliu, Gjuha e Nolit, Toena, Tiranë, 1999, f. 62-64.

¹²⁸ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 76.

Shipwrecking storms and direful thunders break. [Sh:284]

***Pëlcet** fortuna, **bumbullin rrufeja**. [N:14]*

Lidhja në këto tri shembuj të lartpërmendur është me pranëvënie, është asindetike.

Glamis hath murder'd sleep, and therefore Cawdor, shall sleep no more,

Macbeth shall sleep no more. [Sh:291]

*Glamsi ka vrarë gjumin, Kodri **pra s'fle** më, Makbethi*

***nuk fle dot më**. [N:51]*

Në shembullin e cituar kemi zgjerim të një thënieje/fjalie me anë të një thënieje/fjalie tjetër.

Ndërsa në shembujt e mëposhtëm lidhja është me bashkërenditje, me anë të lidhëzës **dhe**.

Lamentings heard i' the air, strange screams of death. [Sh:292]

*Furtun' **e rreptë çirrej dhe vajtonte**. [N:57]*

And prophesying with accents terrible, of dire combustion

and confused events. [Sh:292]

Me klithma dhe rënkime vdekje, me profetira dhe

***me gjëma tmerri**. [N:57]*

Në shembujt e sipërpërmendur kemi zgjerim me shprehjet plotësuese, si: **dhe rënkime vdekje, dhe me gjëma tmerri**. Shpeshherë në procedën e zgjerimit kemi dy gjymtyrë, por mund të ketë edhe më shumë se dy gjymtyrë. Nga ana formale kemi të bëjmë me dy a më shumë fjalë të lidhura me mjete të ndryshme gramatikore. Në pikëpamjen kuptimore kemi një përmbajtje unike të zgjeruar emocionale, si dhe shprehëse-stilistikore.

Gjuha e shkruar priret drejt zbërthimit të foljeve në togje folje+emër prejfoljor. Një varg i vogël foljesh me kuptim të përgjithshëm veprimi, që e zbehin kuptimin e tyre konkret, dalin si gjymtyra e parë e këtyre togjeve¹²⁹.

¹²⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 77

3. 6 Zgjerimi me gjymtyrë emër + emër

Për nga gjymtyrët pjesëmarrëse zgjerimi mund të ketë këto përbërës **emër +emër**. Në shembujt e poshtëshënuar kemi sinonimi kontekstuale, e cila vihet re me gjymtyrët **veten, gjindjen, mallin, shtëpinë** realizojnë një zgjerim dhe paraqesin sinonimi kontekstuale

Your servants ever, have theirs, themselves, and what is theirs, in compt. [Sh:289]

Si veten , gjindjen, mallin dhe shtëpinë. [N:37]

*Edhe në shembullin që vijon vihet re e njëjta gjë me gjymtyrët **zjarr, trazira, vojte, mjerime**.*

Of dire combustion and confused events. [Sh:292]

*Me **zjarr, trazira, vojte dhe mjerime**. [N:57]*

Një tjetër dukuri që vihet re në shembullin e lartpërmendur, siç shprehet dhe Lloshi, është se gjymtyrët e zgjerimit mund të vendosin midis tyre marrëdhënie hiperonimie (superordinate) ose (hiponimie). Në raste të tilla gjymtyrët janë në raport nënrenditës me llojin, kuptimi i njërës përmban edhe kuptimin e gjymtyrës tjetër, që është më e gjerë,¹³⁰ siç është vargu me **zjarr, trazira, vojte dhe mjerime**. Kuptimi i fjalës **mjerime** është i nënrenditur ndaj kuptimit të fjalëve me **zjarr, trazira, vojte** etj.

Sasia e përbërësve nuk është e njëjtë. Ajo mund të jetë më e madhe ose më e vogël. P.sh. në sintagmën **malli dhe shtëpia** kemi dy përbërës në raporte sinonimie të pjesshme. Gjymtyrët, edhe të katra së bashku, nuk përbëjnë sinonimi të plotë, por të pjesshme.

Togu me emër prejfoljor është libror, por për shkrimtarin ai jep mundësi për zgjerime të mëtejshme me interes. Përgjithësisht ka mjaft imtësi të tjera të përdorimit të foljeve, të cilat lejojnë një lojë stilistike të pakufizuar,¹³¹ siç janë fjalët: **vojte, mjerime, trazira**.

Fjalja e dytë, **me zjarr, trazira, vojte dhe mjerime**, përmban elemente që hyjnë gjithashtu në raporte sinonimie të pjesshme. Ky varg gjymtyrësh shpreh mundimin e vuajtjen shpirtërore që shkaktohen në kohë lufte, kur turma luftëtarësh të braktisur, të tradhëtuar enden kuturu, sepse nuk e dijnë a duhet t'i shërbejnë mbretit të ri. Sinonimia në këtë rast është e pjesshme, jo e plotë.

¹³⁰ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 77

¹³¹ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 77

3.7 Zgjerimi me gjymtyrë *folje + folje*

Kuptimi i shprehur nga gjymtyrët vjen dhe intensifikohet në mënyrë të shkallëzuar. Shkallëzimi është një përftesë tipike stilistike për intensifikim, për përforcim. Elementi i dytë mund të jetë gjymtyrë e fushës leksikore të elementit të parë.¹³² Gjatë punës së vet krijuese dhe përkthyes Noli ka ndjerë nevojën e zgjerimit të leksikut me fjalë ose forma fjalësh që të kenë funksione të ndryshme stilistike. Noli e jep realitetin e asaj kohe duke e paraqitur me shumë ngjyrë e stil.

When in swinish sleep their drenched natures lie as in death. [Sh:290]

*Dhe kur të **shtrihen** dhe të **flenë** derrërisht në pellg të gjumit
si në varr të vdekjes. [F:41]*

That they did wake each other. I stood and heard them. [Sh:291]

*Sa që të dy u zgjuan: **ndenja dhe dëgjova**. [N:49]*

Në këtë rast zgjerimi është realizuar folje + folje, duke na dhënë *shkallëzim* të veprimeve. Edhe në gjuhën angleze zgjerimi realizohet me anë të konektorëve ose në mënyrë asindete.

Noli, duke patur parasysh shembujt e lartpërmendur, krijon larmi shprehëse me variante sinonimike të reja, të cilat shprehen në forma të ndryshme, si: *emër me mbiemër, emër me folje, emër me emër, mbiemër me folje, mbiemër me mbiemër, folje me folje, ndajfolje me mbiemër etj.* Të gjitha këto variacione sinonimike i paraqesin tiparet me shumë saktësi, me ngjyrim e me forcë ndikuese. Nga analiza konstatojmë se i njëjti fenomen ndodh edhe në gjuhën angleze

Njësitë e përfutuara me zgjerim tërheqin vëmendjen me informacionin e gjerë dhe me shprehësinë e lartë të tyre. Në ligjërimin e zakonshëm përdoren dendur zgjerime ku fjala zgjeruese sjell ngjyrim emocional-vlerësues.

Gjatë punës së vet krijuese dhe përkthyes Noli ka ndjerë nevojën e zgjerimit të leksikut me fjalë ose forma fjalësh që të kenë funksione të ndryshme stilistike. Mendojmë se me anë të zgjerimit Noli synon të paraqesë sa më mirë idetë e shprehura nga Shekspiri në mënyrë që të tingëllojë sa më i afërt për lexuesin. Me gjithë përdorimin e tyre në gjuhën e gjallë, zgjerimet e mësipërme janë veçori e ligjërimit artistik. Ato janë fryt i kërkimit të një gjuhe sa më shprehëse, kanë shije letraro-artistike.

¹³² E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikon shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f.65.

Ndërtime të tilla përdoren dendur te Noli. Ai i shfrytëzon artistikisht të gjitha mundësitë që ofron gjuha për një shprehje më të detajuar e të hollësishme të ideve dhe të emocioneve.

Qëllimi i Nolit ishte të jepte nuanca të tilla që krijojnë momentin estetik dhe të zbulojnë shtresime të reja kuptimore në fjalë të ndryshme. Me përdorimin e shumtë dhe me pamjet origjinale, zgjerimi përbën një tipar të stilit të Nolit.¹³³ Njësitë e përfutuara me zgjerim tërheqin vëmendjen me informacionin e gjërë dhe me shprehësinë e lartë të tyre. Në ligjërimin e zakonshëm përdoren shpesh zgjerime ku fjala zgjeruese sjell ngjyime emocionale-vlerësuese.

3.8 Enumeracioni/vargëzimi

Noli është mjeshtër në përdorimin e fjalëve. Në manovrimet e tij me leksikun ndodh t'i vendosë fjalët në varg njëra pas tjetrës, në mënyrë të bashkërenditur. Në raste të tilla përftohen vargje që përmbajnë dy a më shumë fjalë.

Ky fenomen përbën një veçori të ligjërit të Nolit, të këtij shkrimtari dhe mjeshtri-përkthyes. Këto vargje fjalësh kanë si karakteristikë të përbashkët mënyrën se si ato janë lidhur midis tyre. Ato lidhen me njëra-tjetrën me lidhëza bashkërenditëse ose në mënyrë asindetike.

Sa më i gjatë të jetë vargu aq më i madh bëhet informacioni dhe së bashku me informacionin rritet efekti i shprehësisë. Pikërisht, krijimi i këtyre vargjeve tërheqin larminë e elementeve me të cilat lidhen.¹³⁴ Vargjet e fjalëve lidhen njëra pas tjetrës, duke lënë mbresë më të pashlyeshme te dëgjuesi ose lexuesi.

Fjalët e vargjeve janë gjymtyrë të fushave të ndryshme leksikore dhe kuptimore. Secili varg paraqet një pjesë të realitetit ose një imazh të realitetit. Për këtë arsye pjesët e vargut kanë lidhje kuptimore midis tyre. Fjalët e vargut paraqesin dukuri të ndryshme, objekte apo fenomene, të cilat lidhen dhe gjenden pranë njëra-tjetrës në hapësirë dhe në kohë. Noli realizon vargje që përbëjnë fusha leksikore (tematike) ose fusha semantike. Vargu mund të përmbajë fjalë që shënojnë objekte, të cilat bashkekzistojnë në një realitet.

¹³³ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, Tiranë, 1999, f.63.

¹³⁴ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f.66

Fjalët e vargëzuara nga Noli paraqesin shpesh sende e dukuri të së njëjtës pjesë të realitetit. Por, ndodh që elementet e vargëzuara, të lidhura njëri me tjetrin, u përkasin fushave të ndryshme të realitetit dhe konceptohen si bashkësi. Lexuesi i konsideron ato si të tilla, si bashkësi reale-gjuhësore, të cilat krijojnë fusha kontekstuale, d.m.th. elemente nga më të ndryshmet përfshihen në një bashkësi gjuhësore, duke na krijuar fusha kontekstuale. Fjalët e bashkërenditura mund të formojnë lidhje të ndryshme, të mirëfillta tematike.

And fill me from the crown to the toe top-full. [Sh:288]

*Nga **koka** e gjer në **thonj** e gjer në **buzë**. [N:33]*

Sons, kinsmen, thanes and you whose places are the nearest. [Sh:287]

***Bij, prindër, thanër dhe ju t'afërm**. [N:30]*

Me këto vargje **koka** e gjer në **thonj** e gjer në **buzë**, të cilat përforcojnë kuptimet e njëra-tjetrës, transmetohet forca, dhuna, hakmarrja, që shprehen me të gjitha pjesët e trupit; po ashtu, **bij, prindër, thanër** dhe **ju t'afërm**, paraqitet shumësi gjithëpërfshirës. Bashkësia e fjalëve të nënvizuara shenjon pjesë të trupit të njeriut. Ato i përkasin të njëjtës sferë, p.sh. **nofullat** dhe **gjoksi**, **koka** e gjer në **thonj** e gjer në **buzë**.

Time and the hour runs through the roughest day. [Sh:287]

*Që sot s'kam **dit'** e **or'** e **çast'** të qetë. [N:27]*

I' the shipman's card I will drain him. [Sh:285]

*Me **kart** e me **gjeografi**. [N:18]*

In thunder, lightning, or in rain. [Sh:284]

*Në **bumbullimë, vetëtim'**, a **shi**. [N:11]*

Fjalët e sipërpërmendura ndërtojnë një fushë të rregullt tematike. Objektet që shënohen me këto fjalë i përkasin së njëjtës sferë, p.sh. **or** e **çast** shënojnë *kohën*; **kart** e **gjeografi** lidhen me *hapësirën*; **bumbullimë, vetëtimë** a **shi** lidhen me fenomenet e natyrës.

Great Glamis! Worthy Cawdor! [Sh:288]

*O **than** i **madh** i **Glamsit**. **Trim** i **Kodrit**! [N:34]*

Të tilla vargje, me emra dhe detyra personalitetesh, takohen herë pas here në veprën “Makbethi”, si në origjinalin e Shekspirit, po ashtu edhe në përkthimin e Nolit. Fjalët e nënvizuara emërtojnë sende a frymorë të së njëjtës sferë.

Your servants ever, have theirs, themselves, and what is theirs, in compt. [Sh:289]

Si veten , gjindjen, mallin dhe shtëpinë. [N:37]

Fjalët **veten**, **gjindjen** u referohen njerëzve, po ashtu dhe fjalët **mallin**, **shtëpinë**, të gjitha lidhen me mjedise njerëzore. Ato luajnë një rol të veçantë në varg. Pozicioni i këtyre fjalëve në krye të vargut vë në dukje rëndësinë e njeriut në mjediset ku ai jeton. Pra, elemente nga më të ndryshmet përfshihen në një bashkësi gjuhësore.

Elementeve të tilla u mungojnë lidhjet e nevojshme për t'i përfshirë në një fushë. Por, përderisa përdoren krahas fushave të mirëfillta, ndërtohen sipas modelit të tyre, transmetohen e rroken si një fushë e vërtetë. Prandaj themi se vargje të tilla përbëjnë fusha tematike kontekstuale. Kështu, në rastin e përdorimit të vargjeve fjalët e bashkërenditura mund të formojnë fusha të mirëfillta tematike:

First, as I am his kinsman and his subject. [Sh:289]

E para e kam prind dhe e kam mbret. [N:38]

O valiant cousin! Worthy gentleman! [Sh:284]

Trim kushëri e Zot i vyer. [N:14]

Dallimi më imët i nocioneve sjell diferencimin e përpunuar të sinonimeve. Vargjet sinonimike janë më të zhvilluara dhe këshillat e kulturës së gjuhës ngulmojnë, që në një nga synimet kryesore duhet të jetë zgjedhja e sinonimit më të përshtatshëm. Që fjala të dalë më e përpiktë (sidomos nga ana nocionore, abstrakte) kërkohet që të shmangen shoqërimet emocionale dhe përfytyrimet konkrete individualizuese¹³⁵.

3.9 Fusha tematike kontekstuale

Në këto fusha nuk jepen objekte a dukuri që i përkasin së njëjtës sferë, por duke qëndruar pranë njëri-tjetrit. Pra, duke krijuar një varg ato bien në sy vetëm brenda kontekstit, që më pas krijojnë fusha tematike kontekstuale,¹³⁶ të cilat duke u krahasuar me origjinalin pasurohen dhe realizohen mjaft mirë nga Noli.

Bear the welcome in your eyes, your hand, your tongue. [Sh:288]

¹³⁵ Xh. Lloshi, *Stilistika E Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2005, f. 185.

¹³⁶ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f.66

Në sy, në dor' e në gjuhë mirëpritjen kij. [N:34]

Kjo është fushë e vërtetë tematike kontekstuale. Veprimet që ato kryejnë nuk janë të njëjta, ndonëse janë pjesë të trupit, sepse me dorë prekim dhe me anë të një shtrëngimi mund të shprehet mikpritja. Me anë të vështimit, përmes syrit, shprehet gjithashtu mirëpritja ose urrejtja, sepse ka vështim të qeshur dhe urryes, dhe me anë të gjuhës, d.m.th. të të folurit, shprehet hapur dashuria, si dhe akte të tjera.

Kështu, bota reale paraqet raste të pranëvendosjes së objekteve apo të pjesëve të ndryshme të trupit, si në rastin e sipërpërmendur, të cilat janë të dallueshme. Midis objekteve të tilla ka lidhje, ku lidhja është e çastit, dhe kështu krijohen vargje kontekstuale.

3.10 Lidhja e fjalëve me kuptim konkret në vargje të ndryshme

Në fushën semantike kontekstuale ndodhin lidhje interesante fjalësh, si lidhja e fjalëve me kuptim konkret.

This guest of summer, the temple-haunting martlet. [Sh:288]

Dhe dallëndyshja, mysafirja e pranverës. [N:36]

Duke i bashkërenduar, **dallëndyshja** dhe **mysafirja e pranverës**, Shekspiri thekson lëvizjen e përhershme të këtij shpendi kaq të dashur, që sinjalizon pranverën, d.m.th. lulëzimin e jetës.

Till he unseams'd him from the nave to the chaps. [Sh:284]

Ia shthuri nofullat dhe gjoksin. [N:14]

Ndërsa në fjalinë e mëposhtme vargëzimi paraqet kombinimin e gjërave konkrete me abstrakte.

Might be the be-all, and the end-all here. [Sh:288]

Pa lën bisht e gjurm' e hije pas. [N:38]

Me anë të vargjeve jepen përmasa të mëdha, sasi të spikatura, një numër jo i vogël frymorësh, sendesh apo dukurish.

Banquo, thy soul's flight, if it find heaven, must find it out to-night. [Sh:296]

Banko fluturove sonte në parajs' a ferr kalove. [N:76]

Qëmtimi dhe krijimi i çasteve të tilla përmban tërheqjen e gjërave të momentit.

3.11 Lidhja e fjalëve me kuptim abstrakt dhe konkret në vargje të ndryshme

Vargjet përdoren në thënie narrative për të treguar me gjallëri e intensitet veprimet e personazheve, në rastin tonë mendoj se shprehen meritat e luftëtarëve ndaj armikut.

So well thy words become thee as thy wounds. [Sh:285]

Fjalët dhe plagët të tregojnë trim. [N:15]

Noli i përdor vargjet në përshkrime dhe në këtë mënyrë ndihmon në paraqitjen e detajuar dhe shprehëse të mjedisëve, natyrës, sfondeve, si dhe veprimeve të personazheve.

Fair is foul, and foul is fair. [Sh:284]

Zbardh e zeza dhe e bardha nxin. [N:12]

Këto vargje paraqesin skena të gjalla pas lufte, të cilat realizohen duke bashkërenditur në një varg, fjalë që i përkasin fushave të ndryshme semantike.

I have begun to plant thee, and will labour to make thee full of growing. [Sh:287]

*Të kam **mbjellur** mu në zemër **dhe të vadit të rritesh plot me pemë. [N:29]***

Në këtë varg ka më shumë fjalë me kuptim të figurshëm: ***të vadit, të rritesh, të kam mbjellur.***

My dearest love. [Sh:288]

E dashur, drit' e syrit tim. [N:34]

Fair and noble hostess. [Sh:289]

E bukur dhe bujare zonjë. [N:37]

Vargjet e sipërpërmendura janë përshkrime plot bukuri dhe epizëm. Gjatë përshkrimit Noli përdor vargje që luajnë rolin e tyre në paraqitjen me vërtetësi të gjendjes shpirtërore.

Macbeth does murder sleep, the innocent sleep, sleep that

knits up the ravell'd sleeve of care. [Sh:291]

Makbethi vrau **gjumin, gjumin e pafajshëm, gjumin**

që shqit përleshjen. [N:50]

God's benison go with you ; and with those that would make

good of bad, and friends of foes! [Sh:294]

Zoti bekoftë ty dhe gjithë miqtë që zbardhin zin

e miqësojn' armiqtë. [N:67]

Në shembujt e sipërpërmendur fjalët të përdorura për krijimin e vargëzimit përdoren në kuptim të drejtpërdrejtë ose mund të përdoren me kuptim të figurshëm. Dhe në gjuhën angleze,

atë të Shekspirit, dallohen të njëjtat shprehje dhe forma të vargëzimit. Është e rëndësishme të theksojmë se elementet e vargëzuara janë të lidhura njëri me tjetrin, ndonëse ato nuk janë të së njëjtës fushë tematike. Ato përfshihen në një bashkësi gjuhësore, duke krijuar kështu fusha kontekstuale.

KAPITULLI IV

SHTRESAT LEKSIKORE NË VEPRËN E SHQIPËRUAR TË “MAKBETHIT”

4.1 Fjalë të vjetëruara të leksikut

Leksiku i një gjuhë nuk është vetëm sasia e fjalëve që përmban një fjalor, por ka një kuptim më të gjerë. Është tërësia e fjalëve që ka një gjuhë, një dialekt, ose një e folme; tërësia e fjalëve, që përdoren në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore ose nga një rreth shoqëror i caktuar; tërësia e fjalëve që përdor një autor në veprën e tij, fjalori i një vepre.¹³⁷

Duke marrë për bazë shpeshësinë e përdorimit të fjalëve në të folur leksiku i gjuhës mund të ndahet në dy shtresa: shtresa aktive dhe ajo pasive shtresa aktive ose fjalori aktiv përfshin fjalët që jo vetëm njihen nga folësit por edhe përdoren prej tyre në jetën e përditshme. Shtresa pasive ose fjalori pasiv përfshin gjithë ato fjalë që nuk njihen nga të gjithë folësit dhe përdoren pak në ligjërim¹³⁸.

Marrëdhëniet e popullit të tij me popujt e tjerë gjatë gjithë historisë së një vendi kanë sjellë edhe ndikime në gjuhë. Kjo duket më drejtpërdrejt në sistemin leksikor. Siç shprehet edhe Xhevat Lloshi nëse do të studiojmë shtresimin e leksikut të një vendi sipas burimit do të vemë re se historia e gjuhës dhe etimologjia e saj përbëhet nga elementet e huazuara dhe nga elementet autoktonë, vetjake, që mund t'i quajmë shtresa vetjake dhe shtresa të huazuara. Gjuha shqipe është gjuhë indoeuropiane. Si e tillë nuk duhet kuptuar që gjithë pasuria e saj leksikore është trashëgimi e fondit të vjetër indoeuropian.¹³⁹

Sipas tij gjuha nuk është prerazi një sistem sinkronik. Brezi më i ri e ndjen se brezi i vjetër flet ndryshe, por jo në mënyrë të pakuptueshme për të, kurse shkolla, letërsia e burime të tjera u japin të gjithëve një njohje pasive për etapat e dikurshme të gjuhës. Rrjedhimisht gjuha e shkruar dhe kultura bëjnë që edhe gjendjet e kaluara të gjuhës të rishfaqen në ligjërimin e sotëm, duke sjellë me vete gjithë shoqërimet e rrafshit historik. Në leksikologji dallohen arkaizmat, si fjalë që nuk

¹³⁷ *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Tiranë, 2002, f. 662.

¹³⁸ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Botimet TOENA, 2006, f.136.

¹³⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 200, f. 148.

përdoren më për shkak të dukurisë që ato shënojnë dhe si të tilla janë mënjeluar prej kohësh nga jeta. Në një punim historik nuk ka përftesa stilistike.¹⁴⁰

Efekti i leksikut arrihet kur fjalët përdoren për t'i dhënë ligjërit ngjyrim ose kontrast. Me atë ato japin atmosferë historike, koloritin e mjedisit, si dhe karakterizojnë gjuhën e personazheve.

Leksiku është rrafshi i gjuhës që ndryshon më shpejt, ndryshe nga rrafshet e tjera, të cilat ndryshojnë shumë ngadalë. Kështu me kalimin e vendit në ekonominë e tregut dolën nga përdorimi shumë fjalë që lidheshin me formën kolektive të pronësisë dhe me organizimin socialist të jetës dhe janë rifutur në qarkullim fjalë të vjetra, ose kanë hyrë shumë fjalë të reja që lidhen me mënyrën e re të organizimit të jetës dhe të prodhimit, si dhe me progresin teknik të shoqërisë¹⁴¹.

Ne do të përqëndrohemi te leksiku i gjuhës shqipe të përdorur nga Fan Noli dhe më konkretisht te leksiku i përdorur në përkthimin e tragjedisë së “Makbethit”. Leksiku i përdorur në këtë vepër përmban dhe dy lloje fjalësh të vjetruara: *historizma dhe arkaizma*.

4.1.1 Historizmat

Historizmat janë fjalë a shprehje që kanë dalë nga përdorimi i gjallë, sepse sendi a dukuria që ato shenjojnë i takojnë një periudhe historike të kaluar, meqë ato shenjojnë sende apo dukuri, të cilat nuk përdoren më në jetën tonë të përditshme.¹⁴² Konkludohet se nocionet që shprehen prej tyre nuk janë më reale.

Historizmat janë fjalë të vjetruara që paraqesin një objekt, një send apo një koncept. Ato lidhen me periudha të ndryshme historike dhe sot përdoren vetëm për të paraqitur atë periudhë në mënyrë më të vërtetë. Noli përdor fjalë, si: **than**, **rreshtar**, **komandar**, **kamë**, **(armë)** etj. Konceptet dhe objektet që ato paraqesin si historizma nuk janë më sot. Ato lidhen me një periudhë të kaluar historike dhe kanë dalë nga përdorimi.

¹⁴⁰ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 200, f. 108..

¹⁴¹ Rami Memushaj, *Hyrje ne gjuhesi*, Botimet TOENA, 2006, f.130-131.

¹⁴² *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Tiranë, 2002, f. 484.

Fjalët e vjetruara nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës letrare, por në letërsi përdoren me vlera stilistike të veçanta. Historizmat lidhen ngushtë me fatin e sendit e të nocionit që ato emërtojnë, lidhen edhe me etapa të ndryshme historike, ekonomike e kulturore.¹⁴³ Sot përdoren vetëm për të dhënë me vërtetësi atë periudhë, si p.sh: **be, aga, pasha**, etj. Dallimi i këtyre fjalëve nga fjalët e vjetruara është se vetë sendet dhe nocionet që shprehin ato nuk janë më sot. Ato lidhen me një periudhë të kaluar dhe janë zhdukur bashkë me atë. Kështu, historizmat e përdorura nga shkrimtari-përkthyes, Fan Noli, i japin ngjyrim historik periudhës që përshkruan në veprat dhe përkthimet e tij. Kjo spikat në të gjitha veprat e Nolit në përgjithësi dhe në përkthimin e tragjedisë “Makbethi” në veçanti.

Efekti i historizmave është shumë i madh. Ekuivalentet e tyre mungojnë shpesh në gjuhën e sotme. Por duke i shprehur ato me një perifrazim, që paraqet të njëjtin objekt, apo nocion të vjetruar, tregohet forca e tyre evokuese¹⁴⁴.

Duke analizuar në këtë mënyrë leksikun e përdorur nga Noli të krijohet ideja sikur Noli vepron vetëm me leksikun e vjetër. Kjo vihet re sidomos në përkthimet e veprave klasike të Shekspirit, veçanërisht në tragjedinë e “Makbethit”, e cila është një dramë me temë nga historia e largët. Sasia e fjalëve të vjetruara është e ndryshme në tekste të ndryshme të Nolit, p.sh. te “Makbethi” ka me shumicë fjalë të vjetruara se sa në veprat e tjera. Përkthyesi përqëndrohet qëllimisht te këta elemente për të përshkruar një botë të huaj në një periudhë të largët kohore.

Leksiku i vjetruar i përdorur nga Noli në këtë vepër ka shërbyer për të karakterizuar epokën, ngjarjet dhe personazhet. Përdorimi dhe shpërndarja e historizmave është e ndryshme. Fan Noli e përdor me shumë ndjenjë shtresën e vjetruar të leksikut. Ai shpeshherë përdor elemente të vjetruara leksikore për të karakterizuar dhe për të bërë një paraqitje sa më të vërtetë. Pikërisht, këta elemente leksikore të vjetruara, të përdorura në mënyrë të vazhdueshme nga Noli, i japin ligjëritimit një atmosferë historike. Te “Makbethi”, ku paraqiten skena, intriga, përpyekje që ndodhin rreth shek. XV, përdoren me shumicë emërtime të objekteve dhe nocioneve të ndryshme të asaj kohe, por që sot janë vjetëruar bashkë me emërtimet e tyre dhe mbeten vetëm si

¹⁴³ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f.85.

¹⁴⁴ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f.85

historizma. Është pikërisht përdorimi i tyre që e bën ligjërimin më të gjallë dhe më të vërtetë. Pa ato ligjërimi do të ishte i zbehtë dhe jo interesant.

4.1.2 Fjalë të vjetëruara, të cilat shenjojnë emërtime veshjesh, objektesh të vjetëruara, nocione që sot kanë tjetër kuptim

Edhe për këtë shtresë stilistika interesohet kur ajo përfshihet në një tekst për të arritur një efekt shprehës. Si pasojë, nuk kemi përftesa stilistike në një punim historik, që i përdor fjalët kur pikërisht dukuritë e shenjuara prej tyre trajton. Efekti arrihet në përfshirjen e tyre në një ind të veçantë a si tufë, për t'i dhënë atij ngjyrim, ose kontrast me të.¹⁴⁵

Të tilla nocione shprehin fjalët e përdorura në shembujt e mëposhtëm.

Here's an English tailor come hither, for stealing out, a French hose:

come in, tailor; here you may. [Sh:292]

*Nga një palë **tirq** të ngushtë prej frëngu. [N:54]*

Fjala **tirq** ka kuptimin **pantallona**. Është fjalë e vjetëruar dhe si e tillë nuk është e njohur nga të rinjtë dhe studentët.

I shall tread upon the tyrant's head, Or wear it on my sword. [Sh:303]

*T'ia pres koken, t'ia vë në majën e një **ushte**. [N:118]*

Sipas Fjalorit të Shqipes së Sotme, fjala **ushtë** ka kuptimin në majë të një heshte, shtize.¹⁴⁶

As this which now I draw. [Sh:290]

*Sa kjo këtu që zhvesh nga **mylli**. [N:46]*

Mylli është fjalë e vjetëruar, kuptimi leksikor është *këllëf*, mbajtësja e kamës apo e shpatës.

Those precious motives, those strong knots of love. [Sh:303]

*...një **penk** të çmuar, **lithmë** dashurie. [N:117]*

Në fakt këto fjalë janë krahinorizma dhe ideja që shprehin është një motiv i çmuar, lidhje dashurie. Fjalët **penk dhe lithmë** nuk janë më aktive në gjuhën e sotme shqipe.

¹⁴⁵ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 200, f. 108

¹⁴⁶ *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Toena, Tiranë 2002, f. 413.

4.1.3 Forma shkrimore të vjetëruara, fjalë të shkruara me apostrof në fund

Duke ndjekur, me sa mundte, zhvillimin e gjuhës në Atdhe, Noli bënte nganjëherë edhe ndryshime për të shmangur trajta pak a shumë të vjetruara. Kështu, në ribotimin e "Historisë së Skënderbeut", formën e gjinore-dhanores *t'ett* (HS1.97), 234), që ai e shkruante me dy **t**, duke menduar, me sa duket, për një rënje të **-i-së**, ashtu si të *shoqt* (HS1,206) e zëvendësoi me trajtën më të re *t'atit*. Edhe format më të vjetra të kallëzores së shquar pa **-i-ose-u-** midis temës dhe mbaresës **-në**, ose me një **-ë-** po në këtë pozicion përbëjnë shfaqje të rralla për gjuhën e këtij shkrimtari dhe e dallojnë kështu nga paraardhësit.¹⁴⁷

Great bond which keeps me pale. [Sh: 297]

senetn' e madh që po ma verdh fytyrën [N:79]

Senetn', është fjalë dhe formë e vjetër, ka kuptimin “dëftesë me të cilën vërtetohet marrja e një huaje me kamatë ose shitja dhe blerja e një malli”¹⁴⁸

when the hurlyburly's done [Sh: 284].

Posa shamat' e luftës të pushojë [N: 11].

Fjala **shamat** është formë e vjetër dialektore me kuptimin zhurmat e luftës, luftimet,

that but this blow, Might be the be-all and the end-all here, [Sh: 289].

Një her' e mir' hesapn' e saj ta mbyllte. [N: 38].

E ashtuquajtura rasë vendore, me mbaresën **-t**, e cila, siç dihet përdoret vetëm me parafjalë, ndeshet pothuaj vetëm në shkrimet e para të autorit. Më pas mund të themi se mënjanohet plotësisht.¹⁴⁹

Mendoj se në këte grup hyn parafjala **në** e shkruar me apostrof **n'** për të evituar takimin e dy zanoreve.

Win us with honest trifless, to betray's in deepest consequence. [Sh:286].

Me profka të pafajishme na fiton, dhe na përmbys n'avueshëm më të thellë.[N:25]

Si përfundim **mund të themi** se fjalët e vjetruara përbëjnë një objekt të rëndësishëm studimi. Ato paraqesin kohën e përdorimit të tyre dhe tregojnë se gjuha shqipe ka evoluar së tepërmi.

¹⁴⁷ F. Agalliu, Gjuha e Nolit, Toena, Tiranë, 1999, f. 101

¹⁴⁸ Fjalor i Shqipes së Sotme, Toena, Tiranë, 2002, f. 172.

¹⁴⁹ F. Agalliu, Gjuha e Nolit, Toena, Tiranë, 1999, f. 101.

4.2 Fjalë të vjetëruara foljore

Në zgjedhimin pësor-vetvetor për të tashmen dhe të pakryerën e dëftores, trajta të veçanta , që më pas do të mënjanohej nga gjuha letrare, hasen rrallë dhe vetëm në fillimet e krijimtarisë së Nolit.¹⁵⁰

Fjalët e poshtëshënuara, ndonëse nuk janë fjalë të vjetëruara, shfaqen me formë e përdorim të vjetëruar.

These evils thou repeat'st upon thyself, Have banish'd me from Scotland. [Sh:304]

*Veset që më shfaqe më **syrgjynosnë** fare nga Skotlanda. [N:121]*

Një dukuri interesante përfaqësojnë disa trajta foljore.

If you shall cleave to my consent. [Sh:290]

*Në ma **përkrash** mejtimin. [N:45]*

We have willing dames enough: there cannot be.

That vulture in you to devour so many. [Sh: 304]

*Gra zemërmira kemi sa të duash; s'besoj të jesh kuçedr' e të mos **nginjesh**. [N:119]*

Sot përdoret si ekuivalente e kësaj fjale “ngop/ngopem”.

And that distill'd by magic sleights. [Sh:299]

*Pastaj **e ysht**, e dishtëlloj. [N:94]*

Kuptimi i fjalës **ysht** është e shtyj, e nxis.

Desired your good advice. [Sh:295]

***Lypja** ca këshilla. [N:69]*

Në gjendjen e sotme të gjuhës folja “**lyp**” në kuptimin që e përdor Noli del rrallë, sidomos në të folmen e dialektit verior.

*Disdaining fortune, with his **brandish'd** steel. [Sh:284]*

*Përbuzi fatin dhe me shpatën **zgjeshur**. [N:14]*

Kuptimi i fjalës **zgjeshur** është “zhvesh”, e kundërta e **ngjeshi**. Me shpatën gati për të goditur në pozicionin jashtë këllëfit.

No jutty, frieze, Buttress, nor coign of vantage, but this bird. [Sh:288]

*S'ka asgjëkund një **çip** ku të mos ketë va, fole e djep për zogjt'. [N:36]*

¹⁵⁰ F. Agalliu, Gjuha e Nolit, Toena, Tiranë, 1999, f. 115.

Edhe forma **çip**, sot “*cep*”, është arkaizëm leksikore dhe formale. Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe kemi shpjegimin: e dytë të fjalës: çip më çip a) në çdo anë, në ç do kënd, kudo, nga një skaj në tjetrin, cep më cep; b) plot e përplot, buzë më buzë, etj.¹⁵¹

For an **earnest** of a greater **honour**. [Sh:286]

Dhe si **kapar** prej nderesh më të larta. [N:24]

Edhe pse fjale e vjetëruar, fjala **kapar** përdoret edhe sot. Por, shumë shqipfolës nuk e njohin fjalën ose kuptimin e saj.

Si përfundim themi se një dukuri interesante përfaqësojnë disa forma gramatikore ose trajta fjalësh nga të dialektit verior, të përdorura pa ndonjë qëllim shprehësie. Noli ishte në gjendje dhe dha prova, ashtu si paraardhësi i tij i adhurar K.Kristoforidhi, të shkruajë në të dy dialektet, duke mbetur vetëm si një ndër mjeshtrit më në zë të toskërishtes letrare.¹⁵²

4.3 Neologjizmat

Leksiku pasurohet vazhdimisht me fjalë të reja që ndërtohen me ndajshtesa, përbërje ose përngjitje. Për stilistikën ato kanë interes për sa kohë e ruajnë perceptimin si diçka të re dhe prandaj mund të shfrytëzohen po ashtu si fjalët e vjetruara, dialektizmat e huazimet. Ato përfshihen në tekst p.sh. për të karakterizuar kohën kur ato ndiheshin si të reja. Fjalët ndihen si të reja për një periudhë, pastaj ato kthehen në leksema të zakonshme ose dalin nga gjuha.¹⁵³

Dheshkronjë, me të cilën rilindësit u përpoqën të zëvendësonin **gjeografinë**, nuk zuri vend dhe sot është një formim i vjetëruar. Vetë kërkesat e jetës e të shoqërisë janë shkaku që të lindin fjalë të reja dhe ato formohen duke u mbështetur në pasurinë e gjuhës e sipas ligjeve të saj.¹⁵⁴

Shkenca dhe teknologjia gjithmonë avancon. Objekte dhe procese të reja krijohen vazhdimisht. Këto zhvillime të pandërprera të shkencës, teknikës, ekonomisë, tregtisë, transportit, etj. kërkojnë dita-ditës nga gjuha plotësimin e fjalorit të saj me fjalë e me shprehje të reja, të domosdoshme për veprimtarinë politike, ekonomike, shoqërore e kulturore. Po ashtu idera dhe

¹⁵¹ *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Toena, Tiranë, 2002, f. 195.

¹⁵² F. Agalliu, *Gjuha e Nolit*, Toena, Tiranë, 1999, f. 117.

¹⁵³ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2000, f.123.

¹⁵⁴ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2000, f.123.

ndjenja të reja vijnë nga media dhe nga jeta e përditshme. Terminologji nga shkenca sociale bëhen pjesë e fjalorit të përditshëm. Për të plotësuar këto kërkesa në gjuhë lindin neologjizma, të cilat pasurojnë fjalorin çdo ditë që kalon. Sipas Peter Newmark te “Text of Translation” rreth 3000 fjalë të reja mund të futen në një gjuhë në një vit.¹⁵⁵

Numri i neologjizmave po rritet si pasojë e nevojave për të paraqitur zhvillimet e reja. Fan Noli, përkthyesi-poet, e pasuron gjuhën shqipe me shumë neologjizma.

Neologjizmat mund të përkufizohen si njësi leksikore ose njësi ekzistuese që mbartin kuptim të ri. Neologjizmat janë fjalë ose shprehje që kanë hyrë rishtazi në gjuhë për të shënuar një send a një dukuri të re dhe që ende ndihet e tillë. Fjala neologjizëm vjen nga greqishtja *véo- néo-*, “e re” and “*λόγος λόγος*” që do të thotë “fjalë, shqiptim, apo një shprehje e re”. Neologjizëm quhet një fjalë, një term i ri i krijuar, një shprehje apo frazë që mund të jetë në procesin e përdorimit të zakonit, por që ende nuk është pranuar në gjuhë¹⁵⁶.

Neologjizmat shpeshherë i atribuohen një personi të veçantë, një periudhe apo një ngjarjeje. Neolexia, që në greqisht do të thotë fjalë *e re* ose veprimi i krijimit të fjalës *së re*, është sinonim i *neologjizmës*. Termi neologjizëm është dëshmuar për herë të parë në gjuhën angleze më vitin 1772, vjen nga frëngjishtja *néologisme*. Personi që studion neologjizma quhet *neologjist*. Neologjistët studiojnë gjithashtu kulturën dhe folklorin. Një neologjizëm mund të jetë gjithashtu dhe një përdorim i ri i fjalës ekzistuese, i cili mund të trajtohet dhe si zgjerim semantik.¹⁵⁷

Në psikiatri termi neologjizëm përdoret për të përshkruar përdorimin e fjalëve që kanë kuptim vetëm te personi që i përdor ato, të pavarur nga kuptimi i tyre i përgjithshëm. Kjo tendencë konsiderohet normale te fëmijët, por për të rriturit mund të bëhet simptomë e psikopathisë, d.m.th çrregullim mendimi ose sëmundje mendore të tilla si skizofrenia. Njerëzit që vuajnë nga autizmi mund të krijojnë gjithashtu neologjizma. Përdorimi i neologjizmave mund të lidhet me afazinë, që do të thotë humbje e të folurit.¹⁵⁸

Në teori një neologjizëm është relativisht një doktrinë e re. Një neologjist është një person i cili propozon një doktrinë të re, një interpretim të ri ose materiale të tjera burimore, siç janë

¹⁵⁵ P. Newmark, *A textbook of translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f. 140.

¹⁵⁶ P. Newmak, *A Textbook of Translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f.140-150.

¹⁵⁷ P. Newmak, *A Textbook of Translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f.140-150.

¹⁵⁸ P. Newmak, *A Textbook of Translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f. 140-150.

tekstet e ndryshme, madje dhe ato fetare. Neologjizmat janë grupe fjalësh, ngjyra stilistikore e të cilave, si dhe funksionet e tyre, dalin nga fakti se ato i përkasin një shtrese të caktuar të leksikut.

Noli, si stilist, është dhe fjalëkrijues i madh. Fjalët e reja ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare.

Vëmendjen e stilistikës e tërheqin ato krijime që përfshihen në tekst jo sepse mungonte fjala përkatëse për të emërtuar diçka, por sepse kërkohet të arrihet një efekt shprehës. Neologjizmat stilistike ndërtohen sipas modeleve prodhuese në gjuhë ose edhe duke u shmangur prej tyre. Shmangia shfaqet edhe në semantikë dhe atëhere kemi jo një leksemë, por një stilemë.¹⁵⁹

Në punën e madhe që Noli ka bërë me fjalorin bien në sy sidomos neologjizmat e farkëtuara me anë të mjeteve që zotëronte gjuha dhe kryesisht me brumin e vetë shqipes. Që të krijosh fjalë të reja duhet jo vetëm të zotërosh mjetet që të vë në dorë vetë gjuha, por edhe të kesh guxim krijues. Ky guxim e ka shtyrë Nolin që kur ia ka dashur të ketë krijuar njëherazi disa fjalë të reja.¹⁶⁰

Mendoj se të jetuarit në Thrakë, pranë Adrianapojës, një zonë turke me disa grupe grekësh në jug të saj, si dhe të studiuarit në Turqi, Greqi, dhe në Havard të USA bënë që Fan Noli të ndikohet nga leksiku i përdorur në ato vende dhe për pasojë të përdorë fjalë nga disa shtresa leksikore dhe të mbushë ligjërimin e tij me neologjizma.

Një nga burimet e shprehësisë në letërsinë artistike është krijimi i fjalëve të reja nga huazimet, ose krijimi i neologjizmave, të cilat janë vështuar teorikisht, si në aspektin gjuhësor, ashtu dhe në kuadrin e letërsisë artistike.¹⁶¹ Një trajtim teoriko-gjuhësor i neologjizmave gjendet në tekstin “Leksikologjia e gjuhës shqipe” të Jani Thomait, i cili jep të dhëna për neologjinë dhe neologjizmat në gjuhën shqipe, për veçoritë e tyre ndërtimore kuptimore. Ato dallohen nga funksioni i tyre stilistikor në vepra të ndryshme letrare-artistike.

Shtresat e fjalëve të reja sjellin në ligjërim diçka vetjake e të veçantë. Ato bien në sy se shfaqen së pari në fjalor e shërbejnë si emërtime të reja për nocione të njohura ose shprehin ide e ngjyime të reja.¹⁶²

¹⁵⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2000, f. 123.

¹⁶⁰ F. Aglliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 46.

¹⁶¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, f.44.

¹⁶² Rami Memushaj, *Hyrje ne gjuhesi*, Botimet TOENA, 2006, f.130.

Neologjizmat trajtohen si elemente të reja gjuhësore. Është kjo arsyeja që ato zënë një vend të veçantë në gjuhë. Funkzioni i tyre gramatikor dhe stilistikor është i ndryshëm.

Disa neologjizma mund të paraqesin madje edhe konceptime psikologjike, si dhe qëndrime subjektive. Krijimi i fjalëve të reja është një proces krijues si në letërsinë artistike ashtu dhe në aspekte të tjera të jetës reale. Mendojmë se krijimi i fjalëve të reja është dhunti, ndaj themi se jo të gjithë shkrimtarët mund të krijojnë neologjizma në punimet e tyre.

Ka shumë shkrimtarë që kanë krijuar letrare shumë të mira në të cilat nuk ka krijime të reja leksikore, d.m.th krijime neologjizmesh. Por, duhet të pranojmë se krijimi i tyre flet për një punë të vazhdueshme me gjuhën, për një kujdes të dukshëm që gjuha të jetë tërheqëse.¹⁶³

Emine Sadiku thekson se ndryshe nga shtresa e fjalëve të vjetruara që gjendet në gjuhë e përdoret në funksione të ndryshme, shtresa e fjalëve të reja lind në procesin krijues të një vepre për të përmbushur nevojat e shkrimtarit. Fjalët e reja janë të kuptueshme nga lexuesit përderisa ato janë të motivueshme dhe shpjegohen me elementet përbërëse.¹⁶⁴

Shkrimtari përkthyes Fan Noli shfrytëzon mjetet fjalëformuese të leksikut të gjuhës shqipe, të cilat mund të jenë të njohura dhe produktive. Gjithashtu ndodh që të përdoren mjete dhe mënyra të veçanta për gjuhën shqipe. Neologjizmat e përdorura nga Noli janë krijime me efekt të veçantë gjuhësor-stilistikor. Ato, kudo që shfaqen, bien në sy dhe janë mbresëlënëse. Neologjizmat janë një mënyrë e re shprehjeje, ndaj marrin vlerë të veçantë në mbarë leksikun.

Fan Noli ka krijuar me anë mjetesh dhe mënyrash të ndryshme një numër të madh fjalësh të reja për nevojat që nxirrte zhvillimi i vetë gjuhës. Por, ai, sidomos në shkrimet në prozë e veçanërisht në artikujt gazetareskë, ka krijuar për qëllime shprehësie edhe disa fjalë që u takojnë të ashtuquajturave neologjizma stilistike, sepse ato ose marrin kuptim vetëm në frazën ku kanë lindur, ose përgjithësisht nuk ndihen të nevojshëm veç për kontekstin e dhënë.¹⁶⁵

Neologjizmat krijohen me shumicë në veprat artistike-letrare. Ato mund t'i grupojmë nga pikëpamje të ndryshme: fjalëformuese dhe për nga funksioni i tyre. Nga ana e fjalëformimit të tyre neologjizmat e krijuara nga Noli janë të llojeve të ndryshme.

¹⁶³ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Tona, Tiranë, 1999, f. 47

¹⁶⁴ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 77.

¹⁶⁵ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Tona, Tiranë, 1999, f. 175.

4.3.1 Neologjizma të përbëra

Leksiku është sistemi më i lëvizshëm i gjuhës. Duke pasqyruar drejtpërdrejt ndryshimet që ndodhin në jetën shoqërore, në fushën e prodhimit, të teknikës, të shkencës, të kulturës etj., ai zhvillohet e pasurohet vazhdimisht. Çdo gjuhë, kur ia diktojnë kërkesat e zhvillimit shoqëror, u përgjigjet këtyre kërkesave duke pasuruar e zhvilluar më tej leksikun e saj. Aq të shpejta e të shpeshta janë ndryshimet në leksikun e një gjuhe, saqë mund të vrojtohen edhe nga folësit e një brezi¹⁶⁶.

Për të patur një ide më të plotë për ngjyrimet afektive të këtyre neologjizmave po japim disa prej tyre në kontekstet ku janë vendosur nga Noli.

For it is a knell, that summons thee to heaven or to hell. [Sh:291]

*Se kjo këmbanë, po të thërret në qiell **a ferrhapsanë**. [N:47]*

Kemi kombinimin e fjalëve *ferr* dhe *hapsanë* që japin kuptimin në *ferr* dhe në *burg*. Në shumicën e rasteve fjalët kanë kuptime të ndryshme. Kështu, secila fjalë sjell informacion të ri. Kjo bën që vëllimi kuptimor i njësisë së re të përftuar të jetë i gjerë. Njësia e re bën përshtypje jo vetëm me vëllimin e gjerë kuptimor, por dhe me kontrastin kuptimor të fjalëve të bashkuara. Kuptimet e fjalëve në disa raste janë të rrafsheve të ndryshme: një kuptim është abstrakt, tjetri konkret. *Ferr* është abstrakt, ndërsa *hapsanë* është konkret; njëri kuptim përfaqëson realie të përveçme, tjetri realie të përgjithshme.

Chief nourisher in life's feast. [Sh:291]

Kryeushqenjësen e dasmës jetës. [N:51]

Me fjalën e përbërë *kryeushqenjësen* Noli nënkupton mbretin, i cili është personi prej të cilit ushqehen njerëzia.

So wither'd and so wild in their attire. [Sh:285]

*Ç'janë këto të fishkura dhe **rrobëçjerra**. [N:20]*

Neologjizmën *rrobëçjerra* e jep me shprehësi dukjen, pamjen e plakave.

Infirm of purpose! Give me the daggers. [Sh:291]

Vullnetsëmurë! Nemi mua kamat. [N:52]

¹⁶⁶ Rami Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Botimet TOENA, 2006, f.173.

Në shembullin e lartpërmendur kemi kompozimin e dy fjalëve, të cilat fjalë për fjalë do të përktheheshin **qëllim i dobët**. Në studimin dhe analizën tonë rreth neologjizmave të përdorura te “Makbethi” zakonisht kemi marrë si neologjizma ato fjalë që nuk kanë përgjegjëse në fjalor, gjithnjë krahasuar me *Fjalorin e Shqipes së Sotme, 2002*. Në shembujt e mësipërm kemi të bëjmë me neologjizma *kontekstuale*. Emërtimi përbëhet nga dy fjalë të bashkuara në një. Vëllimi i madh fonetik e kuptimor bën që fjala të tërheqë vëmendjen. Ngarkesa kuptimore e shprehëse e fjalës fiton peshë të re për shkak të aftësisë evokuese të një krijimi të tillë.

His cloister'd flight, ere to black Hecate's summons. [Sh:296]

*Pa fluturuar lakuriq' i natës, Kasneci i Hekatës **faqemvrojtur**. [N:79]*

Mbiemri *faqemvrojtur* jep pamjen e zymtë e të mvrejtur të njerëzve, e jep tiparin në një shkallë më të lartë, gjë që shkakton emocione negative. Fjala mbiemërore *faqemvrojtur* shenjon një tipar të fytyrës, shpreh njëkohësisht një ndjenjë antipatie për tiparin e për bartësin e tiparit. Fytyra e tij shpreh një brengë të thellë. E përcaktuar nga njësia *faqemvrojtur* fjala fiton ngjyrimë pesimiste në përmasa shumë të forta. Neologjizmat kontekstuale të formuara me kompozim janë më të shumtat në numër.

Be lion-mettled, proud. [Sh:301]

*Jij kryelartë, **shpirtluan**. [N:104]*

Neologjizma me vlerë mbiemërore është formuar nga dy emra: **shpirt + luan**.

According to the gift which bounteous nature. [Sh:295]

*Pas dhurates q' dha natyra, nëna **dorëhapur**. [N:74]*

Of birth-strangled babe. [Sh:300]

***Kurvëllindur** [N:100]*

Ditch-deliver'd by a drab [Sh:300]

***hendekhedhur** [N:100]*

The death of each day's life, sore labour's bath. [Sh:291]

*Banjën e punës **trupkapitëse**. [N:50]*

*In our last **conference**, pass'd in probation with you. [Sh:295]*

*Jua provova në **bashkëfjalimn' e fundmë**. [N:72]*

Në këtë krijim *bashkëfjalimn'* kemi kompozimin e ndajfoljes me emër. Shenjë arkaike është dhe përdorimi i apostrofit në fund të fjalës. Një tipar tjetër i Nolit është formimi dhe krijimi i neologjizmave me anë të emërzimit të mbiemrave.

4.3.2 Neologjizma me mbiemra ose mbiemra të substantivuar

Me zhvillimin dhe pasurimin e një gjuhe letrare, me përpunimin e stileve të saj funksionale, ndër shtresat e leksikut që vijnë e shtohen duke u shumëzuar me fjalë të reja, janë padyshim edhe mbiemrat, me anë të të cilëve shprehen tipare nga më të ndryshmet. Ndër shkrimet e Nolit mes fjalëve të prejardhura me prapashtesa bien në sy formimet e mbiemrave,¹⁶⁷ ose mbiemrave të substantivuar.

*(Distinguishes **the swift**, the subtle,) [Sh: 295]*

***Të shpejtmin**, [N:73];*

(the slow,) [Sh:295],

***të ngadalmin**. [N: 73].*

Mbiemri i substantivuar të *ngadalmin* ka ngjyrim negative krahasuar me antonimin e tij të *shpejtmin*. Përdorimi i antonimeve është dukuri e spikatur e gjuhës së Nolit.

Neologjizmat dallohen nga *ngjyrimi stilistik*. Ato mbajnë shenjën e stileve të ndryshme. Neologjizmat stilistike ndërtohen sipas modeleve prodhuese në gjuhë ose edhe duke u larguar prej tyre. Shmangia shfaqet edhe në semantikë. Përgjithësisht kur shprehësia mbështetet te shmangiet kërkohet kujdes i veçantë, sepse mund të arrihet efekti i kundërt ose teksti del me ton të fryrë, të papranueshëm.¹⁶⁸

Neologjizmat në përkthimin e veprës së “Makbethit” janë të llojit stilistik, janë krijime letrare, stilistike-librore. Zakonisht, ato mbeten brenda veprës e nuk përhapen në ligjërimin e përditshëm. Pothuaj të gjitha neologjizmat e Nolit kanë ngjyrim letrare-artstike ose ngjyrim libra. Raste të tilla janë në shembujt e poshtshënuar

And I feel now, The future in the instant. [Sh:288]

¹⁶⁷ F. Aglliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, Tona, Tiranë, 1999, f.46

¹⁶⁸ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2000, f. 123.

*Dhe po ndjej të **pritmen**. [N:34]*
Than summer-seeming lust. [Sh:304]
*se sa **azgënësia** pranverore. [N:120]*

Larmia e mjeteve formuese e bëjnë grupin e neologjizmave një grup që tërheq vëmendjen e që mban shenja të origjinalitetit krijues të vetë shkrimtarit përkthyes. Këto fjalëkrijime shenjojnë veprime, gjendje reale, nocione, frymorë dhe jofrymorë, pamje të imagjinuara ose reale. Në rastin e imazheve fjalëkrijimi paraqitet më sugjestiv, më me ndjenjë.¹⁶⁹

4.3.3 Neologjizma ndajfoljore

Neologjizmat ndajfoljorë paraqiten në grupe të larmishme. Në formimin e tyre përdoren mënyrat parashtesore ose prapashtesore. Ndër fjalët e krijuara nga ky autor me anë prapashtesash, bie në sy, një mori ndajfoljesh me **-isht**, dhe sidomos me trajtën e zgjeruar – **(ë)risht**. Pas një përzgjedhjeje midis këtyre dy trajtave të fundit, shumë nga këto fjalë erdhën e zunë vend në gjuhën letrare.¹⁷⁰ Kjo lloj prapashtese ndajfoljore formuese është nga më të përdorshmet prej Nolit.

And Fortune, on his damned quarrel smiling. [Sh:284]
*Dhe fati i buzëqeshte **kurvërisht**. [N:14]*

Këto janë mjete të njohura e të përdorshme. Të gjitha formimet me **-isht** bëhen sipas modelesh të njohura. Ndiqen modele të tilla si në zgjedhjen e temës, ashtu dhe në zgjedhjen e afiksit e të lidhjes së tij me temën.

I'll be myself the harbinger and make joyful. [Sh:287]
*Këtë gëzim ma falni **plotërisht**. [N:30]*
With his stealthy pace. [Sh:291]
*Me çap **hajdutërisht**. [N:47]*
When in swinish sleep. [Sh:290]
*Kur të flenë **derrërisht**. [N:41]*

¹⁶⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2000, f. 123.

¹⁷⁰ F.Aglliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, Tona, Tiranë, 1999, f.46-49

Gjenden dhe formime neologjizmash ndajfoljore, si ato që rrjedhin nga pjesorja e foljeve përkatëse me prapashtesën **-ur**.

Which gives the stern'st good-night. [Sh:291]

*Dhe **mvrojtur** na uroi natën e mirë. [N:47]*

Nocioni i shprehur ka kuptimin *pa humor*.

Parapëlqimi për trajtën **-ërisht** dhe përdorimi thuajse vetëm i kësaj forme vjen e bëhet kështu një veçori e stilit gjuhësor të këtij autori. Këtu ka rëndësi të vihet në dukje fakti se Noli e ndjeu nevojën e fjalëve të tilla dhe u vu në ballë të atyre që përpiqeshin ta pasuronin gjuhën me fjalë si këto. Siç vë re A.Xhuvani, në kohën e Rilindjes nëpër gazeta e revista, si në "Albania" etj., por edhe nëpër libra e broshura, u formuan me rrugë analogjike shumë ndajfolje me këtë prapashtesë. Fan Noli, siç duket nga shembujt e sjellë, eci në këtë rrugë, duke iu afruar gjendjes së sotme të gjuhës.¹⁷¹

4.3.4 Neologjizma të krijuara nga togfjalësha apo shprehje frazale

Te Noli vihen re edhe neologjizma të shprehura me togfjalësha apo shprehje frazale. Shprehjet e reja frazale janë të përshtatura në gjuhën angleze për të konvertuar foljet në emra, si p.sh: në anglisht togfjalëshat **work out, trade off, check out** midis shumë kuptimeve mund të përkthehen nga ekuivalentet e tyre, si: zbatoj një plan; të ballancosh dy gjëra që janë të kundërta nga njëra tjetra ose të bësh tregti jashtë vendit; të ç'regjistrohesh. Po ashtu dhe grupi i neologjizmave kontekstuale nuk është i vogël.¹⁷² Në këtë grup ndërtimi përfshihen neologjizma të tilla:

From the murderer's gibbet throw. [Sh:301]

*Nga **konop katil-zuzari**. [N:102]*

Kompozimet ose fjalët e përbëra përmbajnë sasi të ndryshme fjalësh, dy ose më shumë fjalë. Fjalët e bashkuara lidhen kuptimisht **konop katil-zuzari**. Në këto raste fjala e re paraqitet si kompozim fjalësh të njohura, kur emërtimi i ri formohet mbi bazën e shoqërimit të ideve dhe

¹⁷¹ F.Aglliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, Tona, Tiranë, 1999, f.50.

¹⁷² P. Newmak, *A Textbook of Translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f. 141

kuptimi i ri ka natyrë të figurshme (plotësisht ose pjesërisht). Kuptimi i fjalës së re është një shumë e kuptimeve të fjalëve përbërëse. Nuk ka mbartje emërtimi, por një bashkëlidhje fjalësh, të cilat formojnë një njësi të re me kuptim të drejtpërdrejtë.

Were poor and single business to contend. [Sh:289]

Jan' aqë varfërishte dhe të dobëta sa s'mund t'u bëjnë ballë ndereve. [N:36]

Në klasën e neologjizmave ka një grup fjalësh tepër të përkohshëm, më jetëshkurtër se ekzemplarët e tjerë të kësaj klase.¹⁷³ Në raste të tilla kemi të bëjmë me një formim, kuptimi i të cilit mbështetet në një tipar tepër kalimtar të objektit që emërtohet. Tipari nuk ka të bëjë me cilësi të qëndrueshme, por thjesht me vendndodhjen a ndonjë rrethanë tjetër të përkohshme.

But screw your courage to the sticking-place. [Sh:290]

Vidhos kurajën. [N:41]

And wicked dreams abuse, the curtain'd sleep. [Sh:290]

Ia trbullojnë gjumin perdevarur. [N:46]

Shpesh ndodh që shprehjet frazale janë më ekonomike në të përdorur se sa perifrazimet e tyre. Ato janë shumë productive, sidomos në gjuhën angleze dhe ndikimi i tyre është më i madh se ai i gjuhëve greko-latine apo ekuivalentet në gjuhë të tjera.¹⁷⁴

Si përfundim togfjalëshat, me veçoritë e tyre, shërbejnë si një burim tjetër shprehësie. Përftesat me frazeologjinë janë një lloj përpunimi i saj, i cili i rigjallëron, i bën të ndjeshme veçoritë e ndërtimit e të semantikës së tyre, të cilat janë ngurosur po ashtu siç fshihet forma e brendshme e fjalës pas ndërtimit të saj. Atëhere nga përftesat rifitojnë lëvizshmërinë gjymtyrët, rigjejnë fjalët kuptimet që u ishin fshirë, mund të zëvendësohen gjymtyrët, të cungohet ndërtimi, të ndryshohen trajtat gramatikore, të kontaminohen dy njësi.¹⁷⁵

¹⁷³ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 108

¹⁷⁴ P. Newmak, *A Textbook of Translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f. 141.

¹⁷⁵ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2000, f. 127.

4.3.5 Formimi i neologjizmave me parashtesat për- dhe para-

Dua të theksoj se te neologjizmat e ndeshura në shqipërimin e “Makbethit” përfshihen fjalë që i përkasin klasave të ndryshme leksiko-gramatikore, si: emra, mbiemra, folje, ndajfolje. Zakonisht, neologjizmat e Nolit janë fjalë të prejardhura. Ato mund të jenë formuar me parashtesa, të cilat nuk e ndërrojnë kategorinë leksiko-gramatikore të fjalës nga rrjedhin.

Veçori, si të thuash, individuale, vëmë re edhe te mbiemrat e formuar me një parashtesë, shoqëruar nganjëherë edhe me prapashtesë. Mjaft nga këto krijime mbeten neologjizma.¹⁷⁶

Një numur fjalësh të formuara me parashtesa kumbojnë si neologjizma dhe i hasim edhe në klasën foljore.

Në përgjithësi parashtesa **për-** përdoret për të formuar folje dhe emra, nga folje dhe emra të tjerë.

To make their audit at your Highness. [Sh:289]

*Dhe kur të dëshironi **t'i përqyrni**. [N:37]*

Parashtesa **për-** i jep fjalës ngjyrimet përforcimi, intensifikimi kuptimor.

The attempt and not the deed confounds us [Sh:291]

***Përnisja** dhe jo vepra na trondit më tepër. [N:48]*

*Must lave our honours in these **flattering** streams. [Sh:296]*

*Pra, jemi të shtrënguar ta **përlajmë** me lajka madhështinë mbretërore. [N:78]*

This supernatural soliciting. [Sh:286]

*Kjo **parëlajmë** sipërnatyrale. [N:26]*

Parëlajmë është formuar me parashtesën **parë-**.

Këto krijimeve janë gjithashtu të dukshme për ngjyrimet e tyre emocionale-vlerësuese. Shpesh formimet e fjalëve të reja shprehin pothuaj të njëjtin kuptim që fjala ka kur është pa parashtesë. Meqë përmbajtja e fjalëve pa parashtesë shpreh qëndrime pohuese ose emocione pozitive, kuptimi i fjalëve në shqyrtim shoqërohet zakonisht me emocione të njëjta pozitive.

¹⁷⁶ F.Aglliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, Tona, Tiranë, 1999, f.58.

4.3.6 Formimi i neologjizmave me prapashtesa të tjera

Një numër fjalësh të reja ka krjuar Noli me anë të prapashtesave për të emërtuar koncepte cilësish abstrakte ose mjeshtërish.

Duke ecur në gjurmët e një mënyrë të shprehuri të gjuhës popullore, Noli prapashtesës **-isht** i dha formën e një prapashtese mbiemërore dhe ndajfoljore.¹⁷⁷

Produktive paraqiten gjithashtu prapashtesat **-shme**, **-risht**, **-si**.

Art thou not, fatal vision, sensible. [Sh:290]

Pamje fatale, s'je e ndjerëshme [N:46]

I'll be myself the harbinger and make joyful. [Sh:287]

Këtë gëzim ma falni plotërisht. [N:30]

So humbly take my leave. [Sh:287]

Lyp lejen pra përunjërisht. [N:30]

Were poor and single business to contend. [Sh:289]

Jan' aqë varfërishte dhe të dobëta; varfërishte. [N:36]

Në shembujt e sipërpërmendur neologjizmat duken sikur fitojnë një lloj qëndrueshmërie në leksik, duken si njësi që tashmë e kanë bërë vendin e tyre midis njësive të tjera, madje si njësi që kanë traditë përdorimi me prapashtesat.

For sundry weighty reasons. [Sh:296]

Për shumë arsye rëndësore. [N:75]

Kjo neologjizëm është formuar nga tema **rëndë** + prapashtesën **-si** + **ore**. Prapashtesa **-ri** përdoret për të formuar emra të përgjithshëm njerëzish sipas një pune që kryejnë ose një detyrë që kanë.

Macbeth doth come. [Sh:285]

*Na vjen Makbethi, **Kumandari**. [N:19]*

Disa tema që kanë shërbyer për formimet e sipërpërmendura nuk ekzistojnë realisht në gjuhë, por duhen menduar si paraardhëse të mundshme të fjalëkrijimeve.

Art though not, fatal vision sensible. [Sh:290]

Pamje fatale, a s'je e ndjerëshme. [N:46]

¹⁷⁷ F.Aglliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi, Botimet TOENA, Tiranë, 1999, f.50

Në shembujt që vijojnë kemi përdorimin e prapashtesës **-si** në vend të **-(t)i**. Forma është neologjike.

He confessed his treasons. [Sh:286]

I konfeso i të gjitha tradhësitë. [N:28]

Sipas E. Sadikut në këtë formim ndiqet një model i njohur ndërtimor me përdorimin e prapashtesës **-si**. Sipas mendimit tonë fjala dhe modeli ekzistojnë; përdorimi është i ri. Fjala fiton një kuptim më të spikatur (krahasuar me fjalën e sotme tradhëti). Një shembull tjetër interesant i Nolit.

and live a coward. [Sh:289]

Dhe prap rron frikaç në sy të vetes. [N:40]

Kuptimi i fjalës frikaç është frikacak

Në vargun e poshtëshënuar kemi formimin e mbiemrit *fishkëse*. Me anë të prapashtesës **-ës(e)**

Wither'd murder, alarum'd by his sentinel, the wolf. [Sh:290]

Vrasja fishkëse- e alarmuar prej gardianit ujk. [N:47]

Fjala shenjon tipar negativ që lidhet kuptimisht me fjalën *vrasje*.

Vlen të theksohet se në formimet prapashtesore përdoren rëndom prapashtesa arkaike, si:

- zoj.

But in a sieve I'll thither sail. [Sh:285]

Atje me shoshë lundrëzoj. [N:18]

Siç vihet re këto prapashtesa e pasurojnë fjalën duke i dhënë një nuancë a tipar të ri. Kjo prezencë e hollë nuancash i bën tërheqëse këto fjalë. Ato evokojnë modelin e formimit, idenë leksiko-semantike dhe sugjerojnë përdorimin real të tyre.

4.4 Përdorimi i neologjizmave

Prurjet në leksikun e gjuhës janë më të mëdha se daljet dhe me këtë shpjegohet pse leksiku vjen duke u pasuruar nga brezi në brez me njësi të reja. Burimet nga hyjnë fjalët e reja në gjuhë janë të ndryshme dhe disa prej tyre shume prodhimtare.¹⁷⁸

¹⁷⁸ Rami Memushaj, Hyrje ne gjuhesi, Botimet TOENA, 2006, f.174.

Fjalëkrijimet e Nolit janë shumë të larmishme. Shkrimtari-përkthyes i përdor ato shumë bukur dhe hijshëm në gjuhën e personazheve. Ato përdoren sidomos kur gjuha dhe mendimet e personazheve shprehen në ligjëratë të drejtë.

Neologjizmat përdoren gjithashtu në portretizimin fizik të personazheve të ndryshëm. Pjesëmarrja e tyre në portretizim i jep portretit jo në pamje të zakonshme, por të veçantë, me tipare që shquhen e që tërheqin vëmendjen. Në prezantimin fizik përdoren fjalë të ndryshme leksiko-gramatikore, mbiemra, emra etj.¹⁷⁹

Neologjizmat ndeshen dhe në portretizimin moral të personazheve, në paraqitjen e vetive të karakterit, të impulseve të brendshme, si dhe të botës psikologjike. Neologjizmat ndihmojnë që logjika e psikologjia e personazheve të paraqiten në veçantinë dhe në origjinalitetin e tyre. Me gjithë ekuivalencën kuptimore me njësitë ekzistuese në gjuhë, neologjizmat e bëjnë ligjërimin më të larmishëm. Në shumicën e rasteve ekuivalenca kuptimore midis njësisë së re dhe asaj ekzistuese është e plotë. Midis tyre nuk ka dallime të dukshme.¹⁸⁰

Noli ka krijuar mjaft fjalë të reja për të emërtuar veta ose persona sipas veprimit që kryejnë, vendit ku banojnë, mjeshtërisë etj. Bien në sy për trajtën e tyre karakteristike toske emrat e prejardhura nga foljet me prapashtesën –**onjës**.¹⁸¹

Te Noli ka krijime të tilla, si: **lulëzonjëse**, që përmban në semantikën e saj ngjyrimet dhe afeksionin që prodhohet në një vend mbushur me lule që kanë çelur. Në kontekst gjithë atmosfera e mundshme gëzimsjellëse e një përdorimi të tillë kthehet në të kundërtën e saj. Nuk është fjala për lule e bukurira natyrore, por për krime.

But abound in the division of each several crime. [Sh:304]

*Por jam plot me vese dhe me krime **lulëzonjëse**. [N:120]*

Neologjizmi **lulëzonjëse** me kuptimin bazë **të lulëzuara** lidhet kuptimisht me foljen lulëzoj. Këtu kemi një mbiemër prejpjesor. Në këtë rast mbiemri motivohet me fjalën lule (emër), lulëzoj (folje). **Lulëzonjëse** duhet të shprehte cilësi e ngjyrimet pozitive. Por jo, në kontekst ajo lidhet me diçka negative, një nxitje negative që përparon. Fjala **lulëzoj** shpreh një zhvillim shumë të

¹⁷⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, Albas, 2000, f. 104-108.

¹⁸⁰ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e I. Kadaresë*, Tiranë, 1998, f. 108

¹⁸¹ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, TOENA, Tiranë, 1999, f.53.

shpejtë negativ, që ka përmasa në rritje, si në shembullin e lartpërmendur. Këtu flet për krimet e njëpasnjëshme, të cilat shtohen në numër.

Njësitë neologjike të cituara, formale apo kuptimore kanë ngjyime të forta afektive. Për të patur një ide më të plotë për ngjyrimet afektive të neologjizmave po japim disa prej tyre në kontekstin ku janë vendosur.

Art thou not, fatal vision, sensible, to feeling as to sight? [Sh:290]

Pamje fatale, s'je e **ndjerëshme**. [N:46]

Në këtë kontekst fjala e **ndjerëshme** shpreh emocionin e tmerrshëm që ndjen njeriu kur ndodhet përpara një të sapovrari. E ngjashme për nga ndërtimi është dhe fjala e mëposhtme.

Your face, my thane, is as a book where men may read strange matters. [Sh:288]

Fytyra jote është si një libër ku po këndohen gjëra të çudiçime. [N:34]

Fjala mbiemërore **të çudiçime** shenjon një tipar dhe një ndjenjë antipatie për tiparin dhe për bartësin e tiparit. Noli di ta përdorë mjaft bukur fjalën e re, e vendos në kontekstin e duhur duke i dhënë një ngjyrim kuptimor-leksikor mjaft të gjerë dhe të intensifikuar.

Në leksikun e krijimeve dhe të përkthimeve të Fan Nolit është e pamundur të lihen mënjane fjalët e reja të krijuara nga vetë poeti-përkthyes, i cili ndikohet kryesisht nga anglishtja, turqishtja dhe greqishtja. Ai është shumë i vëmendshëm për saktësinë kuptimore të fjalës së përkthyer, kujdeset që të sjellë në ligjërim fjalë që e shprehin saktë e drejtë mendimin e origjinalit, duke e paraqitur atë me një forcë shprehëse, e cila buron dhe nga ngjyrimet e ngarkesat kuptimore-emocionale që fiton fjala në aktin fjalë/formë krijues.

Si përfundim këto krijime vërtetojnë që Noli jo vetëm sajonte fjalë të reja sipas nevojave që i lindnin, por edhe kishte njohuri të sigurt për modelet popullore të formimit të fjalëve si dhe aftësinë për të manovruar me to. Mbi të gjitha ai karakterizohej nga guximi që kishte për të krijuar fjalë të reja.¹⁸²

¹⁸² F.Aglliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, TOENA, Tiranë, 1999, f.62

4.5 Fjalorth neologjizmash nga Noli te përkthimi i tragjedisë së “Makbethit”

Neologjizmat i shtojnë informacionit diçka të re, plot ngjyime, dhe e bëjnë atë shumë tërheqës. Shumica e neologjizmave të përdorura në përkthimin e “Makbethit” nga Noli janë formuar zakonisht me *parashtesa* e me *prapashtesa* të ndryshme, si dhe me përbërje e mbi bazë togfjalëshash. Ato mund të jenë dhe fjalë të parme, të prejardhura, të formuara nga morfema të greqishtes së vjetër dhe latinishtes etj. Neologjizmat e krijuara nga Noli janë një pasuri dhe larmi e fjalorit që e bën lexuesin t’i lexojë me kënaqësi veprat e tij, pavarësisht gjinisë së tyre¹⁸³

konop katil-zuzari- vrasës

rremëbetonjësit- gënjeshtarët

zuzar e lar- të egër, mizorë

formëshkoqur- të shoh shumë *qartë*

vrasja fishkëse- vrasje fatale

përnisja- qëllimin

kasneci- lajmëtari

faqemvrojtur- fytyrë ngrysur, jo i qeshur

fletëfishkur- plak

lundrëzoi- lundroj

përqyrni- këqyrni

parëlajmë- paralajmërim

përnisja- nisja

papemet- pa pemë, pa prodhim

të shpejtmën- të shpejtin

të ngadalmin- të ngadalitin

vidhos kurajën- mblidh veten, bëhu i guximshëm, është neologjizëm kuptimore.

Fan Noli vetë ishte i bindur se përkthimet e mira të kryeveprave letrare përbëjnë rikrijime në gjuhë ku janë përkthyer.

Gjuha e Nolit merr krahë edhe fluturon lirshëm kur ai nis e shkruan ato që mendon, gjykon e imagjionon vetë. Dhe veprat origjinale të këtij shkrimtari nuk janë as shumë as pak për të krijuar

¹⁸³ F.Aglliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, monografi, TOENA, Tiranë, 1999, f.60

një pamje pak a shumë të plotë të punës së tij me gjuhën¹⁸⁴. Mjaft prej krijimeve të tij e pasuruan fjalorin duke u përdorur sot.

Shqipërues kryeveprash nga letërsia botërore, Fan Noli duhet patjetër ta lëvronte e ta çonte përpara edhe gjuhën, e cila për të “nuk qe një mjet i gatshëm, i ngurtë dhe i paluajtshëm midis njerëzve, po kod që afron mundësi të mëdha shprehëse dhe krijuese”¹⁸⁵

4.6 Huazimet në tragjedinë e “Makbethit”

Në këtë pjesë punimi do të trajtohen huazimet leksikore. Do të paraqitet sfera e përdorimit dhe funksionet e tyre stilistike. Punimi do të theksojë gjithashtu se Noli është përkthyes-mjeshtër në zgjedhjen e në huazimin e fjalëve. Në shtresën e huazuar të leksikut paraqesin interes stilistik sidomos huazimet që nuk i kanë ekuivalentet në gjuhën shqipe. Huazimet shquhen për efektin evokues, si dhe funksionet stilistike që ato prodhojnë. Ndaj themi se fjalët e huaja janë elemente të spikatura, që bien menjëherë në sy në thëniet e hartuara në gjuhën standarde. Gjuha e shkruar ka pësuar e vazhdon ta ndiejë ndikimin e gjuhëve të huaja, shpesh dhe pa e kuptuar.

Huazimet dhe fjalët e huaja evokojnë një mjedis nacional tjetër, real që lidhet me një vend e me një popull tjetër. Huazimet përdoren shpesh për ngjyrimet leksikore për qëllime stilistike, për të karakterizuar personazhet etj. Në ligjërime ndodh të përfshihen edhe fjali të tëra nga gjuhët e huaja.¹⁸⁶

Pyetja lind pse ndodh fenomeni i huazimit? Gjatë historisë marrëdhëniet e një populli me popujt e tjerë kanë sjellë edhe ndikime në gjuhë. Kjo duket më drejtpërdrejt në sistemin leksikor. Historia e gjuhës dhe etimologjia i ndajnë elementet e huazuara nga elementet vetjake. Leksikun e një gjuhe mund ta ndajmë në dy shtresa: shtresa vetjake dhe shtresa e huazuar; p.sh. gjuha shqipe, për të cilën thuhet se është gjuhë indoeuropiane, nuk duhet kuptuar që gjithë pasuria e saj leksikore është trashëgim i fondit të vjetër indoeuropian¹⁸⁷.

¹⁸⁴ F.Aglliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi, Botimet TOENA, Tiranë, 1999, f.9.

¹⁸⁵ F.Aglliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, monografi, Botimet TOENA, Tiranë, 1999, f. 45.

¹⁸⁶ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 35.

¹⁸⁷ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 103

4.7. Shtresa e huazuar e leksikut

Gjatë kontakteve historike, ekonomike e kulturore, popujt japin e marrin midis tyre dhe gjurmët e këtyre marrëdhënieve me drejtim përgjithësisht dykahësh pasqyrohen edhe në gjuhë, ku dallohen krahas shtresës së dukurive anase, edhe një shtresë elementesh të huaja, huazimet. Huazimet përbëjnë një dukuri të zakonshme për të gjitha gjuhët. Ato prekin të gjitha rrafshet gjuhësore: fonetikën, morfologjinë, leksikun dhe sintaksën. Por rrafshi që preket drejtpërdrejt dhe më shumë nga huazimet, është leksiku.¹⁸⁸

Huazimi është një proces gjuhësor që haset në të gjitha gjuhët e botës. Kjo tregon se popujt kanë pasur apo kanë marrëdhënie historike, ekonomike dhe kulturore ndërmjet tyre. Huazimi leksikor ndodh në rrethana historike e gjuhësore të caktuara, edhe kur në një gjuhë ka emërtim për të njëjtën realie a për të njëjtin koncept. Hyrja e tyre, përdorimi i kalkeve dhe huazimeve frazeologjike është një dukuri që haset në të gjithë kombet e zhvilluara. Ato janë pjesë përbërëse e shqipes, si gjuhë kulture dhe shenjë e marrëdhënieve të ndërsjellta me kulturat e popujve të ndryshëm. Vitet e fundit në gjuhën shqipe ka një prurje të madhe të këtyre njësisë, si rezultat i hapjes së vendit tonë.¹⁸⁹

Noli është ndër shkrimtarët që ka punuar me fjalët e huaja dhe është përpjekur që t'u japë një trajtë shqipe duke u mbështetur në tiparet asimiluese të gjuhës shqipe, si dhe përshtatjes së morfemave ndajshesore të fillimit dhe të fundit me morfema të ngjashme nga të brumit të saj.¹⁹⁰

Në gjuhën shqipe krahas një fjale është pranuar dhe fjala e huaj, si në rastet kur ka qenë një *term ndërkombëtar* mjeksor, si *epilepsi, grip, kancer, tuberkuloz*, etj. Fjala e huaj është pranuar edhe kur e ka kërkuar *një stil i caktuar i gjuhës*, si stili shkencor dhe ai politiko-shoqëror. Fjalët e reja që huazohen nga gjuhët e huaja i nënshtrohen sistemit fonetik e gramatikor të gjuhës në të cilën futet fjala e huazuar, d.m.th. shkruhen e shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit të saj dhe përshtaten sipas rregullave gramatikore. Nga përdorimi i shpeshtë i fjalëve të sipërpërmendura të krijohet imazhi që këto fjalë janë fjalë të mirëfillta shqipe.¹⁹¹

¹⁸⁸ Rami Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Botimet TOENA, 2006, f.178..

¹⁸⁹ A. Ballhysa, A. Jashari, *Formimi gjuhësor*, Flish, 2011, f. 109.

¹⁹⁰ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 199, f.83.

¹⁹¹ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 113-118.

Por, fjalët e huaja mund të kenë pësuar *edhe ndryshime në formë e në përmbajtje*. Noli i ka marrë fjalët e huaja dhe i ka përpunuar sipas rregullave të gjuhës shqipe. Duke u përpjekur për t'i asimiluar sa më shumë fjalët e huaja, për t'ia përshtatur si strukturës fonetike ashtu dhe asaj morfemore të shqipes, në mënyrë që të ngjajnë si fjalë vendi, Noli në shkrimet e tij të para provoi që shumë fjalëve të huazuara prej tij t'u japë një pamje si të themi shqipe.¹⁹²

Fjalët e huaja vazhdojnë të zhvillohen dhe të bëhen pjesë e fjalorit të gjuhës në të cilën ato hyjnë dhe u nënshtrohen kushteve konkrete historike, që përcaktojnë zhvillimin e leksikut të kësaj gjuhe në përgjithësi. P.sh. në gjuhën shqipe *mjek-u*, latinisht. *medicus* ka dhënë brenda gjuhës shqipe grupimet e familjes: *mjek* = emër, *mjekoj* = folje, *mjekim* = emër i përgjithshëm me kuptimin *kurim*; *i mjekuar* = mbiemër, *mjekësi* = emër, *mjekësor* = mbiemër, si p.sh: *përparim mjekësor*, *i mjekueshëm* = mbiemër etj. Fjalët e formuara në këtë mënyrë janë formime të gjuhës shqipe dhe sot nuk mund të quhen më huazime.¹⁹³

Huazimet leksikore të Nolit mund të jenë: a. ***të drejtpërdrejta***, d.m.th. të marra drejtpërdrejt nga gjuha e huaj. Kështu, fjalët *invasion*, *frankërisht*, *salute*, etj. i ka marrë drejtpërdrejt nga latinishtja, anglishtja, frëngjishtja, nga turqishtja. b. ***huazime strukturore***, kur fjala në të vërtetë është shqip, por është ndërtuar sipas gjedhës së një fjale të huaj (lat.), si: *cilësi*, *sasi*, etj. c. ***fjalë ndërkombëtare***, që i takojnë më shumë terminologjisë, teknike, elektronike etj: *operacion*, *teknologji* etj. Shtresa e huazuar mund të vështrohet edhe sipas burimit. Fjalët e përdorura nga Noli janë kryesisht me prejardhje nga greqishtja, latinishtja, anglishtja, frëngjishtja apo turqishtja.

Huazimet mund të shihen dhe nga çasti historik kur kanë hyrë në një gjuhë. Meqenëse gjuhët bashkëkohore janë gjuhë të reja dhe pak a shumë u dihet gjuha amë, huazimet mund t'i ndajmë sipas përkatësisë historike. Në gjuhën shqipe ato kanë një rëndësi të jashtëzakonshme, sepse kanë peshën e tyre në përcaktimin e historisë së vetë shqipes. Një pjesë e mirë e huazimeve që përdor Noli janë greqizma. Shtresa e huazuar nga greqishtja është ndër më të hershmet. Vend të veçantë në leksikun e shqipes zë shtresa e quajtur huazime orientale, për arsye se ajo ka ardhur nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me turqishten, por edhe ka përcjellë praninë e shtresave të

¹⁹² F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 86.

¹⁹³ <https://www.albasoftcms.com/en/> Kumtesë e lexuar nga Shefkije Islamaj në Seminarin XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare.

ndryshme orientale në këtë gjuhë. Fan Noli, lidhur me qëndrimin ndaj fjalëve orientale të njohura në gjuhën popullore, u largua nga tradita e fazës së parë të Rilindjes, duke qenë në përgjithësi tolerant ndaj tyre dhe herë-herë mund të themi edhe moskokçarës.¹⁹⁴

Përdorimi në mënyrë të veçantë i orientalizmeve nga Fan Noli bëhet shpesh për të dhënë një ngjyrim sakral, biblik te “*Marshi i Barabait*”, ose një atmosferë trishtimi biblike te “*Anës Lumenjve*”, ku përdoren fjalë, si: **vatan, millet, derbederet, sygjyynosur jabanxhinjtë, fajdexhinjtë** etj. Noli në këtë rast ka shfrytëzuar dhe sinharmoninë zanore të tyre dhe emri i *Barabajt* i ka shërbyer si dominante fonetike.¹⁹⁵ Të tilla fjalë të importuara janë për të treguar cilësi të personazheve, të veprimeve dhe emocioneve që ato mbartin. Te “*Makbethi*” Noli sjell me shumicë fjalë të huazuara, të prejardhura nga gjuha latine, franceze, gjermane, italiane, etj., duke u shtuar shpesh prapashtesa të gjuhës shqipe.

Fjalët e huazuara mund t’i klasifikojmë për nga burimi, gjuha prej së cilës ato e kanë prejardhjen; mënyra e hyrjes në gjuhën amtare: të drejtpërdrejta ose jo; kategoria leksiko-gramatikore: të rrënjosura/të parrënjosura. Kur huazohet fjala e tërë, me formën dhe me kuptimin që ka në gjuhën dhënëse, flitet për huazime leksikore. Këto përbëjnë pjesën më të madhe të fjalëve të huaja që ka një gjuhë.¹⁹⁶

4.7.1 Fjalë të huazuara emërore

Në ligjërimin e Nolit sillen fjalë të rralla dhe fjalë shumë të rralla, neologjizma befasuese, huazime etj. Huazimet më të shumta janë emra.

perseverance [Sh:304]

perserveranc’ [N:120]

Kjo fjalë është huazuar nga origjinali ***perseverance***. Në shekullin e XII në frëngjisht kishte kuptimin ***qëndrueshmëri***, që vjen direkt nga latinishtja ***persevarare, perseverant, perseverantia***.

¹⁹⁴F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 90.

¹⁹⁵ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 118.

¹⁹⁶ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Botimet TOENA, 2006, f.180.

Në mes të shekullit XIV është përdorur në frëngjishten e vjetër forma **perseverance**, kuptimi i së cilës ishte përsëri **qëndrueshmëri**.¹⁹⁷

Shembulli i mëposhtëm përmban një element shumë interesant. Noli e ka huazuar drejtpërsëdrejti nga anglishtja. Por duhet të theksojmë se fjala vetë në anglisht është e huazuar nga latinishtja.

*Nor steel, nor poison, Malice domestic, foreign levy,
nothing, can touch him further. [Sh:296]*

S'e nget dot më as hekuri as helmi as kryengritja as **invajz**' e huaj. [N:78]

Në vitin 1400-1450 fjala **invade** është regjistruar në anglishten e Mesjetës, e cila është e prejardhur nga latinishtja **invāstōn** (rrënja e **invāsiō**), ekuivalente **me invās (us)**, infinitivi në latinisht është **invādere (+ -iōn, -ion)**, nga kjo formë ka ardhur dhe fjala në anglisht **invade**. Fjala **invasionne** në mes të shekullit XV në frëngjishten e vjetër do të thotë **sulm**. Fjala frënge vjen nga latinishtja **invasion**, në rasën emërore "**invasion**", përsëri ka kuptimin **sulm**. Rrënja e participit në latinisht "**invader**" ka kuptimin **mësyj, ndërhyj, sulmoj**. Nga ky kuptim është zhvilluar nocioni i pushtimit me forca të armatosura, ndërhyrje, si dhe përhapje e sëmundjes etj.¹⁹⁸ Mendojmë se Noli është influencuar nga gjuha angleze në përdorimin e kësaj fjale. Në shembullin që vijon kemi një emër të huazuar nga turqishtja.

That seems to speak things strange. [Sh:285]

Na sjell habere. [N:16]

Habere, lajme, është huazim nga turqizmat. Gjithashtu edhe fjala odë.

A room in the palace. [Sh:287]

Një odë në pallat. [N:28]

Kjo fjalë është huazim nga turqishtja. Në gjuhën e shqiptarëve të Maqedonisë përdoret edhe sot në kontekstin **Oda e tregtisë**. Ndërsa te shqiptarët e Shqipërisë kemi emërtimin **Dhoma e tregtisë**. Disa shembuj të tjerë huazimesh.

To be his purveyor. [Sh:289]

¹⁹⁷ Online Etymology Dictionary, Retrieved August 03, 2015, from Dictionary.com website: <http://dictionary.reference.com/browse/perseverance>

¹⁹⁸ Online Etymology Dictionary, Retrieved August 03, 2015, from Dictionary.com website: <http://dictionary.reference.com/browse/invade>

Si kasnecë. [N:37]

Balm of hurt minds. [Sh:291]

Ballsamn', e shpirtit vrar'. [N:51]

Fjala e huazuar është “**balm**” = **balsam**. Origjina e kësaj fjale është nga gjermanishtja e vjetër. **Balsamon** rezulton e regjistruar në vitet 1050 dhe më pas në latinisht **balsamum**. Fjala është hasur si emër në fillim të shekullit XVIII, me kuptimin substancë aromatike nga rrëshira ose vajrat. Në frëngjishten e vjetër shkruhet **basme**, në frëngjishten moderne **baumë**, sot **balsam**. Kjo është fjalë që përdoret sot në hebranishte **Basam**, me kuptimin erza. Po ashtu përdoret dhe në arabisht **basham**, me kuptimin **balsam**, erzë, parfum. Në shekullin e XV-XVI në latinisht është përdorur edhe me një kuptim tjetër, **bar** për kurim ose përdorim, që shërben si qetësues. Në vitet 1175-1225 është regjistruar në anglishten e Mesjetës **basme**, **ba(u)**, me kuptimin *erzë*.¹⁹⁹ Në rastin e mëposhtshëm është përdorur fjala **faca** me kuptimin **fytyrë** (njerëzore).

These faces? [Sh:303]

Ç'janë këto faca? [N:114]

Përdorimi më i hershëm i fjalës **faca** ka kuptimin fytyra humane, pamja e fytyrës, imazhi, shëmbylltyra, origjina e së cilës është nga **latinishtja**. Fjala është përdorur në shekullin XII dhe XIII për herë të parë në latinisht dhe më pas në frëngjishten e vjetër në formën **faces**. Nga kjo fjalë rrjedh **façade**, origjina e së cilës daton në shekullin e XII, vjen nga latinishtja, ku përdorej në formën **facies** me kuptimin **pamje**. Më vonë kjo fjalë është huazuar dhe përdorur në italisht **faccia**. Në vitet 1250-1300 është regjistruar edhe në gjuhë të tjera, si në anglishten e Mesjetës, **facen** si emër, po ashtu dhe në frëngjishten e vjetër **facies**, të dyja me preardhje nga latinishtja **faciēs**. Ndërsa në vitet 1650-1660 në frëngjisht është përdorur edhe me kuptim tjetër, “*pjesa e përparme e ndërtesës*”, **façade**.

Në italisht **facciata** është përdorur gjithashtu me të njëjtin kuptim, d.m.th “*pjesa e përparme e ndërtesës*”. Fjalët në frëngjisht dhe italisht janë me origjinë nga latinishtja, **faccia** “**face**”, të përdorura me të njëjtin kuptim. **Facia** është përdorur në mënyrë figurative nga viti 1845.²⁰⁰

Not in the legions. [Sh:304]

As në taborët. [N:118]

¹⁹⁹ Online Etymology Dictionary, Retrieved August 03, 2015, from Dictionary.com website: <http://dictionary.reference.com/browse/balsam>

²⁰⁰ Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper Dictionary.com, website: <http://dictionary.reference.com/browse/face>

Tabor në tekstin e Nolit ka kuptimin “*daulle e vogël*”, që i ngjason një tambourine. Origjina është nga frëngjishtja e vjetër e shekullit XIII. Në frëngjishten e vjetër “*tabour, tabur*” do të thotë *daulle, zhurmë*. Ndoshta vjen nga persishtja e shekullit XI, *tabir* “*drum,*” *daulle*. Përsa i takon evoluimit dhe kuptimit të mëtejshëm të fjalës është i pasigurtë. Për herë të parë është regjistruar rreth viteve 1250-1300 si emër në anglishten e Mesjetës dhe në frëngjishten e vjetër, shkruar *tab (o) ur, tambourinë* është shfaqur në vitin 1782, me kuptimin *daulle e vogël; a small drum* (1570) nga frëngjishtja, “*tambourin*” *daulle*; në arabisht *tumbur*, “*lutë*”, *lahutë*. Në frëngjishten e vjetër *tabor*.

Ndjekja e zhvillimit të fjalës paraqet disa vështirësi në shekullin e XVII dhe XVIII. Referenca të instrumentit është vështirë të përcaktohen. Nga fundi i shekullit XV dhe XVI Shekspiri ka përdorur fjalën *tambourinë*.²⁰¹ Disa shembuj të tjerë përdorimesh.

*Untitled tyrant **Bloody-scepter'd.** [Sh:304]*

*Prej një tirani' dhe **uzurpatori.** [N:121]*

Noli duhet të ketë përdorur versionin anglez “**uzurpatori**”, që është përdorur në anglishten e Mesjetës. Origjina e saj është nga latinishtja dhe është regjistruar për herë të parë në vitet 1350-1400. Në latinisht e kemi *ūsūrpātiōn*, rrënja e fjalës është *ūsūrpātiō*, e cila është ekuivalente me *ūsūrpāt* (us), (pjesorja e shkuar e *ūsūrpāre, to usurp*) + *-iōn, -ion*, që do të thotë marrja e fronit në mënyrë ilegale ose pushtim ilegal.²⁰² Formë tjetër e shkruar është *usurpatory*. Disa shembuj të tjerë:

***Suspicion** of the deed. [Sh:294]*

***Suspekte** për komplotin e pabesë. [N:66]*

Origjina e fjalës *suspect* është nga latinishtja. *Suspect* është regjistruar në vitet 1250-1300. Në latinisht fjalëforma *suspectus* del me kuptimin “*i/e dyshimtë*”. Po në këto vite 1250-1300 në latinisht është regjistruar gjithashtu *suspectāre*, ekuivalente me “*su-, su- + spectāre*”.

Suspect shfaqet në fjalor në fillim të shekullit XIV, me kuptimin “*të dyshosh për veprime të gabuara, të jesh në dyshim*”. Nga mesi i shekullit XIV është përdorur dhe me kuptimin “*të mosbesosh*”, që rrjedh nga frëngjishtja e vjetër “*dyshoj*”, *suspect* zhvillohet më tej në “*a suspected person,*” , (1590) nga *suspect* (adj.) “*njeri i dyshimtë*”, të përdorur në gjuhën angleze,

²⁰¹Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper
<http://dictionary.reference.com/browse/tombourine>

²⁰²Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper <http://dictionary.reference.com/browse/usurpatry>

dhe si emër që rrjedh nga frëngjishtja e Mesjetës **suspecter**, ose direkt nga latinishtja, **suspectare**, “të dyshosh”.²⁰³

Compell'd these skipping kerns to trust their heels. [Sh:284]

*I dham' armikut **dërmën**. [N:14]*

Dërmën është me origjinë turke. Është huazuar nga turqishtja.

What purgative drug. [Sh:308]

*Recin' e **purgatif**. [N:143]*

Fjala **purgatif** është huazuar nga latinishtja. Ajo është hasur nga fundi i shekullit XIV, në latinisht **purgativus**, nga **purgat-**, dhe pjesorja e shkuar e latinishtes **purgare**. Në frëngjishten e vjetër **purgative**. Përdorimi emëror daton në fillim të shekullit të XV.²⁰⁴

Pasonjës, edhe pse është fjalë shumë e përdorur dhe e përhapur, kemi të bëjmë me një huazim nga latinishtja dhe konkretisht formimi realizohet nga rrënja foljore **pas(-oj)** dhe me prapashtesën **-onjës**. **Pass**, nga fundi i shekullit të XIII, është përdorur si folje kalimtare me kuptimin *të kapërcesh diçka*. Është me origjinë latine dhe më vonë është regjistruar me përdorime të tilla, si: *kalimtar francez, kalimtar italian, kalimtar spanjoll*. Në vitet e mëvonëshme del me kuptim figurative “**to pass**”, që do të thotë “*kaloj kohën*”. Me një kuptim të tillë është shfaqur për herë të parë në shekullin XIV. Më vonë, në shekullin e XV, del me kuptimin “**të kalojnë një provim me sukses**”. Ndërsa nga vitet 1865-1869 është përdorur në sport “**të pasosh topin**”, dhe në lojën me letra në poker “**pas**”, kur personi nuk hedh letrën, por ia kalon veprimin shokut. Në vitet 1175-1225 fjala **pass** paraqitet si folje në anglishten e Mesjetës “**passen**”, ndërsa në frëngjishten e vjetër “**passer**”, të prejardhura nga latinishtja.

Passāre, vjen nga latinishtia “**passus**”. Si emër, në frëngjishten e Mesjetës, është forma **passé**.²⁰⁵ Noli, pasi përdor shumë përftesa për fuqizimin shprehës të fjalës, shfrytëzon përdorimin e huazimeve për ta pasuruar leksikun e veprës. Disa shembuj të tjerë të huazimeve të përdorur në veprën e tij.

Luxurious, avaricious, false, deceitful. [Sh:304]

Avaricjen e pangopur. [N:119]

²⁰³ Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper
<http://dictionary.reference.com/browse/suspect>

²⁰⁴ Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper <http://dictionary.reference.com/browse/>

²⁰⁵ Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper

Fjala **avaricjen** do të thotë kopraci, lakmi. Origjina e fjalës “**avaricjen**” daton të jetë përdorur për herë të parë në vitin 1300 në latinisht, në formën e emrit **avaritia**, “*lakmisë*”. Mendohet të ketë ardhur nga mbiemri **avarus** “*i babëzitur*”, si formë mbiemërore e foljes **avere**, “*vdes*”, në frëngjishten e vjetër gjithashtu ka kuptimin *lakmia*, *lakmitë*. Është huazim i plotë nga latinishtja,²⁰⁶ të cilin Noli e ka marrë nga anglishtja, duke ia përshtatur rregullave të gjuhës shqipe.

Be not a niggard of your speech. [Sh:305]

Mos ji avar në fjalët. [N:126]

Fjala **avar** nuk përdoret më. Origjina është e njëjtë me fjalën e sipërpërmendur **avaricjen**, d.m.th **avare**. Fjala e dhënë në anglisht përkthehet *kursej*.

4.7.2 Fjalë të huazuara mbiemërore

Duke u përpjekur për t’i asimiluar sa më shumë fjalët e huaja, për t’ia përshtatur si strukturës fonetike ashtu dhe asaj morfemore të shqipes, në mënyrë që të ngjajnë si fjalë vendi, Noli që në shkrimet e para provoi që shumë fjalëve të huazuara prej tij t’u japë pamje, si të themi shqip.²⁰⁷

Ndër huazimet mbiemra, për nga numri, vendin e parë e zenë fjalët që kanë ruajtur pak a shumë edhe në shqipe trajtën e origjinalit.

Në vend të dytë do të vinin mbiemrat prejpjesorë formuar prej foljesh kryesisht të pahuazuara. Me fjalë të tjera, autori ka huajtur një mbiemër, duke e paisur me fundjen e **pjesores**, sikur të ekzistonte dhe folja gjegjëse në shqipe ose së paku në shkrimet e tij si p.sh: i allarmuar, i datuar, i mallkuar etj.²⁰⁸

Në ligjërimin e Nolit te Makbethi gjejmë shumë huazime mbiemërore.

For where there is advantage to be given. [Sh:308]

Rasje të favortë. [N:145]

²⁰⁶ Online Etymology Dictionary, Retrieved August 03, 2015, from Dictionary.com website: <http://dictionary.reference.com/browse/avaricjen>

²⁰⁷ F. Agalliu *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f.86.

²⁰⁸ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 89.

Neither beg your favours [Sh:286]

*S'ju lyp **favor**. [N:21]*

Fjala e huazuar është **favor**. Nëse do të studiojmë origjinën e fjalës **favor** do ta kemi të regjistruar në fjalor në vitin 1300, me rrënjën nga latinishtja “**favorem**” në rasën kallëzore. Shpjegimi i “**favor**” është “*dëshirë e mire*”, si dhe *tërheqje, bukuri, sharm*. Në frëngjishten e vjetër është regjistruar fjala **favor**, me kuptimin “*trajtim*”. Po në frëngjishten e vjetër, në vitin 1600, kemi evoluimin e fjalës, e cila merr dhe një kuptim tjetër, *aprovim*.

Ndërsa në frëngjishten moderne fjala del në formën “**faveur**”. Mendojmë se Noli për përdorimin e kësaj fjale është influencuar nga anglishtja, e cila e ka huazuar vetë fjalën, ose direkt nga latinishtja ose nga frëngjishtja.²⁰⁹ Ndërsa te shembulli i mëposhtëm fjala **favorite** shenjon një person apo një objekt i trajtuar me një preferencë të veçantë.

Like valour's minion carved out his passage. [Sh:284]

*Si **favorit** i perëndis' së luftës. [N:14]*

Kuptimi është i preferuari.

Fjalën **favorit** në vitin 1580 e gjejmë në frëngjishten e Mesjetës. Origjinën duhet ta ketë nga forma kallëzore e latinishtes **favorem** me kuptimin “*mbështetje*”. Kjo ka të bëjë veçanërisht me një person që ka një influence dominuese superiore. Fjala shfaqet në fjalor si emër në vitet 1590. Si mbiemër është hasur nga viti 1711. Në përdorim figurativ del në vitin 1788, *djali im i preferuar* = **djali favorit**. Në latinisht si mbiemër ishte **fautor**, në frëngjishten e vjetër “**fauteur**”, Në anglishten e Mesjetës **fautour**, e cila daton të jetë përdorur për herë të parë në fillim të shekullit XIV.²¹⁰

How monstrous it was. [Sh:299]

*Punë **monstruoze**. [N:95]*

Fjala **monstruoze** vjen nga latinishtja, “**monstruosus**”, “**mōnstrōsus**”, i çuditshmi, i panatyrshëm, **monstruoze**, i përbindshëm, i shëmtuar. Po ashtu në vitet 1350-1400 në anglishten e Mesjetës **mōnstrōsus** ka kuptimin “*e tmerrshme, gjigande*”.²¹¹

*Most **sacrilegious** murder. [Sh:293]*

²⁰⁹ Internet. Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper

²¹⁰ Internet. Etymology Dictionary, © 2010. Douglas Harper

²¹¹Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper Dictionary.com
website: <http://dictionary.reference.com/browse/faca>

Vrasja sakrilege. [N:58]

Në anglishten e Mesjetës kjo fjalë shfaqet për herë të parë në vitet 1275-1325. Është përdorur në frëngjishten e vjetër të prejardhur nga latinishtja **sacrilegium**, ekuivalente me **sacri**. Më pas dallohet forma e kombinuar me **sacrum** që do të thotë “vend i shenjtë”, dhe **leg(ere)** që do të thotë “vjedh”.²¹² Noli e ka huazuar fjalën direkt nga anglishtja duke ia përshtatur rregullave të gjuhës së sotme shqipe. Fjala e huazuar e përdorur prej Nolit merr një tingëllim amtar, sepse ajo u nënshtrohet rregullave gramatikore-stilistikore të gjuhës shqipe. Këto huazime mbiemërore i japin ligjërimin një bukuri e një forcë të re, sepse mbiemrat dallohen për forcën e veçantë cilësuese.

4.7.3 Fjalë të huazuara foljore

Huazimet, ashtu si shtresat e tjera, p.sh. dialektalizmat, i nënshtrohen kështu një vlerësimi shoqëror e kulturor, prej të cilit mbeten ngjyrimet stilistike në leksik dhe, rrjedhimisht mund të shfrytëzohen po për ato synime dhe me po ato përftesa shprehëse.²¹³

Foljet e huazuara nga Noli, të cilat janë sipas veçorive të tyre formale, përfshihen në një nga zgjedhimet e njohura të gjuhës sonë.²¹⁴

Në tekstin e përkthimit të “Makbethit” nuk mungojnë huazime të tilla foljore.

Have banish'd me from Scotland. [Sh:304]

Më syrgjynosë fare nga Skotlanda. [N:121]

Folja më syrgjynosë është e barazvlefshme me foljen më larguan. Kjo është një folje e huazuar direkt nga turqishtja.

Blaspheme. [Sh:304]

Munxuros. [N:121]

Fjala **munxuros** është e huazuar nga turqishtja.

My noble partner, you greet with present grace and great prediction. [Sh:286]

²¹²Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper
<http://dictionary.reference.com/browse/sacrilege>

²¹³ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 114.

²¹⁴ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 84

*Tim shok bujar këtu e **salutoni** me hir të shpejtm' e profeti të madhe. [N:21]*

Salutoni këtu ka kuptimin “përshëndeteni”. Por është tepër interesant rrugëtimi i kësaj fjale me kuptimet përkatëse, nga koha në kohë, nga gjuha në gjuhë. **Salute** është me origjinë latine, **salūt**, kuptimi primar i së cilës është **puthje**. Në vitet 1350-1400 në latinisht **salūtāre** “të përshëndetësh”, si derivat i **salūt** i latinishtes. Në anglishten e Mesjetës dhe në frëngjishten e vjetër kemi të regjistruar fjalën **salute**, e cila më vonë shfaqet me kuptimin **përshëndetje**.

Ndërsa në ushtri, si shenjë respekti, regjistruar nga vitet 1580, ishte ngritja e dorës deri te kapelja, kur kalon pranë një oficeri të lartë. Më pas është regjistruar më 1832 në gjuhën e flotës ushtarake detare dhe ka të bëjë me ngritjen e flamujve etj.²¹⁵

Është shumë e qartë se Noli ia ka përshtatur fjalën gjuhës shqipe sipas rregullave të saj.

That very frankly he confess'd his treasons. [Sh:287]

***Konfeso**i të gjitha tradhësitë **frankërisht**. [N:28]*

Të dyja këto fjalë **konfeso**i dhe **frankërisht** janë me origjinë latine, **confessus**. Noli i ka përdorur këto fjalë duke ia përshtatur gjuhës shqipe me anë të prapashtesës **-o**; mbaresës **-i**. Tema prodhuese është **confess**, që do të thotë **pranoj**. Kjo fjalë për herë të parë është regjistruar në vitet 1300-1350, në latinisht **confessus**, me vonë në latinishten e Mesjetës **confessāre** dhe pjesorja **confitēri**, pra nga **confess**, **pranoj**. Në anglishten e Mesjetës “**confessen**”, ndërsa në frëngjishten e vjetër **confesser**. Në frëngjishten e vjetër përdorej forma **confesserne** që do të thotë **pranoj**, **flas**, **tregoj**, **them**. Ajo gjendet dhe në anglishten e vjetër, po me atë kuptim: **pranoj**, **tregoj**, **them**. Ndërsa **confessor** është emër. Në anglishten e vjetër përdorej për një person, i cili pranonte besimin e tij fetar, veçanërisht në situata rreziku.

Mendohet se për këtë arsye mbreti i fundit anglo-sakson u quajt Edward, **the Confessor** që jetoi në vitet 1003-1066, i cili u shenjtërua më 1161, sepse **Confessor** e dallonte nga mbretërit e tjerë apo shenjtorët anglo-saksonë. Ai do të pranonte besimin e tij fetar, pavarësisht nga persekutimi apo rreziku që mund t'i kanosej. Në frëngjishten e vjetër **Confessor** ka patur kuptim figurativ, **të lëndosh**, **të dëmtosh**, **t'i bësh keq dikujt**.

Confessed është mbiemër nga "self-acknowledged," që do të thotë **i vetëdijshëm**, e përdorur në vitin 1560 është regjistruar si pjesorja e shkuar **confess**, jo vetëm si folje, por edhe në

²¹⁵Internet: Online Etymology Dictionary, © 2010, Douglas Harper Internet.
<http://dictionary.reference.com/browse/salutoni>

funksionin e mbiemrit. Në shekullin e X është regjistruar në latinisht “*confessionem*”, *confession*, *pranim*. Nga fundi i shek. XIV në frëngjishten e vjetër, fjala *confession* është përdorur si emër me kuptimin akti i *pranimit* të besimit fetar.

Në drejtësi është përdorur me kuptimin *e drejta*. Kjo fjalë është përdorur në anglishten e vjetër nga mesi i shek XV. Në latinishten e Mesjetës *confessionale* është vendi ku prifti qëndron për të dëgjuar personat që pranonin mëkatet e tyre. Në gjuhën angleze në vitin 1727 *confessional* është përdorur me të njëjtin kuptim. Një përdorim të tillë në të njëjtën periudhë e shohim të regjistruar edhe në frëngjisht *confessional*, si emër të prejardhur nga latinishtja e Mesjetës, *confessare*.²¹⁶

4.7.4 Fjalë të huazuara ndajfoljore

Në letërsinë artistike dhe në publicistike dalin jo vetëm fjalë të huazuara, por edhe citime të drejtpërdrejta prej gjuhëve të huaja, që nga fjala e deri te tekste të plota. Kjo është përftesë e zakonshme për të dhënë mjedisin e huaj ose për vërtetësi të folurit të personazhit²¹⁷. Mendojmë se duke dhënë fjalë të huazuara tek shqipërimi i Makbethi, Noli na sjell më pranë periudhës kur është shkruar kjo tragjedi.

Huazimet e Nolit janë jo vetëm emërore, mbiemërore, foljore por gjithashtu edhe ndajfoljore.

*That very **frankly** he confess'd his treasons. [Sh:287]*

*I konfeso i të gjitha tradhësitë **frankërisht**. [N:28]*

Fjala *frankërisht* është e huazuar, por i është përshtatur gjuhës shqipe me prapashtesën *-risht*, që është karakteristikë e fjalëformimeve dhe krijimeve të Nolit në veprat dhe përkthimet e tij. *Frank* është përdorur si mbiemër në shekullin XII, në latinisht *francus* që do të thotë i *lirë*, *njeri i lirë*. Në frëngjishten e vjetër, në vitin 1300, përdorej me kuptimin i *lirë*, *liberal*, *bujar*. Në vitin 1540 në frëngjishten e vjetër *franc* përdorej me kuptimin jo vetëm i *lirë*, por edhe me kuptime të tjera, si: *jo servil*, *i sinqertë*, *i hapur*, *i hijshëm*, *me vlerë*.

²¹⁶ Internet. <http://dictionary.reference.com/browse/confess>

²¹⁷ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 115.

Në shekullin e III të erës sonë ka qenë një fis gjerman, banorët e të cilit quheshin “**Salian Franks**”, të vendosur në Rinin e poshtëm, të cilët në vitin 500 të erës sonë sulmuan dhe mundën keltët-romakët në veri të Gaulcikut. Pjesërisht nga vendodhja dhe pjesërisht nga gjuha u zhvillua **Franca**, të cilën e hasim dhe në frëngjishten moderne. Në anglishten e vjetër, **franc**, **franca** do të thotë *njeri i lirë, i ndershëm, francez*. Më pas është regjistruar fjala **frankish** nga **francus** me origjinë latine. Gjithashtu thuhet se si emër njeriu, **Frank**, e shohim të përdoret nga spanjollët, italianët dhe gjermanët, **Franko**. Origjina e emrit etnik është e paqartë.²¹⁸

Tek fjala **frankërisht** Noli ka marrë rrënjën **frank**, e cila është folje dhe mbiemër në origjinal në gjuhën angleze dhe ia ka përshtatur gjuhës shqipe duke e përdorur si ndajfolje, të prejdardhur nga mbiemri me prapashtesën **-isht**

4.8 Huazim-shkurtime

Në procesin e komunikimit fjalë ose grupe fjalësh mund të shkurtohen. Shkurtime gjithmonë kanë qenë një lloj i përgjithshëm i krijimit të pseudo-huazimeve. Fenomeni i përvetësimit të huazimeve ndodh i plotë ose me shkurtime, ashtu siç është në origjinal. Në gjuhët e sotme moderne ndodhin shumë shkurtime, si pasojë e informacionit të ri që merret dhe kohës tej mase të shkurtër në të cilin ky transmetim duhet të jepet. Këto shkurtime nënkuptojnë shkurtime të pjesëve të fjalëve, p.sh. telefon, **fon** ose **tel**. Por, në shkurtime mund të merren edhe gerrat e para të një grupi fjalësh, p.sh. në anglisht **MP** është shkurtimi i “**member of parliament**”, d.m.th anëtar parlamenti. Mendohet se ka pasur më shumë shkurtime në gjuhën franceze se në gjuhën angleze (**fac**, =fakultet, **philo**= filozofi, **sympa**= miqësore, **huma**= njerëzore, **copter**=polic, **uni**=të bashkuar, **fab**=përrallore, prodhuese, **video**=vidio).

Sipas Peter Newmark ” kemi shkurtime gjeografike, të cilat quhen *acronyms*, **USA**, **UK**, **UE**, etj. Faktikisht këto shkurtime ndodhin vetëm në të shkruar, sepse në formën bisedimore ato shqiptohen të plota. Por çdo gjë është e lidhur ngushtë me kontekstin, sepse i njëjti shkurtime mund të ketë kuptime të ndryshme në kontekste dhe në situata të ndryshme, p.sh. në gjuhën angleze **p.m.** mund të ketë kuptim *post meridiem* (mbasdite) ose *post mortem* (pas vdekjes).

²¹⁸Internet. <http://dictionary.reference.com/browse/franc>

Shkurtime mund të ketë për ditët e javës, emrat e shteteve, adresat, diplomat shkencore, si: **BA** (doktor i mjeksisë), **MA** (master i arteve). Po kështu edhe për gradat e ushtrisë.²¹⁹

Ka tre lloje shkurtimesh me germat e para të fjalëve: 1. Germat e para sipas leximit alfabetik si **UK**, [jukei], d.m.th gërmëzohen sipas gërmave të Alfabetit 2. Ato mund të lexohen si një fjalë e vetme, p.sh. **Nato** [neiteu] etj. 3. Kur ato janë shkurtime shprehjesh quhen *akronime*. Edhe këto mund të lexohen si një fjalë e vetme, p.sh. **scuba** në gjuhën angleze është shkurtimi i fjalëve (*self contained underwater breathing apparatus*). Scuba lexohet si një fjalë e vetme (skju:bə),²²⁰

Pra, të gjitha këto shkurtime rroken si neologjizma të huazuara, d.m.th njësi leksikore të reja. Si rregull përemrat nuk shkurtohen. Kur një fjalë është e gjatë dhe pjesa e parë mbart kuptimin kryesor atëherë kemi shkurtimin e fjalës duke përdorur vetëm pjesën e parë, p.sh. **Disco** (*dicothèque*), **Coke** (*coca-cola*) etj. Faktikisht Neologjizma të kësaj kategorie nuk ndeshen te “Makbethi” i përkthyer nga Noli. Ne mendojmë se të tilla neologjizma dhe huazime janë më të reja në kohë në krahasim me periudhën kur Noli përktheu “Makbethin”.

Funksionet stilistike të huazimeve kanë të bëjnë me ngjyrimet lokale, historike; përdoren për të karakterizuar personazhe apo për të shprehur nocione në mënyrë që të realizojnë në ligjërime njësi me ngjyrimet emocionale e shprehëse. Huazimet shfaqin gjithnjë efektin evokues, si dhe funksionet stilistike që ato prodhojnë. Ndaj themi se fjalët e huaja janë elemente të spikatura e që bien menjëherë në sy në thëniet e hartuara në gjuhën amtare. Huazimet dhe fjalët e huaja krijojnë një mjedis nacional tjetër që lidhet me një vend e me një popull tjetër; përdoren rëndom për të karakterizuar personazhet etj.

“Nga një përjasje me fjalorin e gjuhës letrare të dhjetëvjeçarëve të fundit, para nismës së organizuar për pastrimim e saj nga elementet e huaja, na del që rreth 300 fjalë nga këto kanë mbijetuar deri vonë në gjuhën letrare dhe një pjesë jo e vogël e tyre, duke qenë ndërkombëtare ose duke u rrënjësuar, kanë zënë vend të qëndrueshëm. Në këtë vështrim, po të lemë mënjatë teprimet, Noli dha një ndihmesë të shënueshme për pasurimin e fjalorit të shqipes edhe me elemente të huazuara”²²¹

²¹⁹ P. Newmak, *A Textbook of Translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f.101.

²²⁰ P. Newmak, *A Textbook of Translation*, Prentice Hall Europe, 1988, f.101-102.

²²¹ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 90.

Si përfundim sasia e bollshme e fjalëve të huaja sipas Agalliut flet jo vetëm për kulturën e gjerë gjuhësore të shkrimtarit, që është dhe përkthyes, por edhe për punën e tij serioze me leksikun, për atë që fjalët e huazuara luajnë një rol shumë të rëndësishëm në letërsinë artistike. Duke rikujtuar një kohë tjetër, siç është periudha në të cilën Shekspiri shkroi tragjedinë e “Makbethit”, huazimet e përdorura nga Noli e paraqesin atë kohë me koloritin e nevojshëm e me pamje të vërtetë.²²²

Mendojmë se ka të bëjë studimi dhe jeta e tij jashtë Shqipërisë që ndikuan në përdorimin e shumtë të leksikut të huazuar.

4.9 Arkaizmat, si shtresë e vjetër e leksikut të përdorur në përkthimin e “Makbethit”

Noli me zgjedhjen e me përdorimin e arkaizmave të krijon idenë se rëndësia e një rrëfimi nuk ka të bëjë vetëm me gjuhën kontemporane, por edhe me arkaizmat e përdorura nga përkthyesi për të paraqitur sa më mirë ngjarjet dhe situatat. Arkaizmat i shtojnë informacionit diçka të re plot ngjyrimë dhe e bëjnë atë autentik e tërheqës.

Kur vjetërohen vetëm fjalët e jo nocionet e kur këto fjalë zëvendësohen me njësi të tjera leksikore kemi të bëjmë me **arkaizma**.²²³ Termi arkaizëm vjen nga “arkaik”, që i përket një kohe shumë të vjetër e të lashtë, që ka dalë nga përdorimi, që është e vjetruar.²²⁴ Fjala arkaizëm është përdorur për herë të parë në mes të shekullit të XVII nga latinishtja moderne **archaismus**, që rridhte nga greqishtja, **arkhaismos**, që do të thotë *i vjetër, i lashtë*. Përdorimi *i lashtë* në greqisht ishte **arkhaïos**. Më vonë, po në greqisht, në vitet 1825-1835 përdoret **archaïkós- arkhaïkos**, me kuptimin **antik, i(e) vjetër**.²²⁵

Arkaizmat kanë vlera stilistike të theksuara. Ato kontrastojnë me normën e sotme gjuhësore, me barazvlerat e tyre të gjuhës së sotme. Ky kontrast bën që përdorimi i arkaizmave ta ndryshojë

²²² F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 90.

²²³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, f.42.

²²⁴ *Fjalori i Shqipes së Sotme*, Tiranë, 2002, f. 52.

²²⁵ <http://dictionary.reference.com/browse/arkhaikos>

kursin dhe nuancat e ligjëritimit. Arkaizmat, veç konotacioneve që lidhen me kohën, me mentalitetet njerëzore e me praktikat e ndryshme, bartin emocione të ndryshme, të cilat lidhen me vjetërsinë dhe kuptimin e tyre. Prania e këtyre elementeve të vjetruara bën që thënia dhe konteksti të shkaktojnë reagime emocionale²²⁶.

Përdorimi i arkaizmave në përkthimin e “Makbethit” ndihmon për të paraqitur një atmosferë arkaike, një mjedis arkaik. Arkaizmat zënë një vend të rëndësishëm në veprën e Nolit.

Megjithë prirjen e autorit për të përdorur leksikun normativ të gjuhës së sotme ai u bën vend në fjalorin e tij dhe arkaizmave që kryejnë funksione të caktuara. Shkrimtari i zgjedh dhe i përdor ato me kulturë dhe art. Janë pikërisht arkaizmat e përdorura me aq mjeshtri nga Noli që na japin në mënyrë autentike atmosferën e shekullit XV-XVI. Në disa raste arkaizmat mund të përdoren për t’i dhënë informacionit ngjyrim emocional-shprehës. Një punë të tillë e kryejnë ato njësi të vjetruara që kanë vetë në përmbajtjen e tyre ngjyrim emocionale.²²⁷

Në leksikun e Fan Nolit arkaizmat përbëjnë një grup të mirë fjalësh, të cilat lidhen edhe me historizmat.

Ndarja e shtresës së vjetruar në arkaizma e historizma është mbështetur në ndarjen që bëhet në tekstin e leksikologjisë së gjuhës shqipe.²²⁸ Ndodh që të paraqiten skena tronditëse, momente dramash e konfliktesh, gjendje shpirtërore të ndërlidhura dhe prania e ndonje fjale arkaike e çdramatizon situatën.

Sasia e arkaizmave të përdorura nga Noli në krijimet dhe në përkthimet e tij janë të ndryshme në vepra të ndryshme, p.sh. te “Makbethi” ka shumë arkaizma. Gjithashtu shpërndarja e tyre është e ndryshme. Në përgjithësi veprat dhe përkthimet e Nolit janë me temë nga e shkuara e largët. Kjo është një nga arsytet që përdoren me shumicë arkaizmat.

Fjalët që vjetrohen për shkaqe të tilla gjuhësore janë arkaizma të mirëfillta. Të tilla janë te përkthimi i Nolit fjalët: **than**, **lartësi**, **lartmadhëri**. Arsyeja kryesore e mospërdorimit të tyre mendojmë se ka të bëjë me faktin se këto fjalë kanë të bëjnë me ekzistencën e familjes mbretërore, gjë që sot është një dukuri e rrallë për leksikun e gjuhës shqipe.

Janë arkaizma edhe disa fjalë të fushës ushtarake që janë zëvendësuar më pas me trajta të tjera, si: **rreshtari**, **kumandari** etj. Arkaizmat paraqesin një larmi ndërtimore. Ato mund të jenë

²²⁶E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998. f.84

²²⁷ E. Sadiku, *Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadaresë*, Tiranë, 1998. f. 85-86.

²²⁸ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, f.45.

fjalë të parme, të prejardhura, të përbëra apo njësi frazeologjike. Në gjuhën shqipe ka edhe kuptime të vjetruara, ku fjala përdoret sot, por një nga kuptimet e saj s'është më i gjallë, si kuptimi **lexoj** për foljen **këndoj**.

Ka raste kur një fjalë arkaike mund të jetë e pakuptimtë dhe si e tillë nuk mund të përdoret e shkëputur më vete, por gjithmonë e shoqëruar me një fjalë tjetër për të plotësuar kuptimin. Kështu, fjala **mylli** (te Noli) nuk kuptohet e veçuar. Por, nëse themi *e nxorri shpatën nga mylli*, atëherë është e qartë dhe perifrazohet lehtëazi. Fjalë të tilla ruhen në shprehje të caktuara.

Arkaizmat, duke u përdorur në ligjërimin e personazheve, ndihmojnë në portretizimin e tyre, japin informacion për formimin dhe për botën e tyre. Noli përdor disa lloje arkaizmash sipas nocioneve që ato shprehin.

4.9.1 Arkaizma që tregojnë tituj

Mahir Domi thotë se Noli ka dhënë ndihmesën për zhvillimin dhe rrënjësimin e gjuhës letrare. Ai shkruan se është një mjeshtër i madh i fjalës shqipe, që bashkë me ndonjë tjetër e tëharri shqipen letrare të variantit jugor, të përpunuar prej Rilindësve të mëdhenj të shekullit të kaluar. Nga elemente e tipare arkaike e ngushtësisht dialektore, nga variante të shumta morfologjike, i dha asaj karakter më të përgjithshëm, më të njësuar, më të stabilizuar, dhe e bëri më të lakueshme e më të kristalizuar.²²⁹

Arkaizmat janë pjesë të visarit të gjuhës sonë. Arkaizmat janë fjalë që janë vjetëruar apo vjetërohen dhe për këtë arsye kanë dalë ose po dalin nga përdorimi, kalojnë nga shtresa aktive në shtresën pasive të leksikut. Arkaizmat kanë dalë nga përdorimi për shkak se kanë dalë fjalë të tjera për të emërtuar po ato objekte, për të shprehur nocione apo dukuri të ndryshme. Arkaizmat e poshtëshënuara tregojnë tituj.

*The **thane** of Cawdor lives, a prosperous gentleman. [Sh:286]*

***Than**'i Kodrit rron e përparon. [N:22]*

²²⁹ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f.31

Në këtë rast fjala *than* tregon të *parin* e fisit, të një zone a krahine. Fjala arkaike është tërësisht e huazuar pa ndonjë përshtatje. Noli e ka përdorur këtë fjalë ashtu siç është në origjinalin e Shekspirit. Kjo fjalë nuk përdoret sot.

Worthy thane. [Sh:286]

I vyer than. [N:24]

Në këtë varg fjala e shtuar *than* shenjon një *prirës*, një *luftëtar*.

Arkaizmat, në leksikun e përdorur dhe në ligjërimin e personazheve, ndihmojnë në portretizimin e personazheve, japin informacion për formimin dhe për botën e tyre.

New hohonours come upon him. [Sh:287]

Ofiq' i ri që ka fituar sot. [N:26]

For those of old, and the late dignities heap'd up to them. [Sh:287]

Si për ofiqet e dhuruara më parë. [N:26]

Fjala **ofiq** është përdorur me kuptimin e titullit. Sot ose nuk përdoret fare ose përdoret me vlerë arkaizmi për t'i dhënë ngjyime të ndryshme ligjërimin.

*Implored your **Highness**' pardon and set forth. [Sh:287]*

Nga lartësia juaj lypi ndjesë. [N:28]

My liege. [Sh:287]

Lartësi. [N:28]

Noli e ka përkthyer këtë fjalë me kuptimin **lartmadhëri**.

Noble Banquo. [Sh:287]

Lartësisë suaj. [N:28]

Elementin **lartësi** e kemi trajtuar si arkaizëm, megjithëse sot nuk përdoret gjerësisht, dhe kur përdoret përmban konotacione të botës së shkuar.²³⁰

Pra, nga analiza vihet re se këto fjalë që tregojnë tituj nuk përdoren më në fjalorin aktiv. Por ato na japin mjedisin kohor të largët.

4.9.2 Arkaizma emërore që shenjojnë individë ose profesione të tyre

Shkaku i arkaizmave pra i vjetërimit të fjalëve është jashtëgjuhësor, dmth. emërtimi i mëparshëm ndihet nga folësi si arkaik dhe zëvendësohet nga një emërtim më i ri. Shkaqet e

²³⁰ *Fjalor i Shqipes Së Sotme*, Toena, Tiranë 2002, f. 654.

daljes së fjalëve jasht përdorimit mund të jenë edhe historike-shoqërore: me zhvillimin e shoqërisë sende dhe objekte të vjetra ose dukuri dhe institucione të vjetra braktisen duke u zëvendësuar nga të reja.²³¹

Disa nga arkaizmat janë përdorur për emërtime individësh sipas pozicionit ose tipareve të tyre.

We rest your hermits. [Sh:289]

*Ju mbeteni **vasalë** mirënjohës. [N:36]*

Në këtë shembull fjala **vasalë** ka kuptimin “*njerëz besnikë*”, që binden. **Vasalë** emërton gjithashtu një feudal që i nënshtrohej mbretit. Duke e humbur sfondin historik, sociokulturor që e lindi, fjala përdoret sot me kuptim të figurshëm. Kuptimi i parë, i mirëfilltë tek ne nuk ekziston më.

Hangman's hands. [Sh:291]

*Duar **xhelati**. [N:50]*

Elementi arkaik “**xhelat**” i jep informacionit tonë emocione të forta. Sot fjala shfaqet vetëm me kuptimin e saj të figurshëm për të emërtuar dhe karakterizuar individë të pashpirtë. Si arkaizma mund të shihen dhe fjalët “kasnec”, “tiran” në shembujt e poshtshënuar.

To be his purveyor: but he rides well. [Sh:289]

*Si **kasnecë**. [N:37]*

Kjo fjalë arkaike e përdorur në këtë ligjërim sot zëvendësohet me fjalën *lajmëtar*.

The tyrant's feast. [Sh:300]

*E **tiranin** s’e nderoi. [N:96]*

Filthy hags! [Sh:301]

*Shtriga, **skrofa**! [N:106]*

Në vitet 1400, në greqisht, fjala **scrofula**,²³² midis shumë kuptimeve të tjera do të thotë *derr i vogël* dhe ne mendojmë se fjala **skrofa**, e përdorur nga Noli, ka këtë kuptim, si dhe *njeri i keq*, duke u nisur nga origjinali i Shekspirit. Kjo fjalë nuk përdoret më dhe është arkaizëm i huazuar. Noli përdor dhe disa emra që shenjojnë profesione, por që sot nuk përdoren.

Here's a farmer, that hanged. [Sh:292]

*Një **dhjetar** që ka varur veten. [N:53]*

²³¹ Rami Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Botimet TOENA, 2006, f.173

²³² Internet. *Etymology dictionary*, 2010.

Dhjetar quhej personi që mblidhte të dhjetat në fshat.²³³

English tailor come hither, for stealing out of. [Sh:292]

Një sofist i shenjtëruar. [N:53]

Sofist ka kuptimin *rrobaqepës*. Ndërsa në shembullin e mëposhtëm kemi të pranishëm arkaizmin *paflatar*.

Poor prattler, how thou talk'st. [Sh:303]

*Qysh flet, mor **paflatar** i mjerë [N:113]*

Paflatar ka kuptimin llafazan. Kjo fjalë nuk përdoret në trojet shqipfolëse. Ne mendojmë se Noli e ka huazuar fjalën nga Shekspiri dhe e ka përdorur atë si fjalë të huaj me disa ndryshime duke ia përshtatur rregullave të gjuhës shqipe. Arkaizmat në disa raste përdoren për të dhënë informacione plotësuese. Duke u përdorur në ligjërimin e personazheve, arkaizmat ndihmojnë në portretizimin e tyre, sigurojnë një informacion mbi formimin dhe botën e tyre.

4.9.3 Arkaizma që paraqesin nocione të ndryshme

Arkaizmat në ligjërimin e Fan Nolit kryejnë funksione të ndryshme. Ato paraqesin epoka historike, mjedise të së shkuarës për t'u dhënë ngjarjeve ngjyrimin e nevojshëm kohor.

A desert place. [Sh:284]

Një yrt, i shkretë. [N:11]

Në këtë varg fjala **yrt** do të thotë *vend*. Kjo fjalë nuk gjendet në “Fjalorin e Sotëm të Gjuhës Shqipe, 2002”, ndaj mendohet të jetë arkaizëm.

The blanket of the dark. [Sh:288]

***Kurtinën** ngjyrëpus. [N:34]*

Fjala **kurtinë** sot është e panjohur për shumicën e shqiptarëve. Këtu ka kuptimin *kupë qiellore*.

Tiger's chaudron. [Sh:300]

*Gurmaz **kapllani**. [N:100]*

Kapllan do të thotë *tigër*. Kjo fjalë përdorej e tillë në përrallat popullore. Po ashtu fjala **Chaplain**, origjina e së cilës është nga gjermanishtja *chaplain*, përdorej me kuptimin *prift*. Në

²³³ *Fjalor i Shqipes së Sotme*, Toena, Tiranë, 2002, f. 287.

gjuhën hungareze përdoret gjithashtu me kuptimin *prift*. Kjo fjalë është gjithashtu mbiemër njeriu dhe gjendet e përdorur në Izrael, p.sh. Elezer Kaplan²³⁴, a kuptimin ministër i financës në Izrael. Në gjuhën shqipe **Kapllani** përdoret si mbiemër dhe mendojmë se e ka origjinën nga gjermanishtja.

Whose horrid image doth unfix my hair. [Sh:287]

*Pse **kor'** e saj e tmerrtë m'i ngre qimet? [N:26]*

Në këtë rast fjala **kor'** do të thotë pamje, imazh, ikone. Është momenti që Makbethi don të realizojë ëndrrën e magjistrice, të bëhet mbret.

For ruin's wasteful entrance: there, the murderers. [Sh:293]

*Për hyrjen e **rovinës** shthurëse. [N:61]*

Duke u nisur nga anglishtja, mendojmë që fjala *rovinë* ka kuptimin *e ligë, e dobësuar, e tretur nga sëmundja*.

Hand in hand, hand in hand. [Sh:285]

*dor' për dore **ziruni**. [N:19]*

Në këtë rast kuptimi i vargut është: kapuni dorë për dore. Fjala **ziruni** është formë arkaike. Në ditët e sotme kjo fjalë ka edhe një kuptim tjetër, *grindemi*.

I would applaud thee to the very echo. [Sh:308]

*Do t'të **dorëtrokisja** gjer në qiell. [N:143]*

Dorëtrokisja mendohet si formë arkaike, që sot përdoret **duartrokas**. Noli ka përdorur numrin njëjës në vend të shumës, sepse veprimi është me të dyja duart dhe jo **dorëtrokas**.

Where men may read strange matters. [Sh:288]

***Ku këndohen** gjëra të çudiçime. [N:34]*

Folja **këndohen** del si formë arkaike, e cila është përdorur me kuptimin *lexohen*. Është për t'u theksuar se edhe në vitet 1980 fjala *këndim* ishte shumë e përdorshme. Madje dhe në kurrikulën e shkollave thuhej se një nga lëndët ishte **Këndimi**, i cili sot është zëvendësuar me **lexim, gjuhë** në ciklin e parë pesëvjeçar, dhe në klasat më të larta përdoret **letërsi**.

I' the shipman's card. [Sh:285]

²³⁴ <https://en.wikipedia.org/wiki/Kaplan/surname>

Kart. [N:19]

Në këtë varg fjala **Kart** del me kuptimin *hartë*, pra ka përdorim arkaik, ndërsa sot ka kuptime të tjera të përgjithshme, *letër*, karta e identitetit, karta shëndetësore etj.

Stars, *hide your fires.* [Sh:287]

Yj, *u shuani.* [N:30]

Në këtë rast kemi përdorimin **yj** e jo **yje**. Këto përdorime janë forma arkaike.

Norweyan lord surveying vantage. [Sh:284]

Që përgjonte rasjen. [N:14]

Rasje në fjalinë e sipërpërmendur do të thotë *rastin*. Në këtë shembull **rasjen** është formë dialektore-arkaike.

He brings great news. [Sh:288]

Solli lajmën [N:33]

Në këtë rast kemi përdorimin e mbaresës **-ën**, e cila paraqet formë të vjetëruar në rasën kallëzore. Ajo është formë arkaike. Kjo formë përkon me formën e vjetër të shumësit në gjuhën angleze siç është **children, brethren** etj.

4.9.4 Arkaizma mbiemërore

Fjalët e poshtëshënuara janë mbiemra arkaikë. Në ligjërim arkaizmat e poshtëpërmendura ndihmojnë në portretizimin e personazheve, duke na dhënë informacion të mjaftueshëm për formimin dhe botën e tyre të brendshme. Ndodh që fjala mund të përdoret edhe sot, por një nga kuptimet nuk është më i gjallë, pra nuk ekziston më. Ka dhe raste kur një fjalë arkaike mund të jetë pa kuptim sot, dhe si e tillë nuk mund të përdoret vetëm, por gjithmonë e shoqëruar me një fjalë tjetër për të plotësuar kuptimin.

The close contriver of all harms. [Sh:299]

... dhe zonjën yshtëse të llahtarive. [N:94]

No boasting like a fool. [Sh:302]

S'ka më mburrje prej trullaku. [N:108]

Arkaizmat, në pak raste, përdoren për t'i dhënë informacionit ngjyrimë emocionale-shprehëse. Një punë të tillë e kryejnë ato njësi të vjetruara që kanë në përmbajtjen e tyre ngjyrimë emocionale.

Blaspheming Jew. [Sh:300]

T'yshtur prej shafrani. [N:99]

Shprehja emërton emocione negative.

Lechery, sir, it provokes, and unprovokes. [Sh:292]

...harvalerinë o zot, e provokon dhe e shprovokon [N:55]

Kuptimi i fjalës arkaike të sipërpermendur është të mendosh vetëm për seks. Sot nuk njihet kjo fjalë. Fjalët arkaike mund të përdoren për të shprehur nocione të veçanta për ligjërimin, momente të konflikteve dramatike të lidhura me gjendjen shpirtërore etj.

Arkaizmat nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës standarde. Ato në letërsi përdoren me vlera stilistike të veçanta. Kështu, historizmat, sidomos arkaizmat gjuhësore, përdoren nga Noli për t'i dhënë ngjyrim historik dhe arkaik periudhës që përshkruan në veprat e tij origjinale apo në përkthimet e veprave klasike.²³⁵

Si përfundim fjalët arkaike të Nolit mund të shenjojnë *tituj*, mund të jenë *emra njerëzish*, *emra profesionesh* dhe *objektesh*, mund të shprehin lloje të ndryshme nocionesh, shenjojnë përshkrime aktivitetesh etj.

Qëllimi kryesor i përdorimit të këtij leksiku arkaik është paraqitja me vërtetësi e periudhave kohore, e njerëzve, mentaliteteve dhe psikologjive në rrjedhë kohore.²³⁶ Përdorimi i neologjizmave, huazimeve dhe i arkaizmave nga Noli i shtojnë informacionit diçka të re plot ngjyrim dhe figuracion, duke e bërë punimin autentik dhe tërheqës.

²³⁵ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 108.

²³⁶ Xh. Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1987, f. 107-110..

KAPITULLI V

FIGURACIONI

5.1 Termi figurë

Figurë është realizimi artistik që mishëron veçori tipike të jetës shoqërore që arrihet me anë të një sistemi mjetesish lëndore gjuhësore dhe ndërtimore; fjalë a shprehje e përdorur me kuptim të tërthortë për të shprehur një ide, ndjenjë etj., e cila i jep ligjërimin gjallëri të veçantë.²³⁷

Noli i përdor në veprat dhe në shqipërimin e tij në mënyrë të shkëlqyer figurat artistike. Me anë të figuracionit Noli mishëron anët e veçanta, thelbësore të fenomeneve të ndryshme apo të personazheve të tij. Në stilistikën franceze termi *figure* përdoret për të shënuar një dukuri, si përsëritja, shkallëzimi, antiteza, pyetja retorike dhe ndërtimet paralele.²³⁸ Pra, është e afërt në kuptimin e termi figurë stilistike. Për ta sistemuar dukurinë e lidhjeve kuptimore të fjalëve me fjalë të tjera, retorika ose stilistika tradicionale ka përpunuar nocionin e bartjes së kuptimeve ose të tropeve, të figurave të fjalëve.

Tropet nuk janë dukuri të kuptimit të fjalës së veçuar, por të lidhjes së fjalëve. Me këtë vështrim rrënjësisht të ndryshëm figurat i nënshtrohen një studimi të mirëfilltë gjuhësor dhe ngushtohet trajtimi i lirë asociativ e sidomos jashtëgjuhësor. Figurat përftohen në stilemë që ngërthen një proces të brendshëm, një përftesë. Fjalët zhvendosen nga kuptimet e zakonshme bashkë me lidhjet dhe marrin një kuptim tjetër brenda lidhjes së re. Kur kjo zhvendosje përsëritet, ngulitet, përgjithësohet atëhere kthehet në dukuri leksikore, si aspekt i sistemit leksikor dhe tropeve si stilema individuale të autorit.²³⁹

Dallimi i parë i rëndësishëm është ndërmjet figurave leksikore, si aspekt i sistemit leksikor dhe tropeve si stilema individuale të autorit. Kuptimet e figurshme të fjalëve që studiohen nga leksikologjia janë stilema të fshira, të shuara. Kemi të njëjtën dukuri si marrëdhëniet e frazeologjisë gjuhësore me stilemat. Etimologjia e një kuptimi të figurshëm do të jetë një stilemë

²³⁷ Fjalor i Shqipes së Sotme, Toena, Botimi 2, 2002, f. 330.

²³⁸ E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f. 80.

²³⁹ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f. 139.

me përfitesën e saj, prandaj përfitesat shprehëse me kuptimet e figurshme janë të ngjashme me ato si të idiomave, si p.sh: *Binte shiu me litarë ose binte shiu litar*”.²⁴⁰

Figurshmëria nuk ka të bëjë me synimet estetike letrare, por përbën një nga format e shfaqjes së ngjyimeve subjektive dhe të prirjes për theksim, përforsim. Figurshmëria nisët nga ajo që është konkrete dhe pjesë e jetës tradicionale, që bie në sy dhe ndikon në përfytyrim. Pra, janë figura të ndijimeve. Te vargu i figurave bën pjesë edhe metafora, mbi bazën e identifikimit, p.sh: *e ka kokën gur*.²⁴¹

Siç shkruan Lloshi, studimet dëshmojnë se të menduarit figurativ është një mënyrë e vështirimit të botës, që përshkon sfera të mëdha, prandaj *metafora dhe metonimia* trajtohen tashmë në teoritë e nivelit filozofik e njohjes. Paraqitja e figurshme është një mënyrë ndijimi edhe një qëndrim e vlerësim emocional, estetik.

Figurshmëria është një rrugë e veçantë për përvetësimin artistik të botës, një modelim specifik i saj në të cilin dukuritë materiale e njerëzore zbulojnë reciprokisht vetitë e tyre përmes një prizmi të ri, duke na u zbuluar në mënyrë të papritur, të çuditshme, por shpesh duke na dhënë një njohje e përjetim më të thellë se zakonisht. Figurat ndërthuren dhe mund të përbëjnë tabllo të tëra në të cilat është e nevojshme të studjohet tashmë struktura e figurës e jo thjeshtë kuptimi i saj.²⁴²

Një tipar i rëndësishëm në stilistikë ka qenë interesi i saj në mënyrën se si ne transferojmë konstruktet mendore në një tjetër, veçanërisht kur ne lexojmë tekste të ndryshme. Stilistët gjuhësorë dhe poetët i kanë kushtuar vëmendje këtij sistemi të transferimit konceptual në mënyrë të vazhdueshme, si në letërsi ashtu dhe në ligjërimin e përditshëm. Shkrimtarët i përdorin në forma dhe mënyra të ndryshme figurat letrare, d.m.th. mjetet gjuhësore, sipas individualitetit të tyre krijues, sipas gjinive letrare dhe talenteve të tyre në drejtimin artistik, psikologjik, intelektual dhe padyshim emocional.²⁴³

Kur fjalë dhe grupe fjalësh të një gjuhe të zakonit shfaqen në një tekst letrar atëherë ato trajtohen si elemente të gjuhës poetike. Në një tekst letrar këto fjalë dallohen nga ana semantike, sintaksore dhe fonetike. Natyra e tyre i bën ato ndryshe nga të gjitha sekuencat e tjera të tekstit letrar, të cilat pak a shumë dallohen në gjuhën poetike. Këto quhen trope dhe figura

²⁴⁰ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f. 140.

²⁴¹ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f.149-169.

²⁴² Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f.142.

²⁴³ E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f. 80.

gjuhësore. Në letërsi termi figurë është i njëjtë me termin *trop*, që do të thotë përdorimi i fjalëve në mënyrë të figurshme për t'i dhënë ligjërit një fuqi shprehëse më të madhe.²⁴⁴

Tropet dhe figurat letrare janë studiuar në filologji që në shkrimet e para të letërsisë, në kohën e klasicizmit, kur shkrimi u zbulua. Shpesh mendohej se stili në vetvete konsideronte në përdorimin e tij trope+figurë letrare. Tashmë, kur shkruhet sidomos një prozë narrative, roli i disa tipe shprehjesh është zvogëluar dhe të tjerë elementë mbeten kryesorë në tekstet letrare.

Termi *trop* në leksikologjinë e gjuhës shqipe ka të njëjtin kuptim. Lëvizjet kuptimore kanë në bazën e tyre figurat gjuhësore që në stilistikën letrare e në disa gramatika janë quajtur *trope*.²⁴⁵ “*Trop* quhet përdorimi i një fjale jo në kuptimin e saj të veçantë, por me një kuptim që ka të përpyekun e të përngjamë me kuptimin e parë”.²⁴⁶ Kështu për interpretimin e tyre duhet ditur se mjeti më kryesor i rëndësishëm i paraqitur në trope është ajo e analogjisë.

Në këtë mënyrë janë identifikuar dy trope të rëndësishme apo figura letrare, të cilat janë *metafora* dhe *metonimia*, me anën e të cilave nënkuptojmë realizimin artistik, që mishëron veçori tipike të jetës shoqërore që arrihet me anën e një sistemi mjetesish lëndore, gjuhësore dhe ndërtimore, fjalë a shprehje të përdorura me kuptim të tërthortë për të shprehur një ide, një ndjenjë etj., e cila i jep ligjërit gjallëri të veçantë si dhe fuqi shprehëse më të madhe.

Në veprat dhe shqipërimet e Nolit përdoren disa lloje figurash: krahasime figurative, sinektoda, metonimi, metafora etj. Xh Lloshi ka përpunuar nocionin e bartjes së kuptimeve ose të tropeve, të figurave të fjalëve: “Tropet nuk janë dukuri të kuptimit të fjalës së veçantë, por të lidhjes së fjalëve. Figurat i nënshtrohen një studimi të mirëfilltë gjuhësor dhe ngushtohet trajtimi i lirë asociativ e sidomos jashtëgjuhësor. Figurat përftohen në stileme që ngërthen një proces të brendshëm, një përfatesë. Tropet sjellin edhe veçantitë socio-psikologjike e kulturore të një grupi shoqëror ose epoke. Simbolizmi është një rrymë e quajtur sipas një tropi”.²⁴⁷

Ndërsa për Fatmir Agalliun Noli konsiderohet një orator i zoti në poezitë e veta, po aq poet i zoti dhe në ligjëratat e tij, të cilat dallohen për figuracionin e pasur, për strukturën harmonike dhe për kumbimin melodioz. “Fjala e zgjedhur me kujdes në ato zë vend aq mirë si gurët e skalitur e të lëmuar në fasadën e një pallati të ndërtuar nga mjeshtër plot shije”.²⁴⁸

²⁴⁴ F. Leka, F. Podgorica, S. Hoxha, *Fjalor shpjegues i termave të letërsisë*, Tiranë, 1972, f. 244.

²⁴⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, f. 68.

²⁴⁶ A. Xhuvani, K. Cipo, *Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme*, Tiranë, 1930, f. 50.

²⁴⁷ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albis, 2005, f. 139-144.

²⁴⁸ F. Agalli, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 193.

5.2 Disa tipare të shprehjeve metaforike në tragjedinë “Makbethi” të përkthyer nga Noli

Një tipar që bie në sy në shkrimet gazetareske të Nolit është figuracioni i pasur dhe dendësia e mjeteve shprehëse, shfrytëzimi me mjeshtëri i aftësive shprehëse të disa kategorive gjuhësore, sidomos nga fusha e leksikut dhe e morfologjisë. Antiteza, përsëritja, pyetjet retorike dhe konsultuese janë nga mjetet të parapëlqyera të Nolit në artikujt e tij me një përmbajtje mjaft të larmishme.²⁴⁹

Nëse do të marrim në konsideratë figurat letrare të përdorura nga Noli ato janë të shumta, por ne do të përqëndrohemi vetëm te disa prej tyre. Kështu, më të përdorshmet që spikatin në përkthimin e veprës së “Makbethi” janë metafora dhe metonimia, të cilat shpesh mund të quhen dhe imagjinare, sepse personazhet më shumë meditojnë, ëndërrojnë. Ne mendojmë se janë pikërisht metafora dhe metonimia që krijojnë pjesët përbërëse të gjuhës poetike, që i përkasin tropës.

Metafora është përcaktuar nga stilistë të shumtë gjuhësorë si një proces paraqitjeje të të dy fushave të ndryshme konceptuale. Ato njihen si fusha e burimit dhe fusha e qëllimit. Fusha e qëllimit është tematika ose koncepti që ne duam të përshkruajmë me anë të metaforave, ndërsa fusha burimore i referohet konceptit që përfytyrojmë me qëllim që të krijojmë konstruktin metaforik.²⁵⁰ Kështu ne theksojmë rëndësinë që metafora luan në konceptin tonë të përditshëm.

Metaforat janë baza me të cilën njerëzit e konceptojnë eksperiencën e tyre si dhe botën e tyre të jashtme. Gjuha figurative e përgjithshme, e cila gjithashtu përfshin ironinë, gjendet në ligjëratën e folur dhe të shkruar dhe mbi të gjitha nuk kërkon talent intelektual të veçantë dhe situatë të veçantë retorike.

Metafora është thjeshtë një pjesë e natyrshme e mendimit konceptual dhe padyshim një tipar i rëndësishëm i krijimtarisë dhe nuk duhet të konsiderohet si tipar i veçantë i ligjërimit letrar. Metaforat janë ligjëratat e përditshme. Por, a ka ndryshime cilësore në llojet e metaforave të ndodhura në kontekstet e ligjërimeve të ndryshme? Tipari kryesor është risia e shfaqur nga një metaforë. Metafora mund të zhvillohet në idiomë apo shprehje gjuhësore.

²⁴⁹ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 158.

²⁵⁰ Paul Simpson, *Stylistics*, Routledge, Taylorand Francis Group, London- New York, 2004, f.41.

Metaforat janë të larmishme, si nga veçoritë gramatikore ashtu dhe nga kuptimet e tyre. Kështu dallohen metaforat gjuhësore nga ato stilistikore. Prandaj, J. Thomai trajton metaforën gjuhësore si figurë letrare. Lëvizjet kuptimore kanë në bazën e tyre figurat gjuhësore që në stilistikën letrare e në disa gramatika janë quajtur trope.²⁵¹ Emërtimet e bartura lidhen përfundimisht me sende dhe dukuri të reja.

Metafora gjuhësore bëhet e dallueshme nga ajo që ndjehet si figurë, bëhet e dallueshme nga metafora që nuk është një emërtim i përgjithshëm e i detyrueshëm. Në tekstin *stylistics*, Paul Simpson e trajton metaforën nga ana stilistikore. Gjatë procesit të zhvillimit, metaforat stilistikore mund të kalojnë në metafora leksikore.²⁵² Atëherë, ka dy lloje metaforash: metafora poetike (stilistike) dhe leksikore. Metaforat poetike i shërbejnë qëllimeve stilistike dhe nuk përbëjnë kuptime të reja të fjalëve. Ka autorë të tjerë, të cilët nuk bëjnë ndonjë ndarje midis metaforës gjuhësore dhe asaj figurative. Ata thjeshtë e përkufizojnë metaforën si veprimi i mbartjes që ka të bëjë me përdorimin e emrit të një objekti për një objekt tjetër midis të cilëve ka raport ngjashmërie.

Noli është njohës shumë i mirë i këtyre metaforave dhe bën një dallim të dukshëm midis metaforave poetike (stilistikore) nga ato leksikore. Ai i përdor mjaft mirë këto në ligjërimin e tij. Në shqipërimin e Nolit del në pah përdorimi i metaforave stilistikore. Gjatë procesit të zhvillimit, metaforat stilistike mund të kalojnë në metafora leksikore. Ndaj mund të themi se nuk është e lehtë që të vendoset një kufi midis këtyre metaforave. Përftimi i këtyre metaforave leksikologjike nga ato stilistike ndodh me kalimin e kohës gjatë zhvillimeve gjuhësore. Kur kemi të bëjmë me një vepër letrare artistike, që faktikisht është një realitet gjuhësor sinkronik, që merret me studimin e sistemit të gjuhës në një fazë historike të zhvillimit të saj, nuk mund të diskutohet kalimi nga figurativja në fakte gjuhësore, sepse shtrirja hapsinore dhe koha e gjuhës së veprës janë të pamjaftueshme për realizimin e transformimit si mjet figurativ në fakt gjuhësor.²⁵³

Sipas fjalorit “Oxford advanced learner’s dictionary” metafora është një fjalë apo shprehje për të përshkruar dikë apo diçka tjetër në një formë që është e ndryshme nga forma e përdorimit të saj normal, me qëllim që të paraqesë dy gjëra që kanë të njëjtat cilësi dhe për ta bërë përshkrimin

²⁵¹ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984, f. 68.

²⁵² Paul Simpson, *Stylistics*, Routledge, Taylor and Francis Group, London- New York, 2004, f. 41.

²⁵³ *Fjalor i Shqipes së Sotme*, 2002, f. 182.

më të fuqishëm.²⁵⁴ Te Noli këto cilësi paraqiten qartë. Me mjeshtërinë e tij prej poeti Noli e paraqet metaforën në shprehje figurative. Ai bën transferimin e kuptimit me fjalën, personifikimin e një abstraksioni, përdorimin e një fjale apo të një grupi fjalësh që të përshkruajë një send me anë të një tjetri. Te Noli ne hasim metafora të shprehura me një fjalë të vetme, një fjali apo strofë të tërë. Njohja e thellë e gjuhës së popullit nga Noli duket edhe në shfrytëzimin me mjeshtëri për shprehësi të metaforave popullore, që me kohë vijnë e marrin vlerën e kuptimeve të mëvetësishme të një fjale edhe në ligjëratat e shkrimet publicistike.²⁵⁵

Metaforat e përdorura nga Noli mund të përshkruajmë: 1. një proces apo gjendje mendore si një koncept, një cilësi apo veprim. 2. ato synojnë të ngjallin emocione, ndjenja, interesa; të qartësojnë, të kënaqin, të lehtësojnë, si dhe të surprizojnë. Ato shprehin dy qëllime. Qëllimi i parë është njohës, i dyti estetik. Në një metaforë të mirë të dy qëllimet janë paralelisht të lidhura ngushtë me përmbajtjen dhe formën. Sipas mendimit tonë të dy qëllimet përfshijnë iluzionin.

Gjatë gjithë ligjërimit të tij Noli na i paraqet këto lidhje. Sipas autorëve të ndryshëm vendas dhe të huaj të lartpërmendur, metafora gjithashtu paraqet ngjashmëri, anë semantike të përgjithshme midis dy gjërave me më shumë a më pak ngjashmëri, imazhin dhe objektin. Ky është një proces që shpesh trajtohet si funksion. Kështu, metaforat i hollë, i bardhë, jo serioz, i brishtë, delikat, i dobët, frikacak japin paraqitjen e ngjashmërisë, por jo atë të qëllimit. Metaforat mund të cilësohen pozitivisht ose negativisht. Noli në ligjërimit të tij paraqitet me të vërtetë një njohës shumë i mirë i përdorimit të metaforave me të gjitha karakteristikat e sipërpërmendura. Noli i shpreh metaforat dhe metonimitë me pjesë të ndryshme të ligjëratës.

Termi *figurë*, sipas *Fjalorit të Shqipes së Sotme* (2002), është realizimi artistik që mishëron veçori tipike të jetës shoqërore, që arrihet me anën e një sistemi mjetesh lëndore gjuhësore dhe ndërtimore; fjalë a shprehje e përdorur me kuptim të tërthortë për të shprehur një ide, ndjenjë etj, e cila i jep ligjërimit gjallëri të veçantë.²⁵⁶

Tropet sjellin edhe veçantitë socio-psikologjike e kulturore të një grupi shoqëror ose epoke, prandaj në letërsi drejtimet kanë parapëlqimet e tyre për figurshmërinë. Nocioni i sistemit

²⁵⁴ Oxford advanced learner's dictionary, Oxford university press, 2010, Botimi 8, f. 931.

²⁵⁵ F. Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f. 173.*

²⁵⁶ *Fjalori i Shqipes së Sotme*, Toena, Botimi 2, 2002, f. 330.

figurativ nënkupton tipa të caktuar figurash të parapëlqyera nga një autor ose drejtim, si dhe burimin nga nxirren figurat.²⁵⁷

Ndodh shpesh që të ngatërrojnë metaforën me krahasimin. X.J. Kennedy te “Literature an introduction to fiction, poetry and drama” thotë se “*krahasimi* është kontrasti i dy gjërave të lidhura me anë të fjalëve lidhëse, pra me anë të konektorëve: *tamam si, të ngjashëm me, ashtu si, sesa*, ose me anë të foljes që tregon *ngjashmëri*. Por, që të ekzistojë krahasimi gjërat që krahasohen nuk duhet të jenë të ngjashme. Nuk është krahasim të thuash “gishtërinjtë e tu janë si të mitë”, ky është një vëzhgim letrar. Por kur themi “gishtërinjtë tuaj janë si salçiçe” kemi *krahasim*. Nëse heqim konektorin e themi “gishtërinjte tuaj janë salçiçe”, atëhere rezulton se kemi të bëjmë me *metaforë*, pra gjendja e një sendi apo vetë sendi është diçka tjetër, që në realitet nuk është, por vetëm në kuptimin letrar. Në vargun e dytë të poezisë së *Shellit* hamendësohet se përjetësia është *dritë* ose *ndriçim*, dhe në këtë rast kemi *metaforë* të nënkuptuar.

Oh, dashuria ime është tamam si një trëndalif i kuq, i kuq *Krahasim*

Oh, dashuria ime i ngjan trëndafilin të kuq të kuq *Krahasim*

Oh, dashuria ime është më e kuqe se trëndafilin *Krahasim*

Oh, dashuria ime është trëndafil i kuq, i kuq *Metaforë*

Oh, dashuria ime ka petale të kuqe dhe gjemba të prehtë *metaforë e nënkuptuar*²⁵⁸

Te Noli shohim metafora të shprehura me pjesë të ndryshme të ligjëratës.

²⁵⁷ Xh.LLoshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f.142.

²⁵⁸ X. J. Kennedy, *Literature, an introduction to fiction, poetry and drama, fourth edition*, Boston, Toronto, 1987, p. 495.

5.3 Metafora të shprehura me emër

Klasifikimi i figurave bëhet sipas kriterve të ndryshme. Nga ana gramatikore dallohen figurat emra, mbiemra, folje ndajfolje dhe shihet cila gjymtyrë në togfjalëshin përkatës ndryshon si përfytyrim dhe cila si kuptim.²⁵⁹.

Metaforat të shprehura me emër në përkthimin e Nolit zënë një vend të rëndësishëm, si në vargjet e poshtshënuar:

You greet with present grace and great prediction. [Sh:286]

*Me **hir** të shpejtm' e **profeti** të madhe. [N:21]*

Ndërtimet *metaforike* kanë ngjyrimet emocionale të theksuara, të cilat shpesh janë të zmadhuara, të skajshme.

*That memory, the warder of the brain, Shall be a fume, and
the receipt of reason, a limbeck only. [Sh:290]*

*Ua bëj trutë **tym** e kokën **trokë**. [N:41]*

Në këtë varg janë përdorur metaforat emërore **tym** + **trokë**. Noli shpreh urrejtjen më të thellë të mundshme. Ai i ka shqipëruar me fjalët shumë të gjetura, me shprehësi të ekzagjërues, ku shfaqet shpërfytyrimi i trurit dhe i kokës. Fjalët që përdoren si emërtim **tym** dhe **trokë** shprehin vlerësime mosaprovuesë, qëndrime emocionale negative, paragjykime. Këto fjalë japin imazhin e diçkaje të keqe e të papranueshme, edhe nëse i analizojmë në vlerën e tyre sugjестive. Pra, ai e sheh dhe e koncepton trurin në një prizëm depresioni. Vëmë re se kemi çrregullim *tru* + *kokë*. Pra, kemi pëzierjen e *trurit me tymin dhe kokën me dheun (trokë)*, d.m.th kemi çrregullimin e trurit dhe të kokës. Ky çrregullim përçohet i plotë, ku spikat emri si mjet shprehës.

²⁵⁹ Xh. Lloshi *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f.143.

5.4 Metafora të shprehura me mbiemër

Sipas shkallës së origjinalitetit, dallohen figurat tradicionale nga figurat vetiake dhe figurat e zakonshme nga figurat e papritura.²⁶⁰ Tek Noli të tërheqin vëmendjen figurat vetiake të perdorura në krijimet si dhe përkthimet e tij.

Mbiemrat e metaforizuar kanë fuqi shprehëse të veçantë. Ata gjithashtu kanë ngjyrim vlerësues pozitiv apo negativ të dukshme.

A bleeding Sergeant. [Sh:284]

Një rreshtar i **përgjakur**. [N:13]

Në këtë shembull *metafora* ka fuqi shprehëse negative. Këtu emocionet të japin pamjen e një ushtari që është kthyer nga lufta dhe është *i përgjakur*, ka luftuar trimërisht dhe është plagosur.

This is the sergeant. [Sh:284]

Ky është ai rreshtar zemërluan. [N:13]

Në gjuhën angleze nënkuptohet nga konteksti se rreshtari është *zemërluan*, i cili shpëtoi Malkolmin. Ky mendim në gjuhën angleze përforcohet me shprehjen **this is the, sergeant** d.m.th *ky është ai që më shpëtoi jetën*. Një trim lufton për të mbrojtur veten, shokët, atdheun. Në fjalinë e sipërpërmendur Noli përshkruan një emocion të veshur me nuancë pozitive, *trim, i patrembur, i fortë si luan*.

The merciless Macdonwald -Worthy to be a rebel. [Sh:284]

I pamëshirti Makdonald-rebel. [N:14]

Në këtë fjali paraqiten emocione negative meqë Makdonald rebelon në mënyrë të pamëshirtë.

O valiant cousin! Worthy gentleman! [Sh:284]

Trim kushëri o zot i vyer! [N:14]

²⁶⁰ Xh.LLoshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005,f.143.

Mbiemri **i vyer** merr vlerë metaforike në bashkëvjatje me një emër personi. Emocioni pozitiv shprehet me *Zotin*, me këtë fuqi të mbinatyrshme.

With furbish'd arms and new supplies of men. [Sh:284]

*Me ushtri të re dhe **armëlarë**. [N:14]*

Ndonëse armiku ishte i pajisur mirë me armë dhe me ushtarë të rinj e të fortë, Makbethi me ushtrinë e tij doli triumfator. Ushtria e tij nuk u tremb as nga fiziku i armiqve, por as nga armët e tyre të reja. Emocionet e shprehura janë shumë të forta e pozitive. Noli, origjinalin e Shekspirit 'new supplies' e përkthen me metaforën **armëlarë**. Ai ka bërë një përkthim kontekstual shumë të fortë dhe emocional.

Assisted by that most disloyal traitor. [Sh:285]

*Me **ndihmën e pabesë** tradhëtore nisi luftën e tmerruar. [N:16]*

Me **ndihmën e pabesë** tradhëtore jepet atmosfera e turbullt në prag të vrasjes së mbretit. Ndhima e pabesë tradhtore ka të bëjë me paralajmërimin e vrasjes, ku qëndrimi i Dunkanit ndaj mbretit është i pabesë, tradhëtar. Duke e cilësuar ndihmën të pabesë dhe tradhtore, Noli i sjell lexuesit shqiptar në mënyrë të shkëlqyer me anë të shqipërimit të tij vlerësimin dhe reagimin shpirtëror negativ të Dunkanit ndaj fronit mbretëror me anë të metaforës të përdorur prej tij.

Till that Bellona's bridegroom, lapp'd in proof, confronted

him with self-comparisons. [Sh:285]

*Po dhëndër i Bellonës **i patrembur nga askush**. [N:16]*

Me anë të metaforës kuptohet se dhëndri është *trim*, kurajoz. Në këtë fjali **i patrembur** ka fuqi shprehëse të veçantë (*trim*) dhe ngjyrim vlerësues pozitiv. Kemi përjasje dhëndër **i patrembur**. Ndodh zgjerimi i fjalës së parë dhëndër me **i patrembur** për të dhënë përmasë *trimërie*. Në metaforën me një element paraqitet përjasja e dy nocioneve në mënyrë më intime, më kombinuëse. Kemi kombinim të dy kuptimeve. Kështu themi se kuptimi i figurshëm i shtohet kuptimit të mirëfilltë.

Her choppy laying upon her skinny lips [Sh:285]

*Se përmbi buzët **zhubra** tuaja po veni duart e **krasitura**. [N:20]*

Noli i ka përkthyer vargjet e Shekspirit me shumë emocion, duke i dhënë shpesh kuptim kontekstual. Realiteti i përdorimit të metaforave në shembujt e sipërpërmendur ka të bëjë me sfera të ndryshme, p.sh **zhubra**, buzët nuk janë kurrë me zhubra, por rrobja bëhet e tillë; në origjinal do të përkthehej *buzët e saj lëkure, të holla, “skinny lips”*. Por, forca shprehëse që ka dhënë Noli në shqipërimin e ‘Makbethit’ është shumë e fortë dhe e bukur, ndonëse ka kuptim negativ.

Po ashtu të *krasitura* përdoret për pemët apo bimet, ndërsa në shembullin e lartpërmendur është me kuptim të figurshëm, metaforik. Emocionet shprehen të zmadhuara. Të bien në sy ngjyrimet emocionale të theksuara e të skajshme, ngjyrimet emocionale-vlerësuese janë negative, shprehin pesim, *duart e krasitura*.

My noble partner. You greet with present grace and great prediction. [Sh:286]

*Tim shok **bujar** këtu e salutoni. [N:21]*

Në këtë shembull Noli ka përdorur shprehje mjaft të goditur emocionuese, shprehje e të qenit *dashamirës dhe zemërgjerë*.

*This castle hath a pleasant seat; the air. Nimbly and sweetly
recommends itself unto our gentle senses. [Sh:288]*

*Kështjella është në një vend të bukur. Me **erë t’ëmbël përkëdhelëse**. [N:35]*

Me këtë rast kemi përjasjen e një objekti konkret *kështjella* me një fenomen natyror, me një veçori të veçantë, *erë t’ëmbël përkëdhelëse*.

I have observed, the air is delicate. [Sh:289]

*Kam vënë re që era është **delikate**. [N:36]*

Në fjalinë e sipërpërmendur kemi përjasjen e një fenomeni natyror *era* me një veçori të veçantë *delikate*. Era personifikohet me anë të metaforës, duke e bërë delikate, ashtu siç është njeriu, frymorët, sepse njeriu është delikat. Ose mund të shprehem për një lule apo një objekt të thyeshëm që është delikat, i brishtë.

5.5 Metafora të shprehura me folje

Një mënyrë stilistike që është përdorur dendur nga autori, është dhe zberthimi i shprehjeve frazeologjike. Por ai edhe ndonjë togfjalësh të rëndomtë, si: *shtroj sofrën, korr me drapër*, etj., për efekt të krijimit të përfytyrimit mbi lidhjen e mundshme të qëndrueshme të elementeve duke i dhënë kuptim figurative edhe të dytit, e ka shpërbërë duke i larguar me qëllim këta nga njeri – tjetri: *rrimë në sofrën*.²⁶¹

Një vend të rëndësishëm në përkthimin e Makbethit nga Noli, zë përdorimi i metaforave të shprehura me folje.

Confronted him with self-comparisons, the victory fell on us. [Sh:285]

Dhe sulmën ia dërrmoi. [N:16]

Metafora *ia dërrmoi* shenjon dhe shpreh një veprim me nënkuptime: *sulmi u përball, fituan dhe dolën fitimtarë*.

What he hath lost noble Macbeth hath won. [Sh:285]

Ai e humb, Makbethi e fiton. [N:17]

Këtu bukuria shprehëse dhe forca ndikuese e metaforës shpjegon faktin se që në të njëjtën njësi gjuhësore pleksen dy kuptime. Këto kuptime janë të ndryshme dhe synohet që të jenë sa më të ndryshme:

Hang upon his pent-house lid; He shall live a man forbid. [Sh:285]

Jetën ia nxij e ia mallkoj. [N:18]

Përdorimi i metaforës *nxij* të jep një ndjesi mjaft të fortë negative.

The weird sisters, hand in hand, posters of the sea and land. [Sh:285]

Dorë për dorë ziruni, rreth e rrotull priruni tok' e det përpihuni. [N:19]

²⁶¹ Fatmir Agalliu, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f.192

Me anë të metaforës përqasen dy objekte konkrete, **toka dhe deti** të përpihen, gjë që në realitet është e pamundur.

Për Fatmir Agalliun Noli konsiderohet aq sa ka qenë një orator i zoti në poezitë e veta po aq ka qenë edhe poet në ligjeratat e tij, të cilat dallohen për figuracionin e pasur, për strukturën harmonike dhe për kumbimin melodioz. Fjala e zgjedhur me kujdes në ato zë vend aq mirë si gurët e skalitur e të lëmuar në fasadën e një pallati të ndërtuar nga një mjeshtër plot shije.²⁶²

5.6 Metafora të shprehura me ndajfolje

Përftesat e figurave janë të ndërlikuara dhe të ndërthurura.²⁶³ Është aftësia e Nolit që t'i ndërthurë ato me shumë mjeshtri dhe stil. Mjeshtri i madh Noli di të përdorë edhe ndajfoljen në mënyrë metaforike. Të tilla janë rastet në shembujt e poshtshënuar.

And fortune, on his damned quarrel smiling. [Sh:284]

*Dhe fati i buzëqeshte **kurvërisht**. [N:14]*

Noli e koncepton fatin në një prizëm kënaqësie shpirtërore e mendore, të hareshëm, por kurvërisht, që do të thotë jo në mënyrë të singertë. Me këtë nënkuptojmë se ky fat që po i buzëqesh në këtë mënyrë nuk do të zgjasë shumë, sepse ashtu si kurva shëtit dhe ikën, kështu dhe fati do t'i ikë. Pra, kemi një fuqi shprehëse kënaqësie me ngjyrim negativ.

So clear in his great office, that his virtues, will plead like angels,

trumpet-tongued. [Sh:289]

*Ka qeverisur shtetin **aq pastër** si engjëj me trumpetë . [N:38]*

²⁶² Fatmir Agalliu, *Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij*, Monografi, Toena, Tiranë, 1999, f.192.

²⁶³ Xh.LLoshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005, f.139

Këtu qeverisja e shtetit vlerësohet dhe cilësohet pozitivisht me ndajfoljen *pastër*, e cila shërben si metaforë. Kuptimi i saj ka të bëjë direkt me objektin.

When in swinish sleep. [Sh:290]

Dhe kur të shtrihen, të flenë *derrërisht*. [N:41]

Gjumi, të fjeturit, cilësohet me *derrërisht*. Përqasja të flenë *derrërisht* bën që fjala të flenë të zgjerohet në përmasa kuptimore e në afeksion. Kemi një shprehësi të gjallë.

Away, and mock the time with fairest show: False face

must hide what the false heart doth know. [Sh:290]

Pra, shkojm' e *buzëqeshur* i gënjejme. [N:42]

Segmenti shpreh falsitetin e *buzëqeshjes*, që ka në thelb mashtrimin, gënjeshtren. Metafora përqas dy fenomene, që kanë një ose disa veçori të përbashkëta, të cilat i vë në dukje. Noli është mjeshter në përdorimin e këtyre metaforave ndajfoljore, të cilat ngjallin shumë emocione dhe bëjnë që lexuesi ta lexojë me kënaqësi veprën edhe në ditët e sotme.

5.7 Metafora të shprehura me pjesë të ndryshme të ligjëratës

Kur elementet e përqasura gjatë ndërtimit të metaforës janë të një sfere vihet re prirja drejt përqasjeve të papritura, jo të zakonshme. Në këtë rast elementet kanë pika takimi, por dhe pika që i largojnë. Në ndërtimin e metaforave me anë të përqasjes së objekteve me qenjet frymore, përqasja në sendin, sende-qenie frymore ka epërsi të dukshme²⁶⁴.

You murdering ministers, wherever in your sightless substances. [Sh:288]

O xhindër vrasës, gjakës të padukur. [N:33]

²⁶⁴Emine Sadiku, Ky stilist i madh Tirane 2000,f.95.

Njeriu përqaset me qenie mitologjike, me personazhe biblike, por mund të ndodhë të kemi ballafaqime njeri-njeri, i jetës së gjallë ose të ashtuquajtura *krijesa të paqena*, siç është fjala *xhindër*.

Come, you spirits. [S:288]

*Eni ju o **xhindër**. [N:33]*

Këtu fjala *xhindër* është term biblik-fetar.

The instrument of darkness. [Sh:286]

***Djall' i ferrit.** [N:25]*

But be the serpent under't. [Sh:288]

*Po jij si **gjarpër** i fshehur nën të. [N:35]*

Mund të hasen ballafaqime njeri dhe qenie jonjerëzore. Në raste të tilla përftohen emocione keqësuese, të cilat shprehin vlerësime denigruese siç janë dy shembujt e fundit të lartpërmendur.

Striding the blast, or heaven's cherubim, horsed upon the sightless couriers of the air.

[Sh:289]

*Të hipur mbi kuaj të **padukur** kerubinësh. [N:39]*

Për vargjet e mësipërme Noli na ka dhënë përkthimin më të shkëlqyer. Në rastet kur njeriu përqaset me qenie fetare e mitologjike duhet të theksojmë se është autori, në rastin tonë Fan Noli, te përkthimi i të cilit ndihet krijuesi i figurës. Figura të tilla metaforike evokojnë stilin letrar-poetik. Përdoren dhe metafora të tilla, si: *shtrigë*, *lugat* etj.

Aroint thee, witch! The rump-fed ronyon cries. [Sh:285]

*Shporru **shtrigë**, më tha dosa. [N:18]*

Might yet enkindle you unto the crown. [Sh:286]

*Të kanë për të **ndezur për kurorë**. [N:25]*

Ndodh që metaforat të përftohen nga ballafaqimi i njeriut me diçka jo të gjallë, d.m.th. frymorë me jofrymorë. Metaforat e tilla bien më tepër në sy e për rrjedhojë tërheqin më tepër vëmendjen. Në përgjithësi kjo figurë shpreh diçka të papritur, të mistershme.

When in swinish sleep, their drenched natures lie as in a death. [Sh:290]

*Ishte **në pellg të gjumit**, si në varr të vdekjes. [N:41]*

Në këtë shembull Noli shpreh shumë mirë fjalët e Shekspirit që donte të thonte se ishte në një gjumë të thellë dhe nuk ndjente asgjë që ndodhte rreth tij.

And I have bought golden opinions from all sorts of people. [Sh:289]

*Dhe kam fituar një respekt **të artë**. [N:39]*

Karakterizimi metaforik bëhet mbi bazën e ngjashmërisë. Duket sikur personi është me shumë vlerë, shpreh një tipar që karakterizohet me tiparet e vetë sendit **ar**. Ai karakterizohet nga dëshira për pushtet, ambicje dhe vetëvlerësim. Duket sikur ky atribut është i përhershëm, respektivisht **i artë**. Këtu kemi karakterizim metaforik, i cili bëhet mbi bazën e ngjashmërisë në vlerë të veçantë.

Which would be worn now in their newest gloss, not cast aside so soon. [Sh:289]

*Këtë rrobë **të ndriçime** duhet ta mbaj tani dhe jo ta hedh mënjane. [N:39]*

Në këtë rast del në pah lufta e brendshme e Makbethit për të vrarë mbretin. Ai mendon për një çast që më mirë të mbaj titullin, i cili nënkuptohet me anë të **rrobë të ndriçime**, me të cilin u nderua nga mbreti se sa të vrasë mbretin. Por, nxitja e zonjës Makbeth është më e fortë.

When Duncan is asleep. Where to the rather shall his day's hard journey. [Sh:290]

*Dhe **gjum' i rëndë**, sipas lodhjes sotme, [N:41]*

Lufta e brendshme e Makbethit për të vrarë mbretin vazhdon të jetë shumë e fortë, kështu që ai mendon që ta finalizojë këtë vepër makabër kur mbreti të jetë në një gjumë të thellë. Shpeshherë sendet jofrymore, tiparet e veprimit që kanë të bëjnë me ato, marrin emërtime frymorësh. Kështu ato fitojnë lëvizshmëri, gjallëri, veprimtarinë shpirtërore e mendore të qenieve

të gjalla. Në përqasjen e objekteve me qëniet frymore ndodh që këto metafora të kenë epërsi të dukshme.

Merciful powers, restrain in me the cursed thoughts that nature. [Sh:290]

Fuqi mëshirëplotë! Mbytmini mejtimet e mallkuara të zeza. [N:44]

Of direst cruelty! [Sh:288]

Me zemërgurësinë më të egër. [N:33]

Në këtë fjali duket vendosmëria e zonjës Makbeth për t'u bërë si burrë dhe të largonte çdo ndjenjë prej gruaje, pra të bëhej shumë e fortë dhe të mbaronin veprën e egër që kishin nisur.

Disdaining fortune, with his brandish'd steel. [Sh:284]

Përbuzi fatin dhe me shpatën zgjeshur. [N:14]

Rreshteri me anë të këtyre fjalëve e lartëson figurën e Makbethit, duke thënë se ai zhveshi shpatën dhe luftoi trimërisht duke mosmarrë parasysh pasojat, të cilat mund të ishin vdekjeprurëse për atë.

Nor time nor place did then adhere. [Sh:289]

As koha as vendi nuk ujdin. [N:40]

Me anë të kësaj fjalie vihet re se Makbethi ka një luftë të brendshme me ndërgjegjen e tij. Nga njëra anë ai dëshiron të bëhet mbret duke vrarë mbretin, por nga ana tjetër mendon se nuk është vendi i përshtatshëm për të kryer vrasjen, sepse duhet ta kryejë në shtëpinë e tij, d.m.th. shtëpinë e Makbethit. Koha gjithashtu është e papërshtatshme nga që mbreti për momentin është mik në shtëpinë e Makbethit. Makbethi e kupton se të gjitha dyshimet do të bien mbi vetë Makbethin, sa do që ai do të përpiqet ta mbulojë këtë fakt.

There's husbandry in heaven; their candles are all out. [Sh:290]

Qielli bën kursime. [N:44]

By the name of most kind hostess; and shut up. In measureless content. [Sh:290]

Me falënderje për goshinë e bukur, dhe shkoi në shtrat pa masë i kënaqur. [N:44]

He shall live a man forbid. [Sh:285]

Jetën ia nxij e ia mallkoj. [N:18]

Me anë të dy foljeve, e para metaforike. Magjistrica e parë thekson ashpër se pas veprimit makabër që do të kryejë Makbethi, magjistrica do t'ia nxijë jetën, do të bëjë që Makbethi të kalojë një jetë të keqe, plot vuajtje dhe shumë të vështirë.

So foul and fair a day I have not seen. [Sh:285]

Ditë që zbardh e nxin si kjo s' kam parë. [N:19]

Përshkrimi i ditës është tejmas ekspresiv. Noli na e ka sjellë origjinalin e Shekspirit në mënyrë perfekte. **Zbardh dhe nxin** japin një kontrast.

So wither'd and so wild in their attire. [Sh:285]

Të fishkura dhe rrobëcjerra. [N:20]

Përsëri në këtë fjali kemi karakterizimin e magjistriceve, identifikimin e tyre me qeniet e gjalla, përshkrimi është përbuzës, injorues, **të fishkura dhe rrobëcjerra**, të cilat nuk krahasohen me gjallesat e dheut, me njerëzit e dheut.

To alter favour ever is to fear. [Sh:288]

Se zgjon dyshime faq' e ndrruar dhe e thartë. [N:35]

Makbethi i nxitur nga zonja Makbeth, është i përgatitur për të kryer krimin, por është e shoqja ajo që e paralajmëron të hiqet sikur nuk po ndodh gjë, d.m.th të jetë shumë i qetë dhe dashamirës.

That but this blow. Might be the be-all and the end-all here. [Sh:289]

Sikur kjo vepër njëher' e mir' hesapn' e saj të mbyllte pa lënë bisht dhe hije pas. [N:38]

I have no spur. To prick the sides of my intent. [Sh:289]

S'kam yzengji ta shpoj qëllimin tim. [N:39]

Me anë të kësaj metafore del qartë se Makbethi nuk është plotësisht i vendosur për të kryer këtë akt makabër, ndaj shprehet: "S'kam *yzengji ta shpoj qëllimin* tim, ta nxis mendimin e keq për të vrarë".

But only Vaulting ambition, which o'erleaps itself. [Sh:289]

*Përveç ambicjes **kulmëse** që turret. [N:39]*

Noli me anë të metaforës **kulmëse** pranon se është pikërisht ambicja për t'u bërë mbret që e shtyn në krim.

And live a coward in thine own esteem. [Sh:289]

*Dhe prapë rron **frikaç në sy të vetes**. [N:40]*

Në këtë fjali shihet mjaft mirë që zonja Makbeth e nxit Makbethin drejt vrasjes së mbretit, duke i thënë të mos **jetë frikacak**.

Bring forth men-children only. For thy undaunted mettle should compose. [Sh:290]

*Bëj vetëm djem moj grua se **trimëria jote e patrembur**. [N:41]*

Makbethi është tej mase i habitur nga guximi i zonjës Makbeth, e cila në mënyrë të vazhdueshme e nxit atë drejt veprimit ogurzi. Makbethit, zonja Makbeth, i duket **trime dhe e patrembur**.

False face must hide what the false heart doth know. [Sh:290]

Faq' e rreme fsheh në zemër ç'djejmë. [N:42]

Metafora **faq' e rreme fsheh në zemër** jep dhe shpreh idenë se Makbethi duhet të shtiret, të hiqet shumë i dashur dhe mikpritës që të mos ngjallë dyshime.

That fears a painted devil. [Sh:291]

*Ka frikë nga, **djall' i pikturuar**. [N:52]*

Metafora **djall' i pikturuar** prezanton në mënyrë shpirtërore dhe vizuale njeriun e keq, të lyer me gjak. Makbethi ka kryer vrasjen dhe i ka të përlyera duart.

Proceeding from the heat-oppressed brain? [Sh:290]

*Që rrjedh nga **trur' i nxehur dhe i vrarë**? [N:46]*

Me këto metafora **trur i nxehur dhe i vrarë** jepet ideja se ndoshta mendimi për të vrarë është vetëm një halucinacion, një imagjinatë. Ai është në dilemë në këtë moment për veprën vrasëse që do të kryejë. Ai heziton të kryejë veprimin.

Words to the heat of deeds too cold breath gives. [Sh:291]

*Me **fjalë ftoh zjarr' veprë që valon**. [N:47]*

Grupi metaforik **fjalë ftoh zjarr veprë që valon** shpreh se nuk duhet menduar më, sepse të menduarit dhe fjalët, të cilat i vijnë ndër mend, e pengojnë në kryerjen e veprës makabër dhe mund ta largojnë së kryeri këtë vepër.

That which hath made them drunk hath made me bold. [Sh:291]

*Ajo q'ata i dehu ma **forcoi kurajën**. [N:47]*

Me anë të kësaj metafore ma **forcoi** kurajën, jepet besimi i Makbethit se pija e bëri shumë të fortë dhe kurajoz për vrasjen. Metafora e përdorur është shumë shprehëse.

It was the owl that shriek'd, the fatal bellman. [Sh:291]

*Ish kukuvaia **vajtimtare**. [N:47]*

Metafora shpreh se kukuvaia **vajton** për aktin që do të ndodhë. Kukuvaia personifikohet.

What hath quench'd them hath given me fire. [Sh:291]

*Ajo q'i **shoi** ata ma **ndezi zjarrin**. [N:47]*

Pija e nxit më shumë Makbethin për dëshirën e tij të zjarhtë të eliminojë mbretin për të marrë pushtetin mbretëror. Noli e shqipëron saktë metaforën e përdorur nga Shekspiri.

I had most need of blessing. [Sh:291]

Zemra ma desh bekimn' e perëndisë. [N:50]

Në realizimin e metaforave shpeshherë sendet jofrymore apo organe të veçanta të trupit marrin emërtime frymorësh. Kështu ato fitojnë lëvizshmëri, gjallëri, veprimtarinë shpirtërore e mendore të qenieve të gjalla. Në përqasjen e këtyre objekteve me qeniet frymore dhe me ato biblike, këto metafora fitojnë shprehësi të dukshme. Po ashtu nocionet abstrakte paraqiten me emërtimin e një sendi konkret.²⁶⁵, p.sh. në fjalinë e sipërpërmendur ***Zemra ma desh bekimn' e perëndisë.***

The death of each day's life. [Sh:291]

Vdekjen e jetës së përditëshme. [N:50]

Noli e ka paraqitur rrjedhjen, mbarimin e jetës së përditëshme më anë të metafores ***vdekjen***, e cila jep me art shuarjen e ditëve dhe jetës që gjëllin në ato.

Sore labour's bath. [Sh:291]

Banjën e punës trupkapitëse. [N:50]

Balm of hurt minds. [Sh:291]

Ballsamn' e shpirtit vrrar' e të plagosur. [N:51]

Me anë të metaforave të sipërpërmendura shprehet gjendja fizike dhe morale e Makbethit, e cila është ***e lodhur, e vrrarë dhe e plagosur***, e kërkon shpëtim, balsam.

Bound in To saucy doubts and fears. [Sh:297]

Me frikë dhe dyshime shtypëse. [N:85]

Si përfundim mund të themi se kuptimi dhe shprehësia e metaforës mund të jetë e gjallë, e harxhuar apo e fshirë. Ajo mund të jetë shprehur me emër, mbiemër, folje, ndajfolje etj.

²⁶⁵ Emine Sadiku, Ky stilist i madh Tiranë 2000,f.95

Metaforat janë të ndërtuara dhe shprehen në të njëjtën mënyrë edhe në gjuhën angleze. Janë shqipëruar në mënyrë të kuptueshme e të përsosur nga Noli. Metafora ka vlera shumë të mëdha stilistikore, ka ngjashmëri me krahasimin, lind mbi bazën e një krahasimi, por nuk është krahasim, edhe pse mund të zhvillohet si një krahasim.²⁶⁶

Mund të themi se tropet sjellin edhe veçantitë socio-psikologjike e kulturore të një grupi shoqëror ose epoke, prandaj në letërsi drejtimet kanë parapëlqimet e tyre për figurshmërinë. Nocioni i sistemit figurativ nënkupton tipa të caktuar figurash të parapëlqyera nga një autor ose drejtim, si dhe burimin nga nxirren figurat.²⁶⁷

5.8 Disa karakteristika të metonimisë në tragjedinë “Makbethi” të përkthyer nga Noli

Noli e përdor metoniminë në veprat dhe në shqipërimet e tij në mënyrë të shkëlqyer. Me anë të këtij figuracioni metonimik Noli vizaton e paraqet anët e veçanta, thelbësore për fenomene të ndryshme apo për personazhet e tij.

Metonimia vjen nga greqishtja **meta** (ndryshoj) dhe **onoma** (emër), dhe ne e shqipërojmë “*ndërrim i emrit*”, që shenjon mbartjen e emërtimit të mbështetur në fqinjësinë e sendeve, në takimin e tyre në hapësirë, në kohë, në lëndë etj. Këto marrëdhënie që qëndrojnë në bazë të metonimisë mund të jenë hapësinore, si te fjala *klasë*, kuptimet e së cilës janë: 1. mjedisi ku bëhet mësim, 2. tërësia e nxënësve të një klase; apo fjala *sallë* 1. dhomë e madhe për veprimtari shoqërore, etj, 2. tërësia e njerëzve që ndodhen në sallë etj²⁶⁸.

Për metoniminë Xhevat Lloshi shkruan se metonimia si mjet i stilistikës letrare ka efekt pikërisht kur vendosen lidhje afërie që asnjëherë nuk kanë qenë në mendjen tonë dhe që më së

²⁶⁶ X. J. Kennedy, *Literature, an introduction to fiction, poetry and drama, fourth edition*, Boston, Toronto, 1987, p. 495.

²⁶⁷ Xh.Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005,f.142

²⁶⁸ Rami Memushaj,Hyrje në gjuhësi,Botimet TOENA,2006,f.158

shpeshti as mund të vëzhgohen në realitet, por i bëjnë të mundura përfitesat gjuhësore në stilema gjuhësore²⁶⁹.

Metonimia është një figurë letrare, e cila zëvendëson emrin e një gjëje me emrin e tjetrës me të cilën në njëfarë mënyre është e lidhur. Ndryshe nga figurat e tjera letrare, metonimia bazohet në një transferim. Metonimia vështirëson, komplikon, zhvillon, përpunon, zhvendosjen midis koncepteve të shoqëruara. Shpesh rezulton të jetë zhvendosje midis pjesës dhe të tërës; një institucioni dhe lokalizimit etj²⁷⁰.

Metonimia është një trope e njohur, ndërsa sinekdoka variant i saj, është përdorimi i një fjale emërtuese duke i dhënë një kuptim më të gjerë ose më të ngushtë, duke përmendur pjesën për të tërën ose të tërën për pjesën, njëjësën për shumësin etj., p.sh. **shqiptari** në vend të **shqiptarëve**, **fshati** në vend të **fshatarit**.²⁷¹ Po kështu kur shprehemi: le të takohemi përballë **parlamentit**, këtu nënkuptojmë **ndërtesën**. Në shprehje të tilla **Parlamenti** diskutoi, **Parlamenti** refuzoi, **Ministria** miratoi, **Qeveria** vendosi etj. nënkuptojmë parlamentarët, d.m.th deputetët, ose anëtarët e qeverisë, ministrat etj.

Metonimia, ku prodhuesi i diçkaje jepet me atë çfarë ka prodhuar, duket në shprehje të tilla, si: A e keni lexuar **të fundit të Blushit**? Këtu nënkuptojmë **veprën** e fundit të shkruar nga Blushi. Metonimitë lidhen ngushtë me kontekstin. Metonimia nënkupton një distancë midis konceptit që shpreh qëllimin dhe burimin. Metonimia ngre, përmirëson disa tipare të dukshme, të rëndësishme nga një fushë ose paraqet fushën si të tërë. Kështu p.sh. në fjalinë:

Great king, where the Norwegian banners flout the sky, and fan our people cold. [Sh:285]

Mbret i madh, ku **flamuri** i Norvegjisë **qiellin kërcënon**. [N:16]

Këtu me anë të **flamurit** jepet koncepti i vendit pushtues. Metonimia mund të jetë gjuhësore dhe stilistikore.

²⁶⁹ Xh.LLoshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, 2005,f.141

²⁷⁰ X.J.Kennedy, *Literature*, fourth edition Library of Congress Catalogue -0Boston-Toronto!987,f.502.

²⁷¹ *Fjalor i Shqipes së Sotme*, 2002, f. 1181.

Metonimia gjuhësore dhe ajo stilistikore kanë të bëjnë me emërtimin e një objekti apo dukurie me anë të një fjale që shenjon një tjetër objekt apo dukuri. Midis tyre ka lidhje në kohë dhe hapësirë, shfrytëzohen lidhje shkak-pasojë, mbajtje-përmbajtje, pjesë-e tërë.²⁷²

Kur kuptimi i ri metonimik është ngulitur nga përdorimi, ai bëhet një kuptim i prejardhur i fjalës së dhënë, zhvendosja nuk dihet, kemi të bëjmë me një emërtim direkt të dukurisë apo sendit, p.sh: punim- *punë*, vepër, *studim*; gotë- *pija që nxë një enë e tillë* etj.²⁷³

Në fjalorin e termave të letërsisë metonimia përkufizohet si një trope që formohet kur ua ndryshojmë emrat objekteve apo ideve, duke i quajtur me emra të tjerë që kanë lidhje të ngushtë me ato. Metonimia gjuhësore dallon nga ajo stilistikore. Autorë të ndryshëm mbajnë qëndrime të ndryshme në dallimin midis metonimisë stilistikore nga ajo gjuhësore. Disa i vlerësojnë njëlloj.

Në raste kur kuptimi metonimik përthithet nga përdorimi i shpeshtë, ai bëhet kuptim i prejardhur i fjalës, d.m.th zhvendosja nuk ndihet, kështu kemi të bëjmë me një emërtim të drejtpërdrejtë të dukurisë, të asaj çfarë duam të shprehim, p.sh lexova “*Zogun*” e Blendi Fevziut, do të thotë *librin* rreth Zogut, etj. Jani Thomai për këtë shkruan, se: “është një rrugë e zgjerimit të kuptimit. Kuptimi i ri lind nga një lidhje shkak-pasojë”.²⁷⁴

My noble partner you greet with present grace and great prediction of noble having and of royal hope, that he seems rapt withal. [Sh:286]

Tim shok bujar këtu e salutoni, me hir të shpejtm’ e profeti të madhe, për zyrë

***më të lart’ e shpresë fronti.* [N:21]**

Në këtë rast atributi ***zyrë më të lart*** është mbiemër. Fjala e përcaktuar është fronti mbretëror. Kemi një lidhje shoqëruese midis fronit dhe zyrës, shmanget përdorimi i fjalës *kurorë mbretërore*. ***Shpresë fronti*** jep synimin e dëshiruar për të hipur në fron.

That trusted home might yet enkindle you unto the crown, [Sh:286]

N’u dhëncë besim zotimeve, të kanë për të ndezur për kurorën. [N:25]

²⁷² E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f.99

²⁷³ E. Sadiku, *Kadareja, ky stilist i madh*, Tiranë, 2000, f. 100.

²⁷⁴ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 1984, f. 68.

Në këtë shembull **kurora** që mban mbreti, shenjon të qenit mbret. Kështu me anë të kësaj zhvendosjeje Noli shpreh emocionin e thellë e dëshirën e madhe të Makbethit për t'u bërë mbret.

And fill me from the crown to the toe top-full, of direst cruelty! [Sh:288]

*Nga koka gjer në **thonjt'** e gjer në **buzë**, me zemërgursinë më të egër. [N:33]*

Metonimia ndërtohet me përdorimin e pjesëve të trupi për të shenjuar në mënyrë domethënëse e shprehëse tërë qenien njerëzore. Ndërsa në origjinalin e Shekspirit thuhet *nga gishtërinjt e këmbës (nga këmbët) deri në majë të kokës*. Noli ka dhënë shqipërim të përkryer.

And wash this filthy witness from your hand. [Sh:291]

*Shko shpejt e merr ca ujë dhe e laj nga duart **atë dëshmi** të ndyrë. [N:51]*

Me metoniminë **dëshmi** jepet gjaku me të cilin Makbethi ka përlyer duart. Dëshmia përfaqëson fjalën **gjak**. Noli ka përdorur të njëjtën metonimi që ka përdorur Shekspiri.

Shembuj të tjerë nga Makbethi i Nolit.

Will it be received when we have mark' d with blood those sleepy two?[Sh:290]

*Po **bota** a do ta besojnë vall', q' e kanë vrar' ata q' e ruajnë? [N: 42]*

Në vargun e sipërpërmendur metonimia, **bota**, nënkupton njerëzit e oborrit si dhe të gjithë mbretërisë, kemi të tërën për një grup njerëzish.

I am settled, and been I up, Each corporal agent to this terrible feat, [Sh:290]

E kam vendosur dhe tani tendos, për veprën e tmerruar, gjithë nervat.[N:42]

Me këtë figurë të metonimisë në shembullin e lartpërmendur, kuptojmë çdo pjesë të trupit, mendjen, etj.

Ndonjëherë një metonimi zgjidhet sepse është një tipar i mirënjohur i fjalës. Shembuj famozë janë citatat e Edward Bulwer që përshkruajnë metoniminë mjaft bukur dhe me shumë art “*The*

pen is mightier than the sword” = Pena është më e fuqishme se shpata, që në original vjen nga Edward Bulwer “*Lytton’s play Richelieu*”.²⁷⁵

Kjo fjali përmban dy metonimi: 1. **Pena**, qëndron për fjalën e shkruar dhe 2. **Shpata**, për agresionin ushtarak dhe forcën. Të kuptuarit e kontekstit të metonimisë është i rëndësishëm, p.sh. *pena*, jo gjithmonë qëndron për fjalën e shkruar, ajo shpesh i referohet objektit fizik *penë*.

Music, once admitted to the soul, becomes a sort of spirit, and never dies.²⁷⁶

Në këtë rast kemi barazimin e muzikës me shpirtin.

Si përfundim themi se metonimia është një figurë e cila zëvendëson emrin e një gjëje me emrin e një gjëje tjetër me të cilën në njëfarë mënyre është e lidhur. Metonimia është një fjalë apo shprehje e përdorur në vend të një fjale tjetër. Metonimia e Shekspirit në original është përkthyer përsosshmërisht nga Noli. Ato nuk kanë asnjë dallim (në ndërtim e në shprehësi) nga njëra gjuhë në tjetrën. Noli me anë të përdorimit të figurave letrare, të metaforës, metonimisë etj. në përkthimin e tij ka bërë që shqipërimi i “*Makbethit*” të Shekspirit të lexohet gjithmonë dhe me shumë dëshirë nga shqipfolësit kudo që të jenë.

Robert Dale Parker në librin “*How to interpret literature*” shkruan thënje të Roman Jakobson: se metafora dhe metonimia janë figura retorike. Roman Jakobson pretendon se metafora dominon vizatimet surrealiste në romantizëm, simbolizëm dhe poezi, ndërsa metonimia dominon në vizatimet kubiste në veprat realiste dhe në prozë.²⁷⁷

²⁷⁵ Google.com.edward bulwer-lytton,quote

²⁷⁶ Google.com.edward bulwe-lytton ,quote

²⁷⁷ Robert Dale Parker,How to interpret Literature,Oxford University press, Oxford New York,2008, f.73.

PËRFUNDIME

Nga analiza dhe studimi dolëm në konkluzion se krijimtaria poetike e Nolit është ndër letërsitë me fuqi e vlerë të papërshkrueshme, e cila frymëzohet e drejtohet nga një filozofi humaniste. Noli mban një qëndrim prej mjeshtri në zgjedhjen stilistike, në monovrimin me gjuhën. Ai është njohës i rrallë i visarit të gjuhës. Noli në krijimet dhe në përkthimet e tij ecën në bazë të një parimi drejtues që drejton, përshkon tërësinë e organizuar, duke arritur veçantinë, përcakton tipin e ligjërit, llojet e stilemeve. Parimi është përgjithësim, sjell unitet.

Në letërsinë artistike parimi drejtues është zanafilla e krijimit të një vepre me cilësi letrare. Parimi drejtues në veprat letrare ndërthuret me parimet artistike dhe estetike të autorit me anë të leksikut që ai përdor. Në krijimtarinë e tij Noli përdor ngjyrimet shprehëse, të cilat lindin si marrëdhënie kundrejt vetë gjuhës. Ligjëruesi në mënyrë të vetëdijëshme u drejtohet burimeve të vetë gjuhës, e shfrytëzon formën gjuhësore që të tërheqë vëmendjen. Kjo është fusha e parapëlqyer e letërsisë artistike edhe e Nolit, vargjet e të cilit e arrijnë shprehësinë duke vënë në veprim disa përftesa njëherësh.

Në nivelin fonetik kemi: rimë, theksat në po ato vende (izotomizëm), paraqiten fjalë që nisin me të njëjtin tingull, madje ka një shkallë të lartë përngjashmimi tingullor (paronomazi). Në nivelin gramatikor ka paralelizëm të plotë të trajtave e të ndërtimit (izotopi). Pikërisht kjo ndërthurje e përftesave të të gjitha niveleve shpjegon forcën shprehëse të vargjeve.

Nga analiza nxorëm në pah se përkthimi për Nolin sipas Çuçkës ishte një mision shoqëror dhe jovetiak, ishte për më tepër një mision shoqëror përparimtar, sepse ishte në shërbim të së vërtetës dhe jo reaksionit. Noli ishte njeri me kulturë të mirëfilltë, jo thjesht me kulturë informacionesh, por edhe me kulturën e të menduarit, të arsyetuarit, të logjikuarit. Ai mbetet i patundshëm edhe sot si parim pune dhe si kriter vlerësimi për përkthimet.

Përkthimi për të nuk ishte thjeshtë kalimi nga një strukturë gjuhësore në një tjetër, por ridhënia në një gjuhë tjetër e veçorive kulturore-historike, të mishëruara në lëndën gjuhësore, duke kaluar nga një traditë në një tjetër të formave të komunikimit, të rrëfimit, të përshkrimit, të dialogut, të përçimit të ngarkesës emocionale, të tonalitetit, të përfimit, të shprehësisë.

Noli ishte mjeshër në përkthimin e Shekspirit. Mendohet se mjeshtria e tij qëndronte te ndërtimi shqip i ligjërit, pavarësisht se në disa raste ishte shmangur nga origjinali si besnikëri

ndaj tekstit. Noli e arriti këtë jo vetëm me leksikun e gjerë, por e pasuronte ligjëratën me trajta gramatikore dhe kuptimore. Trajtat foljore kanë vlerësim stilistik dialektor. Me përkthimet qëllimi i tij ishte pasurimi i kulturës shqiptare, me krijimet më të rëndësishme dhe më të mira të popujve të tjerë. Ai ishte gjithashtu mjeshtër në përkthimet e veprave të tjera letrare artistike, duke përdorur një ligjërim ekselent. Askush tjetër deri më sot nuk ka arritur t'i përkthejë aq bukur, me një leksik kompleks, ku spikasin thellësia e mendimit, imponimi i ndjenjës për vrasje, për pushtet, mundësisë së plotësimit asociativ nga ana e lexuesit.

Noli në përkthimet poetike bëri punën e një rikrijuesi, saqë mjaft nga ato mund të mbahen si krijesa të tij. Prandaj lexuesi nuk habitet kur sheh që Kadareja vargun “*dasmë që shkrepëtinte nga zia*”, përkthyer nga Noli, prej një poezie të poetit rus Fjodor Tjutçev, e sjell për ilustrim si varg të vetë Nolit. Fan Noli nuk ka hedhur në letër një ngjarje që e ka jetuar vetë drejtpërsëdrejti, por ç’ka ka lexuar të shkruar tashmë nga Shekspiri. Pra, përderisa kemi përvetësim estetik, qoftë të një realiteti tashmë estetik, në përkthimet e Nolit kemi art. Dhe kemi art, sepse kemi krijim të mirëfilltë, ndonëse kemi njëkohësisht edhe rikrijim.

Kemi krijim në rrafshin gjuhësor, meqenëse Shekspiri nuk e ka shkruar "Makbethin" në gjuhën shqipe, por në atë angleze, në gjuhën shqipe atë e "ka shkruar" Fan Noli; domethënë se në shqip atë e ka krijuar ky i fundit. Noli është mjeshtër në gjetjen e fjalës, për të krijuar lidhjen e fjalës në shqipërimin e "Makbethit". Noli bën që në ligjërimin e tij fjala të jetë e saktë, ashtu siç e përjeton vetë Noli, sepse për atë fjala është forcë.

Noli ka arritur të strukturojë në gjuhën e përkthimit një tekst, i cili ndërthur saktësinë semantike me funksionalitetin pragmatik në një kontekst të ri gjuhësor dhe kulturor në përshtatje me kushtet e komunikimit dhe situatën ligjërimore. Në këtë kontekst vlen të theksohet fakti se stili i tij të mos konsiderohet thjesht si zbukurim dhe stisje gjuhësore, por, përkundrazi, si mënyrë e përshtatshme e përdorimit të mundësive shprehëse të gjuhës në një situatë të caktuar, duke respektuar strukturën e përgjithshme gjuhësore të gjuhës së përkthimit. Pra, përkthyesi nuk duhet të njohë vetëm gjuhën, por edhe historinë dhe topografinë e vendit për të cilën shkruan vepra që po përkthehet. Dhe këtij parimi Noli ia ka arritur mjaft mirë. Shprehësia e leksikut të Nolit ka burime të ndryshme. Në studim janë analizuar disa nga burimet kryesore të shprehësisë në përkthimin e tragjedisë së "Makbethit".

Përkthimet dhe krijimet e tij karakterizohen nga frymëzimi dhe përjetimi i vërtetë shpirtëror. Te "Makbethi" del në pah reagimi i fortë emocional ndaj problematikës që magjistricat e kanë frymëzuar. Dhe është pikërisht imagjinata, pjesëmarrja shpirtërore në përmbushjen e këtij objekti që kanë influencuar në përdorimin e një leksiku shprehës. Shprehësia e leksikut të Nolit është e larmishme. Për të dhënë një ide sa më konkrete të llojit të veprimtarisë përkthyesë të Nolit po japim një tabelë me të dhëna statistikore mbi tipat e mënyrat e përkthimit të realizuara nga Noli. Në përkthimin e "Makbethit" janë hedhur në letër nga Noli 2452 vargje në total.

Nr	Lloi i përkthimit	Nr Vargjeve	%
1	Përkthim fjalë për fjalë	2142 vargje	87%
2	Përkthim kontekstual	156 vargje	6.3%
3	Përkthim me fjalë të shtuara	64 vargje	2.6%
4	Përkthim me përshtatje	40 vargje	1.6%
5	Përkthim me fjalë të hequra	35 vargje	1.5%
6	Përkthim me shtim idesh/+opinione	15 vargje	0.6%

1. Siç shihet dhe nga tabela përkthimi **fjalë për fjalë** zë vendin e parë me 87% të vargjeve. Faktikisht përkthimi fjalë për fjalë krijon më shumë rrjedhshmëri dhe transparencë.

2. Nga analiza e përkthimeve të vargjeve në vend të dytë janë përkthimet **kontekstuale**. Ky lloj përkthimi zë 6.3% të vargjeve të përkthyer. Noli njihet jo vetëm gjuhën, por dhe kulturën e vendit për të cilin është shkruar teksti që përkthen.

3. Noli për t'i dhënë përkthimit një kuptueshmëri sa më reale dhe ta bëjë atë sa më të besueshëm në disa vargje ka kompensuar mendimin, duke **shtuar** ndonjë fjalë a shprehje të cilat nuk janë në origjinal, për të rifituar ndonjë humbje të mëparshme apo të mëvonshme.

4. Nga studimi nxorrëm një tjetër veçori në stilin e përkthimit të Nolit. Është përkthimi me **përshtatje**. Kjo mënyrë përkthimi zë 1.6% të vargjeve të përkthyer. Në këtë rast thëniet apo fjalori i Shekspirit nuk është përkthyer fjalë për fjalë, por duke zgjedhur shprehjen e thënien që përkon me ato në gjuhën ku përkthehet.

5. Një tjetër karakteristikë në përkthimin e Nolit është **heqja** e disa fjalëve. Sipas parimit se të përkthesh do të thotë gjithnjë *të lëmosh e hedhësh tutje* disa prej rrjedhøjave që fjala në origjinal i përmbante. Në këtë kuptim, duke përkthyer nuk thuhet kurrë e njëjta gjë.

6. Së fundi nga studimi i përkthimit të “Makbethit” sipas nesh rezulton se vetëm 15 vargje ose 0.6% janë përkthime të cilat Noli ka pasuruar vargun duke shprehur idetë **apo opinionin** e tij. Në këtë rast Noli ka përpunuar një sërë hamendjesh analitike që e bëjnë të krijojë një manual përkthimi që të përkojë me një manual të tërë, jo vetëm të gjuhësisë, por edhe të antropologjisë kulturore.

Një tjetër veçori e përkthimit nolian është se ai nuk i mbetet strikt faktit që pjesët e ligjëratës të mbeten të pandryshueshme. Ka raste kur foljen nuk e shqipëron folje, por bën përshtatje kontekstuale p.sh:

I know this is a joyful trouble to you, But yet 'tis one. [Sh:292]

E di që të gëzon ky shqetësim, po është një mërzitje prapë. [F:56]

Mendojmë se pjesa më e madhe e leksikut që përdoret nga Noli ka ngjyime letrare librore. Pikërisht këto ngjyime i japin ton letrar-libror ligjërimin e tij. Shkrimtari e përdor mjaft mirë këtë ton dhe krijon brenda tij larmi, shprehësi, natyrshmëri, duke na dhënë mjaft emocion. Shkrimtarët i shfrytëzojnë në mënyra të ndryshme mjetet e mundësitë e gjuhës sipas gjinive dhe temave të parapëlqyera prej tyre dhe sipas prirjeve të tyre.

Kështu, puna mjeshtërore e shkrimtarëve me mënyrat shprehëse gjuhësore të përdorura në krijimtarinë e tyre përbëjnë stilin e secilit autor, duke na dhënë larminë stilistike të letërsisë shqiptare. Edhe prapashtesat e përdorura nga Noli luajnë rol të rëndësishëm në ngjyrim. Fjalët e fitojnë ngjyrimin emocionues përmes prapashtesash me nuanca përkëdhelie ose keqësuese.

Veprat e përkthyer nga Noli sado tragjike tingëllojnë shqip. Fjalori i zgjedhur nga Noli ka stil dhe ngjyrim. Me përftesa apo procedë të ndryshme Noli krijon fjalë të cilat përdoren në

situata të ndryshme, të këndëshme dhe jo të këndëshme. Duke patur parasysh Shpëtim Çuçkën, themi se konkretisht punimet e Nolit para së gjithash shquhen për qartësinë e tyre kuptimore, për faktin se edhe sot shqipja e shkruar, shqipja letrare, ka kryer përparime të jashtëzakonshme, që përbëjnë krenari për shkencën tonë gjuhësore, dhe shqipja letrare e Nolit mbetet për lexuesin thellbësisht e kuptueshme, e qartë dhe estetikisht e këndshme.

Fan Noli mbetet simbol i përkthimit shqiptar me përvojë të madhe. Noli është ndër ato figura jo të shumta të historisë sonë, të cilat kanë spikatur me vlerat e veprimtarisë së tyre në të gjitha fushat ku janë përfshirë. Noli ka qenë, po të përsërisim në një farë mënyre fjalët e Ofelisë kur cilëson Hamletin, publicisti, politikani, burri i shtetit, poeti, kleriku dhe kritiku i letërsisë, historiani, muzikanti dhe përkthyesi.

Në pjesën procedë leksikore-semantike u trajtuan në plan teorik konceptet vlerë stilistike, ngjyrim stilistik, ngjyrim shprehës i rendit afektiv dhe semantik. Përftesa (në vend të huazimit procedë) është mekanizmi i brendshëm gjuhësor i stilemave ose i tufës stilemore. Stilema është një produkt i gatshëm i ligjërimit ku kanë marrë trajtë, janë kristalizuar proceset e saj të brendshme, përftesat. Me mjeshtërinë e tij Noli arriti t'i përdorë mjaft mirë këto përftesa. Shkrimtarët i shfrytëzojnë në mënyra të ndryshme mjetet e mundësitë e gjuhës sipas gjinive dhe temave të parapëlqyera prej tyre dhe sipas prirjeve të tyre.

Në disertacion u trajtuan veçoritë ligjërimore të rrafshit leksikor, rrafsh në të cilin Noli përdor shumë burime shprehësie. Burimet e shprehësisë shihen të lidhura ngushtë me funksionin e tyre. Ato do të përshkruhen në pikëpamje të vlerës stilistike, ngjyrimit stilistik, ngjyrimit shprehës të rendit afektiv dhe semantik. Ky punim synoi të hedhë dritë në stilin e shkrimtarit-përkthyes, duke na paraqitur në plan më të gjerë larminë stilistike të letërsisë shqiptare.

Objekt i veçantë i punimit është fjala, e cila ka ose fiton në ligjërim vlera stilistike. Kjo dukuri stilistike shfaqet qartë te Fan Noli, krijimet dhe përkthimet e të cilat janë me vlera të shquara ideo-artistike. Nga analiza vumë re se fjalët janë ato të cilat kanë ose fitojnë në ligjërim vlera stilistike, të cilat veç kuptimit stilistikor (nocionar) përmbajnë si shtresime mbi këtë kuptim ngjyrimor rendesh të ndryshme. Fjalë të tilla përbëjnë fondin specifik të ligjërimit artistik të Nolit.

Këto fjalë shenjojnë me gjallëri emocionale, mendore dhe bëjnë ngjyrosje ideostilistike të përmbajtjes. Ato luajnë rol mbizotërues kuptimor dhe estetik. Në këtë mënyrë fjalët bëhen

përçuese të artit e të stilit të Nolit. Përdorimi i tyre, si dhe elementet e tjerë të formës, kushtëzohen nga përmbajtja dhe talenti i Nolit, shkrimtari-përkthyes.

Gjatë studimit rreth Fan Nolit, midis shumë gjuhëtarëve, edhe Eqrem Çabej në një ese portretizon profilin madhështor dhe shumëdimensional të Fan Nolit. Kjo ese mbetet si një model mendor, një *modus vivendi*, si mund të shkruhet mbi një figurë që vjen shumë rrallë në histori, që buron nga thelbi i shekujve. Eqrem Çabej nuk mëton të tregojë se Fan Noli, si shkrimtar, përkthyes, poet dhe dijetar është njeriu *paekselence*, pikërisht prototipi i krijuesit, sepse Fan Noli ka diçka demoniake, e cila mbase është vetia e parë e njeriut krijues, qetësia e mirëfilltë e *furor poeticus*, e marrëzisë së poetit të vërtetë.

Shqipërimi i Makbethit nga Fan Noli është i një niveli të lartë shkencor. Fan Noli operon me nocione të përpikta për nivelin bashkëkohor, të gjuhësisë botërore. Nga analiza mësuam se gjuha shërben për të formësuar dhe komunikuar mendimet, që arrihet nga një sistem mjetesh (tinguj, morfema, fjalë, trajta) dhe rregullash e vargëzimesh.

Megjithatë komunikimi nuk arrihet thjeshtë nga vargëzimi i mjeteve sipas disa rregullave, por me ndërthurjen e tyre në përputhje me pasqyrimin e realitetit, të vijueshmërisë logjike, me synimet e folësit në rrethanat e komunikimit dhe me veprimin e përbashkët të të gjitha anëve sipas mënyrave të përvijuara historikisht në përvojën e kulturës gjuhësore të popullit shqiptar.

Gjatë studimit eksploruam se stili është vetë njeriu, individualiteti, ekzistenca e tij, mënyra e tij origjinale e të vështruarit të botës, pra mënyra se si gërshetohen mendimet, emocionet, etj. Nga punimi doli se Noli karakterizohet pikërisht nga stili i tij individual, nga ngjyrimi që i jep fjalëve. Prapashtesat e përdorura nga Noli luajnë rol të rëndësishëm në ngjyrim. Fjalët e fitojnë ngjyrimin emocionues përmes prapashtesash me nuanca përkëdhelie ose keqësuese. Pjesa më e madhe e leksikut ekspresiv të Nolit ka ngjyime letrare librare. Pikërisht këto ngjyime i japin ton letrar-libror ligjërit të Nolit. Shkrimtari e përdor mjaft mirë këtë ton dhe krijon brenda tij larmi, shprehësi, natyrshmëri, duke na dhënë mjaft emocion.

Vlerat artistike të këtyre varianteve janë vështruar në kuadrin e konteksteve ku ato gjenden. Noli, gjatë përdorimit të këtyre varianteve, nuk e respekton gjithmonë ngjyrimin e veçantë të tij, sepse, siç rezultoi nga studimi, një variant me ngjyrim libror mund të dalë në ligjërimin e një personazhi të thjeshtë, nga jeta e përditshme, ndërsa një variant me ngjyime të stilit bisedor ndodh që të shfaqet në situatë formale, etj. Përsa i përket gjymtyrëve të modeleve të përdorura

nga Noli ato nuk janë njëlloj të përdorshme në sferat e komunikimit. Ato dallohen nga ngjyrimi stilistik. Disa prej tyre mund të përdoren në stilin bisedor të përditshëm.

Gjithashtu u analizuan konsumimi semantik dhe variacionet e ndryshme të tij, si: konsumimi semantik për shkaqe fonetike ose semantike. Më e prekshme nga harxhimi kuptimor është ajo pjesë e përmbajtjes së fjalës që përbën atmosferën afektive, si ngjyrimet emocionale, vlerësuese-subjektive, etj. Në të vihet re dukuria e konsumimit stilistik-semantik, ku fjala e konsumuar është zëvendësuar ose ka ndryshuar kontekstin e saj. Ky ndryshim varet nga koncepti artistik i shkrimtarit. Noli është jashtëzakonisht origjinal dhe i veçantë. Me anë të konsumimit semantik ai krijon atmosferë shumë afektive dhe emocionale.

Në këtë mënyrë Noli krijon lidhje të forta lexues-shkrimtar-përkthyes. Konsumimi semantik nga Noli është shprehur me: 1. fjalë ekspresive (me ngjyime emocionale).

2. fjalë me kuptim të figurshëm të ligjërimit afektiv etj.

3. fjalë të tjera, pa ndonjë ekspresivitet të dukshëm, por që përdoren shpesh, shumë shpesh e që sjellin monotoni në ligjërime (për këtë arsye zëvendësohen). Harxhimi kuptimor në disa raste ndodh për arsye shoqërore. Në emër të një etike, të një shijeje parapëlqimi zgjidhen disa fjalë në vend të disa të tjerave që kanë përmbajtje të rëndë.

Analizuar se me konsumimin semantik nënkuptohet harxhimi i kuptimit të fjalës së dhënë, mospërdorimi i saj me kuptimin e parë, daljen e fjalës nga përdorimi ose përdorimi i saj me tjetër kuptim. Konsumimi semantik vepron dendur në letërsinë artistike, ku shprehësia është një dukuri e përhershme e leksikut. Vetë konsumimi është një mënyrë për të arritur një shprehje sa më të lartë. Kur dy fjalë bëhen homonime, d.m.th. përputhen fonetikisht për shkak të pësimeve fonetike që ndodhin në ato, gjuha synon ta zhdukë homoniminë, duke e zëvendësuar njërin fjalë me një tjetër. Fjala që zëvendësohet ndihet e konsumuar. Mendoj se më e prekshme nga harxhimi kuptimor është ajo pjesë e përmbajtjes së fjalës që përbën atmosferën afektive, si ngjyrimet emocionale vlerësuese-subjektive etj.

Vlera ekspresive e fjalëve dobësohet nga përdorimi. Fjalët që shprehin emocione, reagime shpirtërore, vlerësime subjektive, edhe ato më të fortat e më ekspresivet e humbasin forcën, kur përsëriten shpesh. Në mekanizmin e konsumimit stilistik të Nolit ndodh shpesh zëvendësimi i elementeve neutrale, të dobësuar semantikisht me fjalëformime shprehëse.

Sipas mendimit tonë është veçoria e leksikut shprehës të Nolit që gjeneron fjalëformime të tilla. Një grup fjalësh, që në kuptimin e tyre të mirëfilltë shenjojnë sende me një veçori të spikatur, japin tiparin në nivele maksimale e në mënyrë mbresëlënëse. Shprehësia e manifestuar nga elementet ndajfoljore *plotërisht*, *përunjërisht* ka të bëjë me formën e tyre të vjetëruar. Nëse do ta inkuadronim këtë dukuri në procedenë e konsumimit do të na duhej ta ballafaqonim me gjendjen e sotme të këtij grupi: *plotësisht*, *përunjësisht*.

Studjuam se për lexuesin e sotëm diferenca hermeneutike midis këtyre varianteve përbën ngjyrimin stilistik. Krahastuar me fjalët e përdorura nga Noli do të ndjeheshin më të zbehta fjalëformat e sotme. Nga analiza mësuam se konsumimi semantik, që ndodh sidomos në fjalët me vlera shprehëse, është shumë veprues në letërsinë artistike ku shprehësia është një atribut i përhershëm i leksikut. Vetë konsumimi është një mënyrë për të arritur një shprehësi sa më të lartë.

U analizua gjithashtu se procedja e konsumimit semantik në letërsinë artistike kushtëzohet nga mënyra e paraqitjes së materialit letrar dhe nga mënyra e komunikimit me lexuesin. Këto dy momentet e fundit: paraqitja e materialit letrar dhe forma e komunikimit me lexuesin kanë sjellë një përdorim të dukshëm të këtij mekanizimi në tragjedinë e Makbethit të shqipëruar nga Noli.

Veç fjalëve shprehëse njëlloj harxhimi kuptimor të Noli pësojnë dhe një grup fjalësh që përdoren shumë dendur në ligjërim, të tilla janë fjalët: *mos*, *nuk*. Nga përdorimi shumë i madh këto fjalë kanë humbur diçka nga pesha kuptimore. P.sh. mohimi i bërë me fjalën *mos* le vend për t'u plotësuar me ndonjë fjalë tjetër që të marrë pamjen e prerë të një mohimi të mirëfilltë e të padyshimtë.

Fjala *mos* mund të përsëritet, mund të përforcohet nga fjalë të tjera me kuptim mohues, si: *jo*, *kurrë*, *asnjëherë*, etj. Noli shpeshherë në vend të fjalëve mohuese “*jo-së*” dhe “*nuk*” përdor fjalën *mos* (në ndërtime të caktuara) ose ndonjë mjet tjetër. Mohimi i formuluar kështu është i prerë. Një fenomen i tillë në gjuhën angleze shprehet me fjalët mohuese: *no*, *not*, *don't*, *never*, etj.

Leksiku i Nolit përmban një rreth të gjerë njësisish shprehëse që e kanë arritur nivelin e lartë shprehësor duke u përfshirë në proceden e konsumimit. Ky është një konsumim i llojit stilistik, që ndryshon nga konsumimi i përhershëm linguistik nga shpejtësia e veprimit dhe nga përhapja. Por, konsumimi semantik mund të përdoret në emër të një etike, të një shijeje të ngritur, të një

parapëlqimi të përparuar a të përgjithshëm, për këtë zgjidhen disa fjalë në vend të disa të tjerave që kanë përmbajtje të rëndë. Ky fenomen vihet re në leksikun e përdorur nga Noli.

Një çështje tjetër që trajtohet në këtë punim është variacioni sinonimik. Gjatë studimit mësuam se tipat e varianteve dallohen nga ndryshimi gjatë historisë. Shqipja e vjetër vjen deri në shek. VIII-IX, kur ishin përvijuar dy dialektet e saj kryesore. Shqipja e mesme deri në shek. XVII dhe quhet arbërishte. Në kohën e arbërit lindi kërkesa historike për ta shkruar shqipen me librin e Gj. Buzukut, më 1555 na shfaqet varianti kryesor, gjuha e autorëve të vjetër: Shqipja e Re e shek. XVIII e deri në ditët e sotme. Edhe këtu dallohen tri faza, ndër të cilat e dyta është Rilindja (afërsisht 1820-1920) dhe faza e tretë, ose ndryshe quhet gjuha e sotme shqipe, e cila është pas viteve 1920.

Nëpërmjet analizës mësuam se thelbi i variacionit, rrjedhimisht edhe i stilit, duke përbërë lidhjen ndërmjet gjuhës, kontekstit dhe sjelljes gjuhësore në një situatë të caktuar ligjërimi, është dallimi, i cili mund të analizohet duke u bazuar në krahasimet që janë të domosdoshëm për të vënë në dukje shkallën e variacionit stilistik në situata specifike ligjërimi. Efektet e spikatura stilistike krijohen si rezultat i shmangieve nga përdorimi që është më se normal për situatën e dhënë.

Në çdo rast, në marrëdhëniet folës/dëgjues, shkruar/lexues, vendoset një masë e caktuar pritshmërie në varësi të lidhjes mesazh-situatë ligjërimore, rrjedhimisht mesazhi i pritshëm përmbush kërkesat ose e zhgënjën dëgjuesin/lexuesin. Në rast se mesazhi i përmbush kërkesat atëherë ai përputhet me stilin. Noli i shfrytëzon në mënyrë artistike shprehjet me të cilat krijon shpesh variacione sinonimike. Sinonimet janë një dukuri objektive në gjuhë, meqenëse ekzistojnë fjalë, forma morfologjike, kategori dhe ndërtime gramatikore që kanë kuptime të afërta, por jo krejtësisht të njëjta.

Megjithatë, shkrimtarët nuk kufizohen vetëm me mundësitë që u vë përpara sinonimika e gjuhës së përgjithshme, ata përpiqen të fusin në marrëdhënie sinonimie edhe mjete të reja. Varfëria e sinonimeve, sipas mendimit të M. Gorkit, tregon jo vetëm pakujdesi, por edhe padije. Noli është shumë i aftë në përdorimin e mjeteve sinonimike me anën e të cilave synohet që mendimi e ndjenjat të jepen me ngjyra të bukura stilistike.

Kështu ai krijon nga rrënja e një emri, si p.sh. *kurorë*, mbiemrin *i kurorëzuar*. Këto njësi paralele dallojnë njëra nga tjetra. Ato shprehin ngjyime emocionale. Elementi që ka ngjyrim

emocional plotëson elementin tjetër. Ato kanë dhe dallime të cilat lidhen me semantikën dhe shprehësinë e tyre. Edhe pse që të dy variantet sinonimike janë gjymtyrë të dyta të fjalisë, përcaktori emër apo vetë emri luan një rol sintaksor më të pavarur. Kjo ka të bëjë me veçoritë morfologjike të fjalës. Emri në funksionin e përcaktorit e jep cilësinë më të detajuar.

Noli i shfrytëzon artistikisht të gjitha mundësitë që ofron gjuha për një shprehje sa më të detajuar, në mënyrë të hollësishme të ideve dhe të emocioneve. Noli krijon larmi shprehëse me variante sinonimike, të cilat shprehen në forma të ndryshme, si: *emër me mbiemër*, *emër me folje*, *emër me emër*, *mbiemër me folje*, *mbiemër me mbiemër*, *folje me folje*, *ndajfolje me mbiemër*.

Variacionet sinonimike paraqesin tipare me shumë saktësi, me ngjyrimë e me forcë ndikuese. Nga analiza konstatojmë se i njëjti fenomen ndodh edhe në gjuhën angleze, si p.sh. *mystery* (mister) *emër*, (mysterious) (misterioze) *mbiemër* etj. Një procedurë sinjifikative e shprehëse e stilit ligjërimit të Nolit është ekuacioni/barazimi semantik.

Vlen të theksohet se barazimi semantik realizohet kur njësitë leksikore me kuptime semantike të ndryshme marrin shenjë e barazisë dhe barazohen nga ana kuptimore. Barazimi semantik krijon bukuri dhe forcë tërheqëse. Ekuacioni përdoret për të nënvizuar nocione dhe për t'i bërë ato sa më të spikatura. Ato gjithashtu kanë tendencë të afrohen kuptimisht, duke fituar ngjyrimë të njëri-tjetrit. Noli ndërton shumë ekuacione semantike. Ai vë shenjë e barazimit midis dy fjalëve, që nëse i shohim të veçuara kanë kuptime krejt të ndryshme. Po t'i shohim nga ana sintaksore, subjekti dhe predikati janë nocione me përmbajtje të ndryshme. Është dhe konteksti ai që bën dallimin e tyre. Fjalët nuk kanë përdorim të figurshëm.

Barazimi semantik i përdorur nga Noli ndodh kur njësitë leksikore me kuptime semantike të ndryshme marrin shenjë e barazisë dhe barazohen nga ana kuptimore. Të njëjtën gjë themi edhe për gjuhën angleze, sepse në të shumtën e rasteve vihet re i njëjti fenomen, domethënë barazimi shprehet në të njëjtën formë si në gjuhën shqipe.

Gjatë analizës të "Makbethi" i Nolit u vu re *rrezatimi leksikor*, i cili ka të bëjë me përqëndrimin e një ngjyrimi kuptimor a emocional në një mbaresë a prapashtesë, apo parashtesë, e cila arrin të ngjyrosë krejt fjalën.

Për të paraqitur dukurinë e rrezatimit semantik fjalët do të grupohen sipas njësive të përftuara me anë të procedeve apo përftesave, duke patur në konsideratë mjetet e përdorura sipas ngjyrymeve që arrihen në sajë të këtyre procedeve. Si mjete ngjyryese Noli përdorë:

Prapashtesat. Këtu përfshihen një numër i konsiderueshëm prapashtesash, të cilat krijojnë fjalëformime, duke i dhënë fjalës ngjyrim emocional-stilistik. Të tilla janë: **-risht** ose **-isht**, **-(rë)shme**, **-(ë)ri**, **-ar**, **-ra**, **-ur**, **-tur**, **-rak**, **-ak**, **-aq**, **-or**, **-ac-aç**, **-ore**, **-es**, **-ri**, **-(ë)si**, **-ës**, **-os**, **-zë**, **-za**, prapashtesa e dëshirores **-(f)sha**.

Në përkthimin e “Makbethit” bie në sy krijimi dhe përdorimi i njësive leksikore të formuara me **parashtesën pa-**, që shprehin mohimin e njësisë përgjegjëse pa parashtesën në fjalë. Të gjitha formimet me **pa-** përmbajnë ngjyryme emocionale-subjektive, si elemente me funksion mohues. Përgjegjësjë në gjuhën angleze e kësaj parashtese do të ishte parashtesa **un-**, apo prapashtesa **-less**.

Në ligjërimin e Shekspirit shpesh është përdorur prapashtesa **-less**, që e jep gjithashtu në një mënyrë tjetër këtë mohim. Ndër dukuritë e tjera të spikatura të leksikut të përkthimit Nolian janë përdorimi i elementeve **ç’** dhe **q’**. **Ç’** shfaqet gjithmonë atje ku do të shfaqej **çfarë**, ndërsa **q’** del në vend të **që**. Eliminimi i **ë-** së fundore bëhet për t’i lënë vendin zanores që pason, duke reduktuar një rrokje.

Një veçori tjetër gramatikore e gjuhës së Nolit është vendosja e trajtave të shkurtra pas foljes, si: *ziruni, përpihuni*. Në gjuhën angleze ka përdorim të trajtës së shkurtër, por kjo formë nuk i bashkangjitet foljes që të formojë një fjalë të vetme, siç ndodh në gjuhën shqipe dhe në veçanti në leksikun e përdorur nga Noli.

Aty ku në gjuhën standarde do të dilte prapashtesa **-shëm/shme**, te Noli kemi formën arkaike-krahinore të kësaj prapashtese **-çim/çime**. Në përkthimin e Nolit gjejmë dhe shumë pjesëza, elemente leksiko-gramatikore, që bartin vetëm ngjyryme afektive-kuptimore gjithfarëlloj, janë njësi të varfëra semantike, por në ligjërim ndikojnë me aftësinë e tyre rrezatuese. Pjesëzat kanë si veçori të ngjyrosin gjithë fjalën me ngjyrimin afektiv që manifestojnë.

Format e shprehura me dëshirore: *përpifshi, shkretofshi, rrëzofshi, shkallmofshi* etj. janë fjalë me ngjyryme të theksuara subjektive, meqë shprehin dëshira të folësit krahas përmbajtjes objektive të foljes. Ato janë shprehur me mënyrën dëshirore, e cila është ndër mënyrat karakteristike të shqipes. Ato japin modalitet të shoqëruar me ndjenjë dhe prandaj në thelb janë

forma shprehëse, prania e të cilave sjell vetvetiu ngjyrim në fjalitë e tekstit. Fjalët *frikaç*, *dorëtrokaç*, *tradhëtor* janë fjalë me ngjyime dialektore dhe emocionale, të cilat përftohen nga rrezatimi semantik i prapashtesave të vendosura te fjala e dhënë.

Forma me prapashtesën **-or(e)** është e vjetëruar, prandaj përmban dhe rrezaton ngjyrimin stilistik arkaik. Prapashtesa **-aq**, dhe **-ak** janë prapashtesa fjalëformuese, të cilat shpeshherë modifikojnë kuptimin e njësisë së formuar me shtim të ngjyimeve keqësuese. Këto formime bien më shumë në sy për ngjyime dialektore. Është veçori e përdorimit të këtyre prapashtesave në leksikon e Nolit ku fjalët me ndihmen e tyre marrin ngjyrim stilistik.

Në gjuhën e sotme këto prapashtesa nuk sjellin ndonjë ngjyrim të veçantë emocional-stilistik, ato janë prapashtesa fjalëformuese. Te Noli ato paraqesin bashkime fjalëformuese të ndryshme nga ato të sotmet. Rrezatimi semantik është dukuri objektive dhe një lloj mundësie gjuhësore për pasurimin kuptimor të fjalës, duke i dhënë ngjyime të ndryshme emocionale, semantike apo artistike.

Pikërisht ky rrezatim semantik i llojit stilistik te Noli vë në punë më shumë mjete ngjyruese. U analizua se rrezatimi stilistik është tepër veprues dhe një mundësi e hapur. Këto përftesa i sjellin njësisë leksikore, me të cilën lidhen, ngjyime të reja stilistikore, emocionale a kuptimore. Kjo veçori është një veprim mbi fjalën për të rritur domethënien, bukurinë e tërheqjen e saj.

Sipas modeleve kuptimore e ndërtimore të gjuhës së gjallë dhe sipas modelesh vetiake Noli arrin të ndërtojë një sasi të madhe e të larmishme rrezatimesh semantike, të cilat i bëjnë thëniet më të plota, më ndikuese dhe të ekuilibruara.

Një dukuri tjetër leksikore që vumë re të haset rëndom në gjuhën e Nolit është dublimi. Gjymtyrët e dubluara, stilemat që përftohen në këtë rast, kanë vlerë jo vetëm për bukurinë e fuqinë e tyre shprehëse, jo vetëm se e bëjnë ligjërimin tërheqës, por dhe për shërbimet e shumëfishta që kryejnë në ligjërim. Në shembujt që kemi dhënë, dublimet e Nolit janë të shprehura me **emër + emër**.

Mendojmë që elementi i dytë është më shprehës, më domethënës. Por gjithsesi të dyja gjymtyrët kanë forcë tërheqëse ndikuese. Funkcioni që kryen dublimi është të tërheqë vëmendjen, të vërë në dukje. Këtu bëhet fjalë për ngjyrimet pozitive që fiton fjala e parë, që e afrojnë atë kuptimisht me fjalën e dytë që përmban ngjyrim emocional në strukturën kuptimore.

Dublimi bëhet për sqarim, për saktësim. Njëra gjymtyrë saktëson dhe sqaron kuptimin e tjetrës. Shpesh nocioni që shenjon përfshihet në nocionin që shprehet me gjymtyrën e dytë.

Ky nocion ka përmbajtje më të përcaktuar, duke i dhënë aftësi përcaktuese. Pothuaj në të njëjtën mënyrë ndodh dublimi edhe në gjuhën angleze. Fan Noli me raportet midis gjymtyrëve të dublimit, të cilat i analizuam më lart, jep disa modele ndërtimore. Dublimi ka vlerë jo vetëm për bukurinë e fuqinë e tij shprehëse, jo vetëm se e bën ligjërimin tërheqës, por dhe për shërbimet e shumëfishta që kryen në ligjërim.

Krahas përftesave apo procedeve të tjera, u analizua se dublimi është një mënyrë frytdhënëse për ndërtimin e njësive stilistike që paraqesin një informacion më të gjerë dhe një shprehje më të lartë e të spikatur. Gjymtyrët që marrin pjesë në dublim japin secili ndihmesën e vet në përmbajtjen e në shprehësinë e grupit të ri të formuar. Ndërsa në gjuhën angleze, sipas studimeve të bëra, vihet re përdorimi i sinonimeve. Gjuha angleze është shumë e pasur me sinonime.

Noli ka ditur të shqipërojë Shekspirin me anë të dublimit, duke e pasuruar në këtë mënyrë gjuhën shqipe, duke e bërë atë më të gjallë dhe më shprehëse. Vlen të evidentojmë edhe procedenë e zgjerimit semantik që përdoret nga Noli për të dhënë me besnikëri e bukuri tekstin origjinal. Me anë të zgjerimit të gjymtyrëve bëhet e mundur paraqitja sa më e vëllimshme e mendimeve dhe e emocioneve. Një zgjerim i tillë në origjinalin e Shekspirit realizohet me nënrenditje.

Te Noli gjymtyrët e zgjerimit mund të jenë të bashkërenditura ose të nënrenditura. Shpesh gjymtyrët janë folje. Ato ndodh të shprehin veprime që ndjekin njëri-tjetrin në kohë. Kjo afërsi e madhe në kohë bën që kuptimet e tyre të duken të afërta e të rroken si një strukturë e vetme me vëllim të gjerë.

Punimi trajtoi se gjymtyrët përbërës në stilemat e përfutuara me zgjerim vendosin raporte të caktuara. Me anë të këtyre raporteve ato arrijnë të krijojnë atë unitet kuptimor të nevojshëm për ekzistencën e një njësie stilemore me vlerë emocionale, afektive. Në rastin e Nolit bëhet fjalë për një zgjerim të llojit stilistik, ku duke rritur vëllimin e një njësie leksikore, rritet dhe informacioni i emërtuar, por sidomos shprehësinë e segmentit në fjalë. Lidhja bëhet me elemente të ndryshme. Nëse do të përdreshin vetëm këto njësi, nuk do ta kishin vlerën që përftojnë duke u bashkuar me një ose disa njësi të tjera leksikore me të cilat formojnë një stilemë.

Stilema e përfutur u kundërvihet njësisë të marra veç e veç për nga përmbajtja, që është më e gjerë, nga ngjyrimet kuptimore dhe emocionale që janë më të shumta nga shprehësia më e lartë. Shpeshherë në procedënë e zgjerimit kemi dy gjymtyrë, por mund të ketë edhe më shumë se dy gjymtyrë. Nga ana formale kemi të bëjmë me dy a më shumë fjalë të lidhura me mjete të ndryshme gramatikore. Në pikëpamjen kuptimore kemi një përmbajtje unike të zgjeruar, emocionale, si dhe shprehëse-stilistikore.

Gjatë punës së vet krijuese dhe përkthyesë Noli ka ndjerë nevojën e zgjerimit të leksikut me fjalë ose forma fjalësh që të kenë funksione të ndryshme stilistike. Noli e jep realitetin e asaj kohe duke e paraqitur me sa më shumë ngjyrë e stil. Me anë të zgjerimit Noli synon të paraqesë sa më mirë idetë e shprehura nga Shekspiri, në mënyrë që të tingëllojë sa më i afërt për lexuesin.

Qëllimi i Nolit është të japë nuanca të tilla që krijojnë momente estetike dhe të zbulojnë shtresime të reja kuptimore në fjalë të ndryshme. Me përdorimin e shumtë dhe me pamjet origjinale, zgjerimi përbën një tipar të stilit të Nolit. Njësitë e përfutura me zgjerim tërheqin vëmendjen me informacionin e gjerë dhe me shprehësinë e lartë të tyre.

Në ligjërimin e zakonshëm përdoren dendur zgjerime, ku fjala zgjeruese sjell ngjyrimë emocionale-vlerësuese.

Përdorimi i vargjeve, enumeracioni është tjetër dukuri e stilit të Nolit, që trajtohet në këtë punim. Roli i tyre është për të paraqitur sa më me vërtetësi dhe në mënyrë më të detajuar ngjarje e përshkrime. Duke dhënë dukuri objektsh a emërtime njerëzish në mënyrë të vargëzuar, Noli e bën paraqitjen bindëse, që tingëllon si e vërtetë.

Paraqitja e detajeve bën që përshkrimet të kenë një pamje më origjinale, të vërtetë. Kjo mënyrë paraqitjeje me vargje fjalësh arrin të na japë persona dhe objekte në vërtetësinë e tyre, duke e bërë të padukshëm kufirin midis realitetit dhe fantazisë që përmban "Makbethi" i Shekspirit. Vargëzimi te Noli, po ashtu edhe te Shekspiri në origjinal përdoret për të dhënë sende të së njëjtës sferë, për të ndërtuar e paraqitur fusha tematike kontekstuale. Përdoren vargje fjalësh me kuptime konkrete, vargje fjalësh me kuptime abstrakte, vargje të përziera, ku bashkërendohen fjalë me kuptim konkret dhe abstrakt, po ashtu dhe vargje fjalësh me kuptim të figurshëm për të dhënë me shprehësi tipare të njerëzve, objekteve apo dukurive etj.

Fjalët e vargjeve janë gjymtyrë të fushave të ndryshme leksikore dhe kuptimore. Secili varg paraqet një pjesë të realitetit ose një imazh të realitetit. Për këtë arsye pjesët e vargut kanë lidhje

kuptimore midis tyre. Fjalët e vargut paraqesin dukuri të ndryshme, objekte apo fenomene, të cilat lidhen dhe gjenden pranë njëra-tjetrës në hapësirë dhe në kohë. Noli realizon vargje që përbëjnë fusha leksikore (tematike) ose fusha semantike. Vargu mund të përmbajë fjalë, që shenjojnë objekte, të cilat bashkekzistojnë në një realitet. Ne trajtuam vargëzimin si fushë tematike.

Fjalët e vargëzuara nga Noli paraqesin shpesh sende e dukuri të së njëjtës pjesë të realitetit. Por ndodh që elementet e vargëzuara, të lidhura njëri me tjetrin u përkasin fushave të ndryshme të realitetit dhe konceptohen si bashkësi. Lexuesi i konsideron ato si të tilla, si bashkësi reale–gjuhësore. Kështu krijon fusha kontekstuale. Pra, elemente nga më të ndryshmet përfshihen në një bashkësi gjuhësore, duke na krijuar fusha kontekstuale.

Punimi anlizoi shtresimin leksikor mjaft të larmishëm të Nolit, duke përdorur fjalë të vjetra, arkaizma, huazime të cilat përdoren siç janë ose u përshtaten rregullave të gjuhës së sotme shqipe. Ai krijon vetë neologjizma. Leksiku i vjetëruar i përdorur nga Noli në këtë vepër ka shërbyer për të karakterizuar epokën, ngjarjet dhe personazhet. Përdorimi dhe shpërndarja e historizmave është e ndryshme.

Fan Noli e përdor me shumë ndjenjë shtresën e vjetëruar të leksikut. Ai shpeshherë përdorë elemente të vjetëruara leksikore për të karakterizuar dhe për të bërë një paraqitje sa më të vërtetë. Pikërisht, këto elemente leksikore të vjetëruara, të përdorura në mënyrë të vazhdueshme nga Noli i japin ligjërimin një atmosferë historike.

Te "Makbethi", ku paraqiten skena, intriga, përpjekje, që ndodhin rreth shek. XV, përdoren me shumicë emërtime të objekteve dhe nocioneve të ndryshme të asaj kohe, por që sot janë vjetëruar bashkë me emërtimet e tyre. Mbeten vetëm si historizma. Është pikërisht përdorimi i tyre që e bën ligjërimin më të gjallë dhe më të vërtetë. Pa ato ligjërimi do të ishte i zbehtë dhe jointeresant. Ato mund të jenë emra që i përkasin fushave të ndryshme.

Historizmat lidhen ngushtë me fatin e sendit e të nocionit që ato emërtojnë, lidhen edhe me etapa të ndryshme historike, ekonomike e kulturore. Sot përdoren vetëm për të dhënë me vërtetësi atë periudhë, si p.sh: **be, aga, pasha**, etj. Dallimi i këtyre fjalëve nga fjalët e vjetëruara është se vetë sendet dhe nocionet që shprehin ato nuk janë më sot. Ato lidhen me një periudhë të kaluar dhe janë zhdukur bashkë me të.

Kështu, historizmat e përdorura nga shkrimtari-përkthyes, Fan Noli, i japin ngjyrim historik periudhës që përshkruan në veprat dhe përkthimet e tij. Kjo spikat në të gjitha veprat e Nolit në përgjithësi dhe në përkthimin e tragjedisë “Makbethi” në veçanti. Sasia e fjalëve të vjetëruara është e ndryshme në tekste të ndryshme të Nolit. Te "Makbethi" ka me shumicë fjalë të vjetëruara. Përkthyesi përqëndrohet qëllimisht te këto elemente për të përshkruar një botë të huaj në një periudhë të largët kohore.

Neologjizmat e përdorura nga Noli dallohen për ngjyrimin e veçantë stilistik. Ato mbajnë shenjën e stileve të ndryshme. Neologjizmat stilistike ndërtohen sipas modeleve prodhuese në gjuhë ose edhe duke u larguar prej tyre. Neologjizmat në përkthimin e veprës “Makbethi” janë të llojit stilistik, janë krijime letrare stilistike, librore ose bisedimore. Zakonisht, ato mbeten brenda veprës e nuk përhapen në ligjërimin e përditshëm.

Pothuaj të gjitha neologjizmat e Nolit kanë ngjyime letrare-artistike ose ngjyime librore. Vetë kërkesat e jetës e të shoqërisë janë shkaku që të lindin fjalë të reja dhe ato formohen duke u mbështetur në pasurinë e gjuhës e sipas ligjeve të saj. Shkenca dhe teknologjia gjithmonë avancon. Objekte dhe procese të reja krijohen vazhdimisht.

Këto zhvillime të pandërprera të shkencës, teknikës, ekonomisë, tregtisë, transportit, etj. kërkojnë dita-ditës nga gjuha plotësimin e fjalorit të saj me fjalë e me shprehje të reja, të domosdoshme për veprimtarinë politike, ekonomike, shoqërore e kulturore. Po ashtu idera dhe ndjenja të reja vijnë nga media dhe nga jeta e përditshme.

Terminologji nga shkenca sociale bëhen pjesë e fjalorit të përditshëm. Për të plotësuar këto kërkesa, në gjuhë lindin neologjizma, leksik i ri, i cili pasuron fjalorin çdo ditë që kalon. Vlen të theksojmë se kur emërtimi i ri ose neologjizmi formohet mbi bazën e shoqërimit të ideve dhe kuptimi i ri ka natyrë të figurshme (plotësisht ose pjesërisht), në këto raste fjala e re paraqitet si kompozim fjalësh të njohura.

Kuptimi i fjalës së re është një shumë e kuptimeve të fjalëve përbërëse. Këtu nuk ka mbartje emërtimi, por një bashkëlidhje fjalësh, të cilat formojnë një njësi të re me kuptim të drejtpërdrejtë. Te neologjizmat e ndeshura në shqipërimin dhe në krijimin e Nolit përfshihen fjalë që i përkasin klasave të ndryshme leksiko-gramatikore, si: emra, mbiemra, folje, ndajfolje. Zakonisht neologjizmat e Nolit janë fjalë të prejardhura.

Duhet të theksojmë se pikërisht në punën me fjalën Noli shënon arritje. Ai është shumë i vëmendshëm për saktësinë kuptimore të fjalës së përkthyer, kujdeset që të sjellë në ligjërim fjalë që e shprehin saktë e drejtë mendimin e origjinalit, duke e paraqitur atë me një forcë shprehëse, e cila buron dhe nga ngjyrimet e ngarkesat kuptimore-emocionale që fiton fjala në ligjërim. Kjo vlen veçanërisht për neologjizmat.

Neologjizmat janë grupe fjalësh, ngjyra stilistikore e të cilave, si dhe funksionet e tyre, dalin nga fakti se ato i përkasin një shtrese të caktuar të leksikut. Mendojmë se të jetuarit në Thrakë pranë Adrianapojës, një zonë turke me disa grupe grekësh në jug të saj, si dhe të studiuarit në Turqi, Greqi dhe në Havard të USA bënë që Fan Noli të ndikohet nga leksiku i përdorur në ato vende dhe për pasojë të përdorë fjalë nga disa shtresa leksikore dhe të mbushë ligjërimin e tij me neologjizma.

Një nga burimet e shprehësisë në letërsinë artistike është krijimi i fjalëve të reja nga huazimet, ose krijimi i neologjizmave, të cilat janë vështruar teorikisht si në aspektin gjuhësor, ashtu dhe në kuadrin e letërsisë artistike. Neologjizmat e përdorura nga Noli janë krijime me efekt të veçantë gjuhësor-stilistikor. Ato, kudo që shfaqen, bien në sy dhe janë mbresëlënëse. Neologjizmat janë një mënyrë e re shprehjeje, ndaj marrin vlerë të veçantë në mbarë leksikun.

Gjatë studimit u analizua se Fan Noli ka krijuar me anë mjetesh dhe mënyrash të ndryshme një numër të madh fjalësh të reja për nevojat që nxirrte zhvillimi i vetë gjuhës. Por ai, sidomos në shkrimet në prozë e veçanërisht në artikujt gazetareskë, ka krijuar për qëllime shprehësie edhe disa fjalë që u takojnë të ashtuquajturave neologjizma stilistike, sepse ato ose marrin kuptim vetëm në frazën ku kanë lindur ose përgjithësisht nuk ndihen të nevojshëm, veç për kontekstin e dhënë.

Neologjizmat dallohen nga ngjyrimi stilistik. Ato mbajnë shenjën e stileve të ndryshme. Neologjizmat stilistike ndërtohen sipas modeleve prodhuese në gjuhë ose edhe duke u larguar prej tyre. Shmangia shfaqet edhe në semantikë. Përgjithësisht kur shprehësia mbështetet te shmangiet kërkohet kujdes i veçantë, sepse mund të arrihet efekti i kundërt ose teksti del me ton të fryrë, të papranueshëm.

Te Noli vihen re edhe neologjizma të shprehura me togfjalësja apo shprehje frazale. Shprehjet e reja frazale janë të përshtatura në gjuhën angleze për të konvertuar foljet në emra. Duhet të theksojmë se te neologjizmat e ndeshura në shqipërimin dhe në krijimin e Nolit

përfshihen fjalë që i përkasin klasave të ndryshme leksiko-gramatikore, si: emra, mbiemra, folje, ndajfolje. Zakonisht, neologjizmat e Nolit janë fjalë të prejardhura. Ato mund të jenë formuar me **parashtesa**, të cilat nuk e ndërrojnë kategorinë leksiko-gramatikore të fjalës nga rrjedhin.

Ngjyrimet emocionale-vlerësuese të këtyre krijimeve janë gjithashtu të dukshme. Formimet e fjalëve të reja shprehin pothuaj të njëjtin kuptim që fjala ka kur është pa parashtesë. Meqë përmbajtja e fjalëve pa parashtesë shpreh qëndrime pohuese ose emocione pozitive. Kuptimi i fjalëve në shqyrtim shoqërohet zakonisht me emocione të njëjta pozitive. Noli di ta përdorë mjaft bukur fjalën e re, e vendos në kontekstin e duhur, duke i dhënë një ngjyrim kuptimor-leksikor mjaft të gjerë dhe të intensifikuar.

Në leksikun e krijimeve dhe të përkthimeve të Fan Nolit është e pamundur të lihen mënjanë fjalët e reja të krijuara nga vetë poeti-përkthyes, i cili ndikohet kryesisht nga anglishtja, turqishtja dhe greqishtja. Ai është shumë i vëmendshëm për saktësinë kuptimore të fjalës së përkthyer, kujdeset që të sjellë në ligjërim fjalë që e shprehin saktë e drejtë mendimin e origjinalit, duke e paraqitur atë me një forcë shprehëse, e cila buron dhe nga ngjyrimet e ngarkesat kuptimore-emocionale që fiton fjala në aktin fjalë/formë krijues.

Neologjizmat e përdorura prej tij i shtojnë informacionit diçka të re, plot ngjyrim, dhe e bëjnë atë shumë tërheqës. Shumica e neologjizmave të përdorura në përkthimin e "Makbethit" janë formuar zakonisht me parashtesa e me prapashtesa të ndryshme, si dhe me përbërje e togfjalësha, të prejardhura e të formuara (zakonisht) nga morfema të greqishtes së vjetër dhe latinishtes etj.

Neologjizmat e përdorura të "Makbethi" janë krijime të Nolit, i cili jo vetëm i sajonte fjalët e reja sipas nevojave që i lindnin, por tregojnë se Noli kishte njohuri të thella për modelet popullore të formimit të fjalëve, si dhe aftësinë për të manovruar me ato. Neologjizmat e krijuara nga Noli janë një pasuri dhe larmi e fjalorit që e bën lexuesin të lexojë me kënaqësi veprat e tij, pavarësisht gjinisë së tyre.

Fjalët e huazuara dhe të përdorura prej Nolit marrin një tingëllim amtar, sepse ata u nënshtrohen rregullave gramatikore-stilistikore të gjuhës shqipe. Noli është ndër shkrimtarët që ka punuar me fjalët e huaja dhe është përpjekur që t'u japë një trajtë shqipe, duke u mbështetur në tiparet asimiluese të gjuhës shqipe, si dhe përshtatjes së morfemave ndajshitesore të fillimit dhe të fundit me morfema të ngjashme nga të brumit të saj.

Në gjuhën shqipe, në disa raste, krahas një fjale është pranuar fjala e huaj si në rastet kur ka qenë një term ndërkombëtar mjeksor, si: *epilepsi, grip, kancer, tuberkuloz*, etj. Fjala e huaj është pranuar edhe kur e ka kërkuar një stil i caktuar i gjuhës, si stili shkencor dhe ai politiko-shoqëror. Fjalët e reja që huazohen nga gjuhët e huaja i nënshtrohen sistemit fonetik e gramatikor të gjuhës në të cilën futet fjala e huazuar, d.m.th. shkruhen e shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit të saj dhe përshtaten sipas rregullave gramatikore.

Nga përdorimi i shpeshtë i fjalëve të sipërpërmendura të krijohet imazhi që këto fjalë janë fjalë të mirëfillta shqipe. Një pjesë e mirë e huazimeve që përdor Noli janë greqizma. Shtresa e huazuar nga greqishtja është ndër më të hershmet.

Sasia e bollshme e fjalëve të huaja flet jo vetëm për kulturën e gjerë gjuhësore të shkrimtarit që është dhe përkthyes, por edhe për punën e tij serioze me leksikun, për atë që fjalët e huazuara luajnë një rol shumë të rëndësishëm në letërsinë artistike. Duke rikujtuar një kohë tjetër, siç është periudha në të cilën Shekspiri shkruajti tragjedinë e "Makbethit", huazimet e përdorura nga Noli e paraqesin atë kohë me koloritin e nevojshëm e me pamje të vërtetë.

Mendojmë se ka të bëjë studimi edhe jeta e tij jashtë Shqipërisë që ndikuan në përdorimin e shumtë të leksikut të huazuar. Noli është i përsosur në përdorimin e arkaizmave. Ato japin kohën dhe atmosferën historike, koloritin e mjedisit, karakterizojnë gjuhën e personazheve. Kjo shtresë ndihmon për të arritur tonin solemn, që e kërkon gojëtaria dhe poezia.

Arkaizmat bëjnë efekt me trajtën tingullore ose fjalëformimin e pazakontë. Fan Noli ka arritur arkaizimin e gjuhës, ku me një mjeshtëri të veçantë ndërthuren shumë përftesa, madje duke i ngritur orientalizmat deri në stilin biblik. Duhet theksuar se arkaizmat, zakonisht, nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës standarde, por në letërsi përdoren me vlera stilistike të veçanta.

Kështu, historizmat e sidomos arkaizmat e gjuhës shqipe përdoren nga Noli për t'i dhënë ngjyrim historik dhe arkaik periudhës që përshkruan në veprat e tij origjinale apo në përkthimet e veprave klasike. Fjalët arkaike të Nolit shenjojnë tituj socialë, janë emra njerëzish, emra profesionesh dhe objektesh, shprehin lloje të ndryshme nocionesh, përdoren mbiemra neologjikë, fjalë që shenjojnë aktivitete ose përshkrime aktiviteteve.

Qëllimi kryesor i përdorimit të këtij leksiku arkaik është paraqitja me vërtetësi dhe art e periudhave kohore, e njerëzve, mentaliteteve dhe psikologjive në rrjedhë të kohërave. Në leksikun e Fan Nolit arkaizmat përbëjnë një grup të mirë fjalësh, të cilat lidhen edhe me

historizmat. Ndarja e shtresës së vjetëruar në arkaizma e historizma është mbështetur në ndarjen që bëhet në tekstin e leksikologjisë së gjuhës shqipe.

Arkaizmat janë fjalë që janë vjetruar a po vjetërohen dhe për këtë arsye kanë dalë ose po dalin nga përdorimi, kalojnë nga shtresa aktive në shtresën pasive të leksikut. Arkaizmat zenë një vend të rëndësishëm në veprën e Nolit. Megjithë prirjen e autorit për të përdorur leksikun normativ të gjuhës së sotme ai u bën vend në fjalorin e tij dhe arkaizmave që kryejnë funksione të caktuara. Janë pikërisht arkaizmat e përdorura me aq mjeshtri nga Noli që na japin në mënyrë autentike atmosferën e shekullit XV-XVI.

Arkaizmat nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës standarde, por në letërsi përdoren me vlera stilistike të veçanta..

. Përdorimi i falëve të vjetra, neologjizmave, huazimeve dhe i arkaizmave nga Noli i shtojnë informacionit diçka të re plot ngjyime dhe figuracione, duke e bërë punimin autentik dhe tërheqës. Përdorimi i falëve të vjetra, neologjizmave, huazimeve dhe i arkaizmave nga Noli i shtojnë informacionit ngjyime dhe asociacione duke e bërë punimin autentik dhe tërheqës.

Përsa i përket figuracionit të përdorur te përkthimi i “Makbethit” metafora ka vlera shumë të mëdha stilistike, ka ngjashmëri me krahasimin, lind mbi bazën e një krahasimi, por nuk është krahasim, edhe pse mund të zhvillohet si një krahasim. Ajo, ashtu si dhe metonimia janë figura të përdorura dendur nga Noli në tërë veprat e tij, dhe te përkthimi i "Makbethit" të Shekspirit në veçanti. Noli është njohës shumë i mirë i këtyre metaforave dhe bën një dallim të dukshëm midis metaforave gjuhësore nga ato leksikore. Ai i përdor mjaft mirë këto në ligjërimin e tij. Në shqipërimin e tij del në pah përdorimi i metaforave stilistike.

Gjatë procesit të zhvillimit, metaforat stilistike mund të kalojnë në metafora leksikore. Ndaj mund të themi se nuk është e lehtë që të vendoset një kufi midis këtyre metaforave. Përftimi i këtyre metaforave leksikologjike nga ato stilistike ndodh me kalimin e kohës, gjatë zhvillimeve gjuhësore. Kur kemi të bëjmë me një vepër letrare-artistike, që faktikisht është një realitet gjuhësor sinkronik, që merret me studimin e sistemit të gjuhës në një fazë historike të zhvillimit të saj, nuk mund të diskutohet kalimi nga figurativja në fakte gjuhësore, sepse shtrirja hapsinore dhe koha e gjuhës së veprës janë të pamjaftueshme për realizimin e transformimit si mjet figurativ-fakt gjuhësor.

Metaforat e përdorura nga Noli mund të përshkruajnë 1. një proces apo gjendje mendore si një koncept, një cilësi apo veprim; 2. ose ato synojnë të ngjallin emocione, ndjenja, interesa, të qartësojnë, të kënaqin, të lehtësojnë si dhe të surprizojnë. Ato shprehin dy qëllime. Qëllimi i parë është njohës, i dyti estetik. Në një metaforë të mirë të dy qëllimet janë paralelisht të lidhura ngushtë me përmbajtjen dhe formën. Sipas mendimit tonë të dy qëllimet përfshijnë iluzionin. Gjatë gjithë ligjëritimit të tij Noli na i paraqet këto lidhje.

Në realizimin e metaforave shpeshherë sendet jofrymore apo organe të veçanta të trupit marrin emërtime frymorësh. Kështu, ato fitojnë lëvizshmëri, gjallëri, veprimtarinë shpirtërore e mendore të qenieve të gjalla. Në përqasjen e këtyre objekteve me qeniet frymore dhe me ato biblike, këto metafora fitojnë shprehësi të dukshme. Po ashtu nocionet abstrakte paraqiten me emërtimin e një sendi konkret, p.sh. **Zemra ma desh bekimn' e perëndisë**. Mund të themi se kuptimi dhe shprehësia e metaforës mund të jetë e gjallë, e harxhuar apo e fshirë. Ajo mund të jetë shprehur me emër, mbiemër, folje, ndajfolje etj.

Metaforat janë të ndërtuara dhe shprehen në të njëjtën mënyrë edhe në gjuhën angleze. Ato janë shqipëruar në mënyrë të kuptueshme e të përsosur nga Noli. Njohja e thellë e gjuhës së popullit nga Noli duket edhe në shfrytëzimin me mjeshtëri për shprehësi të metaforave popullore, që me kohë vijnë e marrin vlerën e kuptimeve të mëvetësishme të një fjale edhe në ligjëratat e shkrimet publicistike.

Nga Xhevat Lloshi mësuam se: metonimia si mjet i stilistikës letrare ka efekt pikërisht kur vendosen lidhje afërie që asnjëherë nuk kanë qenë në mendjen tonë dhe që më së shpeshti as përftesat gjuhësore nuk kanë qenë në stilema të njohura gjuhësore. Metonimia është një figurë letrare, e cila zëvendëson emrin e një gjëje me emrin e tjetrës me të cilën në njëfarë mënyre është e lidhur.

Ndryshe nga figurat e tjera letrare, metonimia bazohet në një transferim. Metonimia vështirëson, komplikon, zhvillon, përpunon zhvendosjen midis koncepteve të shoqëruara. Shpesh rezulton të jetë zhvendosje midis pjesës dhe të tërës, një institucioni dhe lokalizimit etj. Metonimia mund të jetë gjuhësore dhe stilistikore.

Metonimia gjuhësore dhe ajo stilistikore kanë të bëjnë me emërtimin e një objekti apo dukurie me anë të një fjale që shenjon një tjetër objekt apo dukuri. Midis tyre ka lidhje në kohë dhe hapësirë, shfrytëzohen lidhje shkak-pasojë, mbajtje-përmbajtje, pjesë-e tërë. Kur kuptimi i ri

metonimik është ngulitur nga përdorimi, ai bëhet një kuptim i prejardhur i fjalës së dhënë, zhvendosja nuk dihet, kemi të bëjmë me një emërtim direkt të dukurisë apo sendit, p.sh punim, punë, vepër, studim; gotë “pija që nxë një enë e tillë etj.

Në fjalorin e termave të letërsisë metonimia përkufizohet si një trope që formohet kur ua ndryshojmë emrat objekteve apo ideve, duke i quajtur me emra të tjerë që kanë lidhje të ngushtë me to. Metonimia gjuhësore dallon nga ajo stilistikore. Autorë të ndryshëm mbajnë qëndrime të ndryshme në dallimin midis metonimisë stilistikore nga ajo gjuhësore. Disa i vlerësojnë njëloj. Në raste kur kuptimi metonimik përthithet nga përdorimi i shpeshtë, ai bëhet kuptim i prejardhur i fjalës, d.m.th zhvendosja nuk ndihet, kështu kemi të bëjmë me një emërtim të drejtpërdrejtë të dukurisë, të asaj çfarë duam të shprehim

Metonimia është një fjalë apo shprehje e përdorur në vend të një fjale tjetër. Metonimia e Shekspirit në origjinal është përkthyer përsosshmërisht nga Noli. Ato nuk kanë asnjë dallim (në ndërtim e në shprehësi) nga njëra gjuhë në tjetrën.

Si përfundim, themi se Noli me anë të përdorimit të figurave letrare, të metaforës, metonimisë etj. në përkthimin e tij ka bërë që shqipërimi i “Makbethit” të Shekspirit të lexohet gjithmonë dhe me shumë dëshirë nga shqipfolësit kudo që të jenë. Robert Dale Parker në librin "How to interpret Literature" shkruan se Roman Jakobson shprehet për metaforën dhe metoniminë se janë figura retorike dhe pretendon se **metafora** dominon vizatimin surrealist, në romantizëm, simbolizëm dhe poezi, ndërsa **metonimia** dominon në vizatimet kubiste, në veprat realiste, dhe në prozë.

Por, puna jonë kërkimore shkencore do të vazhdojë më tej në mënyrë të pandërprerë për të gjetur të tjera vlera letrare e gjuhësore të Nolit, jo vetëm të "Makbethi", por dhe në përkthimet apo krijimet e tij. Do të vazhdojmë të shtjellojmë më tej shumë çështje e dukuri, duke bërë analiza më të detajuara nga ato të paraqitura në kapitujt e disertacionit. Mund të nevojitet një tjetër drejtim kërkimor për të hedhur dritë mbi leksikun shprehës të Nolit, konkretisht mbi figuracionin. Do të studiojmë të gjejmë përdorime të figurave të tjera letrare-artistike nga Noli. Puna do të jetë e vazhdueshme, këmbëngulëse dhe e përhershme.

BIBLIOGRAFIA

Materiale të vjelura

Fan Noli, Makbethi Shqip, Tiranë, 1943

Great books of the Western world, Robert Maynard Hutchins, Editor in Chief 27, Shakespeare;II

The plays and Sonnets of William Shakespeare Volume Two William Benton, publisher 1952

Nasho Jorgaqi, Fan Noli, Volume 1+2, Tiranë 2015

Jorgaqi Nasho, Jeta e Fan S. Nolit, Ombra GVG vëllimi i parë, Botim i parë, Dhjetor 2005

Jorgaqi Nasho, Jeta e Fan S.Nolit ,Vëllimi i 2, Botim i parë, OMBRA GVG 2005,

Lloshi Xhevat, Stilistika e gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, Albas 2005

Agalliu, F, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Monografi, TOENA,1999.

Referenca

Agalliu, F, Gjuha e Nolit në veprat origjinale të tij, Monografi, TOENA,1999.

Ballhysa, A., Jashari,A., Formimi i Shprehive Komunikative, “Flesh” Tiranë, Copyright 2011.

Cambridge Advanced Learner’s dictionary, CD-ROM version1.1 Cambridge University press, 2003

Chomsky, N (1957). Syntactic Structures. The Hague: Mouton de Gryter.

Chomsky, N. (1965). Aspects of the theory of syntax. Cambridge, MA:MIT press.

Clifford E.Landers, Literary Translation , A practical Guide Great Britain ,by Cromwell Press Ltd.2001

Çabeji Eqrem, revista “Nëntori”, nr.4, viti 1965.

Çabej Eqrem, F. S. Noli në bashkëkohasit, ribotim Rilindja, Prishtinë, 1968.

Çeliku Mehmet, Sintaksë e Gjuhës Shqipe (Përbërësit Sintaksore), Tiranë 2012,

Dictionary, com Unabridged Based on the Random House Dictionary, © Random House, Inc.

Dictionary.com ëbsite: <http://dictionary.com>.

Dibra Klodeta, Varfi Nonda, Gjuhësi teksti, Ribotim, shblu,Tiranë,2005

D.I Slobin, Learning to think for speaking:Native language cognition, and rhetorical style, Pragmatics, 1991.

Fjalor i Shqipes së Sotme, Akademia e shkencave të Shqipërisë, Botimet Toena, 2002.

Fjalor i shqipes së sotme, Akademia e shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2006.

Fjalor i shqipes së sotme, Akademia e shkencave të RPSSH, Tiranë, 1980.

Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, III, 2, Tiranë, 1983,

Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës së Sotme Letrare Shqipe, II,Tiranë, 1976,

Gazeta Drita. 27.3.1983

Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë , 1995

J.A. Fodor, The language of Thought. New Jork :Croëell. 1975

J.A. Fodor, The modularity of mind Cambridge, MA:MIT press. 1983

Jorgaqi Nasho, Jeta E Fan S. Nolit, Ombra GVG vëllimi i parë , Botim i parë, Dhjetor 2005

Jorgaqi Nasho, Jeta e Fan S.Nolit ,Vëllimi i 2, Botim i parë, OMBRA GVG 2005,

Kuteli Mitrush, Poeti F. S. Noli, Vështrim panoramik, në “Kuteli, Shënime letrare”, Grand Prind 2007, Botuar për herë të parë në librin “Fan S. Noli, Mall e brengë” (Me një vështrim kritik prej Mitrush Kutelit),

Kostallari A, Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve, 1,1972.

Leka F, F.Podgorica , S.Hoxha, Fjalor shpjegues i termave të letërsisë” Tiranë 1972

Lloshi Xhevat, Stilistika e gjuhës Shqipe dhe Pragmatika, Albas 2005,

Lloshi Xhevat, Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe, Studime mbi leksikun e mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, 1972,

Lloshi Xhevat, “njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe” Tiranë 1987,

Memushaj,Rami, Gjuhësia Gjenerative, Botim i dytë, shblu,Tiranë 2008

Memushaj Rami, Hyrje Në Gjuhësi, Botimet TOENA Tiranë, botim i katërt, 2006,

Newmak Peter, A textbook of translation, Prentice Hall Europe, 1988

Noli, Fan S.,Vepra 5, Akademia E Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë,1988,

Noli, S.Fan,Vepra 3, Akademia E Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë,1987,

Noli, Fan S,Vepra 4, Akademia E Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë,1989,

Noli, Fan S, Poezi të zgjedhura, përkthime, introdukta, shtëpia botuese Dituria,1998,

Noli, Fan S, Makbethi I Shekspir, Tiranë, Shtëpia Botuese N. Frashëri, 1943

Noli,Fan, S, Autobiografia ,Shtëpia Botuese Elena Gjika , Tiranë 1994

Online Etymology Dictionary, © 2010 Douglas Harper

Internet: Jeta e Fan Nolit Posted by [AGJENCIONI FLORIPRESS](#) at [Monday, September 02, 2013](#)

Oxford English Dictionary, second edition, on line version

P. Simpson, Stylistics, Routledge, Taylornd Francis Group, London-New York, 2004.

Plangarica Tomorr, Hyrje në studimin e kuptimit Semantikë dhe pragmatikë, Analizë Pragmatike e teksteve, Elbasan , 2013,

Plangarica Tomorr, Universi I Vlerave Të Munguara, Botim I Dytë, Sejko 2002,

Qosja Rexhep, Fan Noli, në “Panteoni i rralluar”, Tiranë 1988,

R.D. Parker. How to interpret Literature Critical Theory for Literature and cultural studies, Oxford University Press, 2008.

Ristani Viktor, Kontribut në Studimet Përkthimore Gjatë Viteve '90, shtëpia botuese Geer, 2010

Sadiku Emine, Vëzhgime mbi leksikun shprehës në prozën e Ismail Kadarese , Tirane 1998

Sadiku Emine, Kadareja ky Stilist I Madh. Tiranë, 2000.

Shakespeare, Great Books of the Western World, volume 2. 1952

Stefanllari,I. (2011). A course of English lexicology. Shtëpia botuese “Geer”.

Thomai Jani, Leksikologjia e Gjuhës Shqipe, 1974,

Thomai Jani. (1989) Prejardhja semantike në gjuhën shqipe.

Tupja Edmond, Këshilla një përkthyesi të ri, Onufri, Tiranë, 2000
 Vepra 5 , Fan S. Noli, prof.Aleks Buda, Prof. Vehbi Balla, prof.dr.Koco Bihiku, doc. Nasho Jorgaqi, Jeta e Fan S. Nolit
 X.J.Kennedy, Literature, an introduction to fiction, poetry and drama, fourth edition, Boston, Toronto 1987
 Xhuvani Aleksandër, K.Cepo”Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme” Tiranë, 1930.
 Cambridge Advanced Learner’s dictionary, CD-ROM version1.1 Cambridge University press, 2003.
 Oxford advanced learner’s dictionary, botimi 8, Oxford University press,
Fjalor, internet
 Internet: Jeta e Fan Nolit Posted by [AGJENCIONI FLORIPRESS](#) at [Monday, September 02, 2013](#)
 Roget’s thesaurus of English words and phrases, on line version.

Burime nga interneti

Internet:Fjala e lirë, prof. Zymer Mehani, Analizë e përmbledhjes ‘Album’ Fan S.Noli’.nga Admin, 11shkurt 2017
 Internet: Kumtesë e lexuar nga Shefkije Islamaj në Seminarin XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare.
 Internet:Posted by [AGJENCIONI FLORIPRESS](#) [Monday, September 02, 2013](#)
[priftipirro@hotmail.com/Agjensia e Lajmeve Sot News/](#)
 m.k.Balkan web, Shpëtim Çuçka, përkthyes, publicist.19 nëntor 2015
 Google.com edward bulwer- lytton,quote.

SUMMARY OF THE SCIENTIFIC RESEARCH

Topic: Distinctive quality of expressive lexicon and style in the tragedy of “Macbeth”. A comparative view between the original text of Shakespeare and the translated one by Noli

The dissertation is aimed at the *distinctive quality of expressive lexicon and style* in the works of Fan Noli in general, and the expressive lexicon and style in the translation of Shakespeare's famous tragedy of "Macbeth" in particular.

The distribution and enrichment of today's literary Albanian language can not be imagined without the remarkable contribution of artistic literature, original and the translated one. The value of literary works can not be fully understood without studying the masterly work of the writers and translators by the means of the language as an inseparable part of creativity. Bringing into evidence the means and the ways of expressive lexicon helps to grasp the style of each author, that is part of the stylistic diversity of artistic literature.

This paper attempts to present and analyse exactly the features of the speech of semantic-lexical field that become the best expressive art and style. The special object of the work is therefore the word that has or gains the stylistic value in speech. The comparative treatment of the theme has brought abundant information on Fan Noli's sources.

The realization of this work is based on rich theoretical sources of different linguists and the tragedy of "Macbeth" in English and in the Albanian language. Equivalent - comparative methods have been used.

From the analysis above and study, I came to the conclusion that Noli's poetic creativity is among the most powerful literature with great value, which is inspired and directed by humanist philosophy. Noli holds a masterful attitude in stylistic choice, in dealing with the language. He is an unusual expert in the thesaurus of the language. In his creations and translations, he works based on a guiding principle which leads, and characterizes the organized comprehensiveness by achieving the peculiarity, and defines the type of discourse, the types of styles. The principle brings unity.

The first chapter has to do with *translation and the translator*. In his poetic translations, Noli did the work of a recreator, so many of his translations can be kept as his creations. Therefore, the reader is not surprised to see that Kadare's verse "*Dasmë që shkrepëtinte nga zia*", translated by Noli, from the Russian poet, Fyodor Tjutchev, illustrates it as a verse of Noli's creation.

In artistic literature, the guiding principle is the origin of the creation of a literary work. The guiding principles in literary works are interconnected with the artistic and aesthetic principles of the author through the used lexicon. In his creativity, Noli uses expressive connotation that arises in connection with the elements of language.

The speaker consciously addresses various linguistic resources. Noli uses these linguistic forms to draw attention because this is his favourite field of artistic literature.

At Noli's phonetic level we notice that rhyme and accents are in the same places. There are verses that begin with the same sound and have a high degree of similarity. At grammatical level there is complete parallelism of the forms and the construction, in this way he creates (Isotope).

This combination of procreations of all levels explains precisely the expressive force of the verses. In his style, there is a sound symbolism which implies the sound-sense connection and the procreation which are used to achieve different effects. Fan Noli is the master of using sound effects. He has accumulated oriental words to give the Biblical heavy atmosphere by utilizing their synchronicity.

From the analysis, we have learned that the translation for Noli was a social mission, not a personal one. It was much more a progressive social mission-because it was in the service of the truth not that of the reaction. Noli was a true culture man. He was not simply with information culture. He was with the culture of thought, reasoning, and logic. Today, he remains impassible, as a working principle and as an evaluation criterion for translations.

Translation for him was not simply translating a structure or a piece of writing from one language to another, but re-giving to another language the cultural-historical features embedded in the language content, passing from one tradition to another the forms of communication, confession, description of the dialogue and the transmission of emotional feelings, tonality and expressiveness.

Noli became an undisputed master of the translations of Shakespeare's works. I think this phenomenon was a feature of Noli's discourse as a writer and translator. His skill lied in creating Albanian constructions. In some cases, while translating, Noli avoided to translate some original words, but he remained loyal to the context. Noli achieved this form of translation with the lexical that he possessed in a broad sense. He enriched the speech with grammatical and meaningful forms. The verb forms have a stylistic and dialectical valuation.

With his translations, his purpose was enriching the Albanian culture, with the most important and best creations of the other people.

He was also a master in translations of other literary works by using an excellent discourse. Nobody else up to now has ever been able to translate so beautifully, with a complex nature of words where the depth of thought, the imposition of a sense for murder, for power, and the possibility of associative fulfilment by the reader is prominent. In his poetic translations, Noli did a wonderful work.

Fan Noli did not put on paper an event that he experienced himself, but what he read, something written by Shakespeare. In his translations, there is aesthetic assimilation, aesthetic reality, so there is art. There is art, because there is a genuine creation, and at the same time there is recreation. We say that there exists art because there is creation.

There is recreation since Shakespeare did not write "Macbeth" in the Albanian language, but in the English language; in the Albanian language it was written by Fan Noli; that is, in the Albanian language it was created by Noli.

Noli was a master in finding a faithful translation in order to create the link between the original work of Shakespeare and the translated one by him. For Noli, the word was the most important thing. It is because of this that in his discourse Noli used the exact words, as he himself experienced the situation.

While translating Noli achieved to structure a text, that combined semantic accuracy with pragmatic language functionality, in a new linguistic and cultural context according to the terms of communication and the discourse situation.

In this context, it is also worth emphasizing the fact that style should not be considered merely as decoration, but, as an appropriate way of using expressive language skills in a given situation, by respecting the general linguistic translation structure.

So, the translator should not only know the language but also the history and topography of the country for which the work which is going to be translated is written. Noli achieved this principle quite well. Noli's expressive lexicon had different sources. His translations and creations are characterized by true spiritual inspiration and experience.

The study has analyzed some of the main sources of expressiveness in translating the tragedy of "Macbeth"

In "Macbeth", there is a strong emotional response to the problems that were inspired by the magistrates. It is precisely the imagination and the spiritual participation that influenced in the fulfillment of the use of the expressive lexicon. Noli's expressive lexicon is diversified.

To give a more concrete idea of the type of Noli's translation, *we are giving a table with statistics on the types and manners of literary translation of "Macbeth"*.

No.	Type of translation	No. of verses	%
1	Literal translation	2142 verses	87%
2	Contextual translation	156 verses	6.3%
3	Translation with extended words	64 verses	2.6%
4	Adaptive translation	40 verses	1.6%
5	Translation with deleted words	35 verses	1.5%
6	Translation with added ideas + opinions	15 verses	0.6%

Noli translated 2452 verses of "Macbeth".

1. As it can be seen from the table, literal translation occupies the first place with 87% of the verses. In fact Literal translation creates fluency and transparency

2. From the analysis of translation of the verses, in the second place is the contextual translation. This kind of translation occupies 6.3% of the verses. The contextual translation proves that not only did Noli know the language but furthermore he knew the culture of the country for which the written text was going to be translated.

3. In order to give a more realistic understanding and make translation as reliable as possible, Noli in some verses had offset the thought by extending words or expressions that were not in the original, in order to regain a previous or a later loss.

4. From the study we found out another feature in Noli's translation style. It is adaptive translation. This kind of translation is necessary for idiomatic expressions. This kind occupies 1.6% of the verses.

In this case Shakespeare's "Macbeth" was not translated word for word but by choosing the expressions and phrases which coincided with the translated language.

5. The removal of some words is another characteristic in Noli's translation. According to the principle: to translate means 'to polish and throw away'. In this way while translating, Noli has left some untranslated words, but the idea does not change, it is just the same, it is understood.

6. Finally, according to my idea, from 'Macbeth's translation study, it turns out that only 15 verses or 0.6% are translations in which Noli has extended the verse by using his ideas or opinions.

In this case, Noli elaborated a series of analytical considerations that made a manual translation to match an entire manual language and culture anthropological.

Another feature of Noli's translation is that he did not remain strict to the parts of speech because the idea remains unchanged. There are cases when a verb is not translated as a verb, or an adjective is not translated as an adjective. In this case Noli made contextual adjustments eg:

I know this is a joyful trouble to you. [Sh.:292]

E di që të gëzon ky shqetësim, [N:56]

According to their favorite genre and topics, writers use the language in different ways. We think that most of the lexicon used by Noli has *literary connotation*. These connotations give literary tone to Noli's discourse. The writer uses this tone in a wonderful way that creates diversity, expressiveness, naturalness that conveys emotions.

His skill work with his linguistic expressions is the style which gives the stylistic diversity of the Albanian literature. Noli is one of the writers and translators who is distinguished for his stylistic work.

The suffixes used by Noli play an important role in connotation. Words gain emotional connotation through suffixes with flattering or worsening shades.

Though tragic, the works translated by Noli, sound Albanian. Noli's chosen language has style and connotation. Noli creates words by means of procreations. They are used in different, pleasant and unpleasant situations. Taking into consideration Shpëtim Çuçka's saying, we conclude that the works of Noli, first and foremost, are distinguished for their semantic clarity, because today the Albanian literary has made extraordinary advances, which make us proud of our language science. Noli's literary Albanian remains deeply understandable, clear and aesthetically pleasing to the reader.

With his great experience, Fan Noli remains a symbol of the Albanian translation. Noli is among those unusual figures of our history that have highlighted the values of their activity in different areas where they are involved. Noli has been - to repeat somehow the words of Ofelia, when named Hamlet: -publicist, politician, statesman, poet, clergyman and critic of literature; historian, musician and translator.

In the part of lexical-semantic procreation (creation of new words through suffixes or prefixes), theoretical concepts of stylistic value, stylistic connotation, expressive connotation of the affective and semantic order are treated in theoretical plan.

Procreations (instead of the word *procede*) is the inner lingual mechanism of the composite unit (*or Stilema* as *Lloshi* calls it). *Stilema* is a ready-made discourse as product and process where the inner processes, procreations have taken shape, and are crystallized. With his skill Noli manages to use these procreations in an excellent way.

In the dissertation, lexical and discourse features of the lexical level of the language are treated. It is a level in which Noli uses many sources for expressive language, which are closely related to their function. They are described in a fantastic manner by Fan Noli, whose creations and translations are of remarkable artistic value. From the analysis we have observed that words are the ones that have or gain in stylistic values. They are words that, besides the stylistic value, have stylistic connotation, expressive connotation of the affective and semantic order. This paper intends to throw light on the style of the writer-translator, by presenting us in a broader way the stylistic diversity of the Albanian literature.

A particular object of our work is the word, which has or gains *stylistic value* in discourse. This stylistic phenomenon contains different connotations. Such words make up the specific fund of Noli's artistic discourse. The word is the main object of Fan Noli's craftsmanship that contains stylistic values, which during the speech are related to different nuances of the art. These words mark emotionally, mentally vivacity, and make stylistic connotation of the content. They play a predominant semantic and aesthetic role. In this way, words become conveyer of art and the elements of form are conditioned by the content and talents of Noli. The way the words are used show the style of Noli.

Among many linguists, Eqrem Çabej in an essay portrays the majestic and multi-dimensional profile of Fan Noli. This essay remains, as a mental model, a 'Vivendi modus', because it is written on a figure that comes very rarely in history, originating from centuries. Eqren Çabej wanted to show that Fan Noli, as a writer, translator, poet, and scholar, was the prototype of a creator, because Fan Noli was demonic (very talented), which is the first and the main characteristic of a creator and a true poet.

Fan Noli's texts on linguistics and especially the volume of etymological studies are of scientific level. Fan Noli operates with precise notions for contemporary level of world linguistics.

From the study, we analyzed that language serves to shape and communicate thoughts, which are achieved by a system of elements (sounds, morphs, words, gestures, etc.), rules and versification. However, communication is not achieved simply by linking elements under some rules but by combining them in accordance to the reflection of reality, logical continuity, with the speaker's intentions in the communication circumstances.

The *distinctive style* depicts the work of a writer as a wonderful work or not a wonderful one. It is the style that distinguishes his/her work. In fact, we need to understand the poetic language, so as to appreciate the way the message is conveyed, the way the content reaches the reader; the language elements the author uses and the way he harmonizes them.

Many linguists have studied style and stylistic connotation. Lloshi writes that the language is diversified and as such it has potential stylistic values. The poetic language and style make Noli really special.

Noli's different words, such as outdated words, loan words, neologisms, provincialisms, have evocative skills that can be used as stylistic values and give *connotation* to 'stilema' or text. The connotation is conceived from simple words or compositions.

As it is mentioned above the word is the main object of Fan Noli's craftsmanship that contains stylistic values. During the speech the word is related to different nuances of art.

Literary language constantly enriches today. But the elaboration and enrichment of the Albanian language are closely related to the contribution of the artistic literature, with all its genres. This thing helps understand the style of each writer by presenting us the stylistic diversity of the Albanian literature. Compared stylistics has to do with the comparative study of the organization of different languages. It is the lexicon of a language that makes us understand the world of a certain country. In organizing the lexicon we also see some distinguishes, which are of great interest when translating into a foreign language. This phenomenon appears in Fan Noli's creations and translations, which are of outstanding artistic value.

Style is the man himself, his individuality, his existence, his original way of looking at the world; the way how thoughts, emotions, etc. are intermingled. Noli is characterized by his individual style, from the connotation he gives the words.

Much of Noli's expressive lexicon has a literary *connotation*. It is this connotation that gives a literal tone to Noli's discourse. The writer uses this tone magnificently and creates within it diversity, expressiveness, naturalness giving us much emotion.

The artistic values of these variants are seen in the context of the texts in which they are found. When using these variants, Noli, did not always respect his special connotation because a variant of bookish connotation can appear to the discourse of a simple character from everyday life, while a variant with colloquial speech happens to appear in a formal situation, etc. As for the terms of the models used by Noli, they are not equally usable in the communication spheres. They are distinguished by stylistic connotation. Some of them can be used in an everyday conversational style.

Noli has used words, which due to the *semantic consumption* no longer exist in the Albanian language. A part of the study aims at presenting and analyzing the consumed lexicon. We have tried to express why the phenomenon of

semantic consumption has happened. In affective discourse, consumed words that often occur due to the phonetic or semantic reasons are not used.

Weakening of the meaning and regaining expressiveness with another synonym are formal actions with the language. The language always follows the thought. It's the artistic conception of the writer that puts the mechanism of semantic consumption into operation. Noli has a very original, interesting and attractive object. He represents an affective-emotional atmosphere. In his work, a kind of communication with the reader has been consolidated.

In artistic literature semantic literary consumption gains special importance and has a large spread that attracts the reader. The process of semantic consumption in artistic literature is conditioned by the way the material is presented and the form of communicating with the reader.

Semantic consumption realizes other procreations. So the consumed word can be in the text or not, or the writer can bring another word in its place. Noli's lexicon is distinguished by its expressiveness, that is, by its emotional connotation, figures of speech, and so on. The consumed words can be very expressive, or because of an ethic, the writer chooses a word he thinks has better content in use.

Lexical semantic consumption can occur due to the volume of words, the phonetic reasons, contextual synonymy, partial contextual synonymy, and for ethical reasons.

Semantic consumption often acts in fiction, where the expressiveness is a constant distinction of the lexicon. **Through** semantic consumption, we understand expressivity achievement. Semantic consumption in fiction depends on the way the material is presented and on the form of communicating with the reader. Noli's lexicon is very expressive. He has included stylistic consumption in which the word is consumed or it has changed the context. This change depends on the writer's artistic concept with which he/she may replace the word. Noli is original and extremely unusual. He creates effective and very emotional atmosphere. In this way, he creates strong connections among reader-writer —translator.

Semantic consumption can happen for social reasons. In the name of *ethics* or preferable tastes some words are chosen instead of some others because Noli thinks they have better usage and content. Their non-utilization may dim their semantic meaning.

The words which show expressivity are words used as adjectives, or they may show actions, express phenomenon and other items as well. It is for this reason that nouns, verbs, and adjectives in their artistic speech are used in figurative meaning because they contain emotional overtones. When the word has a little volume, it may lack expression. Having little volume, the word either disappears from the use or it takes suffixes or prefixes to survive. This phenomenon appears frequently in the Albanian language.

The examples written by Noli have been consumed semantically together with the consumption of the atmosphere of the affective connotation. The expressive value of the words weakens because of the usage. The words that express emotion, spiritual reaction, subjective assessments, even those which are the strongest and the most expressive ones lose their force when they are repeated too often. From our study, *we come to the conclusion* that one-syllable words consume their semantic content but with the help of prefixes and suffixes, some of them gain new stylistic meanings that make the atmosphere affective and emotional. Consumed semantic expressions are used by Noli for a better functional presentation.

Another problem treated in the second chapter has to do with a *synonymous variation*. It should be emphasized that synonymical variation is necessary for the existence of language in the long, rich life of the people. Ristani states that the essence of the linguistical system, called 'variants', is a common grammatical, lexical and syntactical core that serves for further linguistic structuring as the main support for different diachronic and synchronic uses.

During the study, we learned that the types of variants are distinguished by the changes in history. The old Albanian language comes up to the VIII-IX century when its two major dialects were outlined. Middle Albanian language

comes up to the XVII century and it is called Arbërishte. At the time of Arbëri, the historical demand for writing the Albanian language was necessary and it was born with the book of Gjon Buzuku, in 1555. That is the main variant of the middle Albanian language of the old authors. The New Albanian language is from the 18th century to the present day. In this period, three phases are distinguished, the second is the Renaissance (approximately during the years 1820-1920), and the third phase, which refers to today's language, is after the years 1920s.

Semantic variants, which are synonyms, are distinguished by the degree of appearance of a meaningful feature. Through the analysis, we learned that the essence of variation, and consequently that of style, constituting the link between language, context, and language behaviour in a given discourse situation, is the difference which can be analyzed based on the comparison. That is necessary to put the degree of stylistic variation in specific discourse situations. Stylistic effects are created as a result of deviations from the use that is more than normal for the given situation. In any case, in the speaker/listener, writer/reader relationship, a certain precautionary measure is set, depending on the connection to the message-speech situation, consequently, the expected message satisfies the requirements or disappoints the listener/ reader. If the message meets the requirements then it matches the style. Noli uses artistic expressions with which he often creates synonymous variations. Synonyms are an objective phenomenon in languages since there are words, morphological forms, categories, and grammatical structures that have close, but not the same meanings.

However, writers are not limited to the opportunities that lie ahead of the synonymic of the language, in general, they try to introduce in synonymous terms other new means. Not only does the poverty of synonyms show carelessness, but it also shows ignorance. Noli is very skilled in the use of synonymous means by which the intention is that thoughts and feelings must be given in beautiful stylistic connotation.

So he creates from the root of a noun for example *crown*, the adjective *crowned*. These parallel units differ from each other. They express emotional connotation. The element that has emotional connotation completes the other element. They also have differences that relate to their semantics and expressiveness. Although both synonymous variants are the second terms of the sentence, the determinative noun or even the noun plays an independent syntactical role. This has to do with the morphological features of the word. The noun in the function of the determinative gives the most detailed quality.

Noli artistically uses all the opportunities that the language offers for a more detailed idea and emotions. He creates a variety of expressions with synonymous variants expressed in different forms, such as a noun with an adjective, a noun with a verb, a noun with a noun, an adjective with a verb, an adjective with an adjective, a verb with a verb.

Synonymous variations show more precisely and strongly the connotation features of the words. From the analysis we observed that the same phenomenon occurs in the English language: (mystery)=(mister) noun, (mysterious) (misterioze) adjective, etc

The work continues with the *semantic equalization*. In semantic equalization, words enter judgment with their true meaning and the judgment admits their sense of equality. The subject and the predicate are imagined by the writer and the reader as semantic equivalents. What is said about the subject is not compared to what is said in the predicate but it is equalized to that. Thus, interesting and influencing '*stilemas*' are obtained. The aim is to have equality where there is no equality.

It is worth pointing out that semantic equalization is realized when lexical units with different semantic meanings take the sign of equality and are equally matched. Semantic equalization creates a great and beautiful attraction. The equalization is used to highlight notions and make them more prominent. They also tend to approach meaningfully gaining each other's connotation.

Noli creates many semantic equalizations. It equalizes two words that, if viewed separately, have quite different meanings. If we look syntactically, the subject and the predicate are notions of different content. It is the context that differentiates them. Words have no figurative use.

The semantic equalization used by Noli occurs when lexical units with different semantic meanings take the equality mark and are equally matched. The same phenomenon is true for the English language because in most cases the same phenomenon is observed, that is, the equalization is expressed in English in the same form as in the Albanian language.

During the analysis of Noli's "Macbeth", *lexical radiation* was observed. It is another issue treated in this work. It is related to the concentration of the semantic emotional connotation with a suffix, ending, or prefix that colours the whole word. The semantic, emotional-expressive connotation that a word gains is owed only to an element of the word, a meaningless independent lexical element.

Radiation has to do with the semantic and emotional connotation that a word conceives due to suffixes, or prefixes. To present the semantic radiation phenomenon, the words are grouped according to the units obtained through procreation.

Some Albanian suffixes are: -*z(ë)*, -*osh*, -*ça*, -*or(e)*, -*em*, -*inë*, -*aq*, -*an*, -*ra*, -*or*, -*ak*, -*ik(e)*, -*kë*, -*ok(e)*, -*llëk*, -*osh(e)*, -*çkë*, -*th*, -*yer*. These suffixes, do not create new lexical units, but they create different emotional and stylistic patterns.

The significance of the enlargement of the units formed by suffixes, give emotional connotation. They can be observed in the Albanian language. Thus, in Albanian language nouns with diminutive meanings are formed with the suffixes -*th*, -*z(ë)* *Bird*, (*zogth*), *house* (*shtëpizë*), *shelter* (*strehëz*).

I want to stress that in the translation of "Macbeth" we notice the distinction of Noli's lexicon with the Albanian prefix "*pa-*" to express negation.

In Shakespeare's examples, we come across the suffix *-less* to create negation.

Semantic expansion and its variations is treated in the third chapter.

The phenomenon of *dubbing* is another issue treated in this work. It creates semantic equalization by giving us semantic synonyms. But in dubbing, the synonymy between the constituent elements are not complete. This does not mean and does not quite express the same notion. Among them, there are semantic and expressive differences.

One element has a direct meaning, while the other has a figurative one. The figurative term functions as an expressive equivalence for the other term. It is because of this we say that the semantic synonymy between the elements of dubbing is contextual. From a stylistic point of view, one of the terms is neutral.

Xh. Lloshi points out that when we use two nouns for the same notion, we are dealing with dubbing. The denominations can be expressed: one by neutral means, the other by expressive means. Both denominations are located in the same place and constitute a whole, double denomination. The second term completes the meaning of the first one. Dubbing happens for clarification, for precision. One term clarifies the meaning of the other. Often, the marked term is included in the notion expressed by the second term. This notion has more defined content, giving definite ability. Dubbing occurs in English almost in the same way.

Dubbing is a productive way to build stylistic units that present wider information and a higher and more prominent expressiveness. Not only does dubbing have value for its beauty, expressive power, and its attractive force but it also has multiple services that perform in discourse. The terms that participate in dubbing, give their contribution to the content and expressiveness of the newly formed group. While in English, according to our studies we notice the use

of synonyms. The English language is very rich in synonyms. Noli knew how to translate them, enriching in this way the Albanian language, making it more vivid and more expressive.

The semantic expansion is treated in the third chapter of this work. In Noli's creations and translations, there are often two or more words that mark either the quality, the actions, the objects, or the circumstances. The connection is with coordination, with conjunctions in order to reinforce the idea expressed by the sentence.

We distinguish the connection with co-ordination, by means of conjunctions **and, or, yes, but**. The connectors can be logical. They express a logical connection.

By expansion of the terms, it is possible to present the most voluminous presentation of thoughts and emotions. These are actions that succeed each other.

Noli is the master in using words. In his manoeuvres with the words, he puts them in a line one after the other, in a coordinated way. In such cases, the string containing two or more words are obtained. This phenomenon is Noli's feature. These strings of words have common characteristics, in the way they are connected among them. They are linked to each other by means of conjunctions or in asyndeton co-ordination. The longer the string becomes, the greater the information is and, together with the information, the effect of the expression grows.

The creation of these string of words attracts the variety of elements to which they are related. The strings of words are linked one after the other impressing the listener or reader.

The strings of words written by Noli often represent objects and phenomenon of the same part of reality. But it happens that the lined elements belong to different areas of reality and are conceived as a community. The reader considers them as such, as a real-language community. This creates contextual fields. The coordinated words can form different, realistic thematic links.

Chapter four treats *old words as lexical units*. It shows the spheres of usage and their stylistic functions. The dissertation presents that Noli, as a great stylist, has enriched the lexicon with old words which reflect the culture and folklore of the Albanian language. The study emphasises that Noli is a skilled-translator in selecting and in using old words. In this way, he gives the readers a beautiful creation. Noli creates the idea that not only does the beauty of narration have much to do with the existing used language and lexicon but it also has to do with the use of old words in order to conceive better the events and situations. It shows that the old lexical elements are systematically used by the skilled-translator-poet. The old lexicon makes the style of Fan Noli extremely vivid. Without them, the speech would be not interesting. *The study shows that old words may* have a semantic equivalence which belongs to a special lexical and grammatical class that makes Fan Noli's language very attractive. Noli's *historicisms* are old words that represent an object, or a concept. They relate to different historical periods and today they are only used to present that period in a real way.

Later on, the study deals with Noli's *neologisms*. Neologisms can be defined as lexical units or existing units that carry new meaning/s. Neologisms are words or expressions that have recently entered the language to mark an item or a new phenomenon that still feels like that. Neologism is called a word, an expression, or phrase, a newly created term, which may be in the process of use but not yet accepted in the language.

New words are built with the subject matter of the native language. Words invented in vain, without support usually do not exist. The stylistic neologisms are built according to the productive patterns of the language. According to Peter Newmark, it has been stated that each language acquires 3000 words annually. In fact, neologisms cannot be accurately quantified. It is obvious that the number is increasing steeply.

They usually arise first in a response to a particular need. A majority of them have a single meaning and can therefore be translated alone, but many of them soon acquire new (and sometimes lose the old meaning) meanings.

Loan -words are also discussed in this work. They continue to develop and become part of the language, of the lexicon in which they enter and undergo historical conditions that determine the lexicon development of the language. Many of the loan -words used by Noli are from Latin, Greek or Turkish origin. The Greek-borrowed layer is among the earliest. The special use of orientalisms by Fan Noli often gives a biblical sorrowful atmosphere.

The work continues with *lexical archaisms*. The paper treats archaisms as archaic lexical units. It shows that lexical archaisms are archaic-words whose stylistic connotation and function show that they belong to a certain class of lexicon

The dissertation shows the spheres of their usage and stylistic functions. The work presents that Noli, as a great stylist, has enriched the lexicon with archaisms that reflect the culture and folklore of the Albanian language.

The study emphasises that Noli is a skilled-translator in selecting and in using lexical archaisms. It shows that archaisms may have a semantic equivalence that belongs to a special lexical and grammatical class.

Noli's lexicon is distinguished by its expressiveness, emotions and *figures of speech*. Figures of speech are treated in the fifth chapter. Writers realize and express in different forms of figures of speech. This depends on their creative individuality, on their genre, their artistic talent, their psychological, intellectual and emotional tendency.

Metaphors and metonymies as part of a textual structure, play a special role in understanding the meaning of the texts. In this context, they are defined as a structured whole, which represents a dialectical relation among linguistic, social linguistic and nonlinguistic structures, complex image of the reality, the situation, the facts, as well as the recipients and the givers of linguistic activity. Having into consideration the characteristics of literary texts, in our paper, we have searched the role of metaphors and metonymies in the works of the corpus under consideration. We would note that besides aesthetic values, they serve as a means of recognizing, thinking processes in the context of recognition.

Metonymies and metaphors are of great interest to study because not only do they demonstrate artistic/aesthetic values of the work, but they also serve as a means and marked way of unknown realities through familiar once, conceive peculiarities in each language. Their approach in different languages illuminates the differences in language models. Peter Newmark writes that metaphor is the figurative word, which may be one-word, or extended over any stretch of language from collocation to the whole text. Metonymy is a one-word image which replaces the 'object'. It may be a cliché, metaphor ('crown' as monarchy), recently standardised ('juggernaut', mastodon) or original ('sink' as hold-all receptacle). Metonymy includes synecdoche (i.e., the part for the whole, or the whole for the part) e.g., 'bottom' (boat) or 'army'(one soldier).

The translator-poet, **Fan Noli**, in his translation into Albanian language and in his own works, creates many metonymies and metaphors. They are unique and original sounding, as such they enrich the discourse on emotions and expressiveness. They also arise and make interesting images. It is exactly the construction and the operation of metonymies and metaphors in two parallel texts, in Shakespeare's original text and the translated version by **Noli**, that makes the subject of this chapter. Robert Dale Parker in his book "How to interpret Literature" writes that Jakobson claimed that metaphor dominates in a surrealist painting, and metonymy dominates in cubist painting; that metaphor dominates in romanticism and symbolism, while metonymy dominates in realism; and that metaphor dominates in poetry, while metonymy dominates in prose.

The dissertation ends with conclusions.

My research work will continue uninterruptedly to find other literary values of Noli, not only in Macbeth but in his translations or creations as well. I will continue to elaborate on many issues and phenomenon by doing more detailed analysis than those presented in the chapters of the dissertation. My Work will be continual, insistent, persistent, and permanent.

Key words: *Expressive lexicon, stylistic and expressive connotation, semantic consumption, semantic irradiation, semantic equality, semantic expansion, old words, loan words, archaism, neologisms, metaphors and metonymies.*

In this work we have used some abbreviations and symbols.

[N:15] = Fan Noli Makbethi Shqip.Tiranë 1943, f.15

[Sh:288]=Shakespeare, Great books of the Western World, Volume 2. 1952 Encyclopedia Britanica, Inc.p.288.

Notes: The number of pages changes.

Symbols:

= equal.

“ ” inverted commas.

() to limit or to give the Albanian or English equivalent.